

3 KI  
76

ΒΙΒΛΙΟΘΗΚΗ  
ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΟΥ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ



026000339930



3  
K  
H



# Zweihundert Jahre preussisches Königtum.

Volks- und Jugendschrift  
zur zweihundertjährigen Jubelfeier des preussischen Königtums

von

**Friedrich Polack,**

Kgl. Schulrat.

Mit einem Vorworte vom Kgl. Staatsminister D. Dr. Bosse.

Herausgegeben

von


**der Rheinischen Pestalozzi-Stiftung.**

Mit zahlreichen Bildern von A. v. Menzel, R. Krötel, H. Lüders,  
J. v. Kulas u. a.

**Berlin.**

Verlag von August Scherl G. m. b. H.





Botim i Drejtorís së Përgjithshme s' Arsimit

LIBR' I ARTE I SHQIPËRISË

# KRYENGRITJA SHQIPTARE

PREJ

## MIHAL GRAMENOS



Shtypshkronja G. Direttore & C.

VLORE



SHENJE  
MERITE, ATDHESIE E KALORESIE  
KETE LIBRE JA DEDIKONJ  
SHPETIMTARIT EDHE BURRIT MATH  
TE SHQIPERISE  
**AHMET ZOGUT**  
PRESIDENTIT PARE  
TE  
REPUBLIKES SHQIPTARE  
—  
BERESI  
**MIHAL GRAMENO**





AHMET ZOGU

Presidenti i Pare i Republikës Shqiptare





Më 1908 pas lirisë edhe proklamimit të Kon-  
shtutës, të Tyrqisë, pa si u-rëzuan edhe neve nga ma-  
let e Shqipërisë muarm lamtumirë njëri nga jatri, prej  
shoku shokut, edhe u-përndanë në për shtëpitë. Unë,  
dyke kujtuar që detyrat kundrejt atdheut nuk kanë  
kurrë të sosurë, u-mënjtuash që të shkruanë këto li-  
brë, pas shënimeve që kisha mbajtur nga malet me  
shpresë që do t'i shërbenj atdheut edhe do t'i sjell do-  
bi pritmes Shqiptare.

« Kryengritja Shqiptare », që ka emrin libri, është  
histori, e cila tregon qysh u-organizua i pari komi-  
tet kombëtar kryengritës, për lirin' e Shqipërisë, vë-  
prat të Komitetit, pësimet, vojtjet, ndjekjet edhe luftë-  
rat që bënë komitat Shqiptarë me ushtërinë Tyrke,  
gjer sa u dha liria më 1908.

Kur se kombi ynë fati ndodheshe në robëri, ishte  
edhe i dënuarë që të çkombësohet, pa e ndjere këtë  
gjëmë kage të madhe, të turpçme edhe të rezikçme, as  
pak fatzinjë Shqipëtarë! Nuku ishte shkaku i ndry-  
shimit fetar, midis Shqiptarëve, as përdorimi i for-  
cës, as i shka'lëve të nalta që u-jepnin, as dhelpërit,  
as shtrëngimiti maht, që përdornin armiqët, po ishte  
përdorimi i shkollës!

Me anën të shkollave përpiqeshin që t'i përçainë.  
t'i armiqësojnë, midis tyre. edhe më këtë mënyrë t'i  
çkombesojnë. Jo që t'u humbisnin gjuhën e tyre të  
nënës, jo; e dinin fort mirë që gjuha amtare nuk  
humbet lehtë, edhe aq më tepër në kombi Shqiptar,  
po ishte tjetër mënyrë. Në ato shkolla do të mëso-





heshin, pa dyshim, ne gjuhën e tyre edhe do t'i mësonin midis të tjerave historinë të kombeve të tyre.

Cili është aji prej Shqiptarëve, që ka gjyrmuar shkollat edhe nuku është çkombësuar ve'ëm e vetëm nga historia të mësonte, të armiqëvet të Shqipërisë? Që në krye, domethënë të foshnjërisë, të kllisnin dyke mësuar nga nonjë emër trimi, të cilit i vinin edhe fytyrën herojike, të veshur me lloji lloji pëtka edhe të armatosurë që në krye gjer në këmbë! Çunat e vegjel si edhe vajzat çudideshin me genjeshtrat e përallat trimnore. q'u tregonin mësonjësit e mësonjëset, edhe u mbeteshe për tëlë rënjosurë në zemrë. Dale gadale, pas të riturit të femijës, u shtonin këto mësimë gjer i kllisnin në për historitë plot me të rema edhe më von të vërteta, gjer arrinin çunat t'a kishin për turp të quheshin Shqiptarë! Edhe jo kaqe vetën; po riteshin më ndjenjat që një ditë të bëheshin edhe ata therorë, si trimat e historisë, për atdheun. po, për fat të zi, për një atdhe të huaj edhe armikë!

Sa djem prej kombit Shqiptar nuku janë bërë therorë dyke nderuar e xbukuruar faqet e historisë Tyrke, Greke, Serbe, Italiane edhe kombeve të tjerë? Edhe sa e sa nuku janë vrarë midis tyre, vëlla me vëlla, për kombet e huaj, nga shkaku se kishin humbur ndjenjat komkëtare edhe pandeheshin si ca armiqë të pa nginjur? Shumë edhe shumë shkuan më kot më anën të shkollavet, po veçanërisht me anën të historisë, të cilën e thëthinin të rinjtë Shqiptarë!

Në të këtillë gjendje kisha arrirë, edhe unë kur si nga Zoti më dërgojnë librin të të pavdekurit patriot Vasil Dhimitri Russit, nga Romania, të shkruarë shqip me shkronja të ndryshme. Zura gadale të leçit edhe shekonja që sikur më hiqte një magnet që t'e leçit fare e të ndjenj një ëmbëlsinë të madhe dyke kupëtuar ç'do që shkruante. Më gëzim të math, mora librin t'ua tregonj e bashkënxënëzvet, të cilët mbetnë të habitur kur panë që paska libra edhe në gjuhën shqipe.



Gëzimin tonë deshnim t'ja çfaqnim edhe Direktorit e mësonjësit tonë Dhjamantiut, Grek, i cili na qërtojti ashpërisht dyke thënë që është mekat edhe kurrë mos zemë të këtilla libra me dorë. Lumtërisht, përveç meje, zuri rënjë ndjenja kombëtare edhe në shumë bashkënxënës, nga të cilët sjell nër mënt Nuçi Buzon, Kristo Floqin, Foqion Dr. Turtulli, Thoma Avramin, Spiro Duçin etj, kështu që pastaje e kishim për turp që të mos quheshim Shqiptarë! Në 1885 shkova për në Romani edh'atje gjeta fushën të hapur për të xvëlluar e punuar 40 vjet, gjer sot, për rë shenjtin qëllim të atdheut t'im të shtrenjtë.

Këto më shtytinë që të shkruanj e botonj librin « Kryengritja Shqiptare », historinë të vërtetë, të levizjes për lirin' e Shqipërisë, që të mësojnë të rinjtë ndjekjet, vojtjet, burgimet e gjithë të këqiat që kanë hequr vëllezërit edhe atrit e tyre, për të arrirë me therorira të mëdha ditën e sotme, ditën e shenjtë që të valonjë flamuri dykrenor kombëtar mbi Republikën Shqipëtare!

Siç thamë. në krye, dorëshkrimin e pata shkrojtur më 1908 edhe prisnja kohën që t'a shtyp, përjashta, kur se përsëri Tyrgit zunë ndjekjet kundra kombit Shqipëtar. Ju pregatit më prapë kryengritjes po, nga shkaku i baskenevet të përditëshme që më bënin, dorëshkrimin ja dhashë një kushëriri, Vikës P. Llogorit, që t'a fshehë në shtëpi të saj. Mjerisht pas kryengritjeve ngjajti lufta Ballkanike edhe pastaj shkelja e Shqipërisë edhe kësisoj u-përçamë dyke marë muaxhirllëkun. Unë bashkë me gjithë fëmijën u-hohtëmë në Amerikë edhe kushërira në Bullgari.

Që nga Amerika i shkrojta kushërirës në Bullgari, po nuku e silltë nër mënt për librin, kështu që e pandenja të humbur këtë thesar, për historinë kombëtare, kur vjet për fat ardhni Vika nga Bullgaria edhe dyke kërkuar midis plaçkavet gjeti dorëshkrimin. Sa gëzim që ndjeva është e pamundurë që t'a tregoj. Desha me vrap që t'a botonj po një sëmundje më



hodhi në shtrat, ku ndenja 9 muaj pa parë djellin më sy. Me gjithë sëmundjen mëndjen e kisha tek libri edhe me ndihmën të a'dhetarit vyer Dr. Satih R. Zavalani që vuri gjithë shkëncësinë për shërimin t' im kombëtarisht d. m. th pa pagerë, shkrojta gadale edhe vëllimin të 2<sup>u</sup> me qënë e perzjerë në kryengritjet, që pasuan edhe mora anë në të gjitha.

Ndiku dystroji që mësonjësit, nxënësit edhe përgjithërisht gjithë Shqiptarët do t'a pelqejnë këtë histori kombëtare, « Kryengritja Shqiptare », pa verejtur gabimet orthografike, të metal edhe fujet për të cilat u kërkoni ndjesë me qënë që kaqë është fuqia t'ime.

Vetëm u lutem gjithë Shqiptarëve, dyke nisur që nga Kryetari i s'itetit e gj r në i fundit, që të mos u mungonjë kurrë këjo librë nga shtëpia dyke ua lënë trashëgim fëmijës tyre edhe te mësojnë rjedhjet të historisë kombëtare gjer u proklamua Republika Shqiptare edhe të ketë të Parin President Ahmet Zogun, shpëtimtarin edhe burrin të math të Shqipërisë!

Mbaruar më 17 Maj 1925, në Korçë.

Bërësi

**Mihal Grameno**



**VELLIMI I I.**





Nga Baballarët e Kombit

**NAIM FRASHERI 1846-1900**





TRIMI KOMB TAR  
Themistokli Gërmëni





**PANDELI VANGJEL SHALESI**

**Nga Punëtorët e Shqipërisë**





CERCIS TOPULLI

MIHAL GRAMENO







## KRYE E I.

Më 1907, në muaj të Prillit, një anije me pëlhurë iqtë verejtjen të gjindjes të Brindisit, qytet i Italisë, në deti Adriatik. Këjo anie kishte ca ditë që vërtiteshe në ujrat të Brindisit edhe nga lëvizjet që bënte epte dyshim që një qëllim të fshehtë gjyrmonte. Edhe me të vërtet po të gjyrmonjë, për së afërmi Kapitanë të anijes, kur delte përjashta natënë, do të kupëtonjë qëllimin e tij.

Kapitani ishte një burrë mesatar, i thatë, mustaqet të mëdha e të verdha, robat e tij ishin gegënishte, nga të cilat kupëtonjë që ishte Shqipëtar. Në pyetjet, nga ç'vënt je, Ahmeti, siç qulleshë kapitani anijes, psherëtime edhe dyke mbushur sytë me lote përgjigjeshë: nga Ylqini! Këjo pyetje i pikëllonte zemrën të mjerit Ahmet se me syt' e tij kishte parë kur qyteti i tij lindjak, i bukuri Ylqin, kishte rënë në dorë të Malit Zi, më 1878.

Një natë kur qetësia zotëronte në qytet, një vërshëllim dëgjonet ndanë detit edhe pas pakë kohe lopatat fëshëllenin në det dyke sjellë një barkë në drejtim që ku kishte dalë vërshëllimi.

Me të u afruar barka jep parollen, edhe në përgjigje rëzonet Ahmeti, pastaj, si doli përjashta edhe haset me nëntë burra q' i kishin vërshëllyer, u thotë: të gjitha janë gati edhe me qënë që kemi kohë të mirë, është shumë mirë të nisemi që sonte.

Të lutemi Ahmet, i thotë një nga burrat, të na preç gjer nesër brëma me qënë që nuk jemi gati se nesër do të vejë ky Zotëni, dyke treguar një nga burrat, në Bari ku ka për të marë armëtë edhe nesër brëma sigtër do të nisemi.



Si kur të mos ishte qëllimi i shenjtëruar, [për të dashurën Shqipëri, thotë Ahmeti, do të mos u prisnja se duhet të besoni se Qeveria e këtushme zuri të dyshonjë e frikë kam mos pësojmë gjësendi. Tani edhe një ditë mbeti në mest, thotë i pari, e me emërin të Zotit as gjësendi do të mos pësojmë se kemi Perëndinë me vehte.

Ashtu goftë, thotë Ahmeti, po nesër brëma në këtë orë të jini gati, pastaj i ipi barkës edhe shkojti.

Si shkojti Ahmeti shkuan edhe burrat që pamë, të cilët me të u afruar në qytet u përndanë si cilido në Hotel të tij. Këta burra kishin ca ditë që kishin ardhur në Brindis edhe iqnin verejtjen të Brindis anëve, me qënë që dukeshin të huaj me mos kuvenduar as gjuben Italiane, edhe ishin përndarë në për Hotele e vetëm fshehtazi haseshin edhe bisedonin.

Burra t' anë, që tregojmë më sipër, nuku ishin të tjerë përveç se të parët kryengritës (komita) Shqipëtarë, të cilët ishin mbledhur në Brindis që të hidheshin në Shqipëri edhe të përpiqeshin për lirinë. Këta burra ishin Bajna edhe Çerçis Topulli, Veli be Klysyra, Zeman Mashkullori, Idris Jakova. Thanas Nasto, Naum Trebicka, Hasan Toleri edhe Mihal Gramenua.

Të nesërmet brëma, gjithë në atë orë, vjen Ahmeti edhe thotë që është gati së gjithash e me pëllura të hapura, prandaj të vrapojmë të shkuarët. Veli beu i cili kishte vajtur në Bari për armë, nu u u kthye po teligrafisi që në mëngjes do të jetë atje sigurisht, po Ahmeti me mos duruar vendosmë që të vinim neve në anie, q' atë brëma, e të prisnim atje gjer nesër Veli benë.

Kështu vendosmë edhe Çerçizi, Mihali, Idrizi, Zemani edhe Thanasi si muarm armët, fishekët, robat, të ngrënë edhe ç' duheshë për një udhëtim, kaqë të rezikshmë, rymë në barkë edhe për pakë kohë arrimë në anije.

Pritmë të nesërmet gjer më drekë po, mjerisht, Veli beu me shokët e tij, Naumnë edhe Hasanë, nu-



ku dukeshin edhe ishim në dëshpërim të math për një ngjarje të pa pandehur, kur Bajua na dërgon një letrë dyke na lajmëruar që Veli beu me shokët u pendua, kështu që neve u nisëm për në Shqipëri.

Bajua pas marrëveshjes që kishim bërë, edhe veçanërisht në lutjet e mija, qendrojti për çdo ngjarje edhe shkoi në Amerikë për të mbledhur ndihma.

Po më përpara se të nisemi, për në Shqipëri, besojmë të nevojshme që të tregojmë fillimin edhe organizimin të komitetit.

## KRYE E II.

### Fillimi i Komitetit

Më 1905 në qytet Manastir ndodheshe Nënëdirektor i Gjimnasios Turqishte Bajo Topulli, nga Gjino-kastra. Atje bëri të njojturë me shumë Shqipëtarë atdhetarë, me të cilët kuvendontë për gjendjen e tmeruar, në të cilën shkante kombi Shqipëtar. Asi kohe kishte arrirë në një dëshpërim të math, nga shkakku se qeveria Tyrke kërkonte me çdo mënyrë të çfarosurit të gjuhës shqipe, si dhe çdo përhapje të ndjenjave kombëtare midis Shqipëtarëve.

Më tjetër anë andarët Grekë, të organizuar në Greqi prej qeverisë Greke, u kishin shtënë tmerë popullit Shqipëtar me ndjekjet edhe vrasjet që vepëronin për dita, kundra tyre! Të mjerët Shqipëtarë gjithë shpresën e kishin varur tek Perëndia se as nonjë shenjë përmirësimi nuku dukeshë që gjëkund.

Që të gjithë pra e ndjenin rezikun të math edhe që të gjithë dëshëronin një organizim komiteti, për mprojtjen të kombit, po, mjerisht, as nonjë nuku guxonte të çfaqte këtë menjtim, me qënë që kishte arrirë koha sa të druhet vëllaj nga vëllaj i vet! Ajo kohë tiranike, e Hamitit kuq, nuku ka edhe as që do të ketë shëmbëll në histori.

Bajo Topulli më guximtar, nga të tjerët, i çfaqet



më përpara Feim be Zavalanit pastaj së bashku u çfaqin menjtëherë Gjorgji Qirjazit, Jashar Bidinckes, Nuçi Naçit, Riza be Velçishtit, Grigor Cilikës, Qani be Ypit, Sejfi Vellamesit edhe kësisoj, pasi e pritnë me gëzim të math që të gjithë, vendosnë edhe filluan të parin Komitet Shqipëtar, me program kryengritëse.


Komiteti zuri të punonjë edhe të përhapet me çape të mëdha dyke formuar degë edhe dyke bërë anëtarë. Për këtë qëllim Bajua vajti në Korçë edhe në Kolonjë ku fillojti degë të reja, kështu që për dita shtoneshin anëtarët.

Qëllimi i komitetit ishte që të përhapet e të forconet mirë edhe pastaj të zinte nga vepërimi, mirëpo qeveria Tyrke zuri të marrë erë për një lëvizje të Shqipëtarëve, andaj kërkonte me gjithë fuqi të xbulonte qëndrën, fillimin si edhe programin të komitetit Shqipëtar.

Nga ky shkak si edhe nga vrasja e tmeruar, të andarëve Greke, në Negovan, mbi patriotin të math, Papa Kriston bashkë me vëllan' e tij Papa Theodhosin vendosnë që të zënë nga vepërimi, pa u arrirë pema mirë. Me 23 të Marsit 1906 Bajua me Riza Velçishtin, me nxënësit të Gjimnasios Qamil Panariti, Pertef be Rusi edhe Selim be Pojanin lenë qytetin Manastir edhe shkuan në Kolonjë dyke i bashkuar edhe Hysen be Dishnica gjer atje.

Në Kolonjë, si bashkonen me Qani be Starjen Ypin edhe me të tjerë, zunë nga vepërimi dyke formuar çeta komitash edhe t'i regullojnë. Përnjëherësh u përhap fama në Europë edhe në Shqipëri kështu që prisnin të gjithë, me pa durim, të shohin Hoxhen — siç e quanin Bajo Topullin — edhe të bashkoneshin me atë. Qeveria Tyrke zuri ndjekjet edhe Fehim be Zavalanin e bënë syrgjyn në Akri të Sirisë, e të tjerë gjektë.

Po për fat të keq zunë e dhelpëritë — të cilat kanë prishur kurdherë Shqipërinë — edhe bintnë nxënësit që të falen prandaj Bajoja shkojti në Gjinokas-



trë për të filluar degë edhe për të mbledhur shokë e Qani beu Starja me Riza benë mbetnë në Kolonjë gjer të ktheneshe Bajua.

Kur këto ngjishnin në Shqipëri dyke marë një bujo të madhe emri i Hoxhës, i pa lodhuri atdhetar, Grigor Cilka. ngrihet prej Korçe edhe hidhet në Sofje, të Bullgarisë, e në Bukuresht për të organizuar Shqipëtarët e atjeshmë, pas programit të komitetit. Të gjithë e pritnë me gëzim të math lëvizjen kombëtare, pastaj si u filluan me degë zunë të mledhin ndihna për komitetin.

Në Bukuresht kryesinë të veprimit e kishin marë Pandeli Vangjel Shalesi, Vasil I. Zografi, Rafail Shulle, Andre Alilozi, Mihal Grameno, Pandeli Durmishi edhe të tjerë, të cilëvet na shpëtojnë emrat. Edhe në Misir ishin formuar degë në kryesi të Thanas Tashkos, Jani Vruhosh e Milo Duçit.

Në këtë kohë tri djem të rinj, Lambi Bimbli, Kole Rikashi edhe Miçe Papanastas, të mbushun plot ndjenja patriotike ngrihen që nga Amerika, ku jetonin, edhe venë në Sofje për të u-bedhur në Shqipëri. Mjerisht, me gjithë përpjekjet të komitetit Sofjes, nuku muntnë të hidhen dot, nga koha e shkuarë, kështu që u shtrënguan të kthenen prapë për në Amerikë se dimëri afroneshe edhe nga të hollat vinin në shtrëngim.

Gazetat e Europës zunë të shkruajnë gjër e gjatë, për mbi lëvizjen të Shqipëtarëve, edhe t' u tregojnë një simpathi të madhe, po, pa shkuarë shumë kohë, Qani be Starja bindet në këshillat e miqve faqezinj edhe i falet qeverisë Tyrke, e cilla pas pakë kohë e burgosi në Manastir edhe hoqi të këqijat gjer sa u dha lirija. Riza Velçishti me pakë shokë qëndron si burrat edhe vepëron në Kolonjë edhe në Shqëri midis Përmetit e Leskovikut.

Bajua kur u kthye prej Gjinokastre edhe mësojti ngjarjet u helmua pa masë, po si trim që ishte zuri nga vepërimet. Në Gjinokastrë fillojti një degë edhe mori mo vehte vëllan' e tij Qerçizin, Zeman Mashku-



Ilorin, edhe ca të tjerë. Me mos mundur të bashkonen as me Riza Velçishtin hidhen në qarket të Korçës e të Devollit, ku përhapnin levizjen kombëtare. Në këta vënde u shoqëruan edhe me Fejzo be Dishnicën e Apostoll Plasën, kështu që u bënë 11 shpirt.

Në këtë kohë andarët Grekë tmeronin popullin, fort shumë, si edhe grekomanët kishin zënë një ndjekje të reptë kundra Shqipëtarëve kombëtarë. dyke pa-tur-qeverinë ndihmëse, prandaj u vendos prej komite-tit që të vepëronet një goditje. Pas shumë pritave q'i kishin bërë Karavangjelit, Dhespotit Kosturit, e nuku e shtiuin dot në dorë fat' i zi dënojti që të vritet i ndyeri Foti, Dhespot i Korçës, për mbi Bradvicë më 9 të Shtatorit 1906.

Si u vra Dhespoti, Foti, një ndjekje e reptë zuri qeveria kundra komitave Shqipëtarë si edhe kundra kombëtarvet. Zunë edhe burgjimet me dyzina midis të cilvet Jovan Kosturin bashkë me fëmijën, Salih Butkën, Grigor Cilkën, Ohran be Pojanin, Ibrahim qesarakën, sot Baba i Teqesë, Lazo Progrin e shumë të tjerë.

Fejzi be Alizoti, Qeveritar i Korçës, përpiqet me çdo mënyrë që të binteje Bajon për të falur, dyke ju zotuar një nënëpunësi më të madhe, në qeveri, po si pa që Bajua nuku bindet i dërgojti fjalë që të largonet nga Mytesariflleku i tij, se ndryshe do t'a ndjekë këmba këmbës. Bajua mblodhi shokët edhe si biseduan e gjetnë të udhës që të pranojnë këshillat të Fejzi beut, me tjetër anë zunë edhe shirat e pa-reshura, kështu, që vendosnë të hidhen në anët e Gjinokastrës edhe Bajua të shkonjë në Europë për të mbledhur ndihma.

Fezo be Dishnica me tri shokë Devollinj qëndruan në qarkun të Korçës edhe Devollit, e Bajua me shokët e tjerë shkuan për të kërkuar Riza Velçishtin, po si nuku e gjetnë dot shkuan për në Gjinokastrë. Atje u ishte thënë që t' i ndjekë fat' i lik me qënë se u përndanë, si zoqt' e korbit, njëri nga jatri. Shkaku




i përndavjes rodhi se Bajua me Çerçizin rynë në Gjinnokastrë për të regulluar shtëpinë, me qënë që gjithë vëllezërit e tyre ishin burgosur, edhe të marin gjesendi të holla se kishin mbetur pa nonjë para në xhëp, sa për shokët i siguruan në malet ku u dërgonin të ngrënë edhe të nevojshmet.

Një brëma vendosi edhe Abdyl Mersini, i cili ishte më i zoti edhe më i mësuari në ato vende, të shkonjë në Kardhiq, fshat'i ti, e kësisoj mbetnë Apostoli, Zemani, Hasan Nikolica, Malo Çami edhe Rapo Mashkullori pa patur nonjë kryetar kur, një natë Rapo Mashkullori u vjeth armët Apostolit edhe Zemanit e shkon fshehtazi! Kur u xgjuan shokët, edhe shohin ngjarjen të pa pritur, u tmernan dyke pandehur nonjë trathëti prandaj vendosnë të shkojnë dyke marë edhe Zemanë që t' u tregonjë udhën, gjer më tutje.

Mbetur i vetëm, i gjori Zeman, kthenet për në Gjinnokastrë që të lajmëronjë Bajon dhe Çerçizin, për këtë ngjarje, po tjetër e keqe m' e madhe i rueshe Zemanit, se me ryrë në qytet e zunë kollxhinjtë (ruajtësit) të duhanit edhe do t' a shpinin në Policie, po lumtërisht ishte kryekollxhi Raifi, kushëri me Topullenjët, edhe kështu e lanë të lirë e të vejë në shtëpi të Bajos.

Kur mësuan ngjarjen Bajua me Çerçizin u bren-gosnë tepër edhe kaqë u dëshpëruan sa, pa shkuar nër mënt rezikun, duall të armatosur ditën, për mes qytetit, që të kërkojnë shokët e çakërdisur. Si kërkuan më gjithë anëtë, pa gjetur as nonjë shenjë, u ktkyen natën në shtëpi të tyre dyke mallkuar fatin. Pa dyshim që çdo e ndenjurrë, në Gjinnokastrë, ishte një rëzik i math për ata, se u xbuluan andaj vendosnë të shkojnë që të tre në Sofje të Bullgarisë për të dimëruar.

Të nesërmet, si muar lamtumirë shkuan në Palavli, pranë Delvinës, në kombëtari Nazif Aderi i cili i priti me gëzim të math. Si ndejnë ca dit, gjer sa arriti një vapor Austriak, me përpjekjet të Nazilit rynë në vapor edhe duall në Kotor, pastaj, si u veshnë me roba qytetnore, shkuan në Sofje ku atdhetarët e atjeshmë i






pritnë me një gëzim të math. Si ndejnë ca kohë, në Sofje, Bajua me Çerçizin ardhë në Bukuresht ku atdhetarët i pritnë me gëzim të math. Në këtë kohë ardhni lajmeja e zezë për vrasjen të Spiro Kosturit, në Selanik, edhe u helmuan që të gjithë atdhetarët, me qënë që këjo vrasje kishte karakter politik se Grekrit goditnin atje ku u dhembeshe Shqipëtarëve. Bajua nuk u ndenji shumë kohë, në Bukuresht, me qënë që e kërkonte Aladroja Kastrioti edhe shkoi në Paris.

Asi kohe ndodhesha edhe unë, autori i kësaj libre, në Romani prej 20 vjet që jetonja, ikur që i vogël prej atdheut, edhe q' atëhere rym në luftë kombëtare, prandaj kur ardhni Bajua me Çerçizin zemra më qante edhe rihete pa prerë që të munt t' i shërbenj atdheut edhe me pushkë në dorë, po mjerisht isha i dobët nga fuqia edhe i pa i stërvitur, se kurrë gjer atëhere nuku kisha ngjitur male në këmbë. Me gjithë këtë çdo ndryshim i këtij menjtimi ishte i kottë, se më hante mu-shkërinë, prandaj ju luta Bajos të më merrin e mua kur të delnin, përsëri, dyke i thënë që do të jem i lumtur të vdes në shkëmbinjt' e Shqipërisë.

Bajua dyshonte në fjalën time aqë më tepër se më shinte të mësuar në prehje, edhe më tjetër anë shumë veta ishin zotuar vetëm, prandaj më thotë që Shqipëria është e gjithë Shqipëtarëvet, kështu që në dëshëronj në Mars të ndodhem në Sofje të Bullgarisë. Ditët më dukeshin muaj gjer sa ardhni Marsi edhe shkova me vrap në Sofje ku si u mblotimë të gjithë shkuan për në Brindis, përveç Vasil Trebickës të cilin e dërguan në Korçë, për të marrë gjakun të Spiro Kosturit, po komiteti i Korçës e ndalojti të bënjë një goditje se qeveria Tyrke do të mundonte kombëtarët.

Po më përpara se të arrimë në Brindis hoqmë mjaft udhës se në Zejmun, kufi i Maxharisë me Serbinë, na ndalojti komiseri. një bark zhabë edhe i lik, edhe na kthen në Beligrad. Në Beligrad policia e stacionit na dërgon me xhardërma në Prefekturë dyke ngrënë, unë, udhës ca kondakë mbi kuris, kur desha.




të pinja një rugës. Atje na pyesin edhe u thomi që jemi nisur për në Amerikë, po nuku deshmim të na besonin, e kështu urdhruan që të na burgosin edhe të lajmërojnë Ambasadën e Tyrqisë që të dërgonjë njeri. Kur dëgjuam për këtë u tmeruam po duruam të shohim fundin, se nuku kishim ç' të bënim.

Nuku shkojti shumë kohë kur se dy nënëpunës bashkë me një dragoman, të Ambasadës Tyrke, edhe na nxjerin nga podrumi ku na kishin kallur pastaj na pyesin Tyrqisht nga jemi edhe ku vemi. Çerçizi, me qënë që Bajua me Shahin Kolonjën shkuan nga Zejmuni për në Vienë, u thotë Tyrqisht që le të pyesin qeverinë Sërbe, për këtë, kështu që si u lajmëruan na thonë me ashpërim se do të na dërgojnë në Tyrqi.

Për fat unë kisha një pashaportë të vjetër, prej të Romanisë, edhe u thom që unë nuku e njoh Tyrqinë se jam subjek i M. T. Karolit. Kur panë pashaportin u panë në sy edhe më thonë që ti je lindur në Tyrqi po unë u përgjigja që kam ikur i vogël edhe në Romani kam shërbyer në ushtëri edhe fitova të drejtat, kështu që me vrap mua më liruan Sërbët, edhe Çerçizi, Idrizi edhe Zemani mbetnë të burgosur gjer të bëheshin aktet e dhura edhe t' i jepnin në dorë të Ambasadës, për të i dërguar në Tyrqi.

I liruar dal në qytet edhe hasem me Thanasin, të cilin nuku e burgosnë se rëfeu pashaportin që në krye, edhe të përpiqemi për shokët, andej këtej. Për fat gjetmë atdhetarin Aleksandri Balltadorin, në Beligradë, i cili na rekomandojti ne Z. Naum Kristof, një patriot Bullgar, kështu që së bashku lajmëruam Ambasadat të Italisë, Austrisë edhe Romanisë nga të cilët mësuam që shokët tanë të thonë se nuku jepen në Tyrqi me qënë të ikur për politikë.

Lajmërova shokët, në burg, edhe të nesërmet kur u thonë të bëhen gati se do t' i dërgojnë në Tyrqi, këta përgjigjen që nuku venë në Tyrqi, me qënë të ikur për shkakë politike, kështu që u shtrënguan të na kthejnë me xhandërma në kufi të Bullgarisë. Për



këtë ngjarje prisha unë shumë të holla, se shokët nuk kishin pa u gëzuam kur arrimë në Sofje edhe shpëtuam pa u dorëzuar në Tyrqi.

Në Sofje u bashkuam edhe me Bajon, të kthyer nga Viena, teligrafisht, pastaj ndejmë edhe ca kohë në Sofje gjer u përgatitëm se rish për të ikur. Le të mos harojmë shërbimet edhe përpjekjet të atdhetarëve Shahin Kolonja, Kristo Luarasi, Dhimitër Mole edhe Adem Shkaba, të cilët ishin zemra e lëvizjes kombëtare në Bullgari. Kur na kthyen nga Beligradi Kristo Luarasi na mhafti në shtëpi të tij edhe Dhimitri Moleja na dërgojti 2,000 franga nga Filibeja.

Si muam ca pashaporti të rena, për shokët, shkuam në Brinlis edhe q'atje, siç thamë, me anijen të Ahmet Ylqinit për në Shqipëri.


### KRYE E III.

## Nisja për në Shqipëri

Të shtunë pas dreke, më 16 Maj, përhapin pëlhurat të anijes edhe Ahmeti, kapitani ynë, urdhëron: djema gati! Përnjëresh anija mori udhën edhe neve ja krisëm këngës për mëmëdhenë! për mëmëdhenë! të cilë e kisha bërë unë edhe ja kisha dedikuar Bajos.

Me gjithë që ishim kaqë të pakët zemrat tona ishin shumë të gëzuara e plot shpresa, dyke pandehur që gjithë këjo botë ishte krijuar vetëm edhe vetëm për neve! Kur zari që të ngryset na thotë Ahmeti që do të kemi furtunë o djema, e kësaj do të mos mundim të dalëm në stere, siç e pandehnim.

Ahmeti ynë sikur ishte nonjë Flamaryon i dytë, nuk shkoi shumë kohë kur zari një furtunë e marë. Për mbi 36 orë lëftuan, pa reshtur, Ahmeti me shokët e tij kundra atyreve valë që përpiqeshin të na përfshinin! Me mundime të mëdha shumë e dyke udhëtuar siç na losnin valët, dyke u gdhirë e henë e pa nisur që të hapet dita, arrimë në një vënt e na



thotë Ahmeti: këtu është mirë që të delni përjashta, me qënë që, pas shenjave të kohës, duhet të bëjmë shumë kohë gjer të arrimë pranë Sarandës, ku dëshëroni yve.


Neve, të dëshpëruar nga ky udhëtim, midis vdekjes, me të dëgjuar stere e pritme me gëzim të math këshillën e Ahmetit edhe duallmë në një vënt të huaj, të cilin as e dinim as e njihnim. Si nxuarm armët edhe plaçkat që kishim hipmë edhe neve në barkë edhe duallm në stere, si u puthmë me Ahmetin e shokët e tij, dyke lënë njëri tjetrit ndihmës Perëndinë.

Me të shkelur në një shurishtë të bardhë Qerçizi më thotë: gjunjëzo e puth dhenë të Shqipërisë o Mihal për të cilin të ka dëshëruarë edhe dëshëron zemra jote! E putha me mall edhe ju luta Perëndisë që në kishim të drejtë të na mpronte edhe të na ndihmonte. Ndejmë pakëzë të çlodhemi e të shihnim ku gjendeshim se, mjerisht, as nonjë prej nesh nuku e dinte këtë vënt. Kur zuri të xbardhullohet dita ngarkohemi me trajstat, në të cilat kishim nga 500 fishekë, si cilido, edhe të ngrënat pastaj, si muarmë armët, muarmë të përpjetën e malevet.

Për mua ishte e para herë që ngjitesha në male, pa edhe çfarë male?! Të lartë, të dëndur edhe me shkëmbinj të mdhëdhënj dukeshin pa funt. Shokët ishin të mësuar edhe ngjiteshin pa mundim, po unë me Idriz Jakovën ecnim gadale edhe më tepër me duar edhe këmbë, se kishim frikë mos rukulliseshim, në përenjtë pa funt, edhe bëheshim copë copë!

O burrani, o burrani, bertiste Qerçizi, mos u druan po shkelni pa frikë edhe lehtë se, siç eçni yve, lodhi shumë, po cilit munt t' i nxirrije frikën? Arrinte vetëm një e hedhur sytë tatëpjetë të na ngrihshin leshrat përpjetë edhe nga tmeri të na mereshin mëntë e të gjenim fundin.

I gjori, i shtrenjti i pa lodhuri edhe fort i dashuri Zëman Mashkullori! Ky ishte nëna e çetës tonë. I papërtuar edh' i parënduar do të rinte pranë nesh që



të na jepte ndihmën e tij për çdo nevojë. Herë herë na mirte trajstat, herë paltonet edhe shumë herë na ngarkonte mbi kuris, të tij, për të kapërxyer nonjë udhë, të cilën as dhitë nuku e kapërxyenin pa u drojturë.

Zemani ishte prikosurë me një karakter të pashëm-bëlltë. I urtë, i qeshur, i dashur edhe trim pa shëm-bëll; ishte m' i shkuari nga gjithë shokët, po, përveç këtyreve dhuretira, ishte edhe babo. Zemani do të na shtypte koskat edhe do të na fërkonte barkun edhe ngrinte pishqet sa herë që sëmureshim. Sa kohë që bë-më në malet si edhe perjashta, pas lirisë, kurrë nuku e pashë Zemanë që të zemërohet po, për kundrazi, me gëzim të math kërkonte që qysh edhe qysh t' i kënaq-te të gjithë me buzën e tij të qeshurë.

Kur bjerë andej ku këtej u ngjitmë në mal edhe atëhere zuri të hapet mirë dita, po, me gjithë këtë, nuku kupëtonim se ku ndodheshim kur, për fat, shohim me teiqyre (dylbi) një bari i cili kullote bagëtinë. Qerçizi vrapon tek bariu edhe si përsëndoshen e pyet ku ndodheshim e cilat ishin rugat që dëshëronim neve. Si lajmërohet Qerçizi kthenet, i helmuar, dyke thënë që të rëzohemi prapë se ruga që kishim marë na nxir-te për në Vlorë.

Rëzohemi edhe limerjasmë atë ditë në ca lisa ku ishte një burim i ftohtë. Me të perënduar djelli mu-arm rugën të një fshati, që ishte pranë, kur fati na nxori një çoban nga Myzeqeja, i qojtur Ilo, i cili ishte shërbëtor në atë fshat edhe ktheneshe me mushkat në shtëpi. Kuvënduam e na thotë që ishte i pa kënaqur nga i zoti, andaj në pyetjet tona në dëshëronte të bashkoneshe me neve e priti me gëzim të math, kështu që si shpuri mushkat u kthye edhe shkuam, errëtë, midis fshatit.

Ky fshat quhet Vermik edhe është nga fshatrat e Himarës. Që të stolis edhe zugrafis bukurinë të Bregdetit me fshatrat rreth tij, më është një pun' e kottë, me qënë që natyra i ka prikosurë me bukurira të ve-



çanta. Të xbukuronj rëketë, malet me ato shkëmbinj, fshatrat gjithë monë të gjelbëruara me ullinj, portokalë, limonj, fiq, qitra, shegë edhe gjithë lulëzimet e tjera, ose të tregonj bukurinë të gjindjes, të Bregdetit, për gjimin edhe trimëriu e tyre?

Reviera, me San Remon, Mentone, Monte-Karlon, Monakon, Nisen e të tjera, nuku ka as nonjë ndryshim nga Bregdeti, i Shqipërisë, kur një ditë janë për të u ndërtuar edhe vëndet të Bregdetit siç janë këto.

Shkuam dyke ecur gjithë natën kur shohim që do të na zinte dita, pa zënë nonjë limer, andaj vendosmë që të mbyllemi në një kishë të vogël përjashta fshatit, Vunosë dyke besuar që as njëri nuku vjen atje. Ry-më brenda edhe ranë gjithë shokët të flenë veç meje, i cili i lodhur edhe i dirsur po rinja e thëthinja një cingare si edhe për të u mprojtur nga çdo rezik.

Nuku shkojti shumë kohë kur dera hapet edhe ryn prifti me një grua për të meshuar. Prifti bashkë me gruan në vënt që të trembeshin u tremba unë edhe desha të xgjonj shokët, kur prifti më ndalon duke më thënë: Ieri të flenë se janë të lodhur. Kur zumë të përshëndosheshim xgjohen shokët nga gjumi edhe i thomi që kemi ikur nga ushtëria po prifti nuku besojti e na thotë që çfarëdo që të jini mos kini nonjë frikë, pastaj, si mbarojti nga të meshuarit, na ndau meshën që mori edhe na bëri nga një kafe në një qoshe të kishës. Me të ikur i dhamë të holla dyke ju lutur të na blinte ca duhan e të ngrëna, të cilat na i dërgojti me priftëreshën.

Pas nja tre orë rëzohen prej fshatit 10 fshatarë, midis cilëvet ishte edhe një kapitan avullore, i quajtur Ilo, me të cilin ishim njojtur në Brindis, po nuku i ishim çfaqur. Përshëndoshemi pastaj zumë t'u tregojmë cilët ishim edhe qëllimin t' onë. Ca nga këta kishin ndjenja kombëtare, mbjellë prej Petros Fotografit nga Korça, andaj u dhamë edhe mjaft libra për të lëçitur.

Me të perënduar djelli shkuam, si na gostitnë shu-




më mirë, me një udhëtrëgonjës që na dhanë, pa si mu-  
arm lamtumirë edhe u falënderuam për pritjen që na  
benë. Dyke udhëtuar ato ripa edhe rëkera, të Qimarës  
arrimë më të gdhirë në Pilur, ku limerjasmë në një  
pyll, e q' atje udhëtuaam natën edhe arrimë në Kuç.  
Kuçi është historik me qënë që në këtë fshat është  
lindur Gjoleka, një kryengritës trim, të cilit edhe sot  
i këndohen këngë, Labërishte, për trimërin' e tij.

Në Kuç dërguam Ilo çobanë tek Birçoja, një mik  
i Çerçizit që të vinjë të haset me neve edhe të na si-  
llëte gjësendi për të ngrënë. Birçoja vjen i bashkuar  
me një shokun e tij dyke na sjellë të ngrëna po na  
lajmëron që ushtëria e përndarë na ka zënë gjithë ru-  
gët, prandaj na këshillon që të limerjasem në një pyll  
edhe me të u ngrysur mirë të shkojmë, ververisht maleve.

Këshillat të mikut tonë, Birço, i pranuaam edhe  
vamë në një pyll të dendur shumë, që ku vërenim ush-  
tarët kur brithnin posht e lart për të na kërkuar ne-  
ve. Në këtë pyll na gjajti një gjëmë fort e ligë. Kur  
shokët flinin unë me Ilo Çobanin po fshinin pushkat  
edhe mësoheshim qysh t' i përdornim, po, mjerisht, ky  
mësim u bë mbi kuris të Ilos se gabimisht pushka  
time zbrazet edhe godit Ilon në vithrat! Shokët xgjo-  
hen edhe rëmbejnë armët dyke pandehur ushtërinë, po  
u tregoj i helmuar edhe i tmeruar, fajin që kisha bë-  
jë. Me vrap xbulojmë Ilon edhe si e pamë që plaga  
ishte pa nonjë dëm ja lithmë. Sa për ilaç ishte shura  
t' onë, se barat që kishim marrë na i mbajtne në kufi  
të Austrisë.

Në jetë time nuk kam ndjerë më të math helm  
edhe hidhërim se t' asaj dite kur plagosa Ilon. Nuku  
pas'ka më të keqe se të bëhesh shokvrasës! Mirë po  
ay gabim m' u bë një mësim i math që të vërenja push-  
kën tjetër herë.

Gjithë atë ditë e shkuam të brengosur me nj' anë  
për Ilon edhe më tjetër anë se kishim mbetur pa të  
ngrëna, me gjithë këto më të u ngrysur dualëm prej  
pyllit edhe vinim në stan të Birços, që na kishte tre-



guar, po kur njerjesh shohim që Iloja nuku ishte gje-kundi. Bertit edhe kërko, me gjithë anëtë, po Iloja kish marë pushkën edhe kish shkuar. Atëhere mallko-va dorën që nuku e mori mirë se ky vajti që nga pylli në ushtëtarët dyke treguar për neve që e muarm me pahir Birçon, priftin edhe fshatarët të Vunosë, të cilët ndejnë nga një vit të burgosur në Gjinokastrë.

Si e mblohmë mëndjen për Ilon muarm të për-pjetën e maleve, pa nonjë udhë, ca male të lartë shu-më, plot shkëmbinj të thatë pa nonjë pikë ujë, kështu që tani përveç urisë, vuanim edhe nga etja. Dirsët na shkonin çurkë si lumë edhe mernim e thëthinim dhë-në për të shuar etjen. Atëhere u ndodha në një shtrën-gim të math edhe, i dëshpëruar, ngrita sytë në qell dyke bërtitur: Aman o Perëndi i Shqipërisë vdiqmë për ujë! Si për çudi më dëgjojt lutjen Përëndia, se i mjeri Zeman i cili vente në për shkëmbinjte, për të gjetur ujë, bërtet: vraponi se gjeta ujë!

Atë gëzim që ndjemë nuku di qysh t'a tregonj munt që të barabitet si një shpëtim nga vdekja. Kish-te gjetur një lis të math të cilin e kishin shpuar edhe bërë gropë, barinjte, për të u mbledhur ujët kur binte shi. Vrapuam edhe si pimë ujë muarm vehten, se ishim fare të drobitur, pastaj zumë udhëtimin. Me të gdhirë arrimë në një stan, ku i zoti me gruan e tij na shtruan të hamë. Me një shijë të pa treguar hëngrëm atë mën-j-gjes pastaj, si n'çelohmë mirë, shkuam dyke falënde-ruar të zotërit e stanit për mirë pritjen.

Q' atje shkuam në malet e Golemit po, dyke pa-rë që vinte në atë rugë një ushtëri e vogëlë, kthyem udhën edhe duallmë në një stan ndanë një lumi. Nga gjithë stanet që vizituam sa kohë që bëmë malevet, ky stan do të më mbetet një kujtim i paharuar, me qënë që ishte ngritur ne një vënt pitoresk, që nuku rëfchet. Një lumë shkonte midis dy pyeve të veshur, një nisi e vogëlë e rethuarë prej lumit edhe kundrejt nisis ishte stani, kështu që bënin një pamje nga më të bukurat, dyke kujtuar brëmanet kur rëzoheshin bagëtia për të





mjelë. Në këtë stan gjetmë vetëm të zonjën e cila na priti e gostiti me dhallë edhe me kos e ndejmë gjithë ditënë gjer ardhi i zoti me bagëtinë. Përshëndoshemi edhe me vrap porosit djemtë të na pjekin një qëngj të zgjedhur, kështu që na gostitnë si jo më mirë edhe pastaj na kallë në kasolle për të flejtur, dyke thënë të jemi të qetë se këmbë ushtari nuku shkelte atje, veç kësaj na tha që kurdoherë po të jemi në rezik të vemi në stan të tij për çdo siguri.

Besonj që është interesant të tregojmë me këtë rast, që gratë të Kurveleshit nuku mbulojnë fytyrat edhe punojnë bashkë me burrat e tyre në për stanet, në për arat edhe në çdo punë që të kenë. Flejtmë nja 3 orë, në buçim të lumit, edhe si u ngritëm shkuam bashkë me Demon, i zoti i stanit, për mest Kaparejt, fshat' i Demos, gjer arrimë në Zhulat, pastaj, si i falënderuam edhe një herë, mori lamtumirë edhe u kthye për në stan.

Në Zhulat e shkuam ditën në për ca repa edhe më të ngrysur shkuam për në Kardhiq, dyke limerjasur në ca gështenja.

Kardhiqi është një katunt fort i bukur, ngrehur për mbi një breg të fortë, ka një fortesë historike edhe është i rethuarë me male të lartë. Këtë katunt e ka prishur Ali Pasha edhe duken e sot gërmadhat e rëmyera. Ndejme tri dit në Kardhiq për të u çelodhur po më tepër që të mbatheshim me opinga se këpucet na ishin bërë copë copë prej gurëve.

Që këtej muarm grykën e mollës për të dalë në malet e Gjinokastrës. Kjo grykë është një grykë e larë edhe fort e ngushtë, kështu që as nonjë frikë nuku ke prej ushtërie me zënë vëndet e duhura. Këtu vravi Çerçizi një dele të egërë të cilën e kemi ngrënë pa kripë.

Në Gjinokastrë ndejmë tri dit, në Kala të Shen Triadhës, ku u bashkuam me shumë kombëtarë dyke biseduar që qysh edhe qyshë duhet vepëruar, gjer të përgatitim një lëvizje të përgjithëshme. Dëshnin mjaft



djema të bashkoheshin me neve po i ndaluam, me që-  
në që nuku deshnim të mirte qeveria masa të repta,  
kundra nesh, e me këtë mënyrë flinte, dyke marrë lë-  
vizjen tonë pa nonjë rëndësi. Si na solli nga gjithë ba-  
rërat (ilaçet) Besim Vesel Gega, shkuaam në Çajyp në  
stan të Raif Kerit, prej Gjinokastre.

Që nga Çajupi u hohtmë në Zagorie të Tepelenës  
edhe limerjasmë në një pyll, pranë Zheit, ku na ardhë  
ca gjatorë me të cilët kuvënduam gjër e gjatë. Me të  
perënduar djelli shkuaam në mal të Brezhanit, në stan  
të Dhimitraqit Spiros, ku na pritnë fort mirë me gjithë  
q'atë ditë i kish vdekur i ati Dhimitraqit. Si i lamë ngu-  
shëllimet tona, me barinjte, me të ngrysur u rëzuam  
në një tatëpjetë pranë Brezhanit, pastaj muarm anën  
e Viosës edhe arrimë në urë të Muços. (Tregut). Si u  
siguruam që rojtësit flinin edhe nuku kish nonjë rezik  
e kupërxyem edhe shkuaam për në Klysyre ku gjetmë  
evgjitin Seitin, në Sarajë të bejlerëve, i cili më bëri  
një melem me haki e më plakosi këmbët, se më ishin  
berë potillat gjak nga gurët. Ilaçi më beri fare mirë  
dyke ecur lirisht e pa dhembja.

Që nga Klysyra vajtmë në Toler në shtëpi të Ar-  
sllanit, të cilin e kishim lënë në Brindis, edhe s' an-  
zëjmi dyke na bashkuar Myrtezaj, prej Panaritit të  
Përmetit, arrimë në një pyll për mbi çifligun të bej-  
lerëvet të Klysyres. Në Toler, gjetmë edhe shokun to-  
në, Idriz Jakovën, i cili u nda që nga Gjinokastra  
nga shkakun se ishte e pa mundur të duronte jetën to-  
në edhe të gjesdiste maleve i ngarkuar, me qënë që  
ishte më shumë se mua delikat, prandaj qendrojti në  
Gjinokastrë e q'atje e dërguan kombëtarët për në El-  
basan, mik pas miku, se qëllimi ishte të hidheshe në  
Jakovë edhe në anët e Gegërisë për të përhapur ndje-  
njat kombëtare. Mjerisht, në Elbasan, e zunë edhe  
dërguan në Manastir ku e burgosnë edhe munduan  
shumë gjër sa u dha liria.

Një sëmundje e keqe, nga të vojturit e burgut,  
nuku e la të gjorin Idriz të gëzonjë lirinë se, pas pa-



kë dit, mbarojti jetën dyke mbyllur sytë i gëzuar se pa ëndrën e tij të mbushurë, për të cilën ish përpjekur edhe kish vojtur kaqë shumë! Le të përmëdim pak fjalë edhe për jetëshkrimin të këtij dëshmori kombëtar. Idrizi ishte lindurë në Jakovë prej një shtëpie të mirë edhe të nderçme, pa si mbarojti shkollën Turqishte zuri nënëpunës i qeverisë gjer arriu në doganë të Soroviçit. Atje u bashkua me shumë atdhetarë, këstu që u bë një kombëtar nga më të flaktët edhe me urtësin e tij dinte qysh të përhapte ndjenjat kombëtare. Me të mësuar lëvizjen të komitetit shkojti fshatazi në Bukuresht edhe q' atje në Sofje, ku u bashkua me neve edhe dolli maleve. Vdiq 27-28 vjet në lule të vërsës.

Pa si ndejmë një ditë në atë pyll shkuan në pyll të Repanit, ku u hasmë me barinj't e fshatit, e dyke shkuar për mest Sevranit arrimë për mbi Frashër. Atje tek limerjasnim u hasmë me Fejimin, nga Selenica e Pishës, i cili na shpuri në një fshat ngrehur në përue, Sorok, hoqmë në shtëpi të Spiros. miku i Fehimit, i cili na priti e gostiti si jo më mirë. Në mëngjes shkuan pranë Frashërit me mos guxuar të vinim atje se na lajmëruan që kishin vajtar mjaft ushtarë, edhe duallmë në pyll të Koplars.

Në këtë pyll na ngajti një episod shumë i keq. Më të thyer të ditës ktheheshin nga tregu i Frashërit fshatarët, për në shtëpit' e tyre, të cilët dyke i pandehur ushtetarë u ndamë për të u mprojtur, po, mjerrisht, humbi shoku shokun e pas tri orë dyke u thirur me emra u hasmë! Sa gëzim të math nuku ndjemë në zemrat tona kur u hasmë se s' paska më e keqe se asaj që të aratisesh nga shokët në mest të pyllit. Gjithë kohën e shkuan me të ngrënë lule-shtrydbye pastaj, me të afruar perëndimi shkuan në mal të Radomit, në stan të Tasi Çobanit. Atje ardhni nga Kurtesi i ndyeri Sako me të nipin e tij Kasëmin edhe na muar në fshat, në shtëpi të tyre.

Të nesërmet ardhni Ibrahim Efendiu, i cili sot.



është Baba i Teqesë Qesarakës. Z. e tij ishte një patriot nga më të vyerit edhe fort i ditur, kështu që biseduam gjer e gjatë për mbi gjendjen të Shqipërisë. Këtu ndejmë tri dit edhe u bashkuam me shumë atdhetarë prej atyreve anë, të cilët vrapuan të haseshin me neve. Dëshnin mjaft djema të rinj të shoqëroneshin me neve si edhe Kasemi, i nipi i Sakos, një djalosh 18-20 vjet, po i këshilluam të qendrojnë edhe pak kohë kur do të bashkoneshim. Vetëm Abas Nivicën, i cili ishte bari në stan të Tasit, e bëmë shok se me të parë neve nuk desh që të ndaheshë, me as nonjë mënyrë, e qendrojt i pandarë gjer sa u dha liria.

Që nga Kurtesi u kthyem prapë në Frashër edhe qendruam për mbi Teqe, ku ardhë Servet beu, Hysen beu, Dervishlerët, Hasan Ef, i cili ishte Hoxha i Frashërit edhe shumë atdhetarë të tjere. Këtu gjetmë me të vërtet folenë të kombëtarëve, se atje ishte Teqeja, shkolla e madhe kombëtare. Muarm lamtumirë dyke patur mirësinë Dervishlerët që të na japin për shok Zotën, prej Backe, i cili na shpuri në Backë, në shtëpi të Laces, të cilit na dorëzojt nga ana e Teqesë. Zotoja ishte një atdhetar i mirë, plot ndjenja kombëtare edhe trim me fletë, prandaj dyke kënduar arrimë gjer në Backë dyke shkuar midis Dervishies, ku na gostitnë Dervishlerët.

Dervishia është ngriturë në një vënt fort të bukurë, më një fushë të vogël, rethuar me male edhe pyje edhe për mest Dervishies shkon një lumë, kështu që ka një bukuri prej panorame. Shpirt ndrituri Baba Fetahu që ka xgjedhur këtë vënt, kaqë të bukurë, edhe ka ngriturë Dervishien është përkujdesurë që të xbukuronjë edhe ca më shumë përveç asaj natyrale. Ka mbjellë lloji pemë, pjergulla edhe shumë sende të tjera me një regullim të pa treguar, prandaj çdo udhëtar që të shkonjë, në Dervishie, nuk munt të mos e admironjë e të mos thotë: të ndritë shpirti o Baba Fetah!

Në Backë ndejmë dy dit, në shtëpi të Laces i cili na priti edhe gostiti mirë, pastaj të bashkuar me La-



cen, me të vëllanë edhe me Zoton muarm malet përpjetë dyke shkuar qafen të Manës. Malet të Backes janë të lartë shumë po edhe fort të bukurë se janë të veshurë, me ujra e kullotë nga më të mirët. Këtu na hasi Laceja me Tahir Vranishtin, afër Beratit, e me vëllan' e tij Saminë edhe me pesë shokë që kishin pas. Si bëmë mirë të njojturë edh' u treguam qellimin tonë, Tahiri me Saminë dëshëronin nga zemra që të bashkëpunonin edh' ata, për këtë qëllim, e kësisoj u shoqëruan me neve.

Tani nuku isha ajy Mihali i parë se u forcova mirë si nga trupi si nga këmbët edhe nga jeta komite, tani isha njëjeshisht me shokët, për kundrazi kisha marë edhe një barrë tjetër përsipër. Ditënë, si ngopeshim nga gjumi do t' u mësonja këndim edhe shkrim ose, që të mos mërzhiteshin, do t' u tregonja nonjë histori ose përallë prandaj më quanin Hoxhë. Në malet e Backës u hasmë edhe me nja 75 ushtarë po nuku u goditëm me qënë që neve kishim zënë vënde të forta prandaj shkuan më nj'anë edhe neve shkuan për në Qesarakë. Në Qesarakë kishim nevojë që të blinim ca plaçka, që na duheshin, edhe më tepër për të mballosur opingat andaj muarmë me vehte Dhamë Opin-gaxhinë gjer në Lubonjë, ku na mballosi opingat se i kishim copë copë.

Në Lubonjë hoqmë në shtëpi të Dilaverit edh' atje mësuam për vrasjen të Riza Velçishtit edhe për Apostolin, Hasan edhe Malon që kishin pësuar shumë. Hasanë e kishin zënë edhe dënuar me 15 vjet në burg të Gjinokastrës, Apostoli me Malon dimëruan me Bullgarët po. në një goditje me ushtërinë, Maloja u vra, pa si lëftojti burrërisht edhe vravi tri ushiarë. Apostolë e xunë edh' e dënuan, në Manastir, për jetë po u lirua me çpalljen të lirisë. Malo Çami ishte shoku i Rizajit po, me qënë që në një goditje me ushtërinë u plagos, Rizaj e vuri në një vënt të mirë për shërim edhe pa si u be mirë u bashkua me Bajon gjer të haseshe me Rizanë.




Që nga Lubonja u hothmë në Elmas në shtëpi të Rapo beut, i cili na priti fort mirë edhe na mbajti dy dit, se nuku ngopeshe dot me bisedimet kombëtare. Nga Elmezi vajtmë në Kozel tek Refat beu me të vëllezërit e tij, Nuri edhe Dervishi, të cilët na pritnë me gezim të math edhe së bashku me Dervishin u ngjitmë në Gramos dyke qendruar në qafë të Kazanit.

Pa vajtur në Gramos dua pakëzë të zugrafis bukurinë të Kozelit, të cilin ja ka dhuruarë vehtë Zoti. Prikosurë me male të veshur, me boriga e bredha, të cilet i përçan lumi me oshetimet e bukura, pa si vërtit dërstillat edhe mullinjte. Bagëtia kullosin me gezim edhe zilet e këmborët përbëjnë një armoní të pëlqyerë edhe të pangopure. Pa pyshim që barinjte, me fyjejet e tyre, i bashkojnë zëret e bëjnë një melodhí, kaqe të ëmbël sa të perëndon në qell! Kozeli është ngritur për mbi një bregore duke admiruar këto pamje natyrale.

Ne Qafë të Kazanit ishin ngritur stanet të Pitulit i bashkuar me Sali Butkën edhe vëllezërinë të Kozelit edhe na kanë gostitur siç naku rëfenet. Qafa e Kazanit është një vënt strategjik edhe shumë i fortë po, veç kësaj, është edhe tepër i bukur. Q atje do të shëkosh Kolonjën, me gjithë fshatrat edhe fushën e saj, më tjetër anë do të shëkosh Devollin, me fshatrat edhe fushën e tij, edhe pastaj gjithë fushën e Korçës, dyke bërë që të gjitha këta vënde një pamje panorame.

S andejmi u hothmë në Lofkë të Dardhës, ku kemi limerjosurë një ditë. Këtu gjetmë gjyрма e shenja që kishin limerjosur e të tjerë, pa dyshim andarë. Me të perënduar djelli muarim rugen e malevet edhe më të gdhirë arrimë në malet për mbi Dishnicë ku ishin ngrehur stanet. Këtu ardhim, prej Korçe, Laze Progridi i cili na sollti ca fishekë që kishim porositur edhe ngrysur mirë rymë në Korçë, në shtëpi të Oilkës. Oilka ishte zemra edhe shpirti i lëvizjes kombëtare, trim guximtar i math, i padrojtur sido që e kishin burgosur për këtë qëllim, edhe ishte i ditur. Shërbimet të



këtij atdhetari nuku kanë shëmbëll edhe çpagim. Cilka meriton faqe shumë prej të historisë kombëtare, me qënë që ka qënë, është edhe do të vdesë patriot!


Nga Korça shkua, pa si na veshi minë komiteti i Korçës për në Plasë edhe q'andej të hidheshim në Prespë, me qënë që komitat Bullgarë dëshëronin të haseshin me neve. Në Plasë tri nga shokët e Tahirit deshin të shonin për në vënt të tyre, kështu që u shtrëngua edhe Tahiri me Saminë t'i përcjellin gjer tej, në për ca miq të njojtur, edhe do të ktheheshin dyke lënë për fjalë Teqenë të Melçanit që të bashkoheshim.

Nga Plasa u hohtmë për në Prespë edhe dyke marë Grykën e Ujkuat arrimë në Grazhdan. Atje u hasmë për herën e parë me komita Bullgarë, nënë kryesi të Petro Gjermanit. Të bashkuar shetitnë gjithë Prespën, ku u hasmë edhe me shumë Shqipëtarë, të cilët i këshillonim që të shkojnë në armoni me Bullgarët edhe të mësonin gjuhën amtare e të përgatiten për një lëvizje kryengritëse se ora po afron.

Kur ndodheshim në Shulin, në çiflig të Orhan be Pojanit, na lajmërojnë, prej Korçe, vrasjen e Mitës Heqimit si edhe për Qani be Ypin që do t'e shkonin lidhur për në Manastir. Këto lajme na hidhëruan fort tepër edhe vendosmë që të zëmë rug në, Korçë-Manastir, për të shpëtuar Qani benë. Programi ynë ishte që të mbanim gjithë udhëtarët pastaj, si të shkonin Qani benë t'i lironim ose të vrisnim, nonjë nga ata që të kishin gjishtë, në vrasjen të Mitës Heqimit.

Më 7 Gusht 1907 zemë sosenë ku duheshe po, mjerisht, pa shkuar shumë kohë, shkojti Posta e cila vinte që nga Manastiri për në Korçë edhe në bërtimin tonë që të lidhën një bej i qojtur, siç mësuam pastaj, Qerim be Kostreci, veshur ushtërisht, nuku dëgjojti e dyke dashur të shpëtonjë u vra. Pastaj Postën o doq-më edhe si u muerm armët suvarinjvet edhe një mushkë u hohtmë në Nivicë, edhe q'atje në Gjerman.

Në Gjerman u hasmë edhe me Vanço Ohrinë, i



cili kishte dy shokë, edhe së bashku shkuaam për në malet e Kureshtit. Kur do të kapërxenim liqenin me llundra na lajmërojnë që shumë ushtëri po na kërkojnë neve, dyke vënë shtrëngim të math popullit, prandaj kemi marë një udhë të gjatë shumë gjer arrimë në malet për mbi Pisoder. Më nj'anë të lodhur e të raskapitur edhe me tjetër anë pa ngrënë, kemi ndenjur gjith'atë ditë vetëm me një qint dreem llokume që kisha unë në torbë.

Me të ngrysur rëzohemi në një fshat Bullgar, ku na dhanë për të ngrënë edhe porositmë Myftar'e fshatit që të na dërgonte ngrënie, për nesër, në limer ku do të limerjosnim. Të nesërmet brëma si muarmë bukë, me vehte, shkuaam në malet e Koreshtit, ku patmë lumtërinë të hasemi me kryekomitat të Kosturit edhe të bëjmë të njojturë. Nuku munt të mohojmë kurrë që, dyke bashkëndenjur me komitat Bullgarë, shkuaam vëllezërisht edhe përfituam mjaft nga organizacia e tyre. Ishin mirë organizuar, nga çdo pikëpamje, edhe kishin një disiplinë fort të pëlqyerë si kundër edhe fort të reptë. Me këtë program ishin forcuar edhe kishin mundur që të lidhen, midis tyre, kështu që në çdo rezik, që t'i vinte një çete, vraponin ndihmës ata që ishin pranë. Si vizituam fshatrat të Koreshtit muarm lamtumirë edhe shkuaam të bashkuar me voevoden Petro Buzo për në Nestram. Me hidhërim do të tregojmë që Thanas Nastoja, prej Plase, u tregua i dobët edhe i pabesë, se u nda prej neve edhe mbeti me Vançon nga Ohria, sa për armët tona, që i kishim dhënë e donim t'ja mernim, na u zotuan Bullgarët të na i dërgojnë në Korçë.

Në malet të Nestramit ndejmë dy dit edhe, pa si muarmë lamtumirë nga Petro Buzoja me shokët, u hohtmë në Kolivicë në Kala të Abidin Shahu. I famëshmi hajdut, Abidin Shahu, kishte zgjedhurë, fort bukur këtë kala se ishte një fortesë e sigurtë. Ishte Bajram atë ditë e na ka sjellë të ngrënë edhe ëmbël-sira nga shtëpia, Zeneli, një djal' i ri e fort i mirë po,





mjerisht, nuku kish ryrë, siç duhet, në ndjenjat kombëtare.

Pas mezit ditës ardhë edhe të tjerë miq, nga Zeligradi, me të cilët kuvenduam gjer e gjatë.

Pa perënduar djelli u rëzuan në Qytezë. Ishte e shtunë mbrëma edhe fshatarët ktheheshin nga punërat, në fshat. Çerçizi u thëret ca fshatarëve, në gjuhën greqishte, që të qendrojnë edhe ata qendruan. Si u përshëndoshmë i pyet Çerçizi, ç' kemi nonjë të re edhe qysh shkojnë me fqinjët e tyre Muhamedanë. Një nga pleq-të përgjigjet që s' ka nonjë të re edhe, pas shenjave e humbnë çdo shpresë të lirisë të cilën na e kanë kënduar andarët, sa për Muhamedanët, thotë plaku, janë gjith' ata Tyrq që kanë qënë kurdoherë.

Kini të drejtë, ju thomi, që të qani nga këta, po mos harojmë që faji m' i math i ngarkohet qeverisë Tyrke, të Stambollit. e cila dëshëron që të mos ketë kurrë qetësi edhe vëllazëri, në vëndin tënë, midis të Krishterëvet edhe Muhamedanëvet. Këto pra na shtr n-guan të marim armët edhe malet që të sjellëm lirinë të shenjtë, e cila nuku do të vonoujë.

Pa që të gjithë për këtë liri na kuvendonin po për fat të keq, thonë, liria, kaqë e dëshëruarë, nuku duket as gjëkund. Pastaj na pyësen që të kujt Kapitani jini se tjetër herë nuku e kemi parë. U thomi që ramë në një goditje të madhe me ushtërinë, tej Kosturit, edhe me mundime arrimë gjer k tu më parë, se shuca e shokëvet mbeti prapa dyke lënë Kalanë të Abidinit vëndin për të u bashkuar. Pastaj, dyke u treguar Çerçizin u thom unë që Kapitani ynë është Kapitan Xhorxhi.

Nuku kemi dëgjuar këtë emër edhe, siç duket nuku dini as vëndet as regullat, me qënë që djemtë tanë kurrë nuku vinë pa perënduar djelli edhe pa na lajmëruar përpara.

S' ka gjesendi; thotë Çerçizi, po nuku na thoni a ka në fshat nga shokët t' anë?

Njënatëzaj ishin katër shpirt, përgjigjen, po sonte unuk dimë në ka ose jo.



Atëhere, thotë Çercizi, le të vraponjë një përpara për të lajmëruar goxhabashin që të na bënë konak, pastaj neve dyke kuvënduar arrimë ndanë fshatit. Atje kishin dalë shumë burra edhe djema që të na shihnin edhe, me të afruar, na pritën me një mir' s' ardhhtë greqisht. U përshëndoshmë edhe ndëzmë cigaret dyke pritur goxhabashin kur në vënt të tij vjen pojaku (dragati, beçiu ose ruajtësi) dyke na thënë që goxhabashi ishte i sëmurë, edhe nuku vjen dot. Atëhere përgatitni juve një konak u thomi edhe shkojti pojaku.

Abazi kishte mbetur prapa prandaj mbeti i habitur dyke dëgjuar që kuvëndonim neve greqisht, kur se ata flisnin, pa dëshim, shqip, andaj me zemërim u thotë: E pse nuku kuvëndoni shqip, ore, a po e kini për turp?

Të xbuluar, prej Abazit tonë, thotë Çercizi që edhe neve e flasem shqipen pa si jemi nga Epiri, mirpo këjo çfaqje i kalli në dyshim edhe zunë, njëri pas jatrit, të shkojnë e të na lënë vetëm me ca djema të vegjël. Pritmë gjer sa u ngrys po më kot, se pojaku nuku dukeshë të vinjë të na thotë për konak, kur një nga çunat e mbeturë na thotë që munt të vinim e tek ata, në shtëpi, po djethinaj brema kishim nga andarët që nuku dinë shqip.

Me të parë që do të mbeteshim përjashta i thomi çunit të na shpjerë në shtëpi të tyre, ku gjetmë t'ëmënë, një grua e ve, me një bijën ktheur prapa me dy foshnja, me qënë që burri i sajë i ishte martuar në Greqi. Na urdhruan brënda të gjorat edhe, pas zakonit, na përshëndoshmë dyke mbeturë të kënaqura se mereshim vesh në gjuhën tonë. Pritmë që të vinte Thomaj siç quhëshë pojaku, të cilit i kishim dhënë të holla për të na blerë gjësendi të ngrëna, po vonojti dyke thënë që nuku gjen gjekundi. Pa fjalë i kupëtua fort mirë këto të vërtitura, prandaj i thamë që të shkonjë po nesër pa gdhirë të vinjë të na xgjonjë.

E zonja e shtëpisë na shtrojti të hamë, nga ato që kishte, po na kënaqi më tepër se me bakllavara.



Si kuvënduam edhe pakëzë na lutet që të xgjohemi ca më shpejt se ka për të vajtur në Sinicë me qënë që gdhieshe Shën Mitri edhe e meshonin në Sinicë. Ranë shokët edhe flejtnë përveç meje, që kurrë nuku flinja tek do, po të flinim në për shtëpira, aqë më tepër këtu ku na kishin ngjarë episodet e ditës. Pas mezit natës xgjojta Çercizin edhe shokët edhe u thom të pregatiten për të shkuar, se e ndenjura tonë në këtë fshat ishte e rezikçme.

Si u ngritnë shokët edhe u bënë gati xgjuam të zonën e shtëpisë, e cila flinte lart, edhe muarm lamtumirë. Çercizi më të shkuar e doroviti me tri mexhitka për fëmijën, kështu që tepër e kënaqur na përcolli gjer në porta, dyke na uruar udhë të mbarë edhe Zoti të na shpëtonjë nga çdo e ligë.

Si duallm nga shtëpia me shumë vërejtje edhe përkujdesje, shkuam për mest një lumi edhe muarm të përpjetën, pa ditur as neve vëndin mirë, edhe dyke ecur arrimë në një pyll me lajthi, ku vendosmë të limerjasim. Po si u hap dita mirë shohim të vinë çunat nga fshati, për të kallotur bagëtinë. Nga këta mësuam që ndodheshim në pyll të Çipanit, kështu që u familismë me çunat, të cilët i përkëdhelmë edhe i dorovitnë pasandaj dy, më të mëdhenjtë, i dërguam në fshat që të na blinin ca bukë edhe ca djathë,

Si kurdoherë që na kish përkrahur, Zoti i math, kështu edhe këtë herë na dërgonte dy përkrahës. Këta ishin Istref Verleni edhe Ali Çausi, të cilët, me të dëgjuar që u hohtmë në Devoll, po na kërkonin me gjithë anëtë e vetëm tani fati e solli që të haseshim, me anën të çunavet. Vërtet kishim dëgjuar për këta atdhetarë që kishin ndjenja kombëtare të nxehta, po uniforma, prej xhandarmerie, e Ali Çausit na klliste në dyshim, prandaj karauilla i ndalojti që të vinin në limer pa na lajmërnar neve.

Me gëzim të math pritnë lejen tonë edhe si u puthmë e u përshëndosmë rymë në bisedimet e ditës, për mbi çështjet tona kombëtare. Kur zuri të ngriset



u-rëzuan në Verlen, fshat i tyre, në shtëpi të Istrefit, i cili na mbajti tri dit e tre net, me pahir, se nuku ngopeshin dot nga bisedimet. Këtu u-çelohmë edhe u-gostitmë si jo më mirë. po ishin tepër të hidhëruar se në Devoll nuku ishin përhapur ndjenjat kombëtare, nga shkaku i fanatizmës. po tani adhuronin Amerikën e cila përmbloodhi shumë djem të rinj, sa me këtë mënyrë po shtr ngonen të mësojnë shqipen për të lëcitur letrat q' u vinin s' andëjmi.

Bashkë me neve ardhë, edhe Istrefi me Ali Çaushtin, gjer në Mengulas edhe hoqmë në shtëpi të Jotit Major Emin Mengulasi, dyke patur dijë për ndjenjat kombëtare. Z. e tij mungonte se ndodheshe me shërbimin ushtëriak në Janinë, po ishte një burr i urtë, shpirt mirë edhe si lo i pë mësuarë kishte ndjenja kombëtare, siç nuku pandeheshe. Në këtë shtëpi gjetmë një dollap me libra shqip, dyke thënë Aliu që i ka sjellë, nga Janina, Majori për çunat.

Pa si ndejmë dy dit në Mengulas, ku kuvenduan me shumë miq, shkuan në Bozhigrad dyke na bashkuar Alin Mengulasi, Istrefi edhe Ali Çaushtin. Në Bozhigrad hoqmë në shtëpi të Nure Agajit, miku vetiak i tyre, i cili na priti fort mirë. Pa u gdhirë u ngritmë edhe shkuan, si u puthmë edhe muarmë lamtumirë njeri prej jatrit, pa u treguarë drejtimin tonë, siç bënim kurdoherë. Mirpo Istrefi nuku desh të ndaheshë, prej nesh, se dëshëronte të shoqëroheshë po, nga shkaku i dimërit, e qendruam dyke e këshilluar të jetë gati për në prenverë bashkë me shokë të tjerë, se atëhere do të bëheshë lëvizja e madhe.

Gjithë ditënë e shkuan në pyll edhe kur u ngrys ju turmë përsëri Qytezës, ku na kishte mbetur një breng i math, për sjelljet të Qytezësve. Këtë herë u rëzuan në kishë, e cila ndodhet për mbi fshat edhe kundrej kullës të pojakëveve edhe lopëçarëveve. Qercizi vate edhe trokiti në derë të kullës edhe një zë u dëgjuar, që lart, dyke thënë që, me qënë shoku i tij në fshat e ka kyçur, nuku e hap dot po me të kthyer e




sipër është. I pa duruar, siç ishte Çerçizi, u ngjit në supet e shokëvet edhe ryri brënda nga dritareja.

Tek po rinim në kollonat e kishës shohim që ngjiteshë njeri nga fshati, të cilin, sado erëtë, unë e njofta edhe me vrap ju sula dyke i thënë: qëndro Thoma se të vrava! Thomaj, poçaku i njojturi, qëndrojti edh' i verdhë dyllë më lutet t' e lë sa te kërkonjë dy dhi që kishin humbur, po unë i thom që le t'i hajë ujku po finë të vish këtej që të mos na gënjesht si herën e parë. La mërojmë Çerçizin i cili thotë t' e ngjitim lart si kundër edhe bëmë. Nuku shkojti shumë kohë kur vjen dhe lopëçari tjetër, i cili hapi derën edhe rymë që të gjithë brënda.

Në pyetjet q' i bëmë Thomajt, për sjelljet e tyre u përgjigj që fshati, dyke na pandehurë ushtarë Tyrq, u trëmp shumë prandaj nuku na bënë konak edhe as të ngrëna më të holla nuku na dhanë se druheshin. Si e vumë në be e lamë të lirë që të vejë në shtëpi, po i thamë të hapnjë sytë se ku të bënë me komitat Shqipëtarë. Pa si shkojti Thomaj i betuam edhe lopëçarët Sulon me Hasanë, nga Bozhigrati, pastaj kuve nduam, gjër e gjatë, mbi lëvizjet që bëheshin në fshat edhe për qark.

Që të rinim në kullë të gjithë kishim frikë, prandaj dy nga shokët vanë në kollonat për siguri me verejtur çdo lëvizje që të bëheshë. Pyesëm lopëçarët që në cilë shtëpi munt të vinim na thonë që në shtëpi të Dine Qiraxhiut. Vendosi pra për të ryrë në fshat edhe kësoj, me lopëçarët përpara trokasëm në shtëpi të Dines. Me të dëgjuar që ishin lopëçarët porta hapet edhe neve rymë brënda, kur një vajzë e re, 15-16 vjet, trëmbet edhe zuri që të qanjë po me fjalë të ëmbla e qetuan edhe rymë brënda, ku gruaja e Dines ishte e sëmure.

Dinoja kish dalë nga shtëpia po ardhi me vrap me të e lajmëruar lopeçarët. Në krye u tmerua, dyke na parë neve, po neve e përqaftuam, vëllazërisht, edh' e siguruam që të mos ketë fare nonjë frikë. Urdhrojti



të na shtrojnë tjetër dhomë edhe ajy shkojti, pas urdhrit tonë, të lajmëronjë goxhabashin që të mbledhë krerët e fshatit edhe, bashkërisht, të vinë të hasen me neve. Dineja lthehet e na thotë që nuku munt të vijnë, me qënë që ka frikë prej qeverisë. Atëhere i shkrojta unë Nikollaqit, siç quheshë goxhabashi, një biletë, greqisht, në të cilën i thosha që ajy është përgjigjës për çdo që munt t' i ngjasë fshatit. Pas pakë kohë vjen Nikollaqi, bashkë me fshatarët, edhe biseduam gjër e gjatë, pastaj si u treguam programin e qëllimin i betuam. Në Qytezë gjetmë edhe ca djema atdhetarë të cilët lëçitnin fort bukur shqip, prandaj u dhamë mjaft libra për të lëçitur.

Si hëngrëmë darkë na përcuall, me dashuri, edhe na dhanë e pojakuu për udhëtregonjës gjer në Sinicë. Këtu i mblohmë së bashku, Muhamedanët me të Krishterët, edhe si u treguam programin i vumë të betohen. Tek po bisedonim na lajmërojnë që një ushtëri, prej 200 shpirt, ka retkuarë Bozhigratin, për neve, edhe frikë është mos vinë në Sinicë. Me këtë rast muntmë të çmojmë trimërinë të një gruaje, e cila, me të parë që burrat u frikësuan shumë, u thotë: për se trembi kaqë shumë? Le të urdhrojnë edhe ushtarët që të kupëtojnë se dimë t' e japim shpirtin, edhe neve, ashtu siç duhet!

Më të ngrysur shkuam, si muarm lamtumirë, me qëllim që të vinim në Dishnicë, po, mjerisht, një errësirë e madhe edhe një furtunë e tmeruarë me shi na bëri të humbasëm udhënë. Ishte një natë nga më të këqijat, që iqnim, se dyke u lënë në fat po udhëtonim në arati kur, me mundime të mëdha arrimë në majë të malit. Këtu ishte qimetë se na zuri një dborë me furtunë, e cila na perëndonte në qell. U hoqmë në një përua që te mproheshim edhe bëmë një zjar të math që të ngroheshim edhe thaheshim, po më kot mundoheshim se era e marë nukë na linte, kështu që të mos ngrimë muarm udhën, verbërisht, kur dha Zoti, për fatin tonë, të dëgjojmë zënë të gjelave që të këndojnë.



Gëzimi ynë ishte i patreguarë edhe u-lëshuam në atë drejtim kudo që të na shpinte. Të mbytyrë në baltra edhe të ngrirë akull rymë në atë fshat, të paditur, edhe trokitmë në porta të një shtëpie. Një grua dolli në dritare edhe pyet: cilët jini? Njerës të mirë, përgjigjemi, pa kush dëgjonte? Ju lutmë dyke u betuar për krishtin edhe për kungatë po më kot ishin të gjitha. Vamë në tjetër shtëpi po edhe këtu nuku deshnin prandaj, të dëshpëruar, deshmë të thyejmë derën, me qënë që ishim kaqë të ngrirë sa me zor të math mbanimë armët në duart po një nga shokët na ndalon se kishte parë një njeri që shkonte. Me vrap e zëmë edhe, domosdo, na shpuri i gjori në shkolla të fshatit, ku ishte mësonjës, edhe na bëri një zjar të math ku u ngromë edhe u çkristuam mirë.

Pa gdhirë mirë e dërguam të thërese goxhabashin të vinte që të na bënte një konak, kur kthenet mësonjësi e na thotë që goxhabashi nuku munt të vinte, nga shkaku se në shtëpi të tij ka shtatë xhandarë, andaj na këshillonte që të shkonim nga fshati. I dërguam fjalë që ajy duhet të na bënjë konak pa po të kenë qef xhandarët le të urdhrojnë!

Në mëngjes vjen Todi, goxhabashi, edhe na thotë që xhandarët, të cilët ndodheshin në shtëpi të tij, na dërguan kur trokitmë neve në shtëpin' e dytë, prandaj thotë, nuku mar as nonjë përgjigjie përsipër çfarëdo që të ngjasë. Me të vërtet goxhabashi nuku gënjente, po, siç ishim neve ku munt të vinim ditën, preferuam që qëndrojmë andaj i thamë të na bënjë konak. Atëhere thiri pojakun edhe i thotë të na bënjë konak në një shtëpi ndanë fshatit, siç i thamë neve për çdo ngjarje.

Me qënë që goxhabashi kishte punë me taksimdarët (mbledhësit), na kërkoi ndjesë që nuku munt të rinte me neve, po besonj, tha, që gjer më drekë herë të mbarojmë, këtu në Gjyres, edhe t'i përcjell. Po do t' u dërgonj nga fshatarët që të mos u mërzitni vetëm. Me të vërtet na dërgojti mjaft Gjyrëzë me



të cilët kuvënduam gjer e gjatë. Midis tyreve ndodheshin edhe ca të rinj me ndjenja kombëtare, me qënë që punonin në Mali Shenjt edhe ishin predikuar prej patriotit, Oshenar Gjergj Panaritit. Pa si kish përcjellë, taksindarët, ardui edhe goxhabashi, i cili na solli të falura nga dy xhandarë. Biseduam gjer sa u ngrys pastaj, si hëngrëmë bukë, muarm lamtumirë edhe shkuam.

Që nga Gjyrezi muarm malet edhe dyke shkuar nga Gur' i Capit arrimë në Dishnicë edhe hoqmë në shtëpi të Janp Beut, i cili na priti fort mirë. Atë ditë bëheshë, në Korçë, dasma e Sami be Pojanit edhe me gjith kotë, me të mësuar për neve, vrapuan me araba edhe më kembë shumë atdhetarë. Dishnica mban gjysmë ore prej Korçe prandaj nuku qendruam përveç se atë ditë edhe ngrysur shkuam për në Teqe të Melçanit.

Midis atdhetarëve që ardhë për të u hasur, në Dishnicë, ishte edhe një djalë i ri, i qojtur Ferit be Frashëri, i cili me të na shëkuar neve nuku donte që të ndaheshë as një pëllëmbë. Shkuam pra së bashku po baltrat e mëdha, hendeket si edhe errësira na pengonin shumë prandaj, dashur pa dashur, u-shtrëngnam të kthehemi në Orman Çiflig, 20 sekundra prej Korçe, në shtëpi të Vangjos, i cili kishte atë ditë edhe dasmë se martonte të bijën. Me gjithë këtë ndejmë në kullë ku dëfryem edhe me dajirencë dyke lojtur, Çerçizi me shokët edhe me Ferit benë, edhe valle.

Si hëngrëmë darkë, shkuam edhe, duke ecur gadales, arrimë nga të gdhirit në Teqe të Melçanit. Në Teqe ndejmë pesë dit ku Shenjtëria e Tij, Baba Hyseni, na priti, gostiti, ndihmojti edhe na bekojti. Shërbimet të Shënjtërisë Tij nuku tregohen dot, se Baba Hyseni është një nga patriotët e mëdhenj edhe një shtyllë për lëvizjen kombëtare, prandaj historia kombëtare i detyron faqe të arta Shënjtërisë Tij. Në Melçan ardhë plot atdhetarë, prej Korçe edhe prej qarkut, që të haseshin me neve. Midis tyreve nemëronj Cilkën,






Lazo Progrin, Fuat be Dishnicën, Vangjel Gjikan, Jaup be Dishnicën, Aleks Koçin, Sumi be Pojanin, Viske Gorguzi, Lutfi edhe Memdu be Zavalani, Tasi Gramenua, Hasan Selfo be Polena, Thoma Fali, Kristaq Aristidhi, Gaqi Tuanas Viso, Bejlerët e Gogës edhe shumë të tjerë.

Dervishlerët, ca atdhetarë të vërtetë, mbushur plot ndjenja kombëtare, nuku dinin qysh edhe qysh që të na kënaqnin më mirë. Midis tyreve ndodheshe edhe një Dervish i ri, Zylfo, pa i dirsur mustaqeja, i cili dëshëronte të shoqëroneshe me neve, po i thamë që është dimër edhe më tjetër anë, me anën të Teqesë, i shërbeni më shumë çeshtjes kombëtare. Dervish Zylfoja është i nipi edhe trashëgimtari i Baba Hysenit.

Si i pathmë dorën Baba Hysenit e muarm lamtumirë nga Dervishleret shkuan, në Polenë, të bashkuar me Ferit benë, Hasan Selfo benë edhe me Jaup benë. Këtu hoqmë në shtëpi të priftit, i cili u trëmp shumë në krye po pasta, u gëzua tepër nga bise limet edhe me kënaqësi të madhe desh që të qendronim nja dy dit, po neve shkuan për në Korçë.

Ishte një natë e errëtë, me erë edhe me shi, kur u rëzuam nga Polena në Korçë edhe, të lagur qull hoqmë në shtëpi të Cilkës. Këtu ardhë përveç atdhetarëve edhe të çkëlqyerat, atdhetare, zonjëzat Sevasti edhe Parashqevi Qirjas si edhe zonjëza Fanka, mësonjëset të shkollës së çupavet. E palodhura atdhetare Ekaterina Cilka, zonja e Cilk s, na jepte edhe këshilla për rojtjen tonë komitare, pa si kish ndenjor 6 muaj me komitat Bullgarë, kur e muar penk bashkë me Amerikanen Miss Stone.

Në malet pra lindi zonja Cilkë edhe një çupë, të cilën e quajnë Lencë, plot shpresa për pritmjen e atdheut. Zonja Cilkë na qepi edhe nga një qese të madhe për të vënë bukën, dyke thënë që therimet le të mblidhen se munt t' u duhen në nonjë nevojë. Sa herë edhe sa nuku uronim zonjën Cilkë, se me të vërtetë kishim mbetur kaqë herë pa bukë, nga shkakut i ushtërisë.



Që nga Cilka vamë në shtëpi time, për mest qytetit, dyke patur përpara Ferit benë, Kristaq Aristidhin edhe Gaqi Thanas Vison, ku na prisnin prindërit edhe vëllezërit e mij. Pa fjalë që u-gëzuan shumë po edhe u-helmuan kur më panë komit, me mjekrëu e e me leshrat e ghata. Në shtëpinë tonë nuku mbeti as nonjë atdhetar pa ardhur që të haset si kundër qe bëmë edhe kaqë herë mbledhje me rëndësi. Ishte pra një çudi e madhe që shpëtuam pa ngjarë gjësendi. Po mbi k të i detyrohet fort shumë edhe atdhetarit Beqir Progrit, i cili ishte Kryekomiser i Korçës asi kohe edhe, domosdo, mbyllte sytë edhe veshët.

Ndejmë pesë dit në shtëpinë tonë, ku u lamë edhe u ndruam, pastaj, me qënë që qeveria zuri të kupëtonjë, muarm lantumirë edhe shkuan të bashkuar me Feritin, Kristaq Aristidh edhe Gaqi Thanas Viso. Tek përçanim qytetin një patrullë ushtarë rëzoheshe nga Mitropolia e na thiri qëndroni! qëndroni! po neve dyke dredhur rugën muarm ca ngushtësira edhe duallmë në Shën Thanas një bregore për mbi Korçë.

Si u puthmë, me trimat edhe guxintarët atdhetarë, u ndamë dyke u-rëzuar ata në Korçë edhe neve, dyke u ngjitur malit, në Shën Ili të Mborjes. Një ditë ndejmë një dit ku ardhni Fetahu i Qinamit edhe na rojti mjekrat. Më të ngrysur u rëzuam edhe dyke shkuan në për arat duallmë në sose Korçë-Kolonjë. Mjerisht, për veç Abazit, na u sëmur Qerçizi, në Dvoran, kështu që ishte e pamundurë të kapërxejmë Qarin atë natë. Vendosmë pra të qëndrojmë në Bellovodë, në han të Baba Qazimit, ku Shahini, i zot' i hanit, na priti mirë. Mjerisht atë ditë ishte bërë një përpyekje midis andarëve edhe me ushtërinë në Lofkë, të cilët dyke na pendehur neve u-përpoqnë me andarët, kështu që më të kthyer deshmim të kthenen në han, po Shahini i përcolli dyke thënë që s' ka vënt me patur haremet brenda.

Ushtëria mori rugën e Korçës edhe neve, me që në të sëmure Qerçizi me Abazin vamë në Floc, në shtë-



pi të Ibrahimit edhe Almitit, me të cilët isha mik i afërmë që nga Misiri ku kishim bërë bashkë. Me qënë mik në Misir na priti i vëllaj i tyre i vogëli, Shahua, i cili na priti edhe gostiti mirë. Nga Floqi shkua për në Elmas, me gjithë qe binte shi, edhe hoqmë në shtëpi e Rapo Beut. Rapo ben në krye nku desh të na priste brënda, me qënë që kish ca mjeshër që punonin, po si pa Çerçizin edhe Abazin të sëmurë na priti dhe gostiti si tjetër herë.

Që nga Elmazi vamë në Qinam ku ndejmë nja tri dit, në shtëpi të Fetahut edhe Mehmetit me të vëllezërit e tij, të cilët na pritnë edhe gostitnë mirë. Këtu u hasmë, me shumë atdhetarë, se Kolonja është djepi i ndjenjave kombëtare po, për fat të zi, e përçarë, nga shkakut i grindjeve edhe armiqtë që mbretërojnë, midis vëndësve.

Nga Qinami vamë në Starje edhe hoqmë në shtëpi të vllazërisë, të Mehmetit, Ibrahimit Arslanit edhe Batos, të cilët janë ca djema të mirë, të urtë si edhe ca atdhetarë të flaktë. Këtu u hasmë me shumë atdhetarë midis cilëve edhe me Abdyl benë një atdhetar i ditur edhe i mësuar. Që nga Starja vamë në Selenicë, ku na priste Bido ben. Bido ben ishte oficer në ushëri, po patriotizmën të këtij atdhetari fort rall e kisha gjetur në gjithë shëtitjet. Na priti e gostiti fort mirë pastaj u kthyem prapë në Starje, në shtëpi të vëllazërisë të Mehmetit.

Këjo shtëpi ka bërë shumë therrorira edhe ka sjellë shumë shërbime, mbi altarin të atdheut, se kurdoherë këjo shtëpi ishte e hapurë për komitat kombëtarë. Po, përveç këtyre shërbime, deshnin që edhe me jetën t' e mbushin detyrën prandaj një nga djemtë, i dyti, i gojtur Asllan desh që të shoqëroheshë me neve. E ëma u bint edhe i dha lejë pastaj, dyke i dhënë urimet i tha: or bir më mirë të të dëgjonj të vdekurë se sa të më turpërosh! Rëmben armët, Asllani, edhe q' atëhere u bë shoku ynë i pandarë. Djalë i ri, 20 vjet, ishte



prikosurë me virtuta të mira, trim, i papërtuarë, i urtë edhe një atdhetar i vërtetë.

Tani edhe me Asllanë bashkë muarm lamtumirë edhe vamë në Goshtivisht, në shtëpi të Gaziut, ku ndejmë tri dit me qënë që prisnim robat, si të xhandërmarisë, nga Korça, që na kishin porositur atdhetarët. Me të vërtet të tretën ditë ardhi Fetahu me robat, të cilat, me të i veshur, nuku na ndanin as pak nga xhandarët. Një lajmë na vjen që një ushtëri po vjen për neve, kështu që me vrap shkuam pa zënë të ngryset mirë, po me të dalë jashtë fshatit një shi i math na zuri e na bëri qull. Me gjithë këtë po ecnim që të arrinim lumin, pa ardhur shumë, e t' e kapërxenim po ishte e pa mundur.

Rymë në lumë, dyke u zënë dorë pas dore, gjer në mest kur shohim në rezik edhe kësisoj u kthyem prapë. Për fat ndodheshë një mulli i prishur edhe rymë atje ku ndezmë një zjar të math që të thaheshim.

Në mëngjes shtërojti, pakëzë, lumi edhe shkuam m' atënë në rëzet e Radomit. Muarm të përpjetën edhe dualmë në majë të malit, ku na priste një furtunë e madhe me dborë.

Ndejme gjithë ditën në Radom pa mundur të ndezim zjarë nga shkaku i erës e vetëm me të ngrysur u-rëzuan në Kurtez për të ngushelluar Laskën për Sakon edhe nipin e tyre, të cilët ishin vvarë, për fat të zi për të shkretën armiçësi! Këtu gjetmë Fehimin, nga Orgocka, një burrë i verbër po fort i ditur edhe atdhetar. Ndejme tri dit në Kurtez, gjer qëndrojti furtuna e madhe me dborë, pastaj shkuam për në Frashër.

#### KRYE E IV.

### **Të dimëruarit në malet.**

Dimri erdhi edhe duheshe menjtuar qysh do të dimëronim. Kur vinim për në Frashër ishte një nat e ftohtë sa të përvëlonte fytyren. Ciknë të këtillë nuku




kishim shijojtur, gjer ahere, po veç kësaj nuku na linin të qetë as ujqrit. Tufë, tufë dilnin nga pyjet dyke lojtur e dyke ulëritur. Shtimë kaqë herë po nuku aramë as nonjë. Në konak të Sulejman beut gjetmë edhe Nexhip Benjën, trimin të Leskovikut që vravi Kollasin, i cili guxojti t'i shanjë Shqipërinë. Nexhipi ishte një djalë i gjatë edhe ushqente ndjenja kombëtare, prandaj u bashkua me neve.

Në Frashër ndojmë dhjetë dit në për atdhetarët edhe në Teqe, ku Shenjtëria e Tij Baba Abidini na priti e na dha uratat. Që të tregojmë, hollësisht, shërbimet të kësaj Teqeje duhet penda e një historishkronjësi, i cili te mundë të mbushnjë shumë faqe të dobishme, prandaj neve do të përpiqemi vetëm të shenojmë ca shënime, dyke lënë pritmjes që të mbushnjë ketë detyrë.

Më 1879 në këtë Teqe u-mbloth parësia e Toskërisë, nënë kryesi të shpirt ndriturit Baba Alushit për të biseduar edhe vendosur çfarë masa të mernin kundra të kra-stiturisë të Shqipërisë, prej Konferencës të Berlinit. Këjo Konferencë, q' u bë për Luftën Ruso-Tyrke, u dhuronte Greqisë, Sërbisë edhe Malit Zi shumë pjesa nga të Shqipërisë. U vendos pra që të protestojnë, në Europ, edhe xgjodhë Abdyl be Frashërin e Mehmet Pashën Vrionin, delegatë që vanë protestuan, më gjithë dyert e mëdha, po më kot se as një nuku i dëgjonte dyke u thënë këto: komp pa gjuhë të shkruar nuku ka, prandaj përpiquni në doni të njihi, paskëtaj për komp!

I dëshpëruar Abdyl beu kthenet në Shqipëri edhe bashkë me shumë shokë të tjerë filluan ligën të Prizrenit. Kundrështimet, me armë në dorë dyke derdhur gjakun, si rëke, fatzinjtë Shqipëtarë, për mprojtjen të tokës tyre, nuku suall as një dobi se vendimet të Evropës i mbushi, plotërisht, Tyrqia, e cila dërgojti një ushtëri të madhe, nënë Komandë të Dervish Pashës, kështu që të mjerët Shqipëtarë u shtypnë edhe u shtrënguan të behen robër, bashkë me tokën e tyre, në të huajt!



Ngjarjet e atëhershme duhet t' i pikëllonjë në zemër, çdo Shqipëtar, edhe dyke psherëtitur të derdhë lote të nxehta, në këtë kujtim, se faqe më të hidhurë edhe më të zezë nuku do të ketë historia për kombin t' enë! Le të shprehim tek i Madhi Zot që, me kohë, nonjë ditë janë për të u bashkuar në një trup me nënën e tyre Shqipëri!

Duheshe pra të zireshin nga punimi, me themel, që të përgatitnin kombin për pritmjen, që të mos u thoshin përsëri që Shqipëri edhe komp Shqipëtar, pa gjuhë të shkrojturë, nuku ka! Kështu që Abdyl beu, si e zunë edhe e shpunë në Stamboll, thiri edhe Naimin edhe bashkë me Saminë, të vëllezërit, ju vërvitnë punës dyke filluar nga themeli.

Ishte Frashëri vënt i bekuar, për Shqipërinë, se nga Frashëri duall dërgimtarët edhe lëçitësit, të gjuhës shqipe për të ndriçitur kombin e vet, prandaj Frashëri do të mbetet, për jetë, vënt i shënjtëruar i Shqipërisë!

Kur u ngjitmë në mal të Kolonjës, për mbi Frashër, i kam dedikuar këtë vjershë:

*Si ty o Vithehem e Mek' e Arabisë*

*Ku janë lindur Muhamet e Krisht i Krishtërisë*

*Për mua është Frashëri vënt i Perëndisë*

*Tek është lindur Naim beu zemr' e Shqipërisë! etj.*

-Pa si u largova pak nga thema, prapë për të kujtuar të riujtë që kurdoherë të enteresonem për rjedhjet historike të Shqipërisë, po kthehem përsëri në Teqe të Frashërit. Kur hymë brënda mbetnë të habitur për qetësinë, pastrën edhe regullimin që mbretëronin atje. Pandeh që ndodhesh në tjetër botë kur sheh Dërvishlerët me një organizacie të pa treguarë. Cilido, nga Dervishët, ka shërbimin e vet edhe nuk del kurrë jashtë regullit, detyrës edhe disiplinës.

Shënjtëria e Tij munt të quhet me t drejtë një Shënt se Baba Abidini përmbledh virtutet më të nalta, dyke sakrifikuar shpirtin e Tij, vetëm e vetëm, për të ndihnuar edhe shëruar plagët e të vobekëvet edhe gjithëve që ndodhen në nevojë. Me mirëbërësit' e Tij edhe



...tësinë, q' i ka dhuruarë vetë Zoti ka fituarë simpatin' e gjithë popullit, Muhamedanë edhe të Krishterë, kështu që me përunjësi edhe ndjerime të mëdha janë të bindur e vetëm fjalën të Baba Abidinit dëgjojnë.

Le të mos mohojmë edhe këtë që sikundër është Sh. e Tij, Baba Abidini, kështu janë edhe të 15-16 Dervishlerët q' e rethojnë. Të urtë, të ditur edhe patriotë të flaktë. Shërbime të paçmuara i sjellën çështjes kombëtare me përpjekjet e tyre, se si dërgimtarë venë katunt në katunt dyke përhapur, ndjenjat kombëtare. Hejmohem fort tepër që nuku munda të shënonj gjithë emrat, të Dervishevet, prandaj u kërkonj ndjesë, me gjithë këtë sjell nër mënt emrat të këtyreve Dervishe: Meçua, Mustafaj, Shemeja edhe Murati.

Nuku munt të shkojmë nga verejtja Hoxhë Hasanë, një nga të rallët atdhetarë, i cili fshehtazi u jep mësimë fëmijës. Gjithë kësisoj zotin Koste Bullamaçi, mësonjës i shkollës Romane, përpiqet me gjithë fuqi për gjuhën shqipe. Jo me pak nuku duben haruar Sulejman beu, Servet beu, Hysen beu e Doktorët Refati me Xhemalë për shërbimet e mëdha q' i kanë sjellë kombit.

Përveç pritjes të mirë e të paharuarë, që na bëjnë, patnë mirësinë të na japin edhe një ndihmë, kështu që, si muarm lamtumirë, shkuam nga Frashëri më 1 të Dhjetorit dyke vatur në Odricën. Odricani është një fshat i bukur edhe pjellor, rethuar me pyje, me të cilat i jep një bukuri të pëlqyerë. Hoqmë në shtëpi të Gjorgjit Tuxharit i cili na priti edhe gostiti mirë. Këtu gjetmë edhe mjaft fshatarë me ndjenja komkëtare.

Që këtej u hohtmë në Pangri, në shtëpi të Hysen Agajit. Pangria është një fshat i vogël po tepër i bukur sa më ka mbeturë rënjosurë në zëmër. Fshati ngritur në ca bregore ka tatëpjetë një fushë të vogël po pjellor, i rethuar me pyje dushka edhe i ujitur me lumënj e me burime. Ndejmë tri dit në Pangri, ku ardhë shumë atdhetarë, nga qarket, me të cilët biseduam.

gjër e gjatë. Tepër të kënaqur nga pritmja e mirë shkuam në Hotovë, në shtëpi të Salihut.

Si ndenjmë një ditë ne Salihu shkuam bashkë për në Tremishtë, ku hoqëm në shtëpi të Ali Abdullahut, i cili na priti me gëzim të math. Këtu ardhë shumë atdhetarë, midis cilëve e një djalosh i ri që këndonte fort bukur. Ky djalosh, 16-18 vjet, qubeshe Haredin edhe me të parë neve ishte e pa mundur që të na ndaheshë, kështu që, me lejen të prindëve, e muarm bashkë këtë trim, i cili ishte thënë të bëhet theror mbi alltarin të atdheut!

Nga Tremishti muarm malet të Benjës dyke vajtur në Pestë. Këjo udhë më ka pëlqyer më tepër se çdo udhë që kam shëtitur gjër më sot. Një lumë që shkon midis dy mureve prej guri, të bërë nga natyra, të naltë e të zografisurë me gjelbësira, kaqë të bukura, që vetëm në për pikturat edhe panoramat mundt t'i vështrosh edhe shijosh. Këto ujëra minerale që rjedhin e mburojnë janë shumë të mira, se venë shumë njerës, me lloji sëmundje, edhe gjejnë shërim, po sikur të analizohen mirë edhe të ndërtonen siç duhet, pa falë, që bëhen nga Banjat më të mira.

Kapërxyem urën të Kadiut edhe vemë në Pestë dyke hequr në mulli, ku na kishin thënë që këtu kishin vrrarë Riza Velçishtin. Shtrëngime të repta i bëmë millonajit dyke e munduar, gjithë natën, po më kot, se ay dyke qarë thoshte vramëni me fëmijën bashkë, në doni, po unë nuku di gjësendi për vrasjen. Riza beu, tha, kur vinte këtu vinte si në shtëpi të tij po tani ka kohë që nuk ka ardhur.

Nga Pesta u-hoqëm në Postenan, fshat i të ndyerrit e të pavdekurit Jon Vretua, i cili është një nga themelonjësit të shoqërisë, të Stambollit 1879, edhe një shok i pandarë i Samiut edhe i Naim Frashërit.

Jon Vretua ishte i ditur shumë edhe ka lënë vepra, nga të cilat muar lëndë e mësimë shkrintarët e rinj. Librat Mirëvetja, Numëretorja, (Arithmetika) edhe përmbledhja e Ervesës janë veprat të Jon





Vretos, si edhe shumë shkrime të tjera në « Drita » edhe « Dituria » të përkohëshme që botoheshin në Stamboll 1880.

Pa si i ndalojti qeveria Tyrke që të vepëronin për gjuhën shqipe u hoth në Bukuresht ku si një dërgimtar i urtë edhe punëtor, i pareshtur, i solli shërbime të mëdha çeshtjes kombëtare. Me gjithë pleqërinë kërkonte burime të gjuhës shqipe, e për këtë qëllim pra vajti në Athinë, po, mjerisht, vdekja e pamëshirte nuk e la të mbushte dëshirat. Radhën ua kam lënë historishkronjësve Shqiptarë, për të përshkruar jetëshkrimin të këtij dërgimtari të math!

Në Postenan hoqmë në shtëpi të Danges, një atdhetar që kish tregëti në Romani, ku ardhë shumë atdhetarë me të cilët biseduam gjër e gjatë. Mjerisht ushtëri vinte për neve edhe u shtrënguam të shkojmë, po duhej të shkonim një rip të ngushtë, ku as dhitë nuk shkonin, që të shpëtonim nga një rezik të math. Mua më muar për dore Zemani edhe Asllani, se për të e kapërxyer as kurrë të kurrës. Një vështrim poshtë, prej 400-500 metra, ose një gabim në të shkelur mirnjelamtumirë prej kësaj bote! Sot pra edhe një kurorë mbretnore të më dhurojnë nuk e kapërxyenj ripin të Postenanit!

Pa si u çelohmë pak, me qënë në siguri, shkuan në Leskoviç të bashkuar me Komiserë të Policisë, Murat Gjinokastrë, i cili na kish dalë një orë lark qytetit për të na pritur neve. Hoqmë në shtëpi të Haxhiut Gjinokastrës, teligrafist, një nga të parët luftëtarë të çeshtjes kombëtare. Këtu ardhë shumë atdhetarë me të cilët u hasmë edhe biseduam mbi lëvizjen kombëtare. Në Leskoviç ndejmë 4 ditë ne Rahmi be Rusi, Pertef beu edhe në Krita, të cilët na kënaqnë me të tepër.

Si na dhanë edhe ndihma muarmë lamtumirë e shkuan në Shqeri, për të kërkuar gjyrmat të Riza Velçishtit.

Shëtitmë në Shqeri dyke mos lënë kasolle edhe haur pa kërkuar, po gjithë mundimet shkuan kot se-



gjyrmën të Rizajit nuku e mernim dot gjekundi! Shkojti edhe shkojti Rizaj, një nga komitat e parë të Shqipërisë, dyke u-bërë theror për Atdhenë!

Në Shqeri vajtmë në Melan, një fshat i bukur, në shtëpi të Atit Stathaqit, një nga atdhetarët e flaktë, i zgjuar edhe shumë trim i cili na mbajti dy dit në shtëpi të tij. Goditi të vinjë ushtëria, atë natë që vammë neve, po At Stathi me vrap dolli edhe i shpuri në konak të fshatit me qënë se ay ka vlimin të çupës, kështu që u dërgojti raki e verë sa ranë të flenë edhe neve muarm lamtumirë edhe shknam për në Lushnjë, në shtëpi të Sulos edhe në të tjerë. Për fat goditi në një ditë festimi i motit ri me Bajramin kështu që i festuam bashkërisht dyke dëfryer fort mirë.

Në këtë fshat kam bërë një përshtypje të madhe me një trashëgim që kish mbetur nga pleqtë. Në majë të malit ishte një kishë, Shën Koli, edhe e kishin me radhë fshati që të ngjiteshin, nat për nat, për të ndezur kandilen. Po përshtypja e madhe më ardhi se Lushnja është një fshat Mysliman.

Që nga Lushnja u hohtmë në Badillonjë, dyke kapërxyer Viosën e një orë lark Përmetit. Hoqmë në shtëpi të Vangjel Çobanit, i cili na priti fort mirë, po, mjerisht, më drekë herë ardhi Aliu Tremishti me një shok e na lajmëron që ushtëria po na gjyrmon, këmba këmbës, edhe na këshillon që të shkojmë sa më shpejt. Me një anë ushtëria edhe më tjetër anë një dimër i math, që na zuri, na shtrënguan që të shkojmë me vrap edhe në një kishë, për mbi Përmet, u-puthmë edhe u-përdamë nga Nexhip Benja edhe Bidua, shoku i tij, dyke shkuar ata për në fshat të tyre edhe neve për në Gjinokastrë.

Marim të përpjetën të Nemerçkës po dhora, prej 3-4 pëllëmbë, kish mbuluar çdo gjyrmë të udhës, kështu që ecnim verbërisht gjer arrimë në majë të malit. Nuku duhet haruar që malet e Nemerçkës përmbajnë gjithë verën-dborë, domethënë e rea e zë të vjetrën. Një cikmë e madhe na ngrihte edhe dirset, që na der-




dheshin çurkë, po duheshe me domosdo të ecnim se kishim për të bërë udhë të gjatë. U rëzuan nga maja e malit edhe, hop andej hop këtej, gjetmë gjyrmën të ndhës.

Të siguruar tani e në atë kohë, prej çdo reziku, ndezmë nga një cigare edhe u çelohmë pakëzë edhe muarmë udhën se duheshe me domosdo që të kapërxenim karakollat, pa u gdhirë. Ecnim pra jashtë fuqisë tonë gjer arrimë në grykë të Selckës, një grykë e ngushtë që me gurë nga malet e Libohovës munt të të bëjnë thërimë. Me të arrirë derguam Zemanin me Haredinin përpara për të qeruar udhën edhe për të vërejtur xhandarët në ishin të xgjuar ose flinin, kështu që kthehen dyke na lajmëruar që xhandarët, të karakollavet, flinin edhe udha është e qeruarë. Me vrap shkuan ngushtësirën edhe me të gdhirë arrimë për mbi Suh, kundrejt edhe 3 orë lark Gjinokastrës.

Vetëm ata që kanë bërë këtë udhëtim munt që të kupëtojnë edhe çmojnë çfarë udhë kemi bërë, atë natë edhe në mest të dimërit! Unë me sa mbanj mënt kurrë nuku kishim bërë të këtille udhëtimi, me gjithë reziqet që kishim shkuar. Të raskapitur e të drobitur ndejmë të ndezim nga një cigare edhe Çerçizi na thotë: në këto vënde kam ardhur shumë herë për gjah, edhe kam vrrarë mjaft sarkadhe. Nuku kish mbaruar fjalën Çerçizi kur, për çudi, shohim të rëzohen 4 sarkadhe në një përua. Me vrap Çerçizi i qëllojti edhe goditi një dyke ikur të tjerat.

Si muarm sarkadhen u-rëzuan tatëpjetë, në fushë, kur shohim që ishte ngrehur një stan. Shikon me dullbi Çerçizi edhe njojtë barinë, i cili kullote berrat, edhe e thëret më emër po, me të u-afruar, u trëmp dyke na parë të veshur me roba xhandarmerie. Pastaj me të njojtur Çerçizin, ardhi i gëzuar edhe si u puthmë zumë të përshëndoshemi e pyetemi. Na thotë që vetëm tri dit kishin që kishin ngrehur stane, pra ndaj na thotë të qëndrojmë e pakëzë gjer të vejë të



lajmëronjë plakun, t'atnë, edhe vëllanë që të mos na çfaqin, me qënë që për fat kemi një mysafir ardhurë.


Stani ishte i Qarçanit, nga Lekdushi, një nga barinjte më të dëgjuar të Kurveleshit edhe Çerçizi njiheshë mirë edhe kishin miqësi të madhe. Pa si u kthye i biri vamë në stan ku na priti me nderime zyrtare, gjoja si njerës të qeverisë. Si përshëndoshemi urdhron djemtë të na pjekin një qëngj të zgjedhur edhe djemtë tanë vunë sarkadhen në hell, kur se neve po bisedonim na ngjajti një episod komik. Qarçani na pyet nga vimë edhe për se kemi dalë në një kohë kaqë të ligë ?

Mos pyet, i thom unë, se jemi për të qarë halle, se si këtë herë, kurrë nuku na është vënë kaqë shtrëngim, nga Baba Dovleti, për të mbledhur gjithë bekaetë, si edhe xhelepin të këtij viti. Pa le, thotë Çerçizi, për ilamxhinjtë është qiameti se kemi urdhër që të përdorim çdo mënyrë sa edhe t'u djegëm shtëpitë!

Dorën e ka të gjatë Baba Dovleti, thotë Qarçani, edhe vetëm Rahmet' i tij na mban për mbi dhe!

Kur djemtë përgatitnin tryezën, për të ngrënë, mysafiri doli jashtë kasolles po nuku kish të kthehet, kështu që duall djemtë dyke e bërtitur Lamën tonë, siç e quanin, po ku, Lameja ishte bërë i padukur edhe nga qëllimi që kish la brucën që të mos i rëndonte! Rini të hamë bukë, thotë një nga djemt' e Qarçanit, se Lameja e ka zënë bicen kur dëgjojtë që kini dalë për ilamxhinjtë (të dënuarit për burg) se edhe Lameja është ilamxhi.

Qeshmë mjaft më këtë ngjarje, të papandehur, pastaj ju rethuam bukës. Me të ngrënë bukë, me gjithë lutjet të Qarçanit që të rinim e të nesërmet, u përgatitëm edhe shkuam. Qarçani pati mirësinë që të dërgonjë e një nga djemt' e tij me kalin, për të kapërxyer lumin se ishte mjaft i thellë edhe të mos lageshim. Njëherë me të u edhur përtej lumit muarri udhën për në Gjinokastrë. Unë isha i lodhur shumë prandaj djemtë, shokët, më muar në kuris gjer në



shtëpi të Çerçizit, e cila është në një breg të lartë. Në Gjinokastrë rymë pas mezit natës më 6 Janar 1908.

## KRYE E V.

### **Koha Trimnore.**

Shtëpia e Topullenjve, në Gjinokastrë, është e dëgjuar edhe një nga të parat edhe është shumë i math fisi i Topullenjvet, i përndarë, në Gjinokastrë, me që në që ishin shumë vëllezër. Një nga këta ishte Agua prej të cilit u-lintnë 10 djem, midis cilëvet duall trimat patriotë Bajua edhe Çerçizi, për të ringjallur historin' e Shqipërisë.

Në shtëpi të Agos pra ishte Kapua m'i madhi vëlla, i cili kishte equr shumë, për Bajon edhe Çerçizin, se e kishin burgosur me gjithë shtëpinë, në Janinë, si edhe bagëtinë ja kish marë qeveria Tyrke. Me gjithë këto Kapua as pak nuku dëshpëroneshe, përkundrazi ishte gati të bënte çdo therori për qëllimin të shenjtë. Prandaj, kur vajtmë neve në shtëpi, këcente nga gëzimi edhe me vrap dërgojti Alitin, vëllanë më të vogël, që të lajmëronte kombëtarët për ardhjen tonë, të papandehurë.

Me vrap edhe pa u gdhirë mirë zunë të plakosin kombëtarët për të u hasur me neve. S'ka dyshim që të parët ishin të palodhurët propagandistë Idris Guri, Besim Vesel Gega, Refik Budua, Sheme teligrafisti, Nazif Ajderi, nga Palavlia, Alit Sferi edhe shumë të tjerë. Për dita do të vinin, tek neve, për të biseduar edhe u këshilluar mbi çeshtjet kombëtare si kundër edhe masat që duheshin marë, për nevojat edhe interesat kombëtare.

Të nesërmet vjen një djalë i ri, Myftar Axhemi, 24-25 vjet, thatanik edhe pa ju mbushur syri njeriut që munt të ishte i zoti për komit. Me gjithë këto Myftari me të u-hasur me neve nuku donte të ndaheshe, me as nonjë mënyrë, prej neve, kështu që çdo bindje



ishte e kotë edhe më tjetër anë lutjet e s'ëmës tije pranuar në çetë t'ënë, si u betua për liri.

Mbrëmanet ardhë, nga Kardhiqi, Abdyl Mersini i shoqëruar me Bajram Pergjinë. Abdyl, siç dijet, q' u bë shkakëtar pa dashur i shokëve, 1906, që u-përndanë, e u hojnë në Misiu ku e mbajtnë gjithë dimërin, Jon Vruhoja me Thanas Tashkon. Në verë u-hoth në Shqipëri po me mos u hasur me neve vepëronte reth Gjinnokastrës edhe Delvinës.

Si ndejmë 6 dit, në Gjinnokastrë. shkuam në Mashkullor, në shtëpi të Zemanit edhe të tjerëve, ku na pritnë fort mirë, pastaj dyke shkuar nga Monastir' i Cepos, vëmë në Kardhiq. Kardhiqot t, të cilët kishin ndjenja kombëtare, na pritnë me gëzim të math edhe na gostitnë fort mirë. Në Kardhiq na u shoqëruan edhe dy djem të rinj, 20-21 vjeç, Suloja nga Kardhiqi edhe Pirua nga Zhulati, i cili ishte millona (mullxhi) afër Kardhiqit. Nga Kardhiqi u hojmë në Zhulat edhe hojmë në shtëpi të Veipit, një nga të rallët kombëtarë edhe propagandistë, i cili na priti edhe gostiti princërisht. Si na ftuan edhe të tjerë Zhulatas u kthyem prapë në Kardhiq, në Pergji, Plesant, në shtëpi të Sadikut, Mashkullor edhe në Gjinnokastrë dyke lidhur fshatrat në besë, për të i shërbyer atdheut me çdo therori.

Prej Gjinnokastre u-hohtmë në Dropull dyke nisur fshatrat me radhë, që në Kalorçë në Lazarat, Dervican, Goranxi, Bodrisht edhe Bularat, ku na priste populli, tek do, me kënaqësi të madhe. Në Bularat hasmë edhe Ito Lekdushin, i cili po na kërkonte gjyrmat për të u shoqëruar me neve, si kundër që edhe bëmë. Që këtë u hohtmë në Luvinë, në çiflig të Refik Budos.

Stanet ishin në për fushë kësisoj që na prisnin që të gjithë me dashuri të madhe. Alim Karagjozi, një nga të pasurit e Gjinnokastrës edhe prej një fisi me Topullenj të, na priti me gëzim të math, në stan të tij, edhe dha urdhër barinjvet që stani çshtë yni kurdoherë! Mjerisht, në këto kohëra, shirat ishin të pareshtu-



ra edhe dëme të mëdha u-bënin barinjvet, me qënë që për dita u ngorthnin shqerat e vogëla.

Nga shkaku i kohës pra u shtrënguam të rimë në Luvinë 8 dit, pastaj vajtmë në stan të Bukuvales, ku Bajram Pergjia na ka bërë ca gjellra të paharuara, me qënë që Bajrami kish qënë gjellëtar në një Pasha kur ish në sherbim ushtëriak. Që këtej muarm malet për-pjetë dyke vizituar Monastiret të Pepelit, të Drianos edhe të Derviçanit. Igumenët, të dëshpëruar edhe të mërzitur nga kusarët, na prisnin me kënaqësi edhe na gostitnin me gjithë të mirat që kishin.

Mjerisht, në Manastir të Drianos ishte thënë që të na ngjasë një ngjarje e tmershme, e cila na pikëllojti fort tepër po, lumtërisht pa nonjë humbje. Monastiri i Drianos është ngrehur në ca male të lartë edhe të fortë edhe është një Monastir i pasurë. Nga shkaku i kosarëvet, q' e vizitonin dendur, qeveria kishte lënë një xhandërma si mprojtës të Monastirit, prandaj vamë nga të gjithë dyke priturë që të hapesh porta.

Me të dalë i pari shërbëtor e zumë dhe na kalli brënda në dhomë të xhandarit të cilin e xgjuam, nga gjumi, pastaj u përshëndoshmë. Ishte një burrë i urtë edhe i gadalçmë edhe yshqente nājjenja kombëtare prandaj na u lut mos i bëjmë nonjë dëm Monastirit edhe t' e mbanim të fshehtë vizitën tonë që të mos e dënonin.

Shërbëtorët i xgjuan nga gjumi të mëdhenjtë edhe i lajmëruan për vajtjen tonë, kështu që doli një kallugre edhe na thotë që Igumeni mungon, nga Monastiri, po ajo na ftojti në një dhomë të madhe. Urdhrojti shërbëtorët të ndezin zjarë edhe ajo vetë na pregatiti ca të ngrëna, të mëngjazit, me qënë që ishim tepër të urtuar pas një udhëtimi të gjithë natës.

Pas pakë kohe çfaqet edhe Igumeni, i cili nuku mungonte po ishte fshehur, nga frika, se mos ishim njerës të liq, po me të mësuar, nga kallugreja, që ishim njerës të mirë ardhi në dhomë edhe na urojti mirardhje. Ndënji në krye, siç e nderonim, edhe nga

bisedimet që bëmë kupëtojti qëllimin dhe programin tonë prandaj tepër i kënaqur me vrap urdhrojtji të na pjekën dy berra edhe të na pregatitin një tryezë të mirë.

Dëfryem kaqë mirë sa nuku tregonet edhe do të qëndronim e ca dit, me dëshirën e madhe që kish I-gumeni, po të mos na ngjiste një ngjarje e tmershme. Si hëngrëmë bukë shokët duall përjashta për të shtënë në qëllim, pa si ishin në siguri të plotë se Monastiri i Drianos është rethuar me fortesa natyrale e nuku na trëmbeshë syri nga çdo rezik. Tek po qëllonin shokët për të u stërvitur ca më mirë, nënë verejtjen të Çerçizit, siç bënim kurdohere në vënde të forta, vjen ruajtës i Monastirit edhe i flet me zemërim Çerçizit.

Çerçizi i përgjigjet që të shohë punën po Çelua, siç quheshë ruajtësi, nga Lazarati, vazhdon të bërtasë, qaqë shumë sa Çerçizi, me mos duruar, e goditi kur Çelua nxjer gjashtoren gati për të qëlluar Çerçizin. Me vrap atëhere Zemani nxjer kamën edhe ja klllet nënë hije Çelos i cili ra për dhe!

Në këtë kohë unë flinja kur vjen Abdyl Mersini i cili më xgjon nga gjumi edhe me hidhërim më tregon gjemën e madhe që kish ngjarë. U helmuash pa masë e, pa humbur kohë, vrapova tek i plagosuri për të i dhënë nonjë ndihmë. E xhveshmë edhe shoh që plaga ishte mjaft e madhe edhe gulçimet të të plagosurit më tmeronin. E ngritmë q' atje edhe shpëmë në një dhomë ku e lava mirë me aqid-borik edhe aqid-fenik pastaj si e kripa me jodoform e pasata mirë, dyke e ngushëlluar të plagosurin që s' ka gjësendi.

Gjithë atë ditë ishim të pikëlluar edhe të helmuar, për këtë ngjarje të papriturë, u-menjtuam pra që e ndenjura tonë në Monastir ishte në rezik edhe vendosmë që të shkojmë. Me të ngrysur i lava, përsëri, plagën Çelos edhe me sa që kupëtonja nuku shinja nonjë rezik, pastaj e muarm Çelon në dhomë tonë, ku e paqtova me Çerçizin e me Zamanin, që të mos mbeteshë nonjë armiqësi, midis tyre, nga shkaku i gjakut. Hëngrëmë së bashku bukë pastaj muarm lam-






stumirë edhe shkua, dyke porositur xhandarin që të vinte të lajmëronte qeverinë për këtë ngjarje, pa fjalë që t' u thosh se ca njerës të liq plagosnë ruajtësin kur se ajy nuku ndodheshë atje.

Me vrap nisen nga Gjinokastrë Doktorin me një rëzit e qeverisë, për të anqetuar këtë ngjarje, si edhe shumë Luzitas, burra e gra, nga far' e fisi i Çelos, edhe venë në Monastir. Doktorin me të parë pansamentin e lthe barat (ilaçet) mbeti i habitur edhe tha që këto janë bërë prej dorë mjeshtëri, prandaj në Labëri m' u përhap fama Doktor Mihali. Edhe kishin arësye se, me qënë që unë kisha xhantën me barrat, shumëve u kisha shëruar kokën me aspirinë! Taksirati m' i math u veperua për të gjorin Xhandar, të cilin e burgosnë dy muaj.

Kur se këto ngjisnin në Monastir të Drianos Bimbashi i Gjinokastrës (Kumandar i xhandarmerisë) kishite vënë një shtrëngim të math dyke sht në tmerë, popullit, sa që pandeheshin me ndjenja kombëtare. Komiteti i Gjinokastrës ishte tepër i dëshpëruar prandaj dërgojti Idris Gurin që të na lajmëronjë se 30 shpirt, nga qarku i Përmetit, i kishin sjellë në burg, midis të cilëve t' atnë edhe të vëllanë të Haredinit. Idrizi, veshur oficer, arriti me të perënduar të djellit në Monastir të Drianos ku na gjeti të helmuar për ngjarjen e tmersme.

Biseduam gjër' e gjatë edhe përfunduam, me çdo mënyrë, vrasjen të Bimbashit! Idrizin e përcuallmë në Gjinokastrë edhe neve shkua në për male gjer arri më për mbi Gjinokastrë.

Dy herë vajtnë në Gjinokastrë Haredini me Asllanin, për të vrasë Bimbashin, po, mjerisht, nuku patnë fatin me qënë që nuku e gjetnë. Kur se deshnin të vinin të tretën herë na ngjajti një episod. Labërit, domethënë shokët t' anë, kishin biseduar veçanërisht e kishin vendosur që Bimbashin t' e vrasin Labërit, se e kishin për turp t' u këndohet kënga Toskëve! Domosdo e pranua këtë vendim edhe këtë barrë e muar përsipër Ito Lekdushi me Bajram Pergjinë.



Ishte e hënë, 25 Shkurt 1908, ditë tregu, kur u nisnë Itoja me Bajramin për në Gjinokastrë, si i veshmë me roba tregtari. Pas pllanit, që kishim bërë, ata rynë me orënë 8 në qytet, Selfua me Haredinë vanë më orënë 9 ndanë qytetit edhe Zemani me Asllane vanë në Qimitir, të Krishtëreve. për të improjtur shokët kur të delnin nga qyteti. Çerçizi, unë, Abdyl, Myftari edhe Pirrua qendruam në breg që të mpronin shokët nga ushtëria kur t' i ndiqte.

Pllani ishte fort bukur përgatitur prandaj sytë edhe veshët i kishim qepur për mbi Gjinokastrë dyke pritur, me padurim, fërshellimin të pushkës. Çdo sèkundë për neve ishte një mot edhe çdo lëvizje e vogëlë, që të bëheshe, na rihte zemrat. Më orënë 11. 15, koh' e drekës, dëgjojmë të zbraza prej bushke edhe pas pakë sekunda shohim Iton me Bajramin që të dalin, dyke rendur me gjashtorët në dore, nga qyteti.

Haredini me Selfon, më të parë shokët të shpëtuar edhe lajmërohen për vrasjen të Bimbashit, u qëndrojnë dëitareve të Yqmetit edhe i bëjnë cop-copë, pastaj marin rugën që të vinë lek neve. Zemani me Asllanin qëllonin edhe ata, nga Qimitiri, për mbi Yqmet, dyke shtrënguar të mjërët nënëpunës që të kërkonin vrima për të u drojtur nga nonjë plump!

Nuku shkojti shumë kohë kur xhandarë, ushtarë edhe Policia dalin me nxitim të math dyke ndjekur shokët t' anë, të cilët munt që edhe t' i vrisnin, me qënë që ecnin fushës, po të mos ishim neve në breg. Me të parë pra ushtarët, u hapim një zjar të reptë për mbi ata. kësisoj që i shtrënguem të mos lëvizin, nga vendi, po të qëndrojnë vëndit gjer sa arrinë shokët në mal ku ishim neve në siguri.

Këjo luftë mbajti 2 orë pastaj, me të u mbledhur që të gjithë, puthmë trimat, që na nderuan neve e gjithë kombin, edhe si u përgëzuan midis tonë muarim malet. Kur arrimë në siguri të plotë qendruam pakëzë, për të u qëlodhur edhe thëthirë nga një cingare. Q' atje vërenim ushtarët kur u ngjitrë, në breg, nga



kishim lëftuar, edhe bënin kërkime dyke mbledhur fisheskët të zbrazura.


Me të ngrysur u rëzuam në Mashkullor e q'andej muarm malet e lartë përpjetë, për të dalë në male e Kardhiqit, ku ishim në siguri. Gjithë atë natë si edhe të nesërmen e shkuam pa ngrënë gjesendi përveç dyke thëthirë dborë, e vetëm me të perënduar të djellit u rëzuam në Kardhiq ku na gostitnë kardhiqotët.

Vrasja e Bimbashit u prit me një gëzim të pa treguar, nga ana e gjithë popullit, i cili na uronte, nga thelb' i zemrës, se muntmë t' e shpëtojmë prej një Tyrku të lik edhe tiran dyke tmeruar popullin, me faj ose pa faj, me qënë që ishte një Shqiptaromah i math!

U këshilluam midis tonë edhe vendosmë që hëpërhë të qëndronim në malet e Kardhiqit për të shëkuar çfarë masa do të mereshin kundra nesh, nga ana e qeverisë. Muarm malet po duheshë që të kapërxenim një rip të ngushtë shumë, edhe kjo ishte e vetëmja udhë, të cilën e kishin për të fshehur bagëtinë nga xhelepi. Përveç ngushtësirës ishte tepër e rezikçme, me qënë e lartë për mbi 200 metra edhe një gabim i vogël të rekulliste nëpër shkëmbinjte, kështu që të mos shëkonje kurrë të kurrës djellin me sy!!!

Me gjithë këto duheshë kapërxyer me domosdo se të vrisnin shokët, me arësye, për të mos rënë në dorë të ushtërisë, andaj e shkova si të Postenanit, 25 Dhe-tor 1907, dyke më marë në mest e për dore Asllani me Zemanin. Mos pandehni se unë isha ajy më frikanaci. Jo; kishim e shokë të tjerë, të cilët ishin ritur në këto male edhe, shumë herë, kishin frikë të shkonin në për ca ngushtësira më të mira që unë i shkonja pa frikë.

Si kapërxyem ngushticën, të Kardhiqit, duallm në një mal të gjërë me lisa e plot vrima e llagëme natyrale. Ishim pra në siguri të madhe se edhe 2,000 ushtarë nuku kishin se çbënin, arrinte vetëm të kishim fisheskë edhe të ngrënë! Këtu u sëmura unë fort rëndë po, lavdi Zotit, Asllani me Zemanin u përkujdesnë si



nëna për fëmijën e saj. I gjori Abdyl Mersini, në mest të rezikut, u rëzua në Kardhiq që të më sjellë mua fasule të thata se më ishte shtënë, edhe për çudi të madhe, me të ngrënit të fasulevet u shërova!

Këtu ndejmë 3 dit ku shiu binte i parreshturë, po duheshe të shkonim të përndarë, domethënë të bëheshim 2 çeta, se u vinte rëndë kur vinim në përmiqtë gjithë së bashku, edhe më tjetër anë pandehnim për më mirë. Lithmë fjalën midis tonë që me të çelur gjethi edhe me të u-ngjitur stanet, në për malet, të bashkoheshim në Çajyp edhe të vendosnim për të vepëruar ndryshe. Pa si u lajmëruam që ushtëria, e cila kishte dalë kundra nesh, pas shumë kërkimi u kthye në Gjinokastrë u puthmë edhe tepër të mallëngjyer muarm lamtumirë njëri nga tjetri. Qerçizi mbeti vet' i shtatë edhe Abdyl vet' i katërtë, shtrënguan pra edhe nga një herë duart edhe u përndamë dyke lutur Përendisë të na mpronjë edhe bashkonjë për së shpejti.

Qerçizi me neve u-rëzuan në Mashkullor që të mirte Zemani shëndet, nga shtëpia, edhe ca më tepër të mërnim duhan se kishim mbetur pa cigare. Qëndruam 2 orë edhe u ngromë pakëzë e deshmim të shkonim, po një errësirë e madhe me erë të marë edhe me shi si edhe sigurimet të Mërtes, ati i Zemanit, që nuk ka nonjë rezik na shtrënguan edhe na bintnë të qëndrojmë atje.

Ishte thënë prej Zotit që të nderohen armët e Shqipërisë!

## KRYE E VI.

### **Lufta e Mashkullores.**

Duhashe të mos ndodhesha unë që të mirnja anë në luftën e Mashkullorës, se fuqia t'eme është e dobëtë për të përshkruar e zugrafisur ashtu si kundër ngjajti. Duhashe pendë historiografi, të sosur, duhashe penda e një mjeshtëri të vërtetë, duhashe të ndodheshe një skencëtor ushtëriak edhe duhashe që të ndodheshe



një kqyrës i luftës se vetëm atëhere do të përshkruanin të vërtetën.

Vetëm e vetëm këta do të muntnin që të përshkronin edhe zugrafisunin hollësisht, këtë luftë e cila meriton një histori të tërë, se vetëm atëhere do të mësonte edhe kupëtonte, pritmja e kombit t'ënë, që qysh dinin të mbushin detyrën e tyre, për atdhenë, dyke lëftuar, si qëmoti, për të ulënë bijvet tyre lirinë me flamurin të shenjtë që të valonjë për mbi Shqipërinë!

Fati pra e kishte rojtur për mua që të ndodhem atje edhe të mar pjesë në këtë luftë, për liri, prandaj kërkonj ndjesë këndonjësvet që nuku munt të mbush këtë barrë, me gjithë hollësitë, dyke lënë të tjerëve, të zotërit për këtë, që t'ë përshkruajnë edhe rëfejnë të gjallë siç meriton edhe qysh ngjajti lufta e Mashkullores.

Do të përpiqem me sa më është e mundurë që të përmbledh me pakë fjalë ngjarjet të kësaj lufte, e cila ka për të mbetur e paharuarë edhe historike, në historin' e ringjalljes të Shqipërisë, se trimëri e kësaj lufte do të mbetet shëmbëll, për pritmjen, se nderuan armët e Shqipërisë si në kohët e Skënderbeut.

Ishte e martë brëma, dyke u-gdhirë e merkurë 5

Mars 1908, kur ramë të fleme të qetuar që s'ka gjesendi. Edhe me të vërtet gjithë natën as nonjë shenjë nuku kishim kuptuar që ishim të gjurmuar, po kur ngrihet Çerçizi heth sytë në dritare edhe më thotë: Mihal ja shih djem shkollë janë a njerës?

Vështronj po nuku xgjidheshin mirë, kurse Çerçizi me të hedhur dylbinë bërtet: O burrani shokë se na rethojti ushtëria!

Në këtë fjalë ngrihen të tmeruar gjithë shokët edhe me vrap rëmbyen trajstat. gunat armët edhe ca të mbathur e ca të xbathur u-rëzuam në katua e q'atje dyke kapërxyer një mur duallmë përjashta. Atje pamë që ishim në rezik të math po të delnim në shesh, prandaj muarmë një përrua të thellë shumë, plot me shkëmbinj edhe plot me ujë.



Në krye ushtëria nuku na vërejti as pak, me qënë që ata drejtoheshin tek shtëpia, edhe kësisoj do të mos ishim goditur po të mos u-bërtite një tradhëtor edhe t' u tregonte rugën tonë. Ky bukurosh tradhëtor, na kishte mësuar, siç duket, se me të vajtur në Gjino-kastrë sa që kishte arrirë ushtëria edhe i lajmëron për neve, kështu që me vrap i dërguan, nënë kumandë të Oficerëvet Nexhadin edhe një tjatri.

Kur se shkonim me nxitim, në përua, përnjëherësh dëgjojmë buçimin të trumbetës edhe me vrap zunë plumbat të na shkojnë për mbi krye dyke fëshëllitur! Ah! ishte një moment që nuku munt t' e tregonj dot! Zëri i trumbetës, të cilin e dëgjonim për të parën herë kur urdhronte zjar, na tmerojti tepër se ishte një zë i tmershmë, një zë që na ngrinte leshrat përpjetë se me të vërtet ishte zëri i vdekjes!

Gjithë kësisoj edhe fërshëllim' i pushkavet që vinin si breshëri, për mbi krye, na shurdhonin veshët, po, dyke i dhënë shoku shokut kurajo edhe dyke rënë ku këtu ku atje, u mësuan edhe nuku na bënë nonjë përshtypje!

Ushtarët dyke u-rëzuar që përpjetë na e prenë udhën edhe do të na kishin vlarë që të gjithëve po të mos ishin Çerçizi me Asllanin, të cilët me të shpejt, nga këmbët, nxitonin edhe munt në të zenë një haur të rëzuar ku vetëm gurët kishin mbetur. Q' atje me vrap u hapnë zjar ushtarëve dyke shtirë dy prej tyreve kështu që ua prenë hovin e sulmin edhe kësisoj munt në të arrimë e neve gejr atje.

Vërtet arrimë po, për fat të zi, jo të gjithë. Haradin Tremishti me dy pashë lark meje për nder të Shqipërisë edhe të Krisë! Një plump i armikut i kishte shpuar kryet tej-përtej, edhe shpirti i flytyrojti në qell! I rashë me këmbë që të ngrihet po ay nuk lëvizi. I hodha sytë që t' e shoh, për të fundit herë, edhe pashë që një bukuri prej engjelli i kishte rënë mbi fytyrë e zbriturë prej qelli. Psherëtita edhe ngri-ta sytë në qell dyke ju lutur përëndisë t' e ketë në



prehje shpirtin të Haredinit, të atij djaloshi trim, guximtar edhe të urtë që ra dëshmor, dyke lyer me gjakun e tij lirin e Shqipërisë!

Historia kombëtare le t' e ketë në gji të saj emrin të këtij dëshmori trim, edhe të rinjtë le të marën shëmbëll nga Haredin Tremishti që ra mbi alltarin të atdheut për lirinë të Shqipërisë!!!

Kur arriva unë në shokët edhe më pyesin, për Haredinin, të gjithë u-pikëlluan edhe derdhë lote për gjëmën e madhe që na kish gjetur. Po Çerçizi e mbloodhi veten edhe thotë të rronjë Shqipëria se edhe neve gjithë si Haredini do të vritemi po o burrani shokë të zemë vënde që të lëftojmë burrërisht. U regulluam dyke marë ballën Çerçizi, Zemani edhe Myftari, unë me Asllanin muarm anën për të u mprojtur krahët, nga armiku. Sa për Iton dyke kërkuar të zinte vënt, në një mur të një are, ushtarët ja prenë rugën edhe kësisoj u aratis.

Më orën 7 zuri lufta e regullshme edhe e reptë. Ushtëria ishte përhapur edhe na kish rethuar nga gjithë anët, edhe q' andej na lëftonte. Nuku dua të shtonj po, për kundrazi, të pakësonj numrin të ushtërisë që përbëheshe më teper se 150 shpirt, kur se neve nuku ishim, siç dijet, pesë shpirt. Për veç kësaj nuku duhet haruar që neve bënim ikonomi të madhe në fishekët, se gjithë një Çerçizi bërtiste: mos harxhoni o shokë fishekët më kot.

Plumbat na vinin si breshëri po neve qëndronim si ca statuta, në vëndet tona, edhe u përgjigjeshim me plumba, po dyke qëlluar edhe me këngë kombëtare.

Kërkonj ndjesë se më mungon fuqia, e duhur, për të treguar, xbukuruar edhe stolisur, siç meriton, burërinë edhe trimërinë që tregojti trimi ynë Kapitan, luftëtari i math edhe i patrembur që nderojti armët të Shqipërisë! Po; Kapitani tonë i shtrenjtë, Çerçizi, u tregua si një dragua në këtë luftë, kështu që historia kombëtare do të mburet me emrin të këtij djali të ri, po burri të math, të Shqipërisë.



Vetëm edhe vetëm atëhere munda të besonj historinë të kombit t'ënë, me burrërinë edhe trimërinë të stërgjyshëvet t'anë. Atëhere vetëm munda të kupëtonj e të çmonj vleftën të këtij djali trimi të cilit, me gjithë që ishte ritur i përkëdhelur, nuku i trëmbeshe syri kurrë nga vdekja!

Xbathur lakuriq, karos, me leshrat përpjetë vërtiteshe më gjithë anëtë si një kumandant i math, me pushkën në dorë edhe gjashtoren në dhëmbë dyke na burrrur neve edhe dyke qëlluar mbi ushtëtarët! Fytyra e tij, këtë ditë, ishte m' e çelurë se kurdoherë, edhe jo si kur lëftonte po si kur këcente.

Shumë herë e qërtonja edhe këshillonja që të mos nxirte kryet përjashta, nga mprojtjet me gurë që kishim forcuar, me qënë që Qerçizi shumë herë nxirte kryet përjashta, që t'u fliste ushtarëvet, Tyrqisht, që të iqeshin më një anë edhe mos vriteshim vëlla vëllanë. Oficerët prapë i ftonte të dalin në shesh e të lëftonin, një për një, po ata të fshehur i përgjigjeshin me dinakëri e me fjalë të ëmbla që të jepemi se u vinte keq të vritemi, dyke u zotuar jo vetëm falje po edhe nga një *Rytbe* të madhe nga Patishahu!

Me këto mënyra Anadollakët përpiqeshin të na humbasën guximin e të na demoralizojnë, prandaj Qerçizi dyke i sharë rëndë, nxirte kryet edhe u thosh: jepmi bijt' e Skënderbeut edhe nuku jepemi po do të lëftojmë gjer në orën e fundit se Shqipëtari di të vdesë, pas zakonit, me nder për atdhenë. Mirpo ushtarët këtë prisnin që të nxirte pakëzë kryet Qerçizi që, pas urdhërit që kishin, me vrap të shtinin që të gjithë për mbi atë.

Ah! edhe sot e sjell nër mënt tmerë të math që kam ndjerë kur pashë Qerçizin që t'i derdhet gjak prej ballit, edhe i verdhë si dylli i thom me dëshpërim: E ç' na bëre more derëzi që na preve krahët? Pse nuku dëgjon këshillat e mija po të gënjyen Tyrqit gjer të plagosnë? Vrapova t'i jap ndihmën e duhur kur Qerçizi dyke fshirë gjakun më thotë: mos u -dëshpëro





Mibal se nuku jam plagosur po një ciftë, prej guri, më goditi edhe me zemërim qëllon ushtarë q' e kish qëlluar edhe e shtriri për dhe.


Çerçizi qëllon kaqë mirë sa të rallë besonj të ndodhen të këtillë qëllonjës. Një ushtar, i cili kishte zënë një vënt të fortë, e vravi edhe mbeti i mbërthyer vëndit, po Çerçizi e pandehte të gjallë prandaj sa herë që vërtiteshe e qëllonte, kështu që e kishte shpuar, me radhë 16 herë në krahëror!

Kësisoj luftuam gjer në orënë 2 pas dreke kur dëgjojmë trumpetën të buçasë. Gjer në atë kohë ishin vrarë 8 ushtarë edhe buçim' i trumbetës kishte shënim që të mblidhen ushtarët. Neve pandehmë që do të shkonin edh' u gëzuam, po oficerët i mblodhë që t' u japin të tjera urdhrata se pa shkuarë as 5 sekunda nisi, në buçim të trumbetës, një luftë kaqë e reptë sa nuku tregonet. Plumbat na vinin rëke si breshëri edhe të pareshtura, kaqë dëndur, sa nuku muntnim të xbrazim dot nonjë pushkë.

Pllani i oficerëvet ishte që shumica e ushtarëvet të mbante një zjar të pareshtur kur se pakica, nënë hije të plumbavet, të afroreshë edhe të na shtrëngonte të jepeshim ose të na vrisnin. Ky pllan ishte fort bukur pregatitur, po guximtari edhe trimi ynë Kapitan Çerçizi me gjashtoren, prej 10, si nonjë luan i qëndronte që të mos afroreshin dyke na thënë edhe neve që të shtijem, verbërisht, për të i frikësuar edhe mos guxojnë që të afronen pranë nesh.

Këjo luftë, kaqë e reptë, mbajti gjer më orënë 4-5 edhe pastaj, si e panë që pllan' i tyre nuku u solli nonjë dobi, zunë t' e rallojnë edhe ca nga ca të hiqen, të lodhur, të lagur edhe të dëshpëruar dyke lënë edhe dy të vrarë!

Në këtë luftë na u plagos Myftari, i cili lëftojti kaqë trimërisht sa na habiti të gjithëvet. Aqë më tepër unë jam çuditur, me qënë se kur na u shoqërua Myftari pandeha që do të ishte një barr' e rëndë, për neve, se dukeshë m' i pafuqishmë nga mua, po, mjerisht,



isha i gënjyer, në besimin tim, se në këtë luftë Myftari tregojti që me të vërtetë i rritte gjak, prej Shqipëtarit në rembat e tij. Pa u drojturë, pa u trëmburë as pak lëftojti si një dragua!

Kur u plagos u hoq pak më një anë edhe dyke qeshur na thotë: më gërvishtnë pak të liqtë. Unë u trëmba edhe me vrap i shtrëngoja plagën me një brez, pa e xveshurë, edhe dyke i dhënë guxim i thom që s'ka gjësendi, po Myftari më përgjigjet burrisht: e ç' do të ketë, mor Mihal, më tepër se një vdekje për nder të Shqipërisë!

Plaga zuri t' i ftohet edhe ahëre zuri të ndjente dhemka prandaj i gjori Myftar, na lutet që të mos e lëmë të gjallë e të bjerë në dorë të ushtërisë po t' i marim kryet. Të mallëngjyer e të dëshpëruar, për gjendjen të Myftarit, ishim fort shumë, po duheshe t' i japim kurajo se shpresën nuku e kishim humbur.

Me qënë që lufta u rallua, edhe vetëm kur e kur na vinte nga nonjë plump, shkundmë xhepat për të mbledhur fundrat e duhanit edhe kësisoj muntmë të bëjmë një cigare të hollë, nga e cila thëthimë që të gjithë nga një herë përveç Myftarit q' i lamë gjysmën. Këjo ishte e vetmja cigare që kemi thëthirë atë ditë! Sa për të ngrënë nuku kishim as një kafshitë! Përveç luftës e mungesës të bukës e duhanit gjithë këtë ditë e kemi shkuar me shi edhe me breshër.

Më orënë 5 vjen Mytesarifi, (Prefekti) nga Gjynokastri i rethuar me zyrtarët të ushtërisë, Doktorë edhe Farmacistë për të u dhënë ndihmë të plagosurve. Prapa tyreve ardhin tjetër ushtëri e përzjerë me xhandarë, për të çkëmbyer ushtarët e parë të cilët, të dërmuar nga lufta e nga shiu edhe dyke lënë 10 shokë të vrarë, shkuan pa nonjë regull për në fshat.

Mytesarifin si e nga zyrtarët edhe ushtarët munt që t' i qëllonim edhe t' i vrisnim shumë lehtë nga ata, me qënë se vinin drejt neve, po dyke pandehur që pësimi i të parëve, do t' i bëheshe mësim, kur se ushtarët, pa një pa dy, zunë vënde në repat edhe na hap-



në zjar. Të shtrënguar, atëherë, u përgjigjmë edhe neve me zjar, po më përpara i këshilluam që të mos lëftonim.

Mjerisht, këshillat tona nuku i dëgjuan edhe lëftuan gjer sa u ngrys dyke lënë këta 3 të vranë. Të këtillë funt mori lufta e Mashkullores më 5 të Marsit 1908. Midis të pafajshmëvet edhe të mjerëvet ushtarë, q' u vranë e mbetnë lark atdheut tyre, u vra edhe i fëlliquri trathëtor dyke marë, prej Qerçizit, një plump në ballë për ç' pagimin të trathëtisë!!!


## KRYE E VII.

### Shpëtimi nga rethimi.

Errësira e madhe mbretëronte edhe kur e kur dëgjoheshe nga nonjë zë prej pushke, me qëllim, siç duket, që të na mbanin atje gjer nesër. Kjo ishte më shumë se sa vrasja prandaj këshillohemi gadale edhe vendosmë që, me domosdo, të dalim, qoftë që edhe përpiqeshim gjekundi në nonjë prite me ushtarët.

Trimat të palodhurit edhe të patrëmburit Zeman edhe Asllan, të cilët gjithë ditën lëftuan burrërisht, si në kohët e qëmoçme, duall gadale edhe bënë një kërkim, për qark, pastaj ata përpara dyke qeruar udhën edhe Qerçizi, unë edhe Myftari në mest shkuaam gjer sa arrimë në lumë. Për të humbur çdo gjyrmë, të ushtërisë muarm lumin, për mest, edhe me Myftarin kaluar mbi kuris, të Asllanit edhe Zemanit, arrimë në kasolle të çifligut Dino Çiqos, ku rinte një evgjiti me shtëpinë.

Evgjiti më të shoqen na pritnë me gëzim të matë se na dinin të vranë, siç ishte përhapur në Gjinokastrë. Nga këta mësuam për ushtarët e vranë, po një numur të shtuar edhe dy herë, si edhe për të plagosurit. Si u ngromë pak edhe ndezmë nga një cigare muarmë veten, pastaj, gjer të na bënte bukën evgjitka, unë e xvesha Myftarin, e lava me acid-fenik, i vura idoform edh' e pansata mirë. Plaga nuku ishte e rezikçme, me



qënë që plumbi nuku e kish çpuar shumë thellë, po kish nevojë për prehje edhe kërkim më të mirë, nga Doktorët.

Ndejmë u ngromë mirë pastaj na vunë tryezën për të ngrënë bukë. Që të përshkruanj këtë tryezë me gjithë hollësitë më është e pa mundurë, vetëm arrin të mendohet njeriu që hanim pas 30 orë edhe pas kaqë mundimeve edhe reziqeve.

Të urtuar ju shtruan tryezës edhe hëngrëmë një tenxhere plot me fasule, të cilat nofta evgjitrit i kishte hazëruar për një javë që t' e hanin me fëmijën. Këtë gosti mbretrore — siç ishte për neve — kurrë edhe kurrë do të mos e haronj, se në jetë time kurrë nuku mbanj mënt që të kem ngrënë me kaqë shije të madhe! Me të mbaruar së ngrëni u përgatitëm për të shkuar edhe i gjori evgjit na dha një palë opinga, prej të tijat, se ishim xbathurë, një kartë me duhan edhe bukë me qepë.

U puthmë edhe muarm lamtumirë dyke u falënderuar për mirësin' e tyre, pastaj shkuam dyke ju lutur evgjitit të vejë në Gjinokastrë. për të gëzuar atdhetarët që shpëtuan shëndoshë edhe të na dërgonin 2-3 palë opinga e të ngrënë, në mal të gjërë.

Muarm malet edhe vamë për mbi Gjinokastrë, ku limerjosmë. Vetëm atëhere muntmë të gjykojmë prej çfarë reziku të math kishim kapërxyer, kështu edhe rëndësirën të luftës nga e cila na shpëtojti edhe nderojti Zoti, për nder të Shqipërisë. Ramë të flemë po gjumi ku na zinte? Mundoneshim me çdo mënyrë po me kot se nuku na qepeshin sytë. Buçim i hutavet edhe fëshëllim' i plumbavet na shkonin akoma në përveshët! Përpara syve na çfaqeshin gjith' ushtarë me hutat në dorë edhe me robot të zeza! Zër'i trumbetës na tmeronte me atë buçim, të tmeruar, për zjar! zjar! Edhe për mbi këto pamje fytyra e Haredinit flytyronte e çelurë për mbi nëve!

Gjithë atë ditë e shkuam të lagur qull se kishim frikë të ndiznim zjar nga frika e ushtërisë. Pritmë



gjithë ditën të vinte njeri, prej Gjinokastre, me plaçkat që kishim porositur evgjitin po nuku u duk gjikundi pranë. Të nesërmet mësuam që kish ardhur Banushi, vëllaj i Çerçizit, po me gjithë vërshëllimet e kërkimet nuku na kish gjetur gjikundi edhe ish kthyer prapë.


Me të ngrysur, pas proponimit tim, u rëzuam në Gjinokastrë, se unë thashë që do të jemi fare në siguri, me qënë se nuku do t' u shkonte nër mënt, qeveritarëvet, që fshiheshim në qytet edhe ushtarët do të na kërkonin në për fshatrat. Përveç kësaj kishim edhe një barrë të rëndë me vete, ishte Myftari i plagosur edhe kish nevojë për prehje edhe për shërim.

Të raskapitur, nga këmbët e xbathura, të lodhur, të lagur qull edhe të urtuar u-rëzuam në qytet, mirpokus na priste në për shtëpitë? Tmeri u kish ngrirë gjakun, të gjithëvet, me vrasjen të Bimbashit edhe tani ca më tepër me luftën të Mashkullorës, kështu që tani druheshin të zenë emrat tona në gojë edhe jo të na qasnin në për shtëpitë!

Trokitmë, trokitmë edhe trokitmë në shumë dyer po as nonjë nuku na qaste brënda! Si cilido na vinte përpara nga nonjë shkak, dyke na treguar hidhërimin të math, që ndjente, me mos mundur të mbushte këtë detyrë. Kishin edhe arrësye të plotë se një e njojtur e këtillë, në qeveri, ishin të dënuar me vdekje e me djegje!

Më së fundi, të dëshpëruar, vamë në shtëpi të Resul Berberit i cili, lumtërisht, na priti edhe kalli brënda, po një e keqe, na ngjajti. E shoqeja e Resulit kur na pa u trëmp shumë edhe ra e drunjosurë. Me fërkime shumë edhe dyke treguar emrat të Çerçizit e Myftarit ardhni në vete. Resuli ish një plak i ndjerë po fort i vobekët. Atë pakëzë bukë, që kish i gjori, na e dha për të ngrënë, si kundër edhe dy tri fëngjij të qymyrit i vuri në zjar, që të ngronim duart se për të u tharë edhe ngrohur trupin ishte e pamundurë!

Të nesërmet, pas të lajmëruarit, ardhë të motrat.



e Çerçizit bashkë me t' emën të Myftarit edhe na sullë të ngrëna, të ëmbla, opinga fishekë, qylafë, duban etj. Gëzimi i tyre ishte i patreguar kur na panë të gjallë edhe na putnë në ballë, nga ana e trimëreshës nënë të Çerçizit. Burrëria edhe zemrëgjërësia e kësaj së nderçme plakë nuku ka rëfim. Kur ishim rethuar në Mashkullorë vanë gjithë far' e fisi, si edhe miqeshat, në shtëpi të Topullenjvet për të forcuar e ngushëlluar plakën e ndjerë, po trimëresha Hasoja, siç quheshe mëm' e Çerçizit, me një madhështi të madhe u falënderonte edhe u thosh: u lutem tepër, moj motra, të jini të çelura se unë nuku kam nevojë forcimi edhe ngushëllimi me qënë që trimi po më lëfton si burrat për Shqipërinë!

Vetëm atëhere, që Zoti mos e dhëntë kurrë, në qoftë që Çerçizi bije i gjallë, në duar të ushtërisë, ejani, edhe në më doni mua tregoheni, jo të më ngushëlloni po të më vrisni që të mos rronj e gjallë, midis shoqevet, si një faqezë! Po siç e di unë Çerçiziu ajy do të bjerë me nder i vrarë edhe atëhere ejani jy motra që të dëfrejmë edhe këcejmë, së bashku, se atëhere vdes e gëzuarë që na le emrin të patëlliqurë. Kështu kuvëndonte Hasoja, ajo trimëreshë plakë e ndjerë, ajo Kardhiqote që kish nxjerë, nga barku i saj, luanët e Shqipërisë, Bajon edhe Çerçiz Topullin!

Po edhe nëna e Zemanit, e cila e kish përpara syve luftën as pak nuku trëmbeshë po, për kundrazi, mburreshe me birin të saj që lëftonte për Shqipërinë, dyke thënë që po t' i vritet me këngë edhe me valle do t' e mbulonjë!

Trimëresha e ëma e Haredinit është për të habitur me burrërin' e saj, që tregojti, kur i thanë për Haredinin që u vra në luftë të Mashkullorës. As një pikë loti nuku u derth nga syt' e saj edhe as nonjë pshe-rëtim, po zuri t' i këndonjë këngë trimërie. Më vjen keq, tha, që nuku ju vra e Rizaj, vëlla me Haredinin, po ri i burgosur me t'anë në Gjinokastrë!

Kolonjareja, e ëma e Asllan Starjes, trimëreshë



si kurdoherë dolli edhe mburreshe dyke thënë që kështu dinë të lëftojnë bijt' e Skënderbeut, të cilët me gëzim e japin shpirtin e tyre, për Shqipërinë, dyke na n'leruar neve, nënat, edhe gjithë kombim!

Sa për Labëreshën, t'ëmën e Myftarit, është një çudi e madhe me këtë grua, e cila kur e pa të plagosurë e puthi edhe i tha: Më rofsh e prokopç, ore bir, që më nderove po edhe që të vriteshe prapë do t' e kisha për nder që re si burrë për nderë të atdheut.

Nuku do të harronj edhe të dashurën nënë t'eme, e cila është e njojturë në Korçë e gjetkë, si edhe në qeveri për burrërinë të saj. Ishte përhapur në Korçë që isha vrarë edhe unë e këjo lajmë përpëriteshe, midis grave, kur ajo mer vesh edhe me vrap vesh robat e reja dyke thënë që ka dasmë se Mihalit e martova më Shqipërinë!


Kësisoj mbureshin nënat e atyreve luftëtarë, të Mashkullores, prandaj edhe ata, një grusht njerës, qendruan burrërisht dyke lëftuar kundra një ushtërie të madhe, armike t'atdheut.

Si siguriam Myftarin në Sakua edhe ja rekomanduam Doktor Dinos, për shërim, me të u ngrysur muarm udhën që të vinim në Luvinë, në çiflig të Refik Budos. Abazi nuk ishte shëruarë edhe kësisoj e lamë në Gjinokastrë, ku e kishim lënë që kur se vëmë me qënë fort i sëmurë.

Mjerisht, nuku mundnim të arrinim në Luvinë, nga shkaku që këmbët nuku i çapitnim dot, nga të ftohurit, edhe gunat të rënda, nga të lagurit, nuku na linin të udhëtonim, prandaj u shtërnguam të qendrojmë në Dervican. Këtu vëmë në shtëpi të Tomas, bujku i Topullenjvet, i cili me patur shumë fëmijë na shpuri në haur ku qendruamë gjithë ditënë.

Me të ngrysur muarm udhën, mjaft' e gjatë, edhe arrimë më të gdhirë në Luvinë e limerjasmë në pyll, afër Monastirit. Në mëngjes lajmëruam Etemin, për ardhjen tonë atje, i vetëmi njeri që na dinte.

Nur ndodheshim në të këtiilla brenga edhe hidhë-



rime muarm një letrë, nga Misiri, prej Ion Vruhos i cili me fjalë patriotike na jepte kurajo, edhe na shkruante që për së shpejti do të na dërgonin ndihma.

Gjithë atë ditë muarmë edhe nga Bukureshti një letrë, prej Vasil Irakli Zografit, i cili na jepte kurajo edhe na dërgonte 25 Napoleona nga ana e Komitetit të Romanisë, me qëndren në Bukuresht.

## KRYE E VIII.

### Jeta egërsore

Në pyll të Luvinës duheshe të zinin jetë të re, një jetë monotone edhe një jetë të egërsirtë. Ushtëri e madhe plakosi edhe u-përhap më gjithë anëtë, vetëm e vetëm që të na zinte neve të gjallë ose të vdekur. Ky shtrëngim edhe forcim i math rithte nga qeveritarët e mëdhenj, të Stambollit, të cilët një tmer i math i kish pushtuar!

Vrasja e Bimbashit, në Gjinokastrë, edhe fama e luftës Mashkullores ishin përhapur, në Europë, dyke bërë gazetatat e mëdha një bujo të madhe kështu që qarqet e nalta, të Stambollit, zunë t'i japin një rëndësi të madhe lëvizjes kryengritëse Shqipëtare. Më tjetër anë u-hyri frika se në Shqipëri zuri një levizje e mbulluarë, në gjithë anët, për një kryengritje të përgjithëshme.

Të mërzitur, nga një rrojtje tiranike, zunë të menjtonen e të kupëtojnë, të mjerët Shqipëtarë, që dyke ruar këtë tirani kombi Shqipëtar ishte në rezik, me që politikanët e Tyrqisë për dita po e xvarosnin Tyrqinë në greminë. Mirpo bashkë me Tyrqinë ishte lidhur edhe fati i Shqipërisë, prandaj zunë të shkunden nga drunjësia e të njohin vetë vetiu që shpëtimi i atdheut qendronte në një kryengritje të përgjithëshme.

Pema dita me ditën po arrijeshë edhe nuku priteshe përveç se t'i jepnim zjar fitilit, po, mjerisht, neve nuku muntnim pa ardhur Bajua në Shqipëri, të cilin e prisnim pas një letre që na dërgojti.





Nga këto frikëra Tyrqit kishin lënë më nj' anë e në qetësi të plotë komitat Bullgarë edhe andarët Grekë edhe gjithë fuqinë e përkujdesjen e kishin hedhur kundra Shqipëtarëve. Dëshëronin pra edhe kërkonin që me çdo mënyrë të qendrojnë në lëvizje kryengritëse, të përgjithëshme prandaj kishin vënë gjithë fuqinë për të farosur çetat tona, kombëtare, edhe ca më tepër çetën t'ënë, e cila kishte marrë një famë të madhe, në gjithë anët e Shqipërisë!


Për këtë qëllim Tyrqit kishin taksur suma të mëdha, të hollash, shkalla të nalta edhe nishane (çmime) në trathëtorët, të cilët do të mbushnin këtë mision, të mërzitur e të fëlliqur! Pa dyshim që gjithë grackat e dhëpëritë anadollake u-përdorë, në këtë mest, vetëm e vetëm për të farosurit t'ënë!

Po përveç këtyrevet ishte edhe vizita e Imperatorit të Alemanjës Vilqelmit, në Sarandë, prandaj vinte nga gjithë anët ushtëri për të mbajtur më nj' anë qetësinë edhe më tjetër anë për të nderuar vëllamin të Sulltan Hamitit!

Këto gjëra na vunë në menjtëm të thëllë, prandaj, pas një bisedimi midis nesh, vendosmë që, për siguri, të qendrojmë ca kohë në këtë pyll. Pastaj ishim të nevojitur me domosdo, të prisnim që të lulëzonte edhe gjethi, për të lëvizur në malet, si kundër që me këtë mënyrë do të humbisnim gjyrmën t'ënë.

Këtij pylli veç se ay q' e ka vizituarë munt t' i japë rëndësirën e duhur, prandaj shtrëngohemi që t' e përshtkruajmë vetëm me pak fjalë. Një pyll kaqë i dendur sa vetëm nonjë shpesh ose nonjë gjë e vogël munt t' e shkonte, se tjetërsoj edhe nonjë qen po të shkonte ishte e pa mundur që të mos ndjeheshë. Nuku ishte nonjë pyll nga ata pyje me lisa të trashë, po me dëllinja dyke patur midis tyre edhe nga nonjë lis të trashë.

Në këtë pyll kemi rrojtur 45 dit të nëmëruara, që më 10 Mars e gjer më 25 të Prillit. Në këtë kohë nuk pamë as nonjë ditë të mirë, me diell edhe të çelurë, po vetëm shira të pareshtura, ditë edhe natë. Gu-



nat e robat tona ishin kalburë, nga lagësira, edhe nga frika nuku guxonim të ndiznim zjar që të thaheshim! Vetëm që kishim një ngushëllim dyke patur një mashinë të vogëlë, të cilën si e fshehnim me gunat, të mos dukeshë, e ndiznim edhe bënim nga një kafe.

Për të u mprojtur prej çdo reziku, të pandehurë, kishim hapur hendeke të thellë, në shumë vënde, që të mundnim të lëftonim. Në për ca lisa të mëdhenj, të mbuluarë me dëllinja, rinte karaula i cili vërente çdo lëvizje që bëheshe, pa u dukur ushët me dëllinja e gjelbësira.

Gjithë ushtërinë, që ardhni prej Janine e shkonte në Sarandë, e pamë fort bukur me qënë që atje pranë na shkojti. Gjithë kësisoj shëkonim edhe koshadhat (ushtarët shëtites) kur po shëtitnin dyke na kërkuar neve, ku aty ku atje, në për stanet, hauret edhe në për fshatrat. Shumë herë na kishin shkuar fare pranë me qënë që ishte një udhë, midis pyllit, e cila vinte në Monastir.

Një herë na ka shkuar kaqë pranë sa me nxitim të math zumë vëndet, në për hendeket, që të lëftonim dyke pandehur që na kishin trathëtuar. Një ditë tjetër do t' i vinim, vetë vetiu, pilaf ushtërisë. Siç thamë që shirat e pareshtura na kishin dëshpëruar shumë, kur një ditë e një natë ra me stomna, kaqë shumë sa pandehmë që do të përmbyseshe gjithë bota. Tek po rinim për mbi dëllinjat, të lagura qull, shohim të vinjë Ademi të na thëresë në konak se nuku kish nonjë rezik. Ademi ishte besniku shërbëtor i Refik Budos edhe me qënë vatur i dhëndëri i Refikut, në çiflig, dërgojti Ademin të na thëresë në konak që të thaheshim, se kurrë nuku besonte të shkonte ushtëri atë kohë.

Në krye nuku donim të vemë po dyke thënë që s' ka nonjë frikë u bintmë, kështu që i thamë Ademit të shkonjë përpara se pas tij do të vinim edhe neve.

Me të shkuar Ademi u përgatit më të gjyrmojmë kur, me të u afruar ndanë pyllit edhe pa shkuar 5 sekunda, shohim Asllanin, i cili shkonte përpara, të




na bënë shënjë që të shtrihemi. U shtrimë edhe s'andejmi pamë nonjë qint ushtarë që shkuan në rëzë të pyllit, dyke ju drejtuar konakut të Refikut të cilin e rethuan përnjëherësh.

Kërkuan konakun, hauret edhe gjithë fshatin pastaj hëngrë bukë edhe shkuan në tjetër drejtim. Atëhere edhe neve, si u largua ushtëria, u-rëzuam në konak, ku u përgëzuam që na shpëtojti Zoti edhe si u thamë pakëzë hëngrëmë bukë edhe shkuan në folenë tonë.

Sa kohë që ndëjmë në këtë pyll vetëm Ademi, i cili na ka shërbyerë me mish edhe me shpirt, na dinte, dy gra të fshatit, që na sillnin të ngrënë edhe dy barinj të Alim Karagjosit, të cilët na sillnin kur qumësht, kur djathë, kur nga nonjë qengj të pjekur. Midis këtyre barinjve ishte një djalosh i ri 18-19 vjet, i gjatë, nga Golemi, i qojtur Remzi. Një ditë vjen i armatosur që nga stani edhe thotë që do të shoqërohet me neve.

Pa fjalë që nuku deshnim t' e prananim se ishte një turp i math t' i mirnim Alimit barinë, kur se ay na mbante me gjithë të mirat. E këshilluam pra Remzinë që të kthehet në stan, po ay na thotë që me lejen të Alimit ardh, kështu që e shoqëruam Remzinë dyke u betuar edhe ay si gjithë shokët. Mirpo pa shkuar dy dit shohim të na vinjë një plak i thinjurë, i cili na lutet t' e vrasëm me mirë se sa t' i marrim dritën e syrit, me qënë që Remzinë e kish bir të vetëmë. U mallëngjyem fort tepër nga plaku i gjorë edhe kësisoj me këshilla e shumë fjalë të mira e bintmë Remzinë edhe shkojti me t' anë. Pas 3-4 dit përsëri shohim të na vinjë Remziu po prapë e përzumë. Të tretën herë vjen edhe thotë që i vdekur, më mirë ndahet prej neve se sa i gjallë, kështu që u shtrëngua plaku t' i japë uratën edhe neve t' a shoqërojmë.

Këjo jetë egërsore kishte zënë të na rëndohet e mërzhitet, në këtë pyll monoton, se përveç qellit nuku shihnim gjësendi tjetër. Po Perëndi e Shqipërisë që na



kish aratisur, në këtë botë, kish edhe përkujdesjen t'one prandaj në dëshpërimet më të mëdha na jepte durimin e kurajon, kështu edhe tani, në këtë pyll, na dërgojti një mik të shtrenjtë për të defryer e të harojmë gjithë hidhërimet.

Ky mik i dashur nuku ishte tjetër përveç se një zog verdhash i vogël, i cili, mundet, dyke kupëtuar hidhërimet tona do të vinte të na këndonte mbi krye. Kaqë familiarë u bëmë me këtë zog sa nuku druheshe as pak që të vijë të qendronjë për mbi neve. Me një rjalë ishte shoku ynë i pandarë. Shumë herë ndronim limeret, për siguri, kur zogu që me natë do të vinte të na gjente. Kur shtronim që të hanim bukë zogu do të ishte bashkë me neve.

Unë e donja fort shumë se e pandenja për dërgimtar. i dërguar prej Zotit, që të na gëzonte zemrat tona të zhuritura, prandaj shokët qeshnin me mua edhe me të parë zogun më thoshnin: Mihal të ardhni zogu! Mjerisht, një ditë prit të na vinjë zogu, po nuku dukesh, kështu që u pikëlluash kaqë shumë, për të shtrenjtin shok që na çelte zemrat, sa m' u preh edhe të ngrënit. Hidhërimi t' im nuku ka rëfim për zogun e shtrenjtë! Shokët më ngushëllonin dyke thënë që për një zog të brengosem kaqë tepër? Mundet që ngordhi ose e ka ngrënë nonjë shpesh i math, mirpo mua cili ma nxirte nga kryeja?

Gjithë atë natë nuku më zuri as pak gjumi, me qënë që mëndjen e kisha tek zogu, se kisha një besim, në vete t' ime, që humbja e zogut do të sillte nonjë rezik për neve. Të dyjtën ditë tek po rinja i brengosur shoh që të na vinjë zogu i shtrenjtë, po ishte dobësuar se kish vezuar. Gëzimin e math që kam ndjerë atëhere nuku e tregonj dot! I dhashë të ngrënë edhe me vrap flytyrojti dyke vatur për mbi vete. Q'atëhere vetëm për të ngrënë vinte edhe shkante me nxitim në fole.

Ditën kaqë të priturë për shkeljen të Vilqelmit, në tokë të Shqipërisë, na e lajmëruan buçimet e kërcëllimet të topavet, të cilët na shurdhuan veshët. Më



tepër se një mijë topa janë xbraturë atë ditë, prej avullorevet të luftës që ndodheshin në Kerfuz e në Sarandë, për nder të Kaizerit.


Të dyjtën ditë zuri ushtëria që të hiqet edhe vjen Idris Guri, nga Gjinokastra, e na tregon festimin që ju bë Imperatorit, edhe na thotë që ushtërinë, më të teprën do t' e heqin me anë të detit.

Pas ca dit lajmëronemi që kishin shkelur Sarandën edhe na e ngarkonin neve këtë shkelje. Nuku dinim as neve për cilin të besonim që bëri këtë goditje, po më shumë besonim për Bajon, të cilin po e prisnim dita ditës, ose për Abdyl Kardhiqin me të cilin kishim biseduar edhe shtuar në program për një shkelje mbi Sarandën. Edhe më tepër që besonim për Bajon e Abdylin ishte nga shkakut se shkelja ishte bërë me një mënyrë kombëtare, domethënë jo grabitëse, se përveç godinave edhe zyrtare zyrtare as nonjë të huaj nuk kishin trazuar.

Kishin shkelur Yqmetin, Postën, Rexhien edhe Gjymbrykun (Doganën) po mjerisht, në gjithë këto zyrra, nuk kishin gjetur përveç 650 lira Tyrku, se gjithë të hollat i kishin harxhuar për pritjen të Kaizerit.

Këto menjtme edhe dyshime na bënë që të vejë Çerçizi në Gjinokastrë dyke mbetur neve vetëm. Si vajt Çerçizi na shkruan që Sarandën e kish shkelur. Itoja i cili, pas të aratisurit nga lufta e Mashkullores, ishte bashkuar me Demo Nivicen, Asim Hajderin edhe të tjerë shokë, në numur 19, edhe kësioj bashkërisht vendosmë shkeljen të Sarandës, me qellim kryengritëse. Çerçizi na shkruante që Itoja ndodhet në shtëpi të tyre edhe për 3-4 dit do të vinin bashkë e pastaj të shkonim. Shkuan 7 dit edhe Çerçizi nuk kish të vinte, prandaj shokët zunë të mërzhiten ca më tepër sa ishim mërzhitur në atë pyll, kështu që i shkrojta të vinjë një or' e më parë se ndryshe do të shkonim vetë se këjo jetë nuk duroheshe.

Me të marrë këtë letrë dërgon q' atë ditë, shërbëtorin e tyre Hamitin, me përgjigjen që në mos arth-



çin ata për 2 dit të mar shokët e të vemi në Gjino-  
kastrë. Bashkë me letrën na dërguan edhe ca gazeta  
shqipë. Me të hapur gazetën « Kombi » sytë më qën-  
druan tek i pari edhe i shtrënjti ynë prift kombëtar,  
Fan Noli, të cilin e kishin dorëzuar në Amerikë. Gë-  
zimi ynë ishte i patreguarë edhe dyke derdhur lote  
puthnim fytyrën të të bekuarit prift, të Kishës Ortho-  
dhokse Shqipe.

Me pëlqim të math edhe të pa ngopur lëçitnja  
artikujt të gazetës « Kombi » për mbi ceremoninë, të  
kësaj dite kombëtare edhe të shënjtëruarë. Në çdo  
paragraf na dridheshin mishrat edhe nga gëzimi bër-  
titnim: Rroftë Shqipëria! rroftë prifti kombëtar! Lë-  
çita edhe « Dritën » të Sofjes e cila shkruante për lu-  
ftën të Mashkullores, pas teligrameve pa nonjë  
çkoqitje.

Atëhere zura të shkruanij dy artikuj, njërin për  
mbi luftën të Mashkullores, me hollësit' e dhura, edhe  
tjatriin për mbi dorëzimin të të parit prift kombëtar,  
të cilit i kisha dedikuar këtë strofë :

*Beko uratë, tinë beko me ndihm të Perëndisë*

*Që të çkëlqejnë përsëri armët e Shqipërisë!*

*Me atë gjuhë që di ti e kupton çdo Shqipëtar*

*Që të dërmojmë zgjedhen të genitë barbar!*

Mjerisht artikujt e mija nuku ranë në dorë të  
luftëtarit patriot Shahin Kolonjës, Direktorit « Dritës ».

## KRYE E IX.

### **Lamtumirë pyllit**

Dyke pritur Qerçizin me Iton që të vinin e nuku  
ardhë, me të ngrysur, muarim lamtumirë nga pylli në  
të cilin kishim rrojtur 45 dit, nga shoku i ngushë-  
llimevet me të cilin kishim kapërxyer kaqë hidhërime,  
domethënë nga zogu i shtrënjtë i cili nuku munt të  
na gjyrmonte edhe nga i dashuri edhe besniku Adem,  
i cili na kish detyruar me shërbimet e tija, edhe shkua  
për në Gjinokastrë.



Po, mjerisht, nuku munt të arrinim dot, në Gjinokastrë, nga shkaku se nuku munt të ecnim, me qënë që këmbët na ishin mbërthyer, nga të ndënjurit kaqë kohë në një vënt e në shira, prandaj u shtrënguan të limerjasim në një përrua të thellë, midis Goranxisë edhe Dervicanit. Që nga këjo përrua muarm malet po na gjeti një e keqe e madhe. U aratimë edhe me shumë mundim u bashkuam edhe vamë në Manastir të Dervicanit. Këtu si hëngrëmë pak bukë u rëzuam në Kolorçë, gjysmë ore lark Gjinokastrës. Këtu na zuri dita edhe u shtrënguan të hymë në Kishë, ku ndëjmë gjithë ditën. Me të ngrysur mirë fare me shumë të drojtura rymë në qytet edhe vamë në shtëpi të Çerçizit.

Në Gjinokastrë nuku ndëjmë përveç 2 dit edhe pastaj muarmë malet e gjërë e qëndruam në Sopot, për mbi Gjinokastrë edhe Delvinë. Në Sopot kemi ngrënë, në për stanet, ca mishra të shijshme, aqë më tepër me atë ujë të ftohtë e të lehtë. Çkuleshim së qeshuri me Iton se kishte veshur ca roba prej Policisti, të cilat ja kish marë Policies në Sarandë.

Në Sopot na ardhni Idris Guri dyke sjellë Fejzulanë për të u shoqëruar me neve. Fejzua ishte i bir'i Rustemit, nga Libohova edhe mësoheshe për Hoxhë në Janinë. Në krye na u duk që do të mos ishte i zoti për komit, po më von jemi habitur me atdhetarin' e tij. Një i vëllaj i Fejzos, i qojtur Avni, djalë 14-15 vjet që ishte nxënës në Xhimnasio Tyrqishte, të Janinës, ikën fshehtazi edhe vjen në Gjinokastrë për të u bashkuar me neve. Me mos na gjetur shkon në Kardhiq, ditën e luftës të Mashkullorës, kështu që e zunë edhe e dërguan prapë në Janinë.

Pas dy muaj të Avniut vendosi i vëllaj i tij, m'i madhi, dyke ju betuar që i vdekur kthenet e kurrë i gjallë. Fejzua ishte 25-26 vjet, i zheshkë edhe thatanik. Si nxori sërekun edhe robat të hoxhallëkut e veshmë me roba komite edhe e vumë të betohet. Atë që nuku munte t'ja tregonte dot fisionomia e tij, Fej-

zos, ja tregojti zemrë-gjër' e tij se na ka habitur me burrërinë në një rast, kur ndodheshim në Beriavoll, një pyll i math ku bëjnë dru Gjinokastritët e Delvinjotët.

Kur ndodheshim këtu na lajmëruan që kish ardhur Allaj Pasha, prej Janine, në Delvinë edhe kishte zënë një ndjekje të reptë, dyke burgosur burra, gra edhe bagëtinë ua kish mbyllur që të gjenin, me domosdo, shkelësit të Sarandës. Këjo padrejtësi q' i bëheshe popullit të pafajshmë na helmojti pa masë, prandaj vendosmë vrasjen e tij brënda në Yqmet.

Këtë vendim të rëndë e priti me gëzim të math Fejzua që t' e mbushnjë, i cili veshur Hoxhë do t' e vriste. Kur se përgatitnim këtë ardhë shumë njerës, nga Delvina e nga qarku dyke na u lutur që të mos bënim këtë goditje se atëhere mjer populli ç' kish për të ecur nga qeveria. U bintmë edhe e lamë që t' i bënim pritë kur të shkonte, po, si duket, Allaj Pasha, sikur e pikasi edhe shkojti pa pandehur për në Janinë, pa lajmëruar as njeri.

Në Beriavoll ndëjmë ca dit nga shkaku se këtu prisnim Asim Haderin me shokët, që kishin marrë pjesë në shkeljen të Sarandës edhe këtu ishte një vënt shumë i fortë. Na ardhë e një ushtëri e madhe po as që u tuntmë vëndit, kështu që u kthye pa guxuar të afroneshe se ishin sigur që do të vriteshin.

Rinim e verënim që nga Beriavolli Delvinën, Sarandën, pjesë të Qamerisë edhe Korfuzin dyke mallkuar qeverinë Greke, e cila nuku na hapte këtë udhë që të vepëronim lirisht. Se është e drejtë që po të na lenë Grekët të lirë Korfuzin do të mundim të vepërojmë fort mirë në Shqipëri.

Dyke biseduar për mbi shumë vepërime, që duheshe të moushim, vendosmë për një goditje të madhe, kështu që Qerçizi me Asimin shkuan në Gjinokastrë, edhe unë me Zemanin edhe me Myftarin në Kardhiq. Myftari ishte shëruar krejt nga plaga po një cifle i vërtiteshe nënë lëkurë! Në Kardhiq u bashkuam me Abdylin, Bajram Pergjinë e me Muratin edhe ngjitemi





prapë në mal në një vënt ku kishim dhënë parollen.

Atë natë u kthyen edhe Çerçizi me Asimin dyke sjellë e të tjerë shokë, prej Gjinokastre. Një herë të mbledhur, që të gjithë, rymë në bisedim edhe vëndosmë goditjen të burgut edhe të Yqmetit Gjinokastrës. Goditja ishte e sigurtë se me të liruar të burgosurit do t' i hidheshin Yqmetit edhe gjithë godinave zyrtare.

Pllani u vendos, me pëlqim të të gjithëve, edhe u rëzuan që të rymim në qytet edhe të përndaeshim në për shtëpitë, që në të parën shenjë, që po të jepe-she, të delnim edhe t' i hidheshim burgut. Kur se këto ishin përgatitur na vjen një komision, prej 10 shpirt, për mbi qytet edhe na lutet, në emër të Gjinokastritëve, që të shtymë këtë goditje të shumën edhe 10 dit gjer të kupëtonen adh' ata, midis tyre për të mos ngjarë nonjë gjemë e keqe nga mosmarëveshja.

Këtë lutje e gjetmë të arësishme edhe e pranuan. Kështu që shkuam për në Sopot Atje na ardhni një lajme e keqe që konakët të Refik Budos, në Luvinë, ja kishin djegur, andarët Grekë, edhe që kishin qëlluar për të vrarë mbi të birin e tij.

Andarët Grekë kishin kohë që vepëronin në këto vënde më një program që të ndiqnin edhe tmeronin Shqipëtarët për të lënë mall' e tyre. Pa u çfaqur neve në ato vënde vepëronin lirisht e në mes të ditës, po pastaj druheshin shumë e me gjithë kërkimet tona nuk u përpoqmë dot gjekundi. Lajmeja pra e konakëve të Refik Budos na pikëllojti fort tepër, kështu që me një zë vëndosmë një ndjekje të reptë kundra andarëvet edhe kësisoj shkuam për në Luvinë.

Atje si edhe gjetkë bëmë kërkime të plota edhe u siguruam që andarët kishin për qendër të vepërimeve Kastanën, një katunt midis Gjinokastrës edhe Janinës. Këtu kishin mbledhur fshatarët e bujqrit që të lidhen edhe i vinin në kishë të betohen që kanë për të vrarë Shqipëtarët edhe t' u djegën shtëpitë e konakët të çifligjëve.

Vëndosmë pra goditjen të Kastanës me shpresë



që atje, pa dyshim, do të gjenim andarë edhe kishim për të xbuluar gjëra të enteresaçme!

Si muarmë mjaft të ngrëna edhe regulluam pllalin të goditjes, me të perënduar djelli, shkua dyke marë malet. Një natë të tërë kemi udhëtuar në për ca majra edhe ripa, të cilat ishin për dhitë. Me mundime e rekullime, ku këtu e ku atje, nga të gdhirët muntmë të arrimë për mbi Kastanën.

Qendruam vetëm sa muarmë pakëzë frymë edhe ndezmë nga një cigare, pastaj me vrap rëthuam fshatin edhe Çerçizi, unë, Zemani, Abdyl, Itoja, Asimi, Bajrami, Myftari edhe Maxari rymë brenda e shokët e tjerë qendruan reth fshatit, dyke patur urdhër që as njëri të mos linin të dilte përjashta. Nga ky urdhër u vra një fshatar i cili ishte i shurdhër e nuku dëgjojt.

Këjo ditë ishte 3 Qershor edhe prifti, i fshatit, po i binte këmbanës. Me të mbaruar, prifti shërbesen, e thirmë përjashta edhe shtrënguam të tregonjë të vërtetën, edhe në ndodhen andarë në fshat. Prifti na tha të vërtetën, që andarët Grekë i shtërnguan të betohen, në kishë, për farosjen të Shqipëtarëve. Sa për andarë, tha, nuku janë dukur prej 2-3 dit, në fshat të tyre. Dërguam priftin me një nga shokët tanë të thëresin myftarin, të fshatit, edhe pleqësinë që të vinë shpejt në obor të kishës.

Që të gjith u fshehnë përveç myftarit (goxhabashit ose kryeplakut) edhe 4-5 pleqve të tjerë, të cilët arthnë në obor të kishës. Këtu u-bëmë pyetjet e duhura edhe nga shtërngimet kupëtuam që ishin të gjithë fajtorë, prandaj doqinë shtëpin' e Xhutit me magazen' e madhe, e cila ishte depo me armë e fishekë, të fshehura në qilar, shtëpin' e të birit, shtëpin' e priftit edhe të mësonjësit, ngjitur me shkollën, se këta ishin qendra edhe krerët të vepërimevet, n' atë qark.

Nuku do t' e fsheh pa dëftyer të vertejten, që përpara zjarit nuku paska tmer më i math! Lufta e të tjera të këqia nuku janë as gjësendi përpara zjarit! Edhe aqë më tepër kur ja ve vetë edhe shëh me sy-



të tënde! Vetëm kujtimi i këtij zjari edhe sot më dritëron shpirtin! Është gjë e ligë edhe e vështirë, prandaj le të largohen nga zjari, qoftë në luftërat, dyke përdorur të tjera mënyra kundra armiqëvet.

Po; lumtërisht ose nga ana e Zotit, këtë zjarë e ç' paguam edhe me një të mirë. Më përpara se të vinim zjarë i porositmë që të nxjerin çdo gjë të gjallë përjashta, që të mos digjeshin. Kësisoj porositmë edhe në tregëtari Panajot Xhuti, po me të marë zjari përhapen flagët, më gjithë anëtë, edhe në mest të ulërimet, të njerëzvet të shtëpisë, lëshohet një grua e re e tmëruarë, e cila dyke këputur leshrat hidhet për mbi mua e bërtet: Aman Kapitani; më digjet djali në dhomë! Kaqë tha fatzeza nënë edhe ra për dhe e drunjosurë!!!

' Ah! ç' ndjeva, un'i gjori, në këtë zemër?! Mishrat m' u drodhë si purteka, leshrat m' u ngritnë përpjetë edhe humba çdo gjykim! Abdyl Mersini, i cili ndodheshe pranë meje edhe i cili kish djalën e vet lenë në shtëpi, me të dëgjuar këtë gjëmë, nga e dëshpëruara nënë, me vrap sulet në mest të tymit e të flagëvet, dyke vënë jetën e tij në rezik, ryn brenda, rëmben djalën edhe e shpëton nga vdekja!

Burrëria, kalorësia edhe shpirtmadhësia e Abdylit nuku ka shëmbëll edhe rëfim!!!

Gëzimi tim, që kam ndjerë atëhere, nuku tregonet dot edhe vallë do t' e shijonj nonjëherë. Sa për fatzëzën nënë rëmben djalën dyke e pushtuar, si nonjë dragojkë, qante nga gëzimi. Qante e mjera se i shpëtojti djali edhe zjari, që këcente edhe i diqte shtëpinë, nuku i bënte as më të voglën përshtypje! Shpëtimi i djalit nuku barabiteshe, për atë, me as gjësendi në botë!

Si mbaruam me zjaret edhe, pas vendimit e kërkimit të komitetit Gjinokastrës, duheshe të vrasëm ose varëm dy shpirt dëgjohen të xbrazura prej pushkash, jashtë fshatit. U shtrënguam të shkojmë se pandyhem që shokët lëftonin me andarët ose me ushtërinë. Mu armë me vete priftin e myftarin e duallmë përjashta,

kur atje mësojmë që shokët kishin xbratur, për të mos lënë fshatarët që të delnin përjashta fshatit. Me këtë shkak u vra ay i shurdhëri prej Muratit.

Si u mblohmë gjithë shokët shkuaam dyke marë drejtimin të Koshovicës, ca male të lartë shumë e të fortë, po, pa arrirë në rëzët, hapet një zjar i reptë kundra nesh që do të na grinte të gjithëve. Zjarë e hapnë ca xhandërma edhe trimat e fshatit, të cilët manin grykën, me qënë që s'andejmi hidheshin andarët në Shqipëri nga Greqia. Lëftuam edhe atje nja dy orë gjer arrimë të kuptonemi që të mos vritemi me kot, pastaj u ngjitmë në malet të Koshovicës.

Të lodhur shumë edhe të dermuar qendram të çelodhemi pakëzë edhe të hanim bukë. Na suall dy mishra të pjekura, djathë edhe kos kështu që u gostitëm mirë. Pas të ngrënit menjtonemi ç'drejtim do të mirnim, po, më përpara se të shkojmë, thotë Çerçizi, duhet të vrasim priftin, myhtarin e një tjetër që zumë ndanë fshatit. Mirë thonë, ca nga shokët, po priftin duhet të vrasë Mihali.

Duheshe pa dyshim që t'e vrisnja priftin, kur të vendoseshe nga të gjithë, po unë, dyke patur në një menjtim Sulon nga Palavlia, Abdylin, Zemanin, Asllanin edhe të tjerë shokë, u kundërshtuash me arësye kundra këtyre vrasje për këto shkake: që pse nuku i vramë në fshat po tani 5 orë lark fshatit, e dyta hëngrënë bukë bashkë me neve, shoqërisht, edhe zakoni i Shqipëtarit nuku e pranon kurrë këtë. Ë treta, thashë, që kur t' i gjejnë të vvarë, në këto male plot egërsira, çdo të thonë për neve? Pa dyshim që i muarm për të i rjepur, edhe atëhere ku na mbetet nderi ynë edhe i gjithë kombit?

Proponimi t' im pranohet prej gjithë, afër, shokëve edhe u vendos lirimi i tyre. Kur u thamë të mjerrëve që janë të lirë e munt që të shkonin, fytyr'e tyre, e verdhë dyllë, u çel pakëzë edhe deshnin të na puthnin duart, po neve nuk' i lamë. U dhamë të ngrëmë, që të kishin për udhës, edhe i porositëm që t' u




thonë të gjithëve që të shohin punën e tyre e mos cenonjë nonjë Shqiptar, tjatërsoj ishim të shtrënguar të përdornim masa të repta, kundra atyreve bashkë me fëmijën.

U thamë që programi ynë është për lirin' e të gjithëvet edhe duhet të na përkrahin për të mbushur këtë qellim. Muar lamtumirë, prej neve, edhe shkuan të mjerët, po frika nuku u kish dalë, prandaj në çdo dy pashë, kthenin kryet dyke pandehur mos i vrisnim që prapa! Lirimi e të kthyerit, të pashpresuar, të priftit me shokë, në fshat, bëri një bujo të madhe, kështu që aqe përpara gjindjes si edhe përpara Yqmetit treguan programin t'onë, vetëm për liri!

Neve që nga Koshovica muarm malet edh' u rëzuam në një fshat, në Çamëri, ku blemë ca duhan e ca plaçka, pastaj shkuan në malet e Sotiros. Këta male janë ca fortesa të forta e të lartë shumë, ku dbora nuku tretet kurrë. Fshati është në një përrua të thellë shumë dyke patur një të vetëmë rugë, për të ryrë e për të dalë nga fshati. Dërguam dy shokë për të u thënë të na sjellin gjesendi të ngrënë edhe, pa fjalë, të vinin 3-4 shpirt, të zgjedhur, që të kuvendonin me neve.

Ardhë njerëzit me bukë, po na lajmëruan që për mbi 200 ushtarë u kishin vatur, dyke na kërkuar neve. Këjo lajmë ishte e vërtetë, se pa shkuar shumë kohë dukeshin fort mirë ushtarët, kur muar të përpyetën e malit. Mirpo këjo e ardhurë e ushtërisë, nuku na bënte as nonjë përshtypje, nër ato male se duheshe një ushtëri e madhe që të lëftonte me neve, prandaj rinim e vërenim, fatzinjtë ushtarë, kur ngjiteshin me duar edhe me këmbë, kur se neve, po të deshnim, i vrisnim me gurë!

Një nga pamjet e çudiçme, të natyrës, na është çfaqurë atë natë, kur rëzoheshim nga malet e Sotiros. U rëzua, prej qellit, një dritë kaqe e madhe sa u tmeruam që të gjithë. Unë besonj që ishte nonjë trup qeliorë, me qënë që në rezim të tij u dëgjua një buçim i math shumë.



Ndejmë gjer më të ngrysur në malet e Sotiros, dyke lënë të mjerët ushtarë që të na kërhonin neve, pastaj, si hërngëmë mirë, u hothmë, përtej, në malet e Libohovës. Dyke ecur, siç duhet, në një rugë të ngushtë arrimë me të lindur djelli në një krua, në rëzët të një fshati të vogël. Këtu u çelohmë pakëzë edhe, si ndezmë cigaret, muarm të përpjetën gjer duallmë në malet, ku ndodheshin stanet.

Pas të vërtiturit 2-3 dit, në për stanet, me lutje muntmë të çkëputemi nga stanarët, të cilët dashnin të rinim shumë kohë midis tyre, e kështu arrimë në stan të Çarçanit, për mbi Libohovë. Mjerisht e gjetmë shumë të brengosur e të helmuar, mikun tonë të shtrejtë, nga shkaku se u kishte ngjarë një dramë familjare, fort'e tmeruarë, në shtëpi të tyre!

Këjo dramë ngjajti kësisoj: një nga nuset e të bijvet kishte shkelur nderin dyke zënë udhë të ligë. Me të u vërtetuar me prova të plota, për mbi këtë turp, vendosnë bashkërisht, me prindërit e nuses që t'i vrasën të dy të dashurit. Një herë vendosur viret në vepërim vendimi, dyke i rojtur një brëma kur u bashkuan, nuseja me të dashurin, edhe kësisoj i vranë që të dy!

Vrasësit ishin i shoqi i gruas me dy të vëllezërit e tij, edhe me dy të kunetrit domethënë me të vëllezërit e gruas! Këjo dramë më çuditi fort shumë, për mënyrën të mbushjes të denimit. Aqe më tepër habitesha kur i ati i së vranës, me djemte, kishin bagëtinë të bashkuarë me Çarçanin edhe kishin një dashuri të madhe.

Në stan të Çarçanit ardhë, prej Gjinokastre, Alit Sferi, Alit Topulli edhe Bardhua, të cilët na suall edhe plaçkat e nevojshme, q'i kishim porositur. Këta na suall lajmë fort të enteresancme. Një Oficer, bashkë me 200 ushtarë kishte ikur nga Manastiri, me programë kryengritëse, edhe vepëronte në anët e Korçës. Për këtë qëllim, na thonë, Komiteti i Korçës u thëret të vini sa më shpejtë që të hasi edhe të meruni vesh.

Përveç këtyre, na thonë, një njeri i dërguar,



enkas, prej Salih Butkës po u kërkon me gjithë anëtë për të ja dorëzuar letrën në dorë Qerçizit. Me sa mundmë të kupëtojmë tërthorisht, thanë, letra është nga Baba Hyseni, i Melçanit, i cili na theriste që të vinim atje, një orë e më parë.


Këto lajmë më nj'anë na gëzuan tepër po, me tja-tër anë, na kallë në një dyshim, dyke pandehur e besuar që mos kërkonin me këtë mënyrë të na shtinin në nonjë grackë. Me gjithë këto duheshe, pa fjalë, që të marim lajmë të sigurta e të plota, prandaj vendosmë që të hidhemi në Kolonjë ku do të mirehim vesh mirë, me Kolonjën, Korçën edhe Manastirin, edhe do të dinim qysh të vepëronim.

Kur tek rinim edhe bisedonim, mbi këto çeshtje, vjen një nga karaullat, (rojtësit) më orënë 3 pas dreke, e na lajmëron që një ushtëri, mjaft' e madhe, duket edhe po vjen për këtej. Me vrap ngrihemi, përcjellim atdhetarët, edhe regullohem dyke zënë vënde të forta për të lëftuar. Nuku shkojti as pak kur duken ushtarët, që ngjiteshin edhe përndaheshin më dysh, një anë që të lëftonte në ballë edhe tja-tra anë të na mirte krahët.

Abdyl Kardhiqi me vrapë hapi zjarë pa lënë ushtërinë të mbushnjë pllanin, kështu që u nis lufta e regullshme. Një ushtar trim guxoiti të ngjitet, në mest të plumbavet, edhe të zërë një bregore të fortë nga e cila, po t' e zinin, zotëronin për mbi neve edhe ishim në rezik. Qerçizi e qëllon, dyke e shtrirë për dhe, edhe me vrap dërgon 3 shokë që të zënë këtë bregore.

Ushtëria përbeheshe për mbi 200 ushtarë edhe kemi lëftuarë gjer më orënë 8, kur u ngrys mirë edhe nuk dukeshë. Atëhere zumë, një nga një, të hiqemi që të muntim, sa ma shpejt, të kapërxenim të vetëmën udhë, që ishte, edhe kësisoj të shpëtonim.

Këjo udhë ishte një rip i ngushtë shumë, kështu që, sikur të na kishin prerë këtë udhë, vetëm me 5 ushtarë munt të na vrisnin. Këjo luftë ngjajti më 18 Qershor dyke mbetur 4 ushtarë të vvarë. Njëherë të shpëtuar nga reziku i math, i ngushtësirës, qendruam pa-



këzë të çelodbemi e ndezmë nga një cigare, dyke e thëthirë fshehur në gunat

Q'atje u-rëzuan, ose më drejt u xvarosmë, gjer arrimë në rëzet e maleve, edhe u hoqmë në Sub, ku na priti Haxhi Hasha edhe na gostiti fort mirë. Me mos mundur ku të vinim ndejmë mbyllur gjithë atë ditë, në një mulli, e vetëm Zoti na mprojt, se një ushtëri, prej 100 shpirt, shkojti për mbi neve po nuku kërkuar e muar drejtimin të Përmetit. Më të ngrysur u hothmë në Lunçëri, kundrejt Gjinokastrës. Lunçëria është një vënt fort i bukurë, me fshatra të bukura e të pasura, me njërës të ditur edhe me ujra shumë. Këtu pra kishim vendosur të përndaheshim për t' u organizuar më mirë.

## KRYE E X.

### Hasja me Xhon Tyrqit

Lajmet që muarmë, të thirurit e Komitetit Korçës edhe përhapja e lëvizjes kombëtare, në shumë anë, dyke na pritur neve, që t' i organizonin, na shtërnguan të mejtonemi që duhesh një ndryshim për mbi vepërimin tonë.

Pas shumë bisedimeve, vëndosmë që të ndahemi më dy çeta, hë për hë, edhe pastaj më shumë, pa si për dita po na vinin shokë të rinj. Kështu pra Asim Aderi me 14 shokë do të vepëronte në anët e Gjino-kastrës, Delvinës edhe kudo që ishte nevoja, dyke u ndarë me 2-3 çeta pas nevojës, Neve 18 shpirt mbetmë me Çerçizin, gjer në Kolonjë, pastaj do të ndaheshim në 3-4 çeta për të vepëruar.

Me të perënduar djelli u puthmë edhe muarm lam-tumirë, njëri nga jatri, dyke shkuar Asimi në drejtim të tij edhe neve për në Kolonjë. Ditën e parë e shkua- am në Çajup pastaj u hothmë në Nemerçkë, në stan të Fezros Gjinokastrës, një atdhetar edhe njeri me mënt e i mirë, dyke na pritur e gostitur mirë. Që këtu dër- guam Reiz Lanen, në Përmet, me një letër tek Aliu






Abdullahu, Tremishti, i cili kishte marë ruajtjen të qytetit. Aliut i shkruanin që të mirte masat e duhura që të hidheshin përtej Viosës, dyke e shkuar urën e Petres.

Aliu na përgjigjet që na pret dyke na siguruar që mori gjithë masat e duhura, si me të vërtet që kish-te vënë njerës, me të dy anët. për të rrojtur urën. Ngrysur arrimë në vëndin ku kishim dhënë fjalën edhe, me të dhënë parollen, bashkonemi e shkojmë anës qytetit, gjer arrimë në urë. Me të kapërxyer urën, të Petres, shkuam në çiflig të Aliut, për mbi Tremishtë, edhe me vrap shkuam për në Frashër.

Në Frashër u hasmë me atdhetarët e me Dervishlerët, nga të cilët mësuam që Oficeri kryengritës nuku ishte tjetër përveç se Niaziu beu i Resnjës. Niaziu kishte ikur nga ushtëria, pas marëveshjes që kishte me shokët, dyke marë 8 ushtarë Shqipëtarë, me vete edhe bënte propagandë në Resnjë, Prespë, Ohri edhe ishte hedhur në qarkun e Starovës. Niaziu si kuvendojti me shumë atdhetarë të Starovës edhe Korçës, q'ishin në komitet, na shkrojti që të haseshim për të u marë vesh në një bashkëpunim, po, mjerisht, letra kur vinte për në Labëri neve vinim në Toskëri,

Nga Frashëri u hohtmë në Orgockë, në shtëpi të Velishahut, ku na priti i vëllaj i tij Aliu edhe, me të ngrënë pakëzë bukë, shkuam në Selenicë, ne Xhezo beu. Shtëpia e tyre është një nga të parat kombëtare, prandaj Xhezo beu na priti me gëzim të math. Na thotë që të qendrojmë në stan të tyreve për të mbledhur, nesër, krerët e Kolonjës në një mbledhje, se edhe ata e kishin biseduar, midis tyre, për një vepërim, siç duheshe. Pas fjalës që kishin bërë, Kolonjarët, Xhezo beu do të dilte kryengritës me 60 shpirt, po sa të bashkoheshin e kuvendonin me neve.

Ky proponim na pëlqeu edhe qendruam në stan, në malet e Vodices, që nesër brëma të vendosim edhe të lidhëm një besë, kështu që t'i jepnim Korçës një goditje të mirë, si atë që kishim përgatitur për Gjino-kastrën. U-përndamë që të flemë kur, pa u gdhirë mi-



rë, vjen një karullë e na thotë që një ushtëripo vjen nga Erseka!

Me vrap urdhron, Çerçizi, të xgjohen shokët e të zënë vënde të forta. Xgjohemi të gjithë po kur shohim që një nga shokët, Bash Qaushi, një Tyrk, na mungonte. Ky Bash Qaush kishte ikur prej ushtërisë, në Gjinokastrë, edhe dyke kërkuar, andej këtej, nga Shqipëtarët kombëtarë mundi të bënjë të njojturë edhe t'u lutet që t' e bashkonin me neve. U-kishte ardhur keq edhe na e dërguan në mal me një njëri e me një letër rekomandimi.

Mbetmë të habitur, për shoqërimin të këtij Bash Qaushi, Tyrku, po me qënë tepër i rekomanduar, edhe pas thënietvet të tij që gjoja i kishin ngarkuar një faj të math, kur Oficerët vetë e kishin vepëruar e pranuan. Pas zakonit Shqipëtar e donim, nderonim edhe e ruanim më tepër se veten t'ënë. Mjerisht dolli i pabesë ose më mirë mbushi detyrën e tij, se ndofta për këtë qellim " bashkua me neve, me dijën të Kuman-dantit të tij!

Kur kishim rënë të flemë, Bash Qaushi, ngrihet fshehtazi edhe, pa vërejtur karullat, shkon në Ersekë ku na trathëtojt! Trathëtin' e tij e kupëtuam vetëm atëhere kur e kërkuam më gjithë anëtë, dyke patur frikë se mos e kish zënë gjumi edhe binte në dorë të ushtërisë, po nuku e gjetmë, ishim pra sigur që Bash Qaushi na kish trathëtuar.

Ishte 3 Korik këjo ditë, kështu që më vrap shumë vënde edhe si u regulluam ju përgjigjmë zjarit të armikat. Me gjithë që ishte një ushtëri, prej 70-80 shpirt, kishin marë ndihmës edhe civilë, po, dyke parë që nuku na thyenin e farosnin dot, dërguan e në Korçë për ushtëri. Pas pakë kohë shohim talige, (qere) araba edhe kuaj plot me ushtarë, nga Korça, edhe me vrap i kallë në luftë.

Lufta nisi me orënë 6 të mëngjezit edhe mbajti gjer më orënë 6 të ngrysurit, kur neve shumë dale nga dale që të hiqemi, për të siguruar ikjen. Në këtë luf-



të nuku u vra as u plagos nonj shokë, nga ushtarët. nuku mësuam sigurisht po, siç na thanë, ishin vrarë 3 edhe plagosur 5. Herohet në këtë luftë u treguan Remziu edhe Reizi dyke lëftuar si burrat e qëmoçmë!


Si u hoqme në një mal të fortë, që ku vërenim pritrat që na bënin, reth Qafëzezit e gjetkë, ndejmë gjer sa u ngrys mirë edhe pastaj, dyke u hedhur në Blush e dyke kapërxyer lumin, arrimë nga të gdhirët në Butkë, në shtëpi të Salihut, një nga kombëtarët luftëtarë për qellimin të shenjtë.

Salihu u gëzua, pa masë, kur na pa që shpëtuaam faqebardhë nga lufta edhe me vrap porositi të na nxjerin të ngrënë, të cilën e hëngrëmë me këmbë se ishim të urtuar, edhe shkuaam për në Kozel, ne Refati, ku zuri të hapeshe dita mirë. Salihu na porositi që të mos vonojmë po të hidhemi në Teqe të Melçanit për të na bashkuar Baba Hyseni me Niazi benë.

Në Kozel nuku ndejmë përveç sa u çelothmë, pakëzë, edhe u ngjitmë në malet, ku ishin stanet të Pitulit edhe Salihut, në qafë të Kazanit. Këtu mballosmë opingat, se ishim xbathur, edhe si hëngrëmë mirë shkuaam, më të ngrysur, për mest Boboshticës edhe arrimë në mëngjes në Melçan,

Atje u çelothmë atë ditë, se ishim të dërmuar, edhe na ardhë prej Korçe Tasi Gramenua, Hasan beu, Kristaq Aristidhi, Skëndo be Pojani e të tjerë, të cilët na thanë se presëm Cilkën e nja dy të tjerë që të shoqëronen me neve. Në Korçë, për neve, kishin burgosur Gaqi Thanas Vison. Lazo Progrin, Vangjel Gjickën e të tjerë po vazhdonin. Të mjerit Vangjel Gjickës i kishte shitur qeveria gjithë plaçkat të magazisë në tellall.

Do të rinim për të pritur Cilkën edhe të bashkoheshim me Jaup be Dishnicën, i cili vepëronte në Devoll, po Baba Hyseni na thotë të shkojmë, pa humbur kohë, në Gocë, ku ndodheshe Demo Emini me 4 shokë, edhe q' atje të vinim në Starovë për të u hasur me Niazi benë.



Me Baba Hysenin biseduam, gjër e gjatë, mbi çështjet kombëtare edhe vecanërisht mbi hasjen tonë me Niazi benë edhe qellimin të tij, me qënë që neve nuk kishim dijë të sigurtë, për këtë. Baba Hyseni na thotë që edhe Niaziu gjithë programin tonë ka, prandaj e kemi përkrahur që të bënjë propagandë edhe shokë. Sa për nonjë frikë nga Niaziu të mos kini se me ka dhënë besa besën si Shqiptar që është, andaj udhë të mbarë edhe Zoti me juve.

I puthmë dorën Baba Hysenit edhe shkuaam të bashkuar me Islam benë, të Goçës, për në Goçë. Goça është në një vent fort të bukur, me ujra shumë, me dhe pjellor edhe me pyje të dushkta. Na pritnë edhe na gostitnë fort mirë, edhe këtu gjetmë Demo Emin Nivicën më 4 shokë, të cilët deshin të na shoqronin. Qerçizi nuk deshte, se njiheshin që përpara, po une ju luta shumë, me qënë në vent të huaj, kështu që i pranuaam.

Me të prënduar djelli muarm lamtumirë, nga miqtë, edhe shkuaam për në Poradec. Nuku kisha shkuarë kurrë në këto vise, po kisha dëgjuarë që janë fort të bukura, edhe me të drejtë munt të thom që janë jo të bukura po janë panorame. Pyje të veshurë me dushk, pemë, ujëra, gështenja edhe fusha pjellore. Pas një udhëtimi arrimë edhe qendruam në pyll të Pirgut, ku duheshe të vinte Niazi beu që të haseshim edhe kuvendonim.

Me të vërtejt, pas dy orë, shohim të vinë 5 kalorës, të cilët ishin 2 Oficerë, një Policie, Arslan beu kryekatundari i Poradecit, Jashar be Starova, edhe dy suvarinj prapa. Si përshëndoshemi na thonë që Niazi benë t'ë ndjejmë, se nga punërat e shuma nuk ardhin dot, po na pret në Poradec. Ramë në bisedim edhe një nga Oficerët, i qojtur Remzi be, hapi programin për të na e shtruar neve. Thotë që programi qendron në Konstitucion (Konshtutë) të lirë, një jesinë për gjithë kombet, të mbretërisë, dituria në gjuhë amtare, të çdo kombi, drejtësia edhe shumë gjërra, për të përmirësuar rrojtjen e popujvet. Pas programit edhe rregullit që



kanë, thotë, duhet të betohemi edhe neve për mbikë-  
të program.

Me qënë unë më plak më lanë që të përgjigjom,  
se në bisedim, nga ana tonë, ishin Çerçizi, unë edhe  
Abdyli, kështu që u thom që sa për të betuar jemi be-  
tuar me marrë hutat edhe malet, prandaj nuku munt  
të betohemi së rish, kur se Z. uaj tani u çfaqte.

Sa për programin jemi në një bashkim të plotë,  
me ndryshimin vetëm të kësaj pike, e cila qendron që  
Shqipëria të sundohet vetë vetiu me një guvernator,  
të dërguar prej Sulltanit.

Remzi beu thotë që Xhemieti mban shumë në  
kombi Shqipëtar edhe pa dyshim do të mbushjë gjithë  
dëshirat edhe kërkimet të Shqipëtarëve, prandaj na  
fton në Poradec ku na priste Niazi beu.

Niazi beu, siç na thanë Jashar beu edhe Arslan  
beu, ishte dëshpëruar edhe mërziur, më në funt, nga  
Xhon Tyrqit, me qënë që nuku e kushia gjyrmuar,  
prandaj vendosi të punonte si Shqipëtar për Shqipërinë.  
Me këtë program po fitonte simpathinë, të Shqipëtarë-  
vet, të cilët e besonin edhe gjyrmonin. Mbi këtë pro-  
gram, pra, na shkojti edhe neve që të vinim të hasë-  
mi, për një bashkëpunim në një fushë me të gjërrë.

Mjerisht, fati ose më mirë shtrëngimi, i ndryshoj-  
ti punërat përnjerësh. Dyke parë Xhon Tyrqit që lë-  
vizja Shqipëtare po përhapeshë për një kryengritje të  
përgjithëshme, vepërimi i Niazi beut me Shqipëtarët  
edhe luftërat e fundit, të Libohovës edhe Vodicës, kur  
me kaqe ushtëri, që ish dërguar kundra nesh, nuku  
munt të na faroste, i shtërnguam të sjellin lirinë, të  
papandehur, edhe kesisoj gjithë Tyrqit fanatikë, të  
Sulltan Hamitit, u kthyen edhe në një ditë u bënë  
Xhonër edhe shpëtimtarë!!!



## KRYE E XI.

### Proklamimi i lirisë

Pas bisedimit edhe marrëveshjes që bëmë me Oficerët, në pyll të Përgut, vumë ca mishra të pjekura dyke ngrënë e dëfryer, bashkërisht, për kujtim të bashkimit edhe të vëllazërisë. Pa fjalë që u ngritën edhe kupa me verë, të sjellë nga Poradeci, për lirinë edhe për shëndet të popujve. Si hëngrëmë mirë shkuam edhe neve në Poradec, dyke kënduar edhe xbrazur armë.

Atë ditë bëheshe treg, në Poradec, prandaj fshatarët habiteshin edhe bashkoheshin me neve dyke bër-titur: rroftë liria! Me të ryrë në Poradec na lajmë-rojnë që Niazi beu, i thirur me teligraf, shkojti në Ohri ku na priste edhe neve që të vinim. Këto të vërtitura nuku na pëlqenin as pak, kështu që mbli-dhemi në një bisedim ku muar anë edhe nga krerët kombëtarë të Starovës edhe qarkeve.

Bisedimi ynë ishte mbi të vajturit tonë në Ohri, ku nuku kishim bërë nonjë njojtje ose lidhje me Shqipëtarët. Krerët të Starovës e muar përsipër që as një frikë ose dyshim të mos kemi, me qënë që Niaziu ka besë Shqipëtari, edhe për siguri të plotë do të vimë edhe nga neve bashkë. Dyke mbetur në këtë vendim hëngrëmë bukë edhe rymë në për kaiket, pa çelodhur mirë, edhe shkuam në Ohri.

Bukurinë naryrishtë, të këtyre ve vënde, me liqenin (gjolin) të bukur që ka, nuku munt kurrë t' e përshkruanj edhe zugrafis dot, me qënë jashtë fuqisë t' ime, se bukuria e këtyre ve vënde kapër xen çdo pa-noramë të botës!

Dyke rahur lopatat kaikçinjte, në buçim të këngëve, arrimë pa gdhirë në Ohri edhe na përndanë në 3-4 konakë. Në mëngjes na lajmëron Kollazi Remzi beu, i cili na kishte bashkuar, që Niazi beu ka vatur në Resnjë po nesër ka për të ardhur. Përveç kësaj na thotë që të përgatitemi për të vajtur në Yqmet, se



kanë, thotë, duhet të betohemi edhe neve për mbi-këtë program.

Me qënë unë më plak më lanë që të përgjigjom, se në bisedim, nga ana tonë, ishin Qerçizi, unë edhe Abdyli, kështu që u thom që sa për të betuar jemi betuar me marrë hutat edhe malet, prandaj nuku munt të betohemi së rish, kur se Z. uaj tani u çfaqte.

Sa për programin jemi në një bashkim të plotë, me ndryshimin vetëm të kësaj pike, e cila qendron që Shqipëria të sundohet vetë vetiu me një Gubernator, të dërguar prej Sulltanit.

Remzi beu thotë që Xhemietit mban shumë në kombi Shqipëtar edhe pa dyshim do të mbushnjë gjithë dëshirat edhe kërkimet të Shqipëtarëve, prandaj na fton në Poradec ku na priste Niazi beu.

Niazi beu, siç na thanë Jashar beu edhe Arslan beu, ishte dëshpëruar edhe mërziur, më në funt, nga Xhon Tyrqit, me qënë që nuku e kushia gjyrmuar, prandaj vendosi të punonte si Shqipëtar për Shqipërinë. Me këtë program po fitonte simpathinë, të Shqipëtarëve, të cilët e besonin edhe gjyrmonin. Mbi këtë program, pra, na shkojti edhe neve që të vinim të hasemi, për një bashkëpunim në një fushë me të gjorrë.

Mjerisht, fati oso më mirë shtrëngimi, i ndryshojti punërat përnjerjesh. Dyke parë Xhon Tyrqit që lëvizja Shqipëtare po përhapesh për një kryengritje të përgjithëshme, vepërimi i Niazi beut me Shqipëtarët edhe luftërat e fundit, të Libohovës edhe Vodicës, kur me kaqe ushtëri, që ish dërguar kundra nesh, nuku munt të na faroste, i shtërnguam të sjellin lirinë, të papandehur, edhe kesisoj gjithë Tyrqit fanatikë, të Sulltan Hamitit, u kthyen edhe në një ditë u bënë Xhonër edhe shpëtimtarë!!!



## KRYE E XI.

### Proklamimi i lirisë

Pas bisedimit edhe marëveshjes që bëmë me Oficerët, në pyll të Pîrgut, vumë ca mishra të pjekura dyke ngrënë e dëfryer, bashkërisht, për kujtim të bashkimit edhe të vëllazërisë. Pa fjalë që u ngritnë edhe kupa me verë, të sjellë nga Poradeci, për lirinë edhe për shëndet të popujve. Si hëngrëmë mirë shkuam edhe neve në Poradec, dyke kënduar edhe xbrazur armë.

Atë ditë bëheshe treg, në Poradec, prandaj fshatarët habiteshin edhe bashkoheshin me neve dyke bër-titur: rroftë liria! Me të ryrë në Poradec na lajmë-rojnë që Niazi beu, i thirur me teligraf, shkojti në Ohri ku na priste edhe neve që të vinim. Këto të vërtitura nuku na pëlqenin as pak, kështu që mbli-dhemi në një bisedim ku muar anë edhe nga krerët kombëtarë të Starovës edhe qarkeve.

Bisedimi ynë ishte mbi të vajturit tonë në Ohri, ku nuku kishim bërë nonjë njojtje ose lidhje me Shqipëtarët. Krerët të Starovës e muar përsipër që as një frikë ose dyshim të mos kemi, me qënë që Niaziu ka besë Shqipëtari, edhe për siguri të plotë do të vinë edhe nga neve bashkë. Dyke mbetur në këtë vendim hëngrëmë bukë edhe rymë në për kaiket, pa çelodhur mirë, edhe shkuam në Ohri.

Bukurinë naryrishtë, të këtyreve vënde, me liqenin (gjolin) të bukur që ka, nuku munt kurrë t' e përshkruanj edhe zugrafis dot, me qënë jashtë fuqisë t' ime, se bukuria e këtyreve vënde kapërxen çdo pa-noramë të botës!

Dyke rahur lopatat kaikçinjte, në buçim të këngëve, arrimë pa gdhirë në Ohri edhe na përndanë në 3-4 konakë. Në mëngjes na lajmëron Kollazi Remzi beu, i cili na kishte bashkuar, që Niazi beu ka vatur në Resnjë po nesër ka për të ardhur. Përveç kësaj na thotë që të përgatitemi për të vajtur në Yqmet, se






kishte arrirë natën fermani, nga Stambolli, prej Sulltanit që jepte Konshtutën më një liri të plotë, kështu që do të këndohet, përpara popullit, në Yqmet.

Këto gjërra na dukeshin si ca përralla, prej të Kalimasë, edhe na kallë në një dyshim të math, prandaj u mblohmë që të këshillohemi edhe mejtonemi mirë që ç' masa munt të mernim, në qoftë që na bëheshe nonjë grackë, për të mbetur historike. Vendosmë pra, që, me të vajtur në Yqmet, të ndahemi nga 2-3 në një vënt edhe në të parën lëvizje të lëftonim, si Shqipëtarë, me gjashtorët, bombat edhe me kamat, me qënë që mauzërkat i kishim lënë në për konakët, gjer të mos mbeteshe as një, prej neve, edhe të mos vinim për dhjamë qeni!

Ishte 10 Korik edhe më orënë 10 u mblohmë edhe shkuaam në Yqmet. Këtu ishin mbledhur gjithë zyrtarët, kryefetarët edhe gjithë populli i Ohrisë dyke pritur me padurim të shëkonjë e degjonjë ç'nuku kishte shëkuar edhe dëgjuar nonjëherë. Si bëri lutjen Myftiu, u ngri Kajmekami (Nënë prefekti) edhe lëçiti fermanin të Sulltanit, me të cilin i dhuronte popullit një Konshtutë të lirë, me njëjesinë, drejtësinë edhe liri të plotë gjithë kombevet të Imperatorisë.

Nuku di edhe as që munda t'e kapëtonj shkakun të asaj ftohtësire, me të cilën u prit fermani i Konshtutës, jo vetëm nga ana tonë po përgjithërisht nga gjithë gjindja, e përbërë nga shumë kombe e fe. Në vënt të entuziazmit edhe gëzimit, për çpalljen të lirisë, heshtja zotërojti, përveç ca të pakave bërtime me rroftë Padishahu! rroftë liria! Pas ceremonisë hymë brenda për të dhënë urimet tona zyrtarëvet, të cilët na gostitnë me cigare edhe llokume.

Duallmë edhe kur shohim të na presin, për të u njojtur, ca atdhetarë të zjartë, prej Ohrie, të cilët na shëtitnë në për qytet, dyke mbetur tepër të kënaqur. Nga këto mësuam, gjër e gjatë, qysh nuku ishin bashkuar me Xhon Tyrqit, të cilët nga frika e Shqipëtarëve përdorë gjithë mënyrat edhe suall lirinë. Me qënë



që afroheshe dreka u-përndamë, dyke na shpënë një kombëtar i ri. Mustafaj, në vëndin ku na kishin pre-gatitur drekën.

Në këtë drekë zyrtare ishin gjithë Oficerët me Remzi benë, në krye, nga ana e Katundarisë edhe ca të pakë zyrtarë të tjerë. Pa fjalë që në këtë festim du-heshe dëftyer dyke ngritur gotat për shëntet të përpj'e-kësvet të kësaj lirie. Kënduan për mëmëdhen, për më-mëdhenë e të tjera kënge trimnore, kur Qerçizi ngri-het edhe na mbleth të gjithë në valle dyke kënduar këtë këngë :

*Shqipëri moj Shqipëri ; Shqipëri pes Vilajete*

*Pse s' u përpoqe për vete po për shumë ti milete! etj.*

U mallëngjyesh kaqe tepër nga këjo këngë, e ci-la më pikëllojti në zemër, sa nuku durova dot, po u hoqa më nj'auë edhe pa dashur zura të qanj si nonjë foshnjë !

Në këtë orë muarmë nga Niazi beu një telegramë me urime edhe na ftonte në Resnjë. Arabatë, taliget e kuajt për të shkuar ishin gati, me qënë që edhe neve u bëmë 50 shpirt me shokët e Starovës e të tjerë që na u bashkuam, kështu që ngrysur arrimë në Resnjë, kur gjindja po festonte në buçim të daulleve edhe të zurnave. Na kishin dalë për të pritur me drita edhe pastaj na përndanë në për konakët, dyke mbetur unë, Qerçizi, Abdyli edhe Zemani në një konak, ku ardhni edhe Niazi beu që hëngrëmë bukë së bashku.

Nga fisionomia e nga fjalët, Niazi beu, m' u duk një burrë i mirë edhe patriot me të vërtejt, po, mje-risht, e kishin fituar Xhon Tyrqit. Madhështi tek ky patriot nuku pashë, përveç se kupëtova që një breng i përvëlonte zemrën !

Në bisedimet, që patmë, nuku pashë të tregonte nonjë entuziazmë të madhe, për lirinë, po dëfteu gë-zimin e math që me këtë rast do të përfitonjë kombi Shqipëtar, se paskëtaj do të hidhet në punim, për t' u ndrituar në gjuhën amtare, që kështu të jetë i dobish-më për veten e tij edhe për mbretërinë, e cila kombin Shqipëtar e ka patur krahërore të çelnikutë.



Te nesërmet, si mblodhi Niazi beu shokët, shkuan në Monastir, ku festoheshë dita e lirisë. Kishin dalë për të na pritur neve gjithë ushtëria me Banda, Kryefetarët, zyrtarët edhe gjithë populli, i Monastirit, me flamurë në dorë edhe bërtimet e tyre nuku mernin pushim: Rroftë liria! rroftë populli! rroftë ushtëria! Arrinin zërat gjer në qell, dyke lavdëruar shpëtimtarët.

Niazi beu me Çerçizin hipur mbi kuaj shkolin përpara në mest të bërtimevet. Po prapë me gjithë nderimet, fytyren të Niazi beut nuku e pashë të çelurë. Nofta nonjë ditë ka për të zbratur barkun, vetë vetiu, edhe të tregonjë shkaku!

Kur se gjithë bota kishin dalë me flamurët, të shkrojtura në gjuhën e tyre, edhe festonin e dëfrenin, vetëm Shqipëtarët, e Manastirit, po vërtiteshin q' audej këtej. Frika e Sulltan Hamitit, q' u kishte mpirë gjakun të mjerëve, edhe pas proklamimit të lirisë nuku u kishte dalë, se pandehnin, që hijeja, e këtij tirani, munt të dilte edhe t' i ndiqte, prandaj nuku guxonin as një flamur, të shkruarë shqip, që të nxirnin!

Gjaku m' u prish edhe ugrihem dyke u çfaqur hidhërimin tonë kur sot në këtë festim, të cilën ja detyrojnë kombit Shqipëtar, Shqipëtarët e Manastirit të mos kenë një flamur kur kanë nxjerë edhe Evgjitrit!

Q' atë orë bëra një thirje dyke treguar ditën e festimit, për të cilën Shqipëtarët janë bërë therorë për lirinë të sotme edhe theroritë, të kombit Shqipëtar, që ka bërë për Mbretërinë Ottomane. Thirja, të cilën e botojti edhe gazeta « Liria » e Selanikut, u përndah në Shqipëtarët, pastaj bëmë flamurët edhe duallmë në mejdan të lirisë, ku u fotografismë.

Në Manastir ndejmë një javë, ku atdhetarët na mbajtne mirë edhe u çelohmë siç duhet. Atdhetarët e Manastirit na bënë e nga ujë palë roba të mira edhe kësisoj shkuan për në Korçë. Gjindja e Korçës kishte dalë përpara për të na pritur me këngë edhe me flamurë në dorë dyke bërtitur rroftë liria. Ndanë qytetit kishin dalë gjithë zyrtarët edhe Oficerët duke na uruar

mirëardhje. Prej Korçe vajtmë në Ersekë, ku nuk  
ndejmë përveç sa muarmë drekën, në mest të këngë-  
vet edhe të entuziazmit, që mbretërojti midis vëlla-  
zërisë, pastaj shkuan në Leskoviq.

Pritja, e Leskovikut, do të më mbetet një kujtim  
i paharuar. Këtu muntë shpirtet tona të ndjenjë gë-  
zim kombëtarë, edhe të gjejnë një çpërblim për mun-  
dimet edhe gjithë vajtjet që kishin ecur. Gjithë populli  
me fëmijën kishin dalë jashtë qytetit edhe ishin sërën-  
ditur më të dy anëtë të udhës. Për këtë festim ishin  
veshur që të gjithë me robat e Shqipërisë, me fusta-  
nellat e bardha edhe me flamurët në dorë, të shkroj-  
tura të gjitha shqip. Me të u afruar pushkut buçasën  
nga të dy anëtë, edhe sazet na presen dyke kenduar:  
per memdhene, per memdhene! gjer hymë në qytet,  
ku na kishin përgatitur një tryezë siç duhet.

Që nga Leskoviku dëshëronim fort tepër që të  
vinim në Frashër për të i falënderuar edhe puthur do-  
rën Baba Abidinit, si kundër e Dervishlerëvet edhe  
gjithë atdhetarëvet t'u falënderonim, për përkrahjen që  
na kishin dhënë në kohë kritike. Mjerisht një telegramë  
na kërkonte me nxihtim edhe shkuan për në Gjinokastrë.

Kur ndodheshim në Manastir muarm një telegra-  
më, nga Bani Italisë, prej Bajo Topullit, i cili kë-  
konte çkoqitje mbi gjendjen tonë. Ju përgjigjmë që  
liria u dha edhe të vinjë se e nderjura përtej ishte e  
kottë.

Bajua kish 10 dit që ndodheshe në Bari për të u  
hedhur në Shqipëri. Bashkë me Bajon ishin Luji Gu-  
rakuqi, nga Shkodra, Thoma Avrami edhe Stefan Kon-  
dillari, nga Korça, Aleks Paskali, nga Përmeti, Kiço  
Himarioti, nga Brekdeti, edhe Kole Reka me ca Dib-  
ranë, që na mungojnë emrat, nga Dibra.

Gjithë përgatitjet, për të u hedhur në Shqipëri,  
ishin hazëruar, një ditë përpara, se të nisen, kishin mbe-  
tur të habitur dyke lëgitar gazetatat që Sualltan Hamiti  
proklamojti Konshtutën në Tyrqi. Pa fjalë gazetatat  
shkruanin, gjër e gjatë, dyke thënë që lëvizja Shipë-



tare e shtrëngojtë Tyrqinë në këtë ndryshim të papritur. Gjithë nga gazetatat kishin mësuar për hyrjen tonë në Manastir, me Niazi benë, edhe na teligrafosuë.

U hidhëruan e pikëlluan tepër, po nuk kishin se ç'të bënin kështu që vendosnë të përnahen. Thoma Avrami u hoth në Misir, Aleks Paskali në Amerikë, Kole Reka me shokët edhe Kiço Himarioti në Bullgari, Bajua me Stefan Kondillarë në Gjinokastrë edhe Luji Gurakuqi në Shkodrë.

Gjinokastrë na priti fort bukur dyke dalë 200-300 shpirt me kuaj përpara edhe gjithë populli me këngë edhe me flamurë në dorë. Këtu ndejmë 10 dit në shtëpi të Topullenjvet, ku për dit do të vini nga një qint shpirt që na vizitonin, nga qyteti e nga qarku.

Që të uestërmet në mëngjes, si arrimë Gjinokastrë, vajtmë për mbi varr të dëshmorit Haredinit. Përveç neve ardhim edhe nga populli një shumicë e madhe, për të dhënë nderimet e meritushme këtij dëshmori që ra mbi altarin të atdheut për lirinë. U mbajtën fjalë patriotike nga Bajua edhe prej meje dyke i deklamuar një vjershë që kam dedikuar dëshmorëvet.

Qerçizi dyke folur pak fjalë urdhrojti shokët që t'i japën edhe nderimet trimuore, kështu që porositë zjar, edhe pushkat i xbasëm për mbi varr të dëshmorit Haredin Tremishtës! Të pikëlluar u rëzuan në qytet po këjo ditë na u duk sterë e zezë.

Një nga kujtimet e paharuara, edhe ecila është një detyrë që, përveç falën lerjevet, t'e tregojmë në histori shërbimet e mëdha që ka sjellë lëvizjes kombëtare familja e Topullit. Mëma e Bajos edhe Qerçizit me nuset e djemve, me bijat edhe mbesat jo vetëm që do të shërbenin, sa herë vinim, po edhe do të na ruanin. Shumë herë gratë delnin përpara që qëronin udhën, me pushkat në dorë, kur shkonim neve nga shtëpia. Në shumë gjendje kritike, kur, auku muut të vepëronin burat, e mbushnin këto këtë barrë të rëndë burrërisht e plotërisht. Me një fjalë ishin pjesëtarët të lëvizjes tonë.



Pa si ndejmë 10 dit në Gjinokastrë shkuam në Janinë me qënë që na kish ftuar Valiu. Në Janinë na u bë një pritje fort e bukurë. Një shumicë e madhe kishte dalë jashtë qytetit, një orë lark, për të na uruar mirë ardhje. Kur rymë në qytet Bandat ushtëriake, të bashkuara me bërtimet e popullit, na pritnë edhe na shpunë gjer në Yqmet për të i dhënë vizitën Valiut.

Ndejme tri dit në Janinë ku na nderuan kombëtarët me gostira, si edhe nga ana e Katundarisë edhe Xhemietit. Me qënë që një komision i përbashkëtë, nga gjithë kombet, do të viute për vizitë, në Selanik, Shqipëtarët zgjodhë Bajon, Çerçizin e mua kështu që vendosmë të vemi në Selanik. Me qënë që shumë nga shokët deshnin të vinin në për shtëpitë, u ndamë dyke u puthur mijë herë, e me lotë në sy!!!

Në Janinë pata fatin të njihem e bisedonj me Direktorin të gazetës greke « Pelloponisos ». Pa fjalë që desh të mësonte mbi lëvizjen Shqipëtare prandaj më thotë: qysh shkoni me Elinët të Shqipërisë? Ju përgjegja e i thashë që Elinë nuku ka në Shqipëri përveç se në Vilajet të Janinës ose më mirë në kaza të Janinës. Qysh, thotë, në Korçë, Berat, Gjinokastrë, Vlorë e gjetkë nuku ka të Krishterë?

**Ka shumë i thashë po këta janë Shqipëtarë.**

Jo! jo! m'a preu fjalën, këtë mos e thuaj kurrë se ata janë Elinë. Kur e pashë që çdo bisedim ishte i kottë e lashë, dyke i thënë që në është se të Krishterët mësuajnë në shkollat greqisht, këjo i detyrohet mos kujdesjes të gjyshërve tanë edhe ca më tepër qeverisë tiranike,

Pa u ndarë më pyet për emrin t'im, edhe kur mëson që quhem Mihal Grameno këcen nga troni e më thotë: po ti qënke Elin mor vëlla? Mekat, mekat që të paskan gënijer Tyrqit e të bënë Shqipëtar.

Këtë përgjigje e prisnja prandaj dyke qeshur i thashë që jam për të u bërë Elin, paskëta, pa si tani e kupëtova kombësinë edhe u ndamë.

Të këtilla bisedime patmë edhe në vapor kur qen-



druam në Patrë edhe në Ë're, edhe nga këto kupëto-va që populli grek është i pafajshmë, me qëne i paditur, edhe kur udhëhiqet prej njerës politikanë, të ditur edhe gazetarë, të cilët nuku janë gjesendi përveç tabako prej historie!

Që nga Janina vamë në Prevezë, ku na u shoqërua edhe Shehu Sabriu, një nga kombëtarët luftëtarë të pareshtur. U-gëzuam pa masë kur u ujojtme faqëzaj, kështu që e shkuaam kohën, gjer në Selanik me bisedime, për mbi pritmjën të Shqipërisë, me ndryshimin që mori qeverimi i mbretërisë.

Shqipëtarët e Selenikut na prituë me gëzim të math edhe me nderime. Kishin dalë me kaikë gjer në vapor, që ku na muar e na shpunë në hotel Kollombo. Këtu foli Midhat Frashëri, nga anë e Shqipëtarëvet, të Selenikut, dyke trëgnar shërbimet tona me të cilat nderuam gjithë kombiu.

U përgjigja unë dyke thënë që nderimet, që po na bëni neve, i presëm me gëzim të math jo për neve, që nuku mbushmë përveç detyrën, po për kujtim, të Atërvet që na mesuan të duam kombësinë, si edhe për pritmjën që të rinjtë të plotësojnë detyrën tonë. Këtu ardhë na vizituan nga ana e Komitetit Xhon-Tyrk shumë Oficerë të mëdhenj. midis t'cilëvet ishte edhe Enver beu, i cili na shtrëngoiti dorën të gjithëve, si pjesëtarë të lirisë. Në këto ditë u-themelua edhe klubi Shqiptar për të përhapur diturinë Komiteti Xhon-Tyrk shtrojti një tryezë të madhe në Beas-Kulë (Kulë të bardhe) për nder të Delegatëvet të kombeve të ndryshme. Pashallarë edhe Oficerë të mëdhenj muar ana, midis cilëvet ishte edhe Hasan Pasha Masareja. Pa fjalë që, pas zakonit, u mbajtnë fjalë, kështu që nga ana e Komitetit Xhon Tyrke foli Mustafa Qemali, dyke treguar rëndësirën të lirisë e cila do të bashkonjë gjithë kombet e ndryshme në një punim për lumtërinë të mbretërisë Ottomane.

Nga ana e Shqipëtarëvet foli Bajua, në gjuhën Tyrqishte, dyke treguar që duhen hedhur prapa krahëvet




e paskëtaj të përpiqemi, si nje trup, me gjithë fuqi që të xvillojmë mbretërinë tonë. Zuuë pastaj me radhë nga Grekrit, Bullgarët, Serbet edhe Rumanët, por mbeta i habitur kur folë që të gjithë me gjuhën e tyre, prandaj nuku durova dot edhe i thom Çerçizit, që ishim ngjitur, që do të flas edhe unë, kështu që fola shqip-dyke thënë që, prej 500 vjet e tëhu, çdo faqe e historisë Tyrke është zbukuruar me emrat e Shqipëtarëve, të cilët janë bërë t'herorë për këtë mbretëri, si edhe liria e sotme i detyronet më tepër kombit Shqipëtar, etj.


Në krye me qënë i veshur me roba komite, pandehnë se mos u bënja nonjë qyfyfyr po pastaj me qënë shumë Oficerë Shqipëtarë, prej të Komitetit ua çpjeguan fjalën time edhe më përgëzuan.

Në Selanik ndejmë 10 dit pastaj duheshe të përndahemi. Bajua me Çerçizin e shokët e tjerë shkuan me vapor për në Gjinokashtrë edhe unë, mbetur si i shkretë, mora udhën për në Korçë. Lotet na derdhesbin çurkë si lumë kur u putbmë edhe u ndamë së bashku kishim shkuar, si vëllezër, afër dy vjet, dyke shijojtur hidhërimet edhe ëmbëlsirat në për malet e bukura, të së dashurës Shqipëri!

Kujtime të paharuara, kujtime që në çdo sekundë do t'i kujtojsh, prandaj lumtërinë të kësaj kohe, nuku e çkëmbenj me gjithë botën! Për mua është dhuretia m'e madhe që më fali Zoti, të Cilin e lavduronj, që munda edhe unë, pas fuqisë të dobëtë, t'i shërbenj atdheut, t'i shërbenj së shtrenjtës t'ime Shqipëri!







**VELLIMI I II.**



## KRYE E I.

### **Kryengritja e përgjithshme**


Pa si fati e rrojti kaqë vite këtë librë historike « Kryengritja Shqipëtare » e cila mbaron me dhënien të konshtutës Tyrke, 1908, e quanj të nevojshme edhe të dobishme që të rëfenj, me pakë fjalë, vazhdimin të kryengritjes shqipëtare pas lirisë Tyrke, dyke marë edhe unë anë, pas fuqisë t'ime.

Me anën të këtij shtimi dëshëronj që t'u lehtësonj udhën e duhur historishkronjësvet, të cilët kanë për të plotësuar, pa dyshim, historinë të re të Shqipërisë, kështu që nga shënimet t'ime, do të gjejnë burimet edhe lehtësirat, për të mbushar veprat e tyre të mbaruar.

Jo më pak që edhe nxënësit e këndoujësit do të përfitojnë shumë, se me anën të këtij shtimi janë për të ndrituar mjaft mbi rjedhjet kryengritëse, të Shqipëtarëve, për të fituar lirinë.

Me të u dhënë liria, në Tyrqi, Shqipëtarëve e mjerë, të dëshëruar e plot etje, për këtë liri, me vrap edhe si të dehur u hodhë në fushën e luftës, për të ndrituar kombin e tyre fatzi me anën e diturisë! Se më fatzi se kombi Shqipëtar nuku jetonte as noujë komp tjetër, në Imperatorinë Tyrke, me gjithë që kombi Shqipëtar kishte qënë shtylla edhe ajy më besniku i Tyrqisë. Gjaku i vyer, i kombit Shqipëtar, që ishte derdhurë si rëke edhe pa reshturë për Tyrqinë, prej 500 vjet, nuku ka rëfim as në historinë të përbotëshme që t'ë këtë shëmbëllyer tjetër komp!

Mjerisht, Tyrqit, në vënt të mirënjojtjes, ua çpërblyen Shqipëtarëve me ato më te këqia e të tmershme




vepra. Përdorë gjithë mënyrat dhelprake edhe të dobëta me qëllim që të çkombësonin kombin Shqipëtar, edhe me të vërtet, dale nga dale, i arrinë këtij qëllimi se në këto 500 vjet arrinë Shqipëtarët të përçahen, midis tyre, edhe të mohojnë kombësin' e tyre.

Vitet edhe Shqipëtarët, të narkosur, flinin gjumën e vdekjes, në të cilin i kishin shtënë Tyrqit, edhe fort rall xheku ngjalleshe nonjë dërgimtar, për të u kujtuar Shqipëtarëvet që të zgjohen e të kupetojnë se janë, që të gjithë, vëllezër edhe bijtë të një kombi trim edhe fisnik! Po që të gjitha ishin te kotta, këto predikime, se Shqipëtarët flinin gjumën e qetë gjer më 1878, kur Konferenca e Berlinit krastite tokat e stërgjyshërvet t'anë, dyke ua dhuruar fqinjëvet!

Atëhere edhe vetëm atëherë zunë të shkunden nga drunjësia edhe të hapin sytë e të shëkojnë rezikun e math, në të cilin shkonte Shqipëria, kështu pra filluan, ne Stamboll, të parën shoqëri diturake për xgjimin të kombit, dyke shtypur libra në gjuhën shqipe. Në krye qeveria Tyrke i përgëzojti Shqipëtarët, për udhën që nisë, edh' i sigurojti për përkrahjen të saj, mirpo, pa shkuarë as pak, me të parë përparimin që mori gjuha shqipe edhe ndjenjat kombëtare, që përhapeshin në Shqipëtarët, zunë ndjekjet e repta, burgimet, mbylljet e shkollavet edhe gjithë të këqiat kundra Shqipëtarëvet!

Lumtërisht, fara e mbjellë zuri rënjë edh' u përhap në vëndet e huaja ku jetonin Shqipëtarë, kësisoj botoheshin libra, gazeta e të përkohëshme, të cilat i kalluin fshehtazi ne Shqipëri. Po me këtë mënyrë ishte e pamundurë që të sillnin nonjë pemë te dobishme e të plotë, prandaj më 1905 u fillua i pari komitet kryengritës Shqipëtar, në Manastir, i cili shtrëngojti Tyrqinë të japë Konshtutën më 23 Korik 1908.

Me të u dhënë liria me vrap Shqipëtarët zunë të punojnë me nje zell te math dyke çelur klube, shkolla e dyke botuar gazeta e të përkohëshme. Klubi i Manastirit, i cili u fillua i pari, mori nisëativën të nevoj-



shme e të dobishme që të thëresë gjithë Shqipëtarët, të Shqipërisë edhe mërgimit, në një Kongres kombëtar, në muajin Dhjetor 1908, për të biseduar edhe vendosur çeshtja e abeçesë.

Këjo veprë e Klubit Manastirit me përpjekjet të Fehim be Zavalanit, kryetarit edhe Gjorgji Qirjazit do të mbetet historike edhe nuku ka nevojë lëndimi. Ky kongres mundi të përmbledhë, pas 500 vjet, Delegatët që përfaqësuan gjithë kombin, nga gjithë anët e Shqipërisë e të mërgimit, në një bashkim, në një dashuri e në një vëllazëri të pandarë, pa ndryshim feje. Gëzimi i këtij Kongresi nuku tregonet dot, i cili, për heren e parë, përmblihte Toskë edhe Gegë, Muhamedanë, Katholikë edhe Orthodhoksë në një bashkim e një qëllim!

Përveç Abeçesë Kongresi votojti edhe çeljen të një shkolle Normale në Elbasan. Për natë do të mblihdeshin në një tryezë, të ftuar kur prej një anë kur prej tjetre, dyke dëfryer Delegatët si vëllazër, plot entuziazmë e këngë kombëtare.

Përveç këtyreve shërbime, q' i solli Kongresi atdheut, i solli edhe një tjetër shërbim më të math, çeshtjes tonë kombëtare. Qarket diplomatike, të Europës, u enteresuan tepër për këtë Kongres edhe shtypi të merret gjër e gjatë me lëvizjen Shqipëtare, e te botonjë artikulla me rëndësi, prej njerës njojtës mbi historinë të Shqipërisë.

Tyrqit dyke parë përparimin të Shqipëtarëve të zunë me vrap nga dhëlpërit' e zakonëshme, për të ndaluar e përçarë nga ky qëllim e përparim. Në krye nxuar një farë Shqipëtar të blerë, i qojtur Arif Hiqmeti bashkë me ca shokët e tij dyke çpallur një Abeçe, me shkronja Arabishte edhe botuan një gazetë, të përmbajturë, pa dyshim, prej qeverisë Tyrke.

Dinakeja qeveri Tyrke, si kurdoherë, zuri të enteresohet mbi këtë çeshtje edhe të çfaqnjë hidhërimin të math, gjoja, që ndjente për mosmarëveshjen midis Shqipëtarëve, mbi çeshtjen të Abeçesë. Qfaqja pra hi-



dhërimin që është e shtrënguarë të ndalonjë gjuhën shqipe, në shkollat zyrtare, gjer në një vendim tjetër.

Protestimet që rithuin si breshëri, nga gjithë anët e Shqipërisë si kundër edhe mitinget nuku mereshin nënë vështrim, në Stamboll, prej qeverisë Tyrke, e cila për kundrazi vazhdonte programin të saj, që më çfarëdo mënyrë të çfaroseshe lëvizja Shqipëtare. Ndjekjet, mundimet, burgjimet e gjithë të këqiat dita me ditën po shtoheshin, kundra kombëtarëvet Shqipëtarë, kështu që edhe dëshpërimi po shtoneshe në Shqipëtarët e mjerë.

Pa noujë shkak mbyllnin klubet, shkollat edhe çdo shoqëri kombëtare gjer arrinë që të çkatërojnë edhe « Bandën të lirisë » në Korçë, e cila kishte Kryetar të nderit Sulltan Reshatin, i cili kur ishte trashëguantar e ndihmojti leutarisht dyke u zotuar që do t' e ketë nënë hije të Tij!

Shtypi shqip po udiqeshe me një reptësi të madhe gazetat ujera pas jatrës mbylleshin e ksefestroheshin, gazetarët dënoheshin edhe burgoseshin. Nga këta udiqeshin më tepër unë, Dervish Hima, Jashar Erebara edhe Muço Qulli.

Në të këtillë gjendje të tmeruarë gjendeshe kombi Shqipëtar, edhe që të gjithë e kupëtonin rezikun e math, po nisiativën as noujë nuku e mirte, për organizimin e fillimin të një lëvizje kryengritëse. Vërtet shumë patriotë botonin thirje kryengritëse në emër të komitetëve, po mjerisht në Europë kur se në Shqipëri nuku guxonin.

Më 1910 pëlcat një kryengritje në Gegëri po papatur as qellim as program kombëtar. Më tepër këjo kryengritje ishte drejtuar kundra Xhon Tyrqvet edhe për bazë kishte rënien nga Froni të Sulltan Hamitit. Me vrap u dërgua ushtëri e madhe nënë komandë të Xhavit edhe Tyrgut Pashës, të cilët vepëruan ato më të mëdhatë barbarizma kundra fatzinjvet Shqipëtarë!

Të dy gazetat shqipe, të Korçës, « Korça » edhe « Koha » ndalohen edhe Direktorët jepen në gjyq. I ndy-

eri edhe i pavdekuri Sami be Pojani, Direktor i « Korçës » trembet edhe shkon në Klysyre, edhe q'atëhere uga brengu e hidhërimi, që ndjente në shpirt të tij, u shti në sëmundje e cila e shpuri në varr! Unë Direktor' i « Kohës » jepem në gjyq edhe dënohem me 2 muaj burg edhe 75 lira gjobë. Fati, nofta, më shpëtojti se ditën e gjyqit më kërkonte rethimi ushtëriak, për të u gjykuar prej gjykatores ushtëriake, në Dibrë!

Besim Vesel Gegën e muar lidhur nga Korça edh'e dërguan në Ysqyp si shokun tim në çdo lëvizje edhe Hafëz Alinë e ndiqnin dyke i thyer natën penxheret me gurë e të tjera.

Prokurori — këllëu siç i theshnim — një Tyrk fanatik, po fort i nderçmë, më nderonte mua, sido Shqipëtar kombëtar, e më këshillou mos bënjë Apell [Istinaf] në Manastir se shpëtova lehtë në Korçë. Unë nuk'e dëgjova po e bëra Apell edhe kur do të vinja në Manastir u ktheva në Resnjë. Ishte Ramazan edhe vajta, bashkë me të ndyerin Mehmet be Frashërin, ne Niazi beu i cili na priti fort mirë. Biseduam për gjendjen e tmershme të Gegërisë, që vepëroheshin kundra Shqipëtarëvet, prej Turgut Pashës, edhe e pashë që psherëtitë e i helmuar më thotë: vëlla Mihal mos u dëshpëro se është një re me furtunë po do të shkonjë edhe këjo! Sa për dënimin t'im më tha që më jepte një letrë ose t'e hasnja në Manastir, ku do të viute të nesërmet.

As letrë mora as q'e kërkova Niazi benë dykë e lënë në dorë të drejtësisë. Gjykatësit të Apelit patnë mirësinë të më xbresin 10 dit nga burgimi, kështu që u ktheva në Korçë ku mbusha dënimin në burg edhe pagova gjobën, për të cilën më udihmuan nga kombëtarët e vjetër të Korçës, edhe të Amerikës. Ky dënim ishte i dyti ose i treti, andaj të burgosurit më prisnin me gëzim që t'u mësouja shqipen e t'i ngusëllonja që për së shpejti do të lirohen.

Me përpjekjet të Hasan Pashës Mesarese m'u dha lejë për botimin të « Kohës », teligrafisht nga Stambolli, po shumë atdhetarë pandehnin se e ndrova fletën,



me qënë që lëvdonja shumë Mahmut Shefqet Pashën. Po këto dyshime nuku më bënë nonjë përshtypje, se deluin nga ca atdhetarë vetëm të berihajit edhe që i prisnin gështenjat t' i hanin të pjekura!


Në këtë kohë ishte hedhur në luftën kombëtare edhe trimi patriot, dëshmor i pavdekur, Themistokli Gërmenji, i cili vepëronte në Manastir. Kishte mundur të nxjerë Spiron me Mihal Bellkamenin komita e kësisoj të zëshim për organizacie e vepërim të gjërë, po, mjerisht, tmeri edhe ftohtësira i kish pushtuar zemrat të Shqipëtarëve.

Organëzimi në Manastir udhëhiqeshe prej Ferit be Ypit, Themistokliut, Dr. Bedri Përmetit, Tellemah Gërmenjit edhe të vyerit patriot, që ra dëshmor në Durrës, Kamber Sejçedini.

Me qënë që ardhi dimëri vajti Themistokliu me të pavdekurin trimin edhe dëshmor kombëtar, Ferit be Frashërin, në Kolonjë edhe suall Spiron me Mihal Bellkamenin në Korçë, ku i mbajtmë ca dit, fshehurë, në Bandë të Lirisë edhe në shtëpi të të ndyerit patriot Vangjel Gjika. Si i veshmë me roba prej redifi (rezervë në ushtëri) i përcuallm në Korfus e q' andej në Napoli edhe Misir ku dimëruan.

Ishim unë, Themistokliu, Feriti edhe Vaugjeli që i kemi shkuar për mest qytetit edhe tregut gjer arrimë në han të Radeneçit, dyke ja dorëzuar Laskës qiraxhiut, me siguri që t' i hithte në Korfus. Ishte mez' i natës edhe po ruim reth mangallit me zjar, gjer të pregatiteshin kuajt, dyke pirë nga një raki të ugrohtë për urim të djemvet që shkonin në Amerikë, se ndodheshin edhe ca udhëtarë të huaj. Në këtë kohë ardhi një patrullë, për inspektim, edhe Vangjel Gjika, siç ishte guximtar, porositi hanxhinë t' i gostitë me raki për të uruar djemvet udhën e mbarë.

Me gëzim të math pranuan gostitjen si edhe cigaret e udejnë gjer i përcuallm, po unë me Vangjelin udejmë me patrullën dyke pirë nga rakia edhe dyke qarë hallet. Ndejmë se kishim frikë edhe dyshim, mos-





na ngjiste nonjë gjësëndi, gjer u kthyen Themistokliu me Feritin të cilët i kishin përcjellë jashtë qytetit, pastaj u kthyen në Bandë ku i gjori profesor Paskali u ngrit nga gjumi i tmeruar se mos ishin nga qeveria, po më të na njojtur hapi portën e udejmë brenda gjer në mëngjes, kur u përudamë.

Në të këtillë gjendje ndodheshim prandaj më 1911 unë shkova në Stamboll i thirur me një letrë si prej Çerçizit po jo, ishte prej Zemauit. Dyke udenjur nat' edhe ditë me Çerçizin vështrouj që as nonjë shenjë nuku tregonte për një lëvizje kryengritëse, me qënë tepër i dëshpëruar. I tregouj gjendjen e tmershme, të Shqipërisë, edhe bindet po më thotë gjej të holla se vetëm kështu munt të vendosim. Edhe mbi këtë pikë kish arësye të plotë se fort të rallë ishin ata që të ndihmouin.

Në këtë kohë kishin ardhur, në Stamboll, edhe Bektash Cakrani me të ndyerin, patriot e dëshmor Baki Gjinokastra gjithë për këtë qëllim, që të mireshin vesh me politikanët Shqipëtarë, të Stambollit. Për ditë bashkoheshin në zyrë të «Shqipëtarit», drejtuar prej Dervish Himës, ku mblidheshin e bisedonin shumë atdhetarë, po bisedime të kotta.


Një ditë mbetur vetëm neve, unë, Dervish Hima, Bektash Cakrani, Baki Gjinokastra edhe Hil Mosi vendosim të mblidhemi në Hotel Imperial, ku ndodheshin fshehur nga ndjekja e qevërisë, Bedri Peja e të bisedojmë xgjeshur. Dhamë fjalën e nderit që as nonjë tjtër do të mos e dijë, kështu që të nesërmet u mblotmë edhe e gjetmë të arësishme të ftojme nga deputenjtë Shqiptarë Nexhip be Dragën edhe Hasan be Prishtinën.

Këtë barrë e muar Dervish Hima me Bektash Cakranin që t' i lajmërojuë edhe kesisoj të nesërmet, në orën e caktuar, u mblotmë në Hotel Imperial. Bisedime të gjata nuku duheshin me qënë që ishim në një menjtim të plotë. I ndyeri Nexhip be Draga me Hasan be Prishtinën thonë që për në Kosovë kanë shpresën më të madhe për një kryengritje të përgji-



thëshme, pa e ditur qëllimin përveç ca të pakë nga krerët me dije, po sa për në Toskëri nuku besojnë, arrin vetëm që të dalin çeta e të bëhen lëvizje vendia-ke, ku aty ku atje, për te i dhënë ngjyrën të bashki-mit, Gegë e Toskë të kësaj kryengritje.

Ky menjtëm u pëlqye prej të gjithëvet edhe e pranuan që në Kosovë do të vepëronin Nexhip be-Draga edhe Hasan be Prishtina, në malësi të Shkodrës Hil Mosi edhe në Toskëri unë, Bakiu edhe Bektashi. Dervish Hima mbeti për në Stamboll edhe të hidhet në Çamëri me të parë që i aftohet reziku. Bedri Pejën-vendosmë të hidhet në Romani e në Bullgari, ku të-pakën të na ndihmonin atdhetarët me anën të shtypit European edhe me protestimet, në fuqit' e mëdha. Si mbetmë të lidhurë në këtë vendim u përndamë.





Dr. HAKI MBORJA      VANGJEL GJIKA





## KRYE E II.

### Plasja e kryengritjes

Më të u përndarë Bedri Pejen që të nesërmet e burgosnë kur përgatiteshe për të u hedhur në Rumani, Bektashi me Bakinë shkuan për në Vlorë me anën të Korfuzit, ku do të qëndronin 2-3 dit për të u bashkuar e biseduar me Ismail Qemalin, Gurakuqin e të tjerë Shqipëtarë që u lodheshin atje. Hil Mosi shkojti për në Shkodrë edhe unë për në Korçë.

Gjithë udhës po menjtonesha për barrën e rëndë që kisha marrë, aqë më tepër që në këto kohëra ndjenjat e nxehta ishin ftohur edhe ishin larguar nga atdhetarët, më të shumët, me mbylljen të shkollave, shoqëritë edhe ndjekëvet të kombëtarëve. Arriva në Selanik edhe u bashkova me Myftarin po nuku i çfaqta qëllimin, dyke i thënë që si të vete në shtëpi të shohim ç'vendim do të miret.

Në Manastir ku kisha një shpresë të madhe më doli e krimburë. I ndyeri Telemah Gërmënji më thotë që Themistokliu, vëllaj i tij, ishte hedhur për në Bullgari e q'andej do të ktheheshe në Shqipëri. Arriva në Korçë edhe zunë të më pyesin për të reat e Stambollit. Në Stamboll, u thashë, këtë kupëtova që gjithë fuqi edhe nuku është çudi të shohim një lëvizje të përgjithëshme edhe neve të mbetemi për turp të botës!

Që të gjithë psherëtitnin po duheshe punë e jo fjalë të thata. Atëhere u thom vetëm shokëvet, luftëtarë, të vjetër edhe mblidhemi që të vendosim programin. Mblidhemi edhe formojmë një komitet, i përbërë prej meje, Tefik Panaritit, të ndyervet patriotë Vangjel Gjika e Ferit Frashëri, Goni Katundi, Jaup Dishnica, Lumbi Bimbli, të ndyetët e të pandarët Kristaq Aristidhi, Gazi Thanas Viso e Qamil Panariti, Doktor Hakiu, Iazo Progri, Skendo Pojani, Stavre Karoli, i




ndveri Aleks Koçi, Nepsi Kerenxhin, Shaban Plasa djaloshi Gavril Pëppo, Stefan Kondillari etj.

Në Devoll ishin vepëronjës Mehmet Bidincka, Istref Verleni, Ali Çauush Verleni edhe i ndyeri Ali Mengulasi. Në Starovë Jasbar ben edhe në Kolonjë Salih Butka, i ndyeri dëshmor Qani Ypi, Xhezo beu e të tjerë.

Vërtet këjo punë u regullua po duheshe vënë në vepërim e në lëvizje programi, se për fat të keq neve Shqipëtarët i harojmë shpejt zotimet edhe fjalën, kështu që punën e barrën më të rëndë e muarm, unë, Vangjeli. Feriti, Goni, Jaupi, Skendoja, Stefani edhe Qamili. Duheshe një marëveshje e plotë më gjithë anët që të jepnim, në një kohë të caktuar, një shenjë për lëvizje kryengritëse. Të holla na mungonin prandaj vendosmë të dërgojmë të ndyerin Stefan Kondillari që të miret vesh me Beratin, Vlorën, Gjinokastrën, Fra-shërin e viset e tjera.

Çdo nisje është gjysm' e punës e mbaruarë, kështu që nisa unë i pari! Pagova qiraxhinë gjer në Berat, për të ndyerin Stefan edhe i dhashë shifrën, të marëveshjes, e cila ndodhet edhe sot e shkruarë në dollap, në shtëpinë tonë. Duheshin spenzime për udhëtimin në Shqipëri edhe që të hidheshe në Korfus të kupëtoheshe me Ismail Qemalin, Gurakuqin, Pandeli Calen e të tjerët që ndodheshin atje. Spenzimet u bënë prej gazetës time «Koha» dyke mbledhur pajtimet, të cilat u bashkuan edhe këto me të tjerat për atdhenë.

Letrat e Stefanit na gazonin, që tekdo mbretëronin dëshira e nxehtë për qëllimin e shënjtë. Kësisoj na shkruante edhe nga Delvina, i kthyer nga Korfuzi, që po marrin masat e duhura për të kallur armë në Shqipëri, nga Korfuzi edhe pastaj të pëlcase kryengritja! Mirëpo ditët shkounin, Themistokli Gërmënjin e zunë në Delvinë edhe Kolë Rodhen me Vasil Tromarën i burgosnë në Gjinokastrë. Nonjë shenjë nuku dukeshë q' as gjëkundi. Neshat be Vrioni me të ndyerin Ferit Lumanin vinë



nga Berati që të mësonin ç' bëheshe në Korçë. U thamë që jemi gati po ata ç' presin, kur se as nouj vënt nuku ka si pengimet e Korçës me qarket e sajë?

Duheshe nisja, të cilën as një nuku guxonte, prandaj u mblohtë në një qark të ngushtë edhe u vendos që Korça të japë shenjën e parë. Flamurin pra të kryengritjes e rëmbyen Doktor Haki Mborja Vangjel Gjika, Dervish Ibrahimini edhe Nepeci Kërënxiu dyke marë malet përpjetë, më 16 Qershor kur Sulltan Reshati ardhni në Manastir.

Këjo nisje bëri një bujo të madhe në të gjithë anët e Shqipërisë edhe ca më tepër kur duallë, pas një javë, Qamil Panariti, Lambi Bimbli, Sabri Lamariti, Kostaq Kosturi, Odhisea N. Kotta, Tushi Krastafilaqi, Kristaq M. Furxhiu, Nuçi V. Iapi, Fetah Qiuami e të tjerë. Armët më të tepërtat dhamë ata që kishin, Qamili dy, unë dy bashkë me gjithë takëmin të komitarisë, për të cilat më qan zëmra edhe sot, Fëriti dy, Kristaqi një, Sabriu dy, Jaupi një, Skendoja një, Goni dy e kësisoj zumë mblihuim për të tjerët. Të holla për të i veshur të pakën me guna edhe opinga, hë për hë, shtimë si cilido pas fuqisë.

Po të holla duheshin pas këtaj më shumë edhe zumë të mbledhim nga atdhëtarët që nuku trazoheshin në lëvizjen kryengritëse. Sjell nër mënt këto emra: Spiridon Ilo 15 lira, Selim Mborja 10, Stavre Karoli 15 lira, Fuat be Frashëri 10 lira edh' u zotua të na dërgonte 5-6 Tugra, Nikollaq Zoji 15, Aleks Koçi 15, Mahmut be Pojani 10, Jorgaq Raci 10, Thodhoraq V. Mano 10, Kostaq Fundo 10, Lytifi be Zavalani 10, Vangjo K. Turtulli 10, Viskë Gorguzi 10, Nikolaq Vangjeli 10, Miljadhi Adham 7, e shumë të tjerë, të cilëvet helmohem që nuku u sjellë emrat nër mënt.

Qani be Dishnica zuri të mblethë edh' aji midis të njohurve si në Korçë kështu edhe në Starovë. Të tjerë gjetkë për të përmbajtur Komitetin. i cili kish harxhe të mëdha se për dita po shtoheshin komitat, kështu që duheshin veshur e armatosur.




Gegëria gjithë me malësin' e Shkodrës ishin në kryengritje të plotë, e cila tani kishte shtruar edhe një program kombëtar, dyke kërkuar autonominë të Shqipërisë me një Guvernator prej Sulltanit. Edhe në Toskëri zuri një lëvizje më gjithë anëtë po organizimin qysh u bë nuku e dimë, prandaj ma lëmë dijesvet edhe atyre që muar anë në këto lëvizje kryengritëse.

Komiteti i Korçës dyke u forcuar dërgoiti, në Stamboll, Aleks Koçin për të dërguar Qerçizin këtu që te hidheshe në Gjinokastrë e gjetkë për të vepëruar. Qerçizi dyke marë edhe Myftarin, nga Selaniku, arriti në Korçë më 15 Korik ditën që martohesha unë dyke shpresuar që me mënyrën të martesit do të shpëtonja nga verejtja e qeverisë. Si udejnë tri dit, uë shtëpinë tonë, edhe biseduam gjër e gjatë shkuan për në Gjinokastrë, dyke ju dhënë nga arka e Komitetit 50 lira përveç spenzimeve. Veç këtyreve të holla u dha edhe Lambi Ramizi një sumë.

Në Korçë plakosi një ushtëri e madhe edhe gjithë qyteti u rethua an' e mbauë edhe u deklarua rethimi ushtëriak. Më 21 Korik që me natë na ruanin edhe me të dalë nga shtëpitë na shpinin në Yqmet, ku, si na kërkonin gjithë robat e trupit e na pyesnin për emrat, na klisnin në burg. Atje po sillnin një nga një prej nesh ku përshëndosheshim, midis tonë, po mjerisht ishin edhe ca të pafajshmë si Idhomenea e Kristaq Kosturi.

Nga Devolli suall në burg Mehmet Bidinckën bashkë me të dy bijt' e tij Hasanë edhe Haxhinë. Istref Verleni, i cili si për çudi kishte shpëtuar nga vdekja, kishte shkuar me Ali Qaushin për të blerë armë nga Bullgarët po ushtëria u kish bërë prite edhe Ali Qaushin e vranë edhe Istrefin e zuuë të gjall. Trupi i tij nuku ishte përveç plehë edhe gjakrat i rithnin uga të rahurit q' i bënë 3 dit e tri net! Pastaj të lidhur e suall në burg bashkë me Reufin, vëlla me dëshmorin Ali Qaushin.

Kësisoj u mblotëm në burg 26 shpirt si suall e






Themistokli Gërmenjin lidhur, nga Janina e Dervish Hajderin, sot Baba në Teqe të Turanit Korçës. Ishim pra këta, me sa sjell nër mënt, të burgosur: Unë, Tefik Panariti, Ferit be Frashëri, Idomenë Kosturi, Mehmet Bidincka me Hasan e Haxhinë, Stavre Faroli, Japup be Dishnica, Kristaq Kosturi, Skendo be Pojani, Baba Hajderi, Themistokli Gërmenji, Istref Verleni, Kristaq Aristidhi, Reuf Verleni, Bido Tepelena, Gaqi Thanas Viso, Dervish Ibrahim, Rexhep Vinçani edhe Alim Tragjasi, nga Vlora. Ishin pastaj një rojtës në çiflig të Pandeliut, lopëçari i Burgalecit, një xhandërma nga Taçi, një çoban q' e kishin marë udhëheqës.

Me një fjalë shpirti edhe zemra e lëvizjes kombëtare, jo vetëm i Korçës po edhe në viset e tjera, ndodheshe në burg. Dëshpërimi i të jashtmevet ishte i math shumë edhe frika u kish mbirë në zemër. Një nga vëllezërit tanë, të Komitetit, Goni Katundi mundi të shpëtonjë, nga burgu, dyke u fshehur po nuku munte që të punonte dot. Në burg na vunë në një vërejtje më të madhe dyke na përndarë në për kaushet nga 2-3 me urdhrin që të mos kuvendonim midis nesh.

Mbi gjithë këto u kish rënë në dorë një letrë e shifruar drejtuar mua, nga Gjinokastra. Më nxjerin nga burgu në Yqmet, në dhomë që ishte ngrehur enkas për neve, prej rethimit ushtëriak, për të na bërë hetimet më kallin brenda kur shoh që ishin 8-10 Oficerë, Pyetësi, edhe Lytifi be Zavalanin, të cilin e kishin marë për përkthenjës (terxhumah). Pyetësi më tregon një thirrje të Komitetit, botuarë në gazeta «Koha» edhe më thotë që përse e botova?

I thashë që e përktheva nga gazetatat tyrqishte edhe gërqishte me qëllim për të i hequr vërejtjen qeverisë që të marë masat e duhura. Oficerët tundnë kryet me një qeshje të mvrojturë. Mirë fare, thotë pyetësi, po kur qënke kaqë dashëmirë i qeverisë lëçite edhe tregona ç' të shkruajnë në këtë letrë, se s' ka fjalë që vetëm tinë e kupëton.

Mar letrën e me të shtënë sytë e njojtja shkrimin,



po dyke e vertitur u thom: plitkua si edhe letra janë për mbi mua po unë nuku e njoh këtë shkrim si kundër as këtë gjuhë, me të cilë është shkrojturë, nuku e kupëtonj.


Atëhere ngrihet me zemërim një Kolonel (Bimbash) e dyke më treguar ca shkopiuj të ujontë më thotë: A i sheh këta shkopiuj? të gjitha mbi kurishtënt janë për të u thyer po trego të vërtetën, se tinë edhe tinë je kryeja i këtyreve trubullimeve që vepërouen në Shqipëri!

Dorën e kini të gjatë edhe munt të më bëni ç'të doni, u thom, po dijeni këtë që unë as fajtor jam as letrën nuku e mar vesh kush ma dërgon.

A qen ore qen, më përgjigjet, do të veshtrosh tinë edhe vrapon tek dera për të thirur një ushtar që të më rinte kur një tjetër Oficer m' i math, prej të shtetit Madhor, e udalon edhe mblidhen që të gjithë, në një qoshe të dhomës për të biseduar. Dyke mbetur vetëm me Lytfi benë më thotë: mbaju burrë Mihal se pastaj litarka të pret! Le të bëjnë si që të duan Lytfi be, në dorë më kanë, po unë jam i pafajshmë. Pa dyshim që druhesha e nga Lytfi beu edhe nga cilido që të ishte.

Si biseduan midis tyre kthenet, pranë meje, Oficeri i shtetit Madhor e më gjuhë të ëmbëlë, se dukeshë që kishte një arësim të ualtë, më thotë: Grameno Efendi tinë je një gazetar edhe është turp që të rihesh, prandaj tregona për letrën kush ua dërgon, me qënë që juve nuku u ngarkouet nonjë faj. Tregona që cili është shkronjësi i letrës ose në mos e njihni mbi cilin kini dyshim?

Besomëni, në kini Perëndi, u përgjigjem, që nuku e njoh as shkronjësin as gjuhën të letrës, po s' ka dyshim që letra më është dërguar mua me qëllim që të më humbasin. Si gazetarë kam bërë edhe armiqë, edhe dyshimi tim qendron vetëm me Propaganda Greke, e cila më ka hale në sy, me qënë që i kundrështonem në qellimet që yshqen kundra mbretërisë tonë!



Dyke parë që nuku uxirniu nonjë tjatër fjalë më dërgojnë prapë në burg, po më thonë kësisoj: të lemë të meujtonesh mirë se nga këjo nuku ke shpëtim.

Kur ryra në burg shokët po prisnin me padurim, edhe mjaft të frikësuar, të mësoniu pësimet e mija, po unë që në porta zura të shanj ata që më kishin dërguar letrën. S' duhet thënë që as shokëve nuku u tregova për shifrën sa kohë që ndejmë të burgosur, me gjithë që i ndyeri Themistokli e kupëtojti që do të ishte nonjë letrë e shifruar.

Gjendeshim pra në një gjendje të keqe shumë, po me gjithë këtë nuku dëshpëroneshim edhe meujtonim që me çfarë mënyrë munt të delnim nga burgu se ishim sigur që do të na dënoun rëndë. Direktori i burgut ishte Take Talaj, me të cilin njiheshim edhe kishim që të gjithë miqësi po jo të përzjerë në çeshtjen kombëtare, gjer në një besim të plotë. Me gjithë këto i çfaqim meujtimin dyke i proponuar kryesinë që do t' e kish ay, kështu që do të mbeteshe i pavdekur në histori të Shqipërisë, për një veprë patriotike si këjo.

Në krye Takeja u zëmërua edhe nuku afroheshe gjëkund, po pastaj, dyke i treguar neve famën që do të mirte edhe shërbimet e mëdha që do t' i sillte atdheut, pranojti të bënim këtë goditje. Vendosmë pra që nesër brëma të zëmë rojtësit e xhandarmarinë të burgut, të cilët do t' i mblithte Takeja që t' u jepte nonjë urdhër gjësendi, edhe do t' i mbyllnim në burg edhe neve gjithë, sa që ndodheshin të burgosur 135-150 shpirt, do të shkouim për në Ersekë, ku kishte mjaft municione.

Pllani ishte prementuar fort bukur, po fat' i zi nuku na udihmojti që t' e vinim në vepërim. Një gjemë nga më të këqiat e të tmeruarat ngjajti atë mëngjes pa u gdhirë mirë. Qetat e Qamil Panaritit edhe Spiro Bellkamenit ishin bashkuar në Frashër edhe kishin ardhur në Orman Çiflig, gjysmë ore lark Korçës me qëllim që të tareshin vesh edhe t' i binin burgut. Këto po menjtoniu trimat e Shqipërisë, edhe fliuin me



këto ëndëra të bukura pa shkuar nër mënt që një ushtëri e madhe i kish rethuar natën!

Kur zuri të hapeshë dita karauilla veshtron që ishin trathëtuar edhe rethuar, prej ushtërisë, kështu që vrapon të lajmëronjë shokët. Ngjohen të tmeruar edhe kërkojnë në të zënë nonjë vënt të fort, me qënë në fushë të hapet, po zjari hapet nga gjithë anët edhe kësisoj dyke lëftuar arrinë në kënetë. Të mbytur në baltra muntne të hidhen përtej, po për fat të zi jo të gjithë! Duheshë vaditur dheu i Shqipërisë me gjakun e vyer, të bijvet saj, për të shenjtënë liri!


Kristaq M. Furxhiu, Nuçi Lapi, Pajazit Rehova, Kostaq Spiro Kosturi, Odhisea N. Kotta edhe Tushi Krastafilaqi ranë dëshmorë për mbi alltarin të atdheut!!!

Dita pra 28 Korik 1911 do të jetë një ditë e zezë, po edhe një ditë historike për Shqipërisë!

Alim Çelo Trajazin, i cili ishte nxënës në Korfuz edhe u shoqërua me Spiron e Mihal Belkamenin kur u hodhë në Shqipëri, e zunë në një fshat ku kishte mundur të shpëtonjë nga lufta, e zunë të gjallë edhe e suall në burg bashkë me neve.

Q' atë ditë u rethua edhe burgu me ushtëri, kështu që plani ynë mbeti i pambushur. Zëmë nga ankimet në Stamboll po përgjigjeja ishte që, punën tonë, do t' e kqyrnjë drejtësija. Me gjithë këto nuku dëshpëroneshim as pak, përkundrazi gëzoneshim kur mësonim që lëvizja kryengritëse po përhapeshë në gjithë anët e Toskërisë.

I pavdekuri patriot e dëshmor Memdu be Zavalani ishte hedhur në anët e Përmetit edhe me Mehmet Pavarin kishin regulluar shumë mirë çetat edhe lëvizjen. Dyke u bashkuar e me çetat e Delvinës, nënë kryesi të Nafiz Aderit nga Palavlia, qëllonin të goditnin Përmetin edhe t' u vinin ndihmë Gjinokastritëve, po, mjerisht ushtëri e madhe ish dërguar e në ato vënde, kështu që në një luftë që bënë për mbi Pangri ra dëshmor Nazif Haderi, dyke lëftuar burrërisht për të shpëtuar gjithë shokët!



Kryengritja pra e madhe e Gegërisë, si edhe përhapja që po merte në Toskëri, e shtrënguan qeverinë Tyrke të menjtonet që të përdorë tjetër mënyrë, për pushimin të kryengritjeve. Si e pa që me gjithë ushërinë të madhe, që dërgojti, si e me masat barbare që u vepëruan, kundra Shqipëtarëve, uuku munte të sjellë nonjë dobi vendosi të dërgonjë Komisione paqësore edhe këshilloujësë, prej Shqipëtarësh, që të bindin Shqipëtarët që të mos vazhdojnë me armë në dorë të lëftojnë kundra qeverisë.

Në Toskëri u emëruan edhe dërguan Fejzi be Alizoti edhe i ndyeri patriot Abdyl be Ypi. Shetitnë Çamërinë, Labërinë edhe pastaj ardhë në Korçë. Tekdo kishin pushuar kryngritjet, në Toskëri, me amnistinë që dhanë edhe me zotimet të qeverisë Tyrke — si nga hera — që paskëtaj do të mbushen, plotërisht, kërkimet edhe të drejtat e Shqipëtarëve.

Fejzi beu me Abdyl benë ishin nga Shqipëtarët, të cilëvet nuku munt t' u mōhonjë patriotizmën, kësh-tu që nuku kishim nonjë dyshim përveç asaj që i shërbenin edhe qeverisë. Na vizituan në burg dyke na thënë që do të përpiqen edhe për lirim tonë, pa si tani qendron në dorë të drejtësisë, po të jemi sigur që për së shpejti do të lironemi.

Mbi emër të shokëve u përgjigia kësisoj: U njohim fort mirë që jini kombëtarë po sot jini dërgatës të qeverisë prandaj u lutemi t' i thoni qeverisë që edhe pas të liruarit prapë burgu do të na presë. Sa për lëvizjen kryengritëse që e pushuat, Z. uaj, jini të gabuarë, se ajo do të përsëritet edhe xgjerohet më tepër sa kohë që qeveria nuku na jep të drejtat tona.

Atëhere i ndyeri Abdyl be tepër i hidhëruar thotë: Q' munt të bënim tjetër kur se nuku gjetmë gjekundi nonjë organëzim siç duhet? Dëshpërimi edhe mosmarëveshja mbretëronte kudo se ja edhe juve po ndodhi të burgosur!

Jemi të lumtur, thotë Fejzi beu, që fituam amnistinë e për Toskërinë, e cila ishte dhënë vetëm për



Gegërinë, se tjetër soj do të jepeshin vetë edhe të namбетeshe një turp i math gjithëvet.

Si biseduam mbi rjedhjet e ditës, atdhetarisht, shkuan edhe ardhë pas 3-4 dit kur muar lamtumirë se shkuan për në Stamboll. U përpoqnë me gjithë fuqin' e tyre, për lirimiu tonë, po më kot se drejtësia (Adlia) vinte pengime, kështu që ditët shkonin edhe pas tyre shkonin edhe javët e muajt.

Për fatin tonë ardhë në Korçë një korespondent i «Tajmsit» Loudrës, Z. Guod, i cili na vizitojti në burg i bashkuar prej Z. Kenedy edhe prej Prokurorit me dy anëtarë të Gjykatores. Na pyeti edhe mori shënimet e duhura, kështu që me të vajtur në Manastir ju qa Valiut edhe Stambollit për mbajtjen tonë në burg, kur se ata që kishin rëmbyer armët u falë.

Nuku shkuan shumë ditë kur na liruan më të shumët, pas 5 muaj burgimi edhe mbajtne Tefik Panaritin, Themistokli Gërmënjin, Dervish Ibrahimin, Ferit benë, Istref Verlenin Alim, Trajasin edhe Xhandarin akoma edhe tri muaj. Veç këtyrevet mbetne në burg edhe Shpatarakët që nënë kryesi të Sadik Zashit, dërguar prej Korçë, goditne Postën të Elbasanit.

Kësisoj mori funt kryengritja e vitit 1911 dyke u pandehur që qetësia do të zotëronte paskëtaj.





Kryengritësit Shqiptarë  
**SPIRO BELRAMENI**      **QAMIL PANARITI**      **MIRAL BELRAMENI**



### KRYE E III.

## **Lufta Ballkanike edhe vetëqeverimi i Shqipërisë**

U pandeh me të vërtetë që u shua zjari, q'ish ndezurë, në gjithë anët e Shqipërisë, po ish vetëm një pandihm, se me të ardhur pranvera e të gjelbëronte gjethi zuri të lëviste prapë kryengritja, në vitin 1912. Barbarizmat e tmeruara vepëruar, prej Turqvet, kundra Shqipëtarëvet deshnin shumë kohë që të shërohen edhe harrohen, po gjithë këto Tyrqit, në vënt të gjenin melemën për të mbyllur plagët, përkundrazi kërkonin t' i hapin ca më tepër.

Pas amnistisë në vënt të mbushnin zotimet zunë të ndjekin krerët edhe bajraktarët, të Gegërisë, dyke burgosur ca nga këta edhe me mënyra dhelpërake kërkonin që qysh e qysh t' i përçanin, midis tyre, edhe t' i armiqësonin! Në vënt të ndreqeve të shtëpive të djegurra, prej ushtërisë, të rugave, të çelura të shkollave zunë me një reptësi të madhe ç' armatimin edhe të përsëritin ndjekjet e para, kështu që të mjerët Shqipëtarë u shtrënguan të marrin malet për të mprojtur jetën e tyre.

Kryengritja plasi në gjithë anët edhe zuri të zgjerohet e në Toskëri, ku kishte ardhur Kapiten Tajari me nipin e tij Tasimin, të ikur prej ushtërisë nga Manastiri. Shtypi European për dita nuku mereshë përveç se me kryengritjen të Shqipëtarëvet të cilën e quanin tani lufta Turko-Shqipëtare dyke treguar trimëritë të Shqipëtarëvet, edhe për herojin më të math kishin trimin burrë Isa Boletinin!

Ushtëria Tyrke për dita po thyeshe nga Shqipëtarët, të cilët në numur 30.000 shpirt po përgatiteshin që t' i rrujë Ysqypit. Në Toskëri plasi kryengritja e përgjithëshme edhe qëllonin të marin qytetet. Në këtë kohë vranë komitat Shqipëtarë të tmeruarin Rexhep Palla, i cili vriste edhe priste në Prefekturë të Korçës pa pyetur njeri, me qenë zemra edhe shpirti i Xhemietit!





Qeveria Tyrke atëhere vetëm e kupëtojti që me dhelpëritë, të zakonëshme, si edhe me ushtërinë nuku munte te pushonjë kryengritjen Shqypëtare prandaj dërgojti një Komisjon fuqiplotë, nga Stambolli, për të nënëshkruar një traktat të marëveshjes edhe lidhjes midis Turqisë e Shqipërisë.

Komisjoni arriti në Ysqyp ku ardhë dhe përfaqësonjësit e Shqipëtarëvet edhe zunë nga bisedimet. Pas shumë mbledhjeve arrinë në një kupëtim dyke lënë nga Nyjet edhe nga njëra anë edhe nga tjatra. Me një fjalë njiheshe Kryesia e Turqisë po me një Shqipëri Autonome! Kështu pra u pushua kryengritja edhe nuku priteshe përveç që të emëroheshe Guvernatori, prej Stambollit, e të zinin nga vepërimet qeverimtare edhe organizatore. Mirpo pa shkuarë shumë kohë plasi lufta Ballkanike!

Armiqët më të mëdhenj, midis tyre, gjer djethinaj, dyke përfituar nga politika e qelburë Tyrke, e cila kishte 3 vjet me radhë që po përdorte fuqinë kundra Shqipëtarëvet, pernjërjesh u bashkuan edhe lithuë aliancë kundra Turqisë. Ata që dridheshin nga hijeja e Turqisë me të parë që Shqipëtarët, të cilët ishin shylla edhe krahërori, të Tyrqisë, u armiqësuan si kundër edhe frika e Autonomisë Shqipëtare, i bënë që t' i hedhin prapa krahëvet gjithë merite edhe armiqësitë, që kishin midis tyre, e të bashkohen Grëqia, Serbia, Bullgaria edhe Mal' i Zi kundra Tyrqisë, së cilës i deklaruan luftë më.

Kohë më të bukurë edhe rast si këtë nuku munt të gjenin kurrë të kurrës Ballkanasit, me qënë që Shqipëtarët ishin tepër të mërzitur nga politika Anadollake, kështu që nuku muar anë në këtë luftë. Se përveç mërzitjes ishin të ç'armatosur, kështu që vetëm një kundërshtim të vogël treguan. Prandaj ushtëritë Grekë, Serbë edhe të Malit Zi nuku gjetnë nonjë kundërshtim të math, prej ushtërisë Tyrke, edhe rynë e zapëtuan Shqipërinë me të rënë Selaniku.




Shqipëria po shkeleshe, an' e mbanë, me nj' anë prej ushtërive Greke edhe me tjatër anë prej ushtërive Serbo-Malëzezë, dyke gjetur pengim edhe kundrështim vetëm në kryeqytetet të Shqipërisë, Shkodrë edhe Janinë, ku lëftonin trimat Shqipëtarë nënë Komandë të dy luftëtarëvet të mëdhenj, Esat Pasha Toptani edhe Esat Pasha Janina, dy herojë të cilët habitnë gjithë botën me burrërin' e tyre që treguan!

Dëshpërimi pra ishte i pa treguarë nër gjithë Shqipëtarët, për fatin që i priste, po ç' munt të bënin? Gjithë shpresën e kishin varur tek Përendia për të mjerën Shqipëri, edhe si të hequr prej magneti drejtoheshin në Vlorë për të gjetur nonjë shpëtim. Plakosnë nga gjithë anëtë të Shqipërisë po as nonjë vendim nuk u mereshe prej askujt, për shpëtimin të atdheut, kur se armiqët po shkelnin më gjithë anëtë.

Në këtë kohë edhe gjendje, kaqë kritike e të rezikçme, arriti në Vlorë plaku Ismail Qemali, kështu që gjithë vështrimi ishte drejtuar tek ky plak i rahur me diplomatinë Europeane, edhe priste shpëtim. Edhe kishte aresye populli që të mvarte gjithë shpresën, tek ky plak i vyer edhe i ndjerë, me qënë që vetëm mendja e Ismail Qemalit munte të gjithë një enigmë kaqe të koklaviturë!

Shqipëria po shkente në orën e fundit të rezikut, se më nj' anë ushtëria Serbe arriti në Durrës, ushtëria Greke po vazhdonte përparimin të saj edhe ushtëria Tyrke, e thyerë edhe çkatëruarë, po përmbledheshe në Berat. Nuku kishte mbetur pra përveç Vlorës e cila lidheshe me Gjinokastrën edhe me Janinën dyke ju kundërshtuar ushtërisë Greke pa nonjë shpresë.

Në të këtyllë gjendje duheshe mëndje e hollë edhe guxim, prandaj Ismail Qemali si mendouet, vetë vetiu, mblodhi gjithë parësinë, që udodheshe në Vlorë, edhe si u tregou gjendjen edhe rezikun të math u thotë që melemi edhe shpresa e fundit e shpëtimit qendron këtu: Të çkëputurit të Shqipërisë, nga Tyrqia, edhe proklamimi i vetëqeverimit të saj si një i pavarure. Me-



njtimi i Plakut pëlqenet nga të gjithë edhe me gëzim te math nënshkruhet protokoli i shenjtë!

Atëhere Ismail Qemali përpara popullit proklamoi vetëqeverimin të Shqipërisë edhe me duart e tij të çel-nikta ngriti flamurin dykrenor të Shqipërisë në mest të entuziazmit, të pareshturë, të popullit i cili qante nga gëzimi!

Pas 500 vjet, pra, u dërmuan zinxhirat e robërisë edhe atëhere Toskë edhe Gegë, Muhamedanë e të Krish-tëre u njojnë që janë vëllezër edhe bijt' e vërtejtë të nënës Shqipëri! Q' atëhere u çporë gjithë dhelpëritë edhe intrigat e armiqëvet, të cilët i kishin përçarë Shqipëtarët, në Turq edhe Kaurë, kështu që e kupë-tuan se Shqipëria është një e të gjithëvet pa nonjë ndryshim feje!

Simbolli edhe dita më e shenjtë, kombëtare edhe historike, për kombin Shqipëtar, është edhe do të jetë, sa të rronjë bota, dita e flamurit 28 Nëntor 1912!!!

Formohet Kabineti i parë, i Shqipërisë, nënë Kry-esi të Ismail Qemalit kësisoj: Kryeministër Ismail Qe-mali edhe nënëkryetar Nikolla Kaçori, Ministër Myfid be Libohova, Mehmet Pasha Kalkadeneli, Luigj Gura-kuqi, Petro Poga, Abdi be Toptani, Lef Nosi, Midhat Frashëri edhe Pandeli Cale. Me të u formuar Kabine-ti me vrap Ismail Qemali u bën të njojturë Fuqive të Mëdha vendimin të kombit Shqipëtar edhe u lute-she t' i mprohen të drejtat e tij në Konferencë të paqës.

Proklamimi i vetëqeverimit Shqipërisë, i pa pri-turë edhe i papandehurë, solli një ndryshim të math në qarqet diplomatike aqë më tepër kur se në Lon-drë ishte hapurë Konferenca e paqës Balkanike edhe bisedonin për zgjidhjen të kësaj çështje. Pas ca dit një vapor lufte Greku bombardojti Doganën e Vlorës dy-ke bërë të paka dëme. Qeveria tonë protestojti në Gre-qi, për mbi këtë ngjarje, e cila u përgjigj që gabimisht u vepërua këjo goditje dyke pandehur se flamuri ishte i Tyrqisë edhe jo i Shqipërisë.

Grekit, për të mos patur marëveshje me Europën,



na prenë kabllon, kështu që mbetmë të rethuar, si peshku pa ujë, nga gjithë anëtë edhe ca më tepër ahë kur se kishim nevojën më të madhe që të mësonim gjyqin të fatit t' onë, prej Konferancës së paqes. Vetëm kur vinte nga nonjë anie lufte, për të kqyrun bllokatin, e na jepte nonjë gazetë mësonim edhe neve se ç' beheshe në botë!

Lufta po vazhdonte me reptësi të madhe në fortesat të Janinës, ku, ishte mbledhurë gjithë fuqia Greke për të shtrënguar rënien të Janinës. Po Esat Pasha qendronte i çelniktë me ata burra luftëtarë Shqipëtarë, me gjithë që municionët edhe të ngrënat kishin zënë t' i sosën. Pas shumë luftërave, të repta e të pareshura dit' e natë, u shtrëngua të vinjë vetë mbreti, i Greqisë, edh' atëhere u përsëritnë goditjet më të mëdha, gjer sa mbeti Esat Pasha pa nonjë gjyle e pa bukë edhe kësisoj e dorëzojti Janinën në duart të ushtërisë Greke, 6 Mars 1913!

Me të rënë Janina ju turë Gjinokastrës, Delvinës, Përmetit e Tepelenës, pa gjetur nonjë kundrështim fare, edhe po i afroreshin Vlorës. Atëhere na pushtojti një frikë e madhe, andaj me vrap bëmë një mbledhje me Kosovasit dyke patur për kryetarë trimat burra Isa Boletine, Riza be Jakovën, Zenel be Ipekun, edhe neve gjithë refugjatët e Toskërisë me Salih Butkën, Muharem Rushitin edhe vendosmë që të lëftojmë gjer të mbetet i fundit, për nder të flamurit q' u ngrit në Vlorë, me gjithë që e dinim fort mirë se kundrështimi ynë ishte varrimi i sigurtë! Lumtërisht ushtëria Greke nuk kish urdhër për Vlorën edhe kështu zunë prapë jetën të bllokates, dyke pritur dita ditën që të nënëshkrueshe paqeja.

Kur se ndodheshim në të këtillë gjendje e dëshpërim ardhni në Vlorë, prej Serbie, Fehim be Zavalani i dërguar me një mision të posaçmë nga ana e qeverisë Sërbe. Misioni ishte një proponim q' i bëheshe qeverisë tonë që të rynte Shqipëria në një Konfederacie me Serbinë dyke patur të dy shtetet Kryetar mbretin




të Serbisë. Qeveria Shqipëtare nuku e priti këtë proponim nga shumë shkakë e kësisoj nuku rynë as në nonjë bisedim për marrëveshje.

Të bllokuarë, zumë të ndjejmë mungimin e gjërave të rrojtjes edhe neve, pa nonjë shpresë që do të hapeshë bllokata. Për fat të keq kishte ca kohë që edhe aniet Greke nuku na vizitonin si përpara, prandaj ndodheshim të brengosur e të mërzitur po ç' munt të bënim?

Në të këtillë dëshpërim ndodheshim kur një brëma, errëtë fare edhe gjindja ishte mbyllurë në për shtëpitë, dëgjonet një signall vapori që rynë në liman të Vlorës, më 26 Mars 1913. Ishte mjaft që të çkulët gjithë gjindja e të rëzohet në skelë për të mësuar ç' vapor ishte edhe ç' të reë na sillte. Dritat po llamein që për së largu dyke i dhënë një bukuri të veçantë, limanit, aqë më tepër ahëre kur kish mbeturë, prej kaqë kohë i shkretë. Me të u afruarë heth ankoren edhe dalin me një shallupë me benzinë Petre Goxhamani edhe Petre Kakariqi, nga të cilët mësuan që ishte Yakti i Duk Moanpensierë. Pyes Goxhamanin, shok të vjetër, veçanërisht për Princ Gjikenë në ndodheshë në Yakt, e m'u përgjigj që jo, përgjigjie e cila më kalli në dyshim, me qënë që Goxhamani ishte sekretari i Princ Gjikesë.

Ramë të flemë po mua nuku më zinte gjumi, kësisoj që pa u gdhirë mirë rëzohem në skelë edhe heth sytë në Yakt, kur shoh që pranë flamurit Engles valonte edhe flamuri i Shqipërisë! Zemra më rihte pa prerë, nga gëzimi, kur pashë edhe flamurin tonë të valonte për mbi Yakt e një mijë shpresa të bukura më shkuan nër mënt, për pritmjën të Shqipërisë. Një shallupë niset nga Yakti edhe me të u afruar sallutonj Princ Gjikenë, me të cilin njihesha fort mirë që në Romani. Dalin përjashta e më bën të njojtur me D-rë të Dukës edhe një Oficer që ishin bashkë.

Me pak fjalë Princ Gjika më thotë: I dashuri Grameno, po eq dorë nga kërkimi i Fronit Shqipërisë



për të ja ofernar Duk Moanpesierë, trashëgimtar i Burbunetve edhe një nga më të pasurit e Mbretërve të Europës. Fati i ardhë në dorë Shqipërisë edhe tani le të përfitojnë Shqipëtarët, se rast të këtillë nuku do të gjejnë. Si ndejmë edhe pakë, në zyrë të karantinës, më mori edhe mua në Yakt ku isha i pari që më paraqiti L. N. Tij Dukës. Më priti me kënaqësi të madhe edhe biseduam për mbi Konferencën të paqës edhe pritmjën të Shqipërisë.

Duka doli në qytet e vizitojti qeverinë dyke i dhuruarë Bashkisë 2,000 fr. ar për të vobekëtit. Biseduan për mbi ofertën të Fronit edhe të beheshe proklamimi i Dukës për Mbret i Shqipërisë që të dyjtën ditë. Ismail Qemali, Myfit Libohova, Gurakuqi si edhe që të gjithë Ministrët e populli e pritnë me gëzim, këtë ofertë, po mjerisht nuku dinim as pak frymën e Europës, prandaj u vendos që Ismail Qemali me Gurakuqin edhe Isa Boletinin të vinin me Yaktin në Europë për këtë çështje si edhe çështjet të kufivet e të ngriturit të bllokos.

Në Europë nuku gjetnë nga fuqit' e mëdha që t'ë përkrahin kandidaturën të Dukës edhe kësisoj Fronin e lanë në dorë të fuqive të mëdha. Me përpjekjet e lutjet të Ismail Qemalit, pas 5-6 dit u ngrit bllokata edhe ardhë i pari vapor Italian. Niazi be Resnja, tepër i sëmurë, ardhë nga Berati, në Vlorë, për të shkuar në Stamboll po, mjerisht' e vranë kur do të ipte në barkë për çështje vetjake. Unë me të ndyerin Pandeli Cale shkuan në Itali dyke u hedhur Pandeliu në Svicërë edhe unë në Milano, ku ishte Komiteti Shqipëtar në kryesi të Preng Bid Dodes.

Pas përpjekjeve që bëmë që të gjithë, të përndarë në Europë, u mblohmë në Vlorë dyke pritur xbrazen të Shqipërisë prej ushtërive lëftonjëse. Me qënë që Gjinnokastrat ndodheshe në rezik shkuan në Europë Myfit Libohova me Petro Pogën, Reuf Ficon edhe Thoma Papapanon për të protestuarë kundra kërimit të Greqisë.



Shkodra qendronte e rethuarë edhe e bombarduarë, dit' e natë, po luani Esat Toptani qendronte i patundurë edhe që nga Taraboshi edhe nga Bardica i shtynte armiqët. Me rethimin e Shkodrës mbeti Europa e habitur edhe gjithë qarket ushtëriake edhe diplomatike çuditëshin me guximin edhe trimërinë të Esat Pashës, i cili me një grusht Shqipëtarë mori një famë të madhe edhe nderojti gjithë kombin Shqipëtar!

Mirpo goditjet e repta e të përditëshme zunë t'ja sosin municionet Esat Pashës, edhe të ngrënit arriu kaqe pak sa  $\frac{1}{4}$  t' i jepte ushtërisë, sa për popullin  $\frac{1}{10}$  nuku i vinte, përveç të tjeravet sende të nevojshme që i ishin sosur! Me gjithë këto herohji i Shqipërisë nuku tundeshe po, si një Kapitan anie që vështron mbytjen edhe ri i patundur mbi detyrë, kërkonte që të qendronjë gjer në orën e fundit, për të mbushur detyrën ushtëriake edhe Shqipëtare!

Vetëm atëhere kur e pa që gjindja vdiste nga urija edhe yshqeheshe me rënjë binë e pemësh, ushtëria arriti me  $\frac{1}{8}$  të të ngrënit municionët u sosnë krejt edhe ç' do shpresë ndihmë ishte e prerë që t' i vinte, nga gjekundi, atëhere edhe vetëm atëhere vendosi Esat Pasha që t' e japë Shkodrën, në dorë të armiqëvet, më 23 Prill 1913!

Shkodra vërtet ra, po Xhenerali i math, Esat Pasha Toptani, nuku e dha! Bëri marëveshje me armiqët, me konditë, që të jetë i lirë që të liqet me ushtërinë, në Tiranë, edhe kësisoj ditën 23 Prill pas një rethimi prej 7 muaj, dyke lëftuar si burrat më të mëdhenj të botës, doli me nderime të mëdha, nga ana e armiqëvet, doli nga Shkodra jo si i mundur po mundës!!!

Pa si ndenji ca kohë në Tiranë edhe mori vehten, pas kaqe të vojtura, ardhni në Vlorë edhe për hir të atdheut pranojti të rënjë në Kabinet dyke marë Ministrinë të punërave Brendëshme. Gëzimi ishte i patreguarë në zemrat e popullit, për këtë marëveshje e cila siguronte pritmjën e lumturë për Shqipërinë, po ky gëzim ishte i shkurtër se me vrap zunë mjerimet! Si





në shumë raste historike, kështu edhe ahëre u ndodhë zemër liq të cilët, për të mbushur inatet edhe qëllimet vetiake, kallë grindje midis Ismail Qemalit edhe Esat Pashës edhe muntënë të bindin Esat Pashën që të formojë tjetër qeveri në Durrës me Shqipërin e mesme nënë sundim!

## KRYE E IV.

### Gjendj' e dëshpëruarë

As shuplaka e madhe që ju dha Shqipërisë, me padrejtësinë që vepërojti Konferenca e paqes, nuku u ndjeli kaqe shumë sa goditja e paanëshme e Durrësit! Vërtëjt Konferenca e Londrës 1913 krijoi një Shqipëri të krastiturë, siç është sot, po përçarja e Durrësit tregojti që nuku meritoni as për kaqe.

Armiqësitë zunë midis të dy qeverive, për të treguar zotimin e fuqinë cilado, kështu që arrinë edhe në luftë vëllavrasje! Është një nga faqet më të tmershme edhe më të zeza, prej të historisë kombëtare, me ngjarjet e ahershme, të vepëruara në një kohë kaqe kritike kur se pjesa m' e madhe e Shqipërisë ndodheshe e pa liruare nga ushtëritë Greko-Serbo-Malëzezë.

Në këtë kohë zunë të vinë edhe Kontrollorët të Fuqive të mëdha, në Vlorë, për të kqyrur edhe organizuar Shqipërinë, pas vendimit të Konferencës, po mjerisht nga t' e zinin punimin, kur se vetë Shqipëtarët u sillnin pengime edhe ngatërime? Nga këto shkaqe Mali i Zi nuku desh t' e lironte Shkodrën, kështu që Fuqit' e Mëdha e shtrënguan të hiqet edhe t' e marrin ato sundimin të Shkodrës dyke lënë për Qeveritar Amiralin Engles, Kolonel Filipsin.

Sërbet u hoqnë nga Poradeci dyke ua dorëzuar Shqipëtarëvet, kështu që u bashkua me Elbasanin, i cili ishte nënë sundim të Vlorës. Poradeci u bë një qendër për Korçarët e Kolonjarët refugjatë, të cilët prisnin ditë me ditën xbrajtan të vëndeve tyre, prej




ushtërisë Greke. Mirpo lufta vllazërore po vazhdonte, për të mbushur egoizmat edhe inatet vetiake, kështu që pas kaqe goditjeve ra Elbasani në dorë të kryengritësvet, të cilët u bashkuan me qeverinë të Durrësit, kështu që edhe Poradeci u bashkua me Durrësin.

Babillonia po mbretëronte më gjithë anëtë, të së ngratës Shqipëri, edhe populli i gjorë nuku dinte nga cila anë të anonte, po desh nuku desh ish i shtrënguarë të gjyrmonte të fuqishmët e ditës, të cilët ç' këmbeshin njëri pas jatrit. Kontrollorët po përpiqeshin t' i paqësonin qeveritë të Vlorës me të Durrësit, aqe më tepër për të lehtësuar ardhjen të Mbretit, të cilin e kish pëlqyer dhe zgjedhur Europa, po burrat patriotë preferonin prishjen të Shqipërisë, më mirë, se sa të bënin therori egoizmat edhe inatet e tyre vetiake!!!

Duheshe, pra, përsëri plaku i Shqipërisë, Ismail Qemali, që me mëndjen e tij të çkëlqyer të japë shëmbëll urtësie edhe patriotizme. Diplomati i math u menjtua thellë që përpara atdheut duheshe të bënjë çdo therori, prandaj vendosi që të hiqet nga punërat edhe të largohet nga Shqipëria, për të lehtësuar barrën e rëndë, që kishin marë Kontrollorët, edhe me këtë mënyrë të sillte paqen në Shqipëri.

Nuku ndenji as pak në menjtime po thiri Kontrollorët edhe si u çfaqti qëllimin u dorëzojti fuqinë në dorë të tyre. Të mallëngjyer Kontrollorët përgëzuan burrin të Math për këtë therori, pastaj, si muar fuqinë në dorë, nënshkruan një Proces-Verbal ku çfaqnin shërbimet e mëda si edhe theroritë q' i kish sjellë Shqipërisë, gjithë kohën e sundimit edhe aqe më tepër me therorinë të fundit. Kësisoj mori lamtumirë Plaku, prej së dashurës Shqipëri, edhe u hoth në Europë, që ku prapë vazhgonte mirëvajtjen të Shqipërisë!

Me të marë fuqinë në dorë Kontrollorët zunë nga vepërimet, dyke mbajtur në punërat Ministrit që ishin gjer të vinte Mbreti. Për të sjellë paqen e duhurë zgjodhë një Komision nënë Kryesi të Esat Pashës, i cili të vinte në Waldenburg të Saksonisë, për të i



oferuar Princit Wilqelmit të Wjedit kurorën të Shqipërisë, pas pëlqimit të Fuqivet të Mëdha. Komisioni arriti në Waldenburg edhe u prit me nderime të mëdha. Princi priti me gëzim të math kurorën që i oferronte kombi Shqipëtar edhe tha që paskëtaj jeta e Tij është lidhurë me fatin e Shqipërisë.

Me gjithë këtë grindjet, përçarjet edhe goditjet, midis Shqipëtarëve, po vazhdonin se fara e mallkuarë kishte zënë rënjë të shëndoshë edhe nuku ç' kuleshe dot!

Korça do të liroheshe prej ushtërisë Greke po kujt t' i dorëzoheshë? Xhandarmërisë Vlorës ose të Durrësit? Nga Vlora ishte dërguarë një kompani me 100 xhandarë, nënë Komandë të Major Mustafa Aranitesit edhe Kapiten Gjilardit, për të marë Korçën në dorëzim, po mjerisht gjetnë ndalime nga xhandarët të Elbasanit edhe Poradecit, edhe u shtrënguan që të përçajnë malet me dborë gjer arrinë në kufi të Korçës, më 25 Shkurt 1914. Qeveritari Grek Konduli, Shqipëtar prej të Greqisë, i dorëzoiti Korçën Xhandarmërisë Shqipëtare dyke çkëmbyer urimet e zakonëshme në të këtilla raste, më 2 Mars 1914.

Me 7 Mars 1914 arriti në Durrës Madhëria e Tij Wilhelmi i I, Mbret i Shqipërisë bashkë me Mbretëreshën, në sallutin të topave nga aniet e luftës, të Fuqive të Mëdha edhe të fortesavet të Durrësit. Populli me entuziazmë edhe bërtime të pasosura i priti me të shkelur tokën e Shqipërisë edhe gjer rynë në Pallat që ishte përgatitur fort bukur.

Kontrollorët me të I uruar mirëardhjen i dorëzuan fuqinë prej dorës tyre, kështu që Mbreti i ngarkojti barrën Turhan Pashës për të formuar Kabinetin. Kabineti u formua kësisoj: Turhan Pasha Kryeministër edhe i p. të jashtme, Esat Pasha i luftës e i brendëshme, Dr. Turtulli i Arësimit, Prenk Bib Doda i pun. Bortore, Myfid beu i drejtësisë, Hasan be Prishtina i postavet, Dr. Adamidhi i financavet, Azis Pasha i bujqësisë.




Shqipëria gjithë festojti me gëzim të math ardhjen të Mbretit dyke shpresuar që paskëtaj vetëm lumtëria do të zotëronte ne e ngrata Shqipëri, pas kaqe vojtjeve. Mjerisht, ishte vetëm një pandihm që vareshe, mbi këtë shpresë, se me ardhur Mbreti të shkuarat do të haroheshin edhe së bashku, të rethuar reth Fronit, do të përpiqeshin për përparimin të atdheut. Mirpo zjari nuku ishte i shuarë por vetem i mbuluarë prandaj nuku priteshe përveç një shenjë që të pëlqiste kazani që po zjente. Gazeta « Atdheu », të veteranit Jani Leshova me Milto Gurën, i hiqte vërejtjen qeverisë të marë masa të repta se zunë ku këtu ku atje nga nonjë lëvizje po nuku i jepnin nonjë rëndësi dyke i pandehur vendiake. Qeveria kërkonte që me mënyra qetësore të sillte prehjen, aqe më tepër që Mbreti i gjorë sa që kishte ardhurë. Edhe kur se këto vepëroheshin, në Shqipërin' e mesme, fare pa pandehur pëlqet kryengritja e Korçës brenda në qytet.

Këjo kryengritje nuku ka refim edhe shëmbëll në histori të përbotëshme! Organizatorët, të kësaj kryengritje, u treguan ca barbarë të dobëtë, të cilët për të mbushur qëllimet e tyre katilë vepëruan kryengritjen e Korçës për të i dhënë një ngjyrë patriotike. Mjerisht u xbulua më von, maska po si suall kaqe mjerime mbi gjindjen të së zezës Korçë!

Mundet që qeveria Greke të mos kish dijë, për këtë kryengritje, po provat që u zunë vërtetuan, plotërisht. që zyrtarë edhe Oficerë Grekë jo vetëm se kishin dijë po ata vetë e kishin organizuar, dyke përdorur për veglë popullin e mjerë, për të fituar famë e të linin emrat e pavdekura, në histori të Greqisë!

Vërtejt kanë ngjarë kryengritje edhe shkretime, po kanë patur një qëllim edhe një organizacie të atillë që kanë habitur botën edhe i kanë mprojtur, lëvduar e nderuar. Shtrengime tiranike e të paduruara edhe dëshpërimi i fundit i ka shtyrë që të bëjnë kryengritje në për qytete, me qëllim që të fitojnë të drej-



stat e tyre, po jo kurrë që të bëjnë rëmuje qytetet edhe të vriten vëlla me vëlla si ca armikë!

Kryengritja pra e Korçës nuku ka aspak nonjë lidhje me një qëllim të këtillë. Kur të ishte se populli i Korçës nuku desh flamurin e sundimin të tij, domethënë nuku desh të ronte i lirë po rob nënë flamurin Grek, atëhere munt që të kundërshtoheshe me armë në dorë, pa u ngritur flamuri i Shqipërisë, edhe jo si shkuan ditë e të pëlçasë pa nonjë shkak kryengritja brënda në qytet.

Besojmë që është e nevojshme, për të rinjtë edhe për pritmjen, që t' u rëfejme me pak fjalë kombësinë të Korçës si edhe rjedhjet historike. Korça është një qytet i kulluar Shqipëtar, pa as nonjë të huaj, edhe përbëhet nga të krishterë edhe Muhamedanë dyke patur shumicën të Krishterët. Brez pas brezi stërgjyshët kishin shkuar në një dashuri e vllazëri, të pa shëmbëlltë, edhe as m' i vogli episod nuku ka ngjarë nga shkak i ndryshimit fetar. Bajramet, Pashkat, dasmat, gëzimet si edhe hidhërimet do t' i kapër Xenin së bashku vëllazërisht.

Muhamedanët sido që kishin fuqinë në dorë prej qeverisë Tyrke, me qëllim diallëzie, kurrë nuku e kishin përdorur kundra vëllezërve tyre të Krishterë, kështu që dashuria edhe vëllazëria mbretëronin në Korçë. Edhe në çeshtje qeveritare bashkoheshin, kurdoherë, dyke mprojtur nevojat edhe enteresat e vëndit.

Për fat të zi armikët nuku e shëkonin me sy të mirë, këtë dashuri, edhe nuku e pëlqenin përparimin të Korçës, prandaj gjuhanin që t' u çfaqeshe i pari rast për të përfiturë që të mbillnin mollën e grindjes e të përçarjes! Ky rast u ardh në dorë edhe me vrap zunë nga vepërimet. Tyrqit edhe Grekrit, armikë sekullorë midis tyre, u bashkuan përnjerjesh vetëm e vetëm për të mbushur qëllimin të përbashkëtë që t' i përçanin Muhamedanët nga të Krishterët edhe t' u mbillnin mollën e grindjes e të armiçësisë! Ky ishte programi edhe qëllimi i Tyrqvet edhe Grekëvet jo ve-




tëm kundra Korçës po gjithë kombit Shqipëtar, po Korçën e kishin pengim edhe hale në sy, prandaj ju turë Korçës dyke përdorur ç' do mënyrë edhe propagandë.

Rasti, i kaqe pritur, u çfaq me Konferancën e Berlinit, pas luftës Russo-Tyrke, kur zunë edhe Shqipëtarët të xgjoben nga gjumi i rëndë, ku i kishin shtënë, edhe të kërkojnë edhe ata të drejtat e tyre kombëtare. Këjo ishte vdekje për Tyrqinë e Greqinë, aqe më tepër u drodhë kur Shqipëtarët zunë të shtypnin libra shqip në Stamboll, prandaj u hodhë në luftë për të farosur ç' do ndjenjë kombëtare, që kish zënë të ngjallet në zëmrat e Shqipëtarëve, po më tepër kundra Korçarëve që rëmbyen kryesinë, si në mërgim si në Korçë brënda!

Më 1881 viziton Korçën i mallkuari Dervish Pasha, armiku m'i math i kombit Shqipëtar, edhe, ca dit që ndenji, nuku pati tjetër punë e qëllim përveç të këshillonte Muhamedanët që t'i urejnë të Krishterët, se janë armikë, edhe të largohen nga bashkëpunimi edhe më tepër nga gjuha shqipe, e cila është kundra fesë Muhamedane! Me këtë rast përndahu nishane edhe mjaft të hola në për Hoxhallarët edhe fanatikët.

Më tjetër anë Greqia, me anën të Fanarit edhe përkrahjen të qeverisë Tyrke, zuri të kallë fanatizmen të Krishterëve, me anën e fesë edhe shkollavet, të cilën nuku e dinin as që e kishin dëgjuar nonjëherë. Pa si qeveria Tyrke e çkatërojti shoqërinë të Shqipëtarëve, në Stamboll, edhe ndalojti ç' do botim në gjuhën shqipe, flamurin e rëmbyen Shqipëtarët e Bukureshtit, afër që të gjithë Korçarë me qarkun e Korçës, formuan shoqërinë « Drita » blenë një shtypëshkronjë të tyre edhe zunë të botojnë librat shqip, të cilat i përndahnin darovisht, pas statuës të shoqërisë.

Korçarët e Misirit e që gjetkë me gëzim të math u bashkuan, në këtë lëvizje kaqe të shenjtë, edhe me vrap zunë të fillojnë shoqëria e të përhapin ndjenjat kombëtare. Le të përmëndim që në Misir jetonte i pavdekuri patriot Efthim Mitkua nga Korça, autori i



«Mbletës Shqipe» i cili kish që më 1875 që meresho me gjuhen Shqipe.

I pavdekuri mirëbërës Korçar, Nastas Lakçeja, përveç dhuresisë q' i bëri shoqërisë «Dritës», në Bukuresht, i dhuronte edhe qytetit tij lindjak një sumë të madhe, prej 10.000 lira Tyrke, me konditë që të klliteshe edhe gjuha shqipe bashkë me gërqishten në shkollat e Korçës. Fanari me të mësuar këtë proponim këshillon Dhespotin me Pleqësinë që me as nonjë mënyrë mos pranojnë këtë dhureti. Edhe një të Djelë i tregojnë popullit, mbledhur në Kishë, dhuretinë të Lakçes dyke i thënë bukuroshët kësisoj: dhuretia duhet të na gëzcnjë të gjithëvet po duhet të dijni edhe këtë që, dyke pranuar të hollat, duhet të ndryshojmë edhe fenë, domethënë të bëhemi Tyrq!!!

Pa fjalë që një proponim të këtillë, të cilin ua treguan Dhespoti me sharllatanët Dhimogjerontë, nuku e pranuan edhe q' atëhere hyri një fanatizmë e madhe në të Krishterët. Në për Kishrat gjithë këndimet e Ungjillin, që thuheshin shqip, i ndaluan, në për shkollat mësonjësit, që ishin Shqipëtarë edhe i mësonin nxënësit me gjuhën grëqisht edhe shqip, i nxuar edhe suall Grekë edhe vunë gjobë, në nxënësit e nxënëset, për ç' do fjalë që të kuvëndonin shqip!

Më 1886 pas shumë përpjekjeve u dha lejë, prej Stambolli, për të u çelur e para shkollë shqipe, në Korçë, edhe pas 3-4 vjet u çelë 5 në Kolonjë, 1 në Starovë edhe 1 në Qytezë të Devollit. Shkollat zunë të përparonin me gjithë ndjekjet e mallkimet, me katran edhe pishë, që bëheshin në për kishrat edhe Xhamitë kundra të pabesëve kombëtarë, po qeveria Tyrke nuku i shihte me sy të mirë këto shkolla, prandaj i mbylli edhe zuri një ndjekje të reptë kundra kombëtarëvet edhe ç' do ndjenjë kombëtare.

Q' atëhere ryri grindja e madhe në Korçë dyke u përçarë populli në Kombëtarë, Grekomanë edhe Tyrkomanë, të cilët shëkoheshin si armikë midis tyre.

Korça pra me bijt' e saj të mërgimit meritojnë



faqen e parë të rilindjes Shqipërisë, edhe nuku duhet kurrë mohuar, që po të mos ishin Korçarët vallë do të ishin përhapur ndjenjat kombëtare edhe sot të kishim një Shqipëri të lirë!

Përpara pra se të lironin Korçën, Grekët, kishin ndarë armë në për grekomanët me të shënuar që t'i kishin me vehte. Për veç kësaj, në ikjen e tyre, kishin lënë mjaft ushtarë, gjoja për të mbledhur municionët që kishin mbetur edhe për të ngritur të sëmurt që ndodheshin në spitalet. Qeveria e Korçës as pak nuku e shkonte nër mënt për nonjë lëvizje kryengritëse, po kërkonte me ç' do mënyrë paqësore, që qysh edhe qysh, të sillte vëllazërinë, midis popullit të Korçës, nënë hijen të flamurit kombëtar.

Mirëpo Greqia, me anën të komitetit organizator, vepëronte si brenda në qytet ku klliste fshehtazi ushtarë edhe andarë, kështu edhe në qarkun e Korçës po mblidheshe fuqi e regullshme prej ushtërie që në she-njën e parë, që do t' u jepeshe, të brendëshmit të vraponin të zinin Teligrafianën, Prefekturën edhe gjithë zyrat e të jashtmit të rethonin Korçën për të mos i ardhur nonjë ndihmë, në qoftë se bënte nonjë kundrështim xhandarmaria edhe Shqipëtarët kombëtarë të cilët kishin, pas zaptimit Grek, gjithë Muhamedanët që iqeshin për Tyrkomanë.

Pllani edhe dita ishin vendosur për ditën 7 Prill, dita e Vangjelizmoit, kur është proklamuarë kryengritja e Greqisë më 1821, po pa pandehur u xbulua më 5 dit përpara edhe plasi në mest të natës. Kryekomiseri i Policisë, Themistokli Gërmënji, për siguri edhe qetësinë të qytetit do të kqyrte për natë qytetin për të u siguruar në mbusheshe plotërisht detyreja q' u kish besuar policisteve edhe vetëdashësvet. Kësisoj fati shpuri një natë në një udhë tek shkonin nja 10 shpirt të veshur me roba andarçe, të cilët me armët në dorë ecnin me gadale nënë strehë të shtëpive. Pa u dhënë zë i gjyrmon gjer sa rynë në një shtëpi të xbrazëtë.

Me vrap Themistokliu mbleth shokë edhe rethon



shtëpinë për të u dhënë, po ata përnjerjesh hapin zjar edhe kësisoj plasi kryengritja më 2 të Prillit. Ajo tmer nuku tregonet dot kur se nga gjithë shtëpitë zunë të xbrazen armë gjithë natën. Në mëngjes një shumicë e madhe e armatosurë mblidhet në Mitropoli për të proklamuar bashkimin me Greqinë. Abdyl Ypi, zëvendës Prefekti, bashkë me Themistoklinë i këshillojnë me urtësi po më kot se lufta vazhdonte pa kumandë midis kryengritesvet. nga shtëpitë. edhe xhandarmarisë e cila u forcua përveç kombëtarëvet të Korçës edhe me vetëdashësit që vrapuan nga fshatrat. Lufta mbajti tri dit e tre net dyke u vrrarë mjaft njerës, midis cilëvet Vasil Trebicka me Riza be Biblishtin kur mbushnin detyrën e tyre si vetëdashës, Kola Kotta Xhemaliu edhe të tjerë, nga të dy anëtë. Kryengritësit qëlloniu që të zinin telegrafin e Prefekturën po gjetnë një kundrështim të reptë nga ana e xhandarmarisë e kombëtarëvet, dyke u plagosur në dorë edhe një Oficer Hollandez.

Si e panë që ndihmë ushtëriake nuku u vinte që përjashta, pas programit, zunë të jepen mëhallë pas mëhallye edhe lëftonin vetëm ushtarët edhe andarët Grekë që nga brigjet të Sh. Thanasit edhe Sh. Elisë.

Në Sh. Eli u bë një luftë e reptë se ushtëria Greke kish zënë vende të forta, dyke patur edhe Bushon me vehte për qeveritar të Korçës, po u thyen dyke lënë mjaft të vrrarë pas tyre. Në këtë luftë tregojti një trimëri të madhe plaku i dëgjuar Kapitan Kajua me shokët e tij. Një ushtëri tjetër e bashkuarë me andarë kërkonte të rynte nga gryka e Mborjes po u thye edhe zuri Dardhën po u ndoqnë edhe që këtej, nga Mborjarët me Dr. Hakinë, Qemal Banushi, Aliu me Ibrahimin edhe Gorarët.

Natën e fundit të Kryengritjes andarët edhe ushtarët Grekë kishin vepëruar ca masakra të patreguara në mëhallë të Vlehve ndanë Korçës. Kishin copëtuar barbarisht Papa Lambron Bullamaçin, priftin të Vlehve, një luftëtar i fortë për çeshtjen Shqiptarë.




Bashkë me priftin kishin masakruar edhe të vëllanë Sotir Bullamaçin edhe Vasil Tallabakun. Gratë i munduan që të tregonin të hollat edhe u muar çfarëdo që kishin nga gjërrat e arta e të argjenta që kishin. Këto u gjentnë në ushtarët e regullshme edhe andarët Grekë, të cilët u zunë të gjallë edhe u burgosnë.

Pas qetësisë të Korçës luftërat zunë në Kolonjë edhe përtej Dardhës edhe Arezës 3 orë lark Korçës. Në luftën të Arezës nga ana tonë ishin Demir Aliu Areza, Jashar be Starova edhe Kapitan Kajua Babi-eni, të cilët me një grusht luftëtarë u qendruan burrërisht një ushtërie të madhe e të regullshme Greke, të bashkuar edhe me një shumicë andarësh. Lufta mbajti një ditë pa pushim edhe me së fundi u thyen Grekët dyke lënë mjaft të vrarë. Nga ana tonë u vranë 2 veta edhe 3 të plagosurë.

Lufta e Kolonjës mbajti 3-4 dit se një ushtëri e madhe Greke e përndarë njëra nënjë komandë të Majorit Varda, me 800 shpirt, tjatra nga ana e Vakëfevet bëjnë një goditje të reptë për të i hyrë Korçës po më së fundi u dërmuan Grekët edhe të thyer arrinë gjer në Mes të Urave, të ndjekur prej Shqipëtarëve që përbëheshin prej xhandarmarisë, nënjë komandë të Majorit Mustafa Aranitasit, prej Salih Butkës me shokët e tij edhe me filloshqiptarë Amerikan Spencerin, Kole Rodhes e Mina Gramenos etj, prej Qani be Ypit me shokë, Mehmet Dusharit e gjithë Kolonjarëve luftëtarë.

Grekrit lanë mjaft të vrarë edhe me të ikur për siguri doqnë qytetin Leskovik pa si e rëmyen. Edhe nga Shqipëtarët u vranë 10 shpirt midis cilëve Qani be Ypi edhe u plagos rëndë Mehmet Dushari e 4 shokë. Lufta do të vazhdonte po një telegramë nga Durrësi, prej Esat Pashës lajmëronte që u lith armëpushim se Komisioni i Kontrollit ka vajtur në Korfus për marrëveshje me Zografon.

Këjo lajmë edhe ky urdhër ranë si rufeja mbi Shqipëtarët, të cilët përparonin po u shtrenguan të pushojnë luftën edhe të caktojnë një kufi sa kohë të



mbanjë armëpushimi. Më tjetër anë populli i Korçës bashkë me qarkun mbajnë një meeting të math edhe zgjedhin delegatë Midhat Frashërin e mua për të vajtur në Durrës që të protestonim tek Mbreti, Ambasadorët, edhe tek Komisioni Kontrollor kundra venomeve që kërkonte Greqia të kish në Shqipëri.

## KRYE E V.

### **Mbreti shkon nga Shqipëria**

Kur se këto ngjishnin në Korçë edhe në krainat e saj në Durrës xbulonte një përgatitje kryengritëse prej Esat Pashës. Oficerët Hollandezë me xhandarmarinë e shumë vetëdashës kombëtarë rethojnë shtëpinë të Esat Pashës, ku njerzit e tij kundrështohen me armë edhe vetëm pas bombardimit jepet i gjallë. Ministri i Italisë Baron Alioti përzjehet edhe kësisoj e liruan Esat Pashën edhe shkon për në Napoli dyke dhënë fjalën që nuku do të kthehet kurrë në Shqipëri.

Pas dy dit të largimit të Esat Pashës, me 21 Maj, pëlqet kryengritja e përgatiturë në Shjak edhe në Kavajë ku ishin mbledhur fanatikët. Të forcuar i afrohen Durrësit edhe zënë goditje nga të dy anëtë ku u vranë kaqë trima, vëlla me vëlla, njëra anë dyke lëftuar për menjtimin e kalbur që të sjellin Tyrqinë prapë, edhe tjetra anë lëftonte për flumurin kombëtar e për vetëqeverimin të Shqipërisë.

Në këto goditje ranë dëshmorë Kapiteni Kamber Sejдини nga Elbasani, Ceno Shara nga Vlora, Zef Arapi edhe Haki Gllina! Më 4 të Qershorit rebelet Osmanllinj kërkajnë nga Kontrollorët që të largohet Mbreti nga Shqipëria se ndryshe do të vazhdojnë luftën. Kryengritja po përhapashe në gjithë Shqipërin' e mesme pa ditur as ata të mjerë ç' kërkonin.

Më 15 të Qershorit behet një luftë e rreptë afër Durrësit nga të dy anëtë me qëllim që të zapëtonin



kryeqytetin. Bëhet një luftë e reptë edhe dëshpëruarë-gjer sa u kthyen rebelet dyke lënë shumë të vranë e të plagosur. Edhe nga ana e xhandarmarisë edhe vetë-dashëvet u vranë edhe u plagosnë mjaft, të cilëvet u jepte ndihmën i pa-përtuari atdhetar Dr. Nikollaq P. Zografi.


Koloneli Hollandez Thomson tek po kqyrte istikamet edhe jepte kumandë në ushtarët ra edhe ay i vranë.

Kryengritja po përhapeshë e në Myzeqe edhe vazhdonin që t' i vinin Beratit. Fejzi Alizoti më lutet mua edhe të pavdekurit patriot Grigor Cilkës që të vinim edhe neve me një top nënë komandë të një Oficeri Gjerman, më tepër që të këshillonim të Krishterët në-quetësi. Midhat Frashëri pranojti edhe hyri në Ministri të dyjtë të Turhan Pashës kështu që mbeti në Durrës.

Në Fjer u mblloth një fuqi e madhe nga Vlora edhe nga Berati dyke patur për Kumandarë Kollonellet Besim Koken edhe Zia be Beratin. Atje mësuam që-përtej Viosës ishte me rebelet edhe Bektash Cakrani me 200 shpirt edhe që llundrat i kish zapëtuar Bektashi. Këjo gjë, e pabesuarë, na pikëllojti në zemër prandaj kërkuam lejë që të vinja unë me Cilkën të haseshim me Bektashin përpara se të goditemi, me qënë që nuku na besoheshë kurrë që bashkëluftëtari ynë i vjetër të kish rënë në të këtillë gabim të pandjerë.

Proponimi ynë u pëlqye prej të ndyerit Bexhet Nepravishtës, Prefekt i Beratit e të tjerëve e shkruam me vrap. Me të arrirë në Viose pyesim rojtësit të llundravet për Bektashin e na përgjigjen që Bektashin e kanë mbyllur në kishë të Libofshës. U thomi që të lajmërojnë Bektashin që është Mihal Gramenua me Grigor Cilkën edhe kështu pas pakë vjen Bektashi më 10-15 shokë edhe dergon llundrën të na marë. Puthemi e Bektashi dyke qarë si nonjë foshnjë na tregon pësimet që kish hequr nga ata që ishin armikët të Shqipërisë edhe tani e quanin trathëtor!

Si e ngushëlluam i thamë që detyra e kombëtarëvet të vjetër është të hedhin prapa krahëvet çfarëdo, se-




atyre u dhembet Shqipëria, kështu që si na tregon ku duhet shtënë me top kthenemi edhe u rëfejme biscedimin edhe marëveshjet që bëme. Që me natë shkuam që të gjithë edhe pas dreke zuri topi të bombardonjë. Me vrap ikin rebelet edhe vjen llundra për të na hedhur përtej. Arrimë më të ngrysur në Monastir të Ardenicës, për mbi një breg të ualët shumë, që ku dukesh Myzeqeja si nonjë panoramë.

Si ngritmë topin e xbrazmë 5-6 here në erë për të lajmëruar popullin që t'i përunjët qeverisë. Vendosim që në mëngjes të përndahen komisionë paqësorë për të mbledhur armët edhe për të i këshilluar në qetësi.

Topi xbriti kundrejt Karbunarës me luftëtarët që ku dukeshin rebelet për mbi brigjet. Në një komision paqësor isha edhe unë, Cilka, Coruni nga Vlora, Lazo Bozo nga Kolonja e Myzeqesë e të tjerë. Vamë në Bubulinë e zumë të mbledhim armët me urtësi, kur këtu ishte thënë të ngjasë i pari episod fatzez, edhe solla nër mënt fjalët të Bektash Cakranit që më tha në Ardenicë që, në qofte të vëpërojme me urtësi do të fitojmë, ndryshe jemi të humburë.

Tek mblithnim armët vjen Zia beu me 50-60 Smokthinas edhe urdhëron të djegin shtëpinë të priftit edhe myftarit me qënë se Bubulina ishte ciftig i Zia beut edhe kish mërira kundra priftit e myftarit që në kohë të Sundimit Sërb. Ishte mjaft ky urdhër që të përhapet zjari në të gjithë këtë dyke plaçkitur e rëmbyer gjën e gjallë. Lufta u ndez kundrejt Karbunarës me rebelet ku vriten e plagosen mjaft, midis cilëvet Seit Qemali edhe si për çudi shpëtojti Nuredin be Vlora dyke ju vvarë kali. Dr. Vasil P. Zografi po rente si në fushë të luftes si në Spital të Fjerit për të u dhënë ndihmën e tij të plagosurve.

Lufta plasi edhe gjetkë pa nojë komandë e pa nonjë regull edhe shumica e luftëtarëve u përndah në për fshatrat për të pjekur mishra e pula deti edhe ranë pas të plaçkiturit. Një pleqësi ardhë nga Karbunara e Lushnja dyke kërkuar pushimin e luftës edhe zo-




stoheshin ata të sillnin qetësinë edhe së bashku t' i vinin qeverisë ndihmë në Durrës. Mirpo komandantët nuk u pranuan edhe kësisoj rebelet u forcuan ca më shumë me gjithë popullin të Myzeqesë, të cilëvet nuku u mbeti tjetër përveç vdekjes, pa si shtëpitë na diqnin edhe gjënë na rëmbenin!

Ato të këqia që më panë sytë në Myzeqe varrit ja kam për të treguar! Të mërzhitur, nga këto ngjarje, edhe dyke parë që e thyera ishte e sigurtë vendosmë me Cilkën të kthehemi në Fjer edhe q'atje në Vlorë. Shkuam si i thamë Besim Kokës i cili na dha një letrë për Fejzi Alizotin e na u qa që vetëm një paki-cë luftëtarë kishin mbetur. Shkuam me gadale edhe si u drekosmë në Kolonjë, në Lazo Bozua muarm të përpjetën e Ardenicës edhe si kapërxyem Viosën arrimë ngrysur në Fjer po mbetmë të habitur kur pamë një shumicë të madhe të armatosur edhe të tjerë po vinin të tmeruar e me nxitim.

Shkaku ishte se ishin thyer, ndyrërisht, edhe i kishin vënë përpara dyke lënë pelat të ngarkuara me plaçkat që të shpëtonin nga vdekja, kështu që mbetnë mjaft të vrarë edhe mjaft u mbytnë për të kapërxyer Viosën. Me të këtillë katastrofe edhe rëmujë përfundoj lufta e Myzeqesë! Kumandarët me Oficerin Gjerman i gjetmë në Konakët të Vrionasvet, ku ndodheshin Fejzi Alizoti me Bexhet Nepravishtën edhe u tregonin lidhërimin që nuku muntnë të shpëtonin topin. Sa për katastrofën deshnin t'ja ngarkonin Bektash Cakranit po unë me Cilkën protestuam për këtë padrejtësi edhe faji, thamë, u ngarkohet vetëm Kumandarëvet.

Bektashi ardhni më vonuar me shokët e tij, edhe me qënë frikë mos plaçkitnin tregun të Fjerit, Fejzi beu me Bexhet benë ja ngarkuan barrën Bektashit si edhe qeverimin. M' u lut Bektashi të qëndronja edhe unë se ishte sigur që në pakë ditë do të sillnin qetësinë e do të muntnin t' i ndihmonin Durrësit, po me qënë tepër i mërzhitur shkova për në Vlorë.

Në Vlorë kisha 4-5 dit edhe nuku kisha vendosur



për ku të shkonj, Durrës ose Korçë, kur një ditë dalin në skelë ca atdhetarë, prej Amerike, midis cilëve shoh bushkëluftëtarin të vjetër Vangjel Gjikën me zonjën e tij Thinë edhe me vajzën Tefta 3 vit edhe çunin Gjorgji prej 4-5 muaj. Vangjeli pas prishjes 2-3 herë nga qeveria Tyrke mori fëmijën edhe shkojti me 1913 për në Amerikë. Edhe këtu ju përvesh luftës patrioti se « Vatra » me « Djellin » kishin mbetur në dorë të Lambi Çikozit, Vani Çekanit edhe Thimi Naçit, me qenë që Faik Konica, Fan Noli edhe Kristo Floqi ishin hedhur në Europë, ku bisedoheshë çeshtja Shqipëtare. I ngarkuan menaxherinë Vangjelit edhe me konferenca e përpjekje ringjalli « Vatrën » e « Djellin » edhe ngriti shtypëshkronjën me mashina e vegla të rea, për të cilat e ndihmonin me gëzim Shqipëtarët.

Pas ardhjes të Mbretit ju ngrit mëndja, mer fëmijën e kthenet në Shqipëri. Vendosmë e shkuaam për në Korçë po në qafë të Berzeshtit ramë në dorë të Osmanllinjvet të cilët na mbyllë në kishë. Atë mbrëma na lanë të qetë si ardhni një tabor me flamurin të Tyrqisë edhe si thirë tri herë: çok jasha Patishah, në obor të kishës! Më tepër se të gjithë unë dridhesha si purteka se e dinja ç' më priste po të më dinin. Në mëngjes na nxjerin e pyesin edhe unë me Vangjelin i thomi kumandantit Çerçit, nga anët të Elbasanit, që ktheheshim nga Amerika për në shtëpi edhe jemi me miletin i cili përpiket për Babën. Unë kisha qylaf të bardhë po kumandani urdhron të ma çjerin se kaurët kanë të drejtë të mbajnë kapella. Na thotë që të jemi gati se nesër ose pasnesër na dërgon në Shjak edhe q' atje të shkonim me udhën të Elbasanit.

Aman e derman nuku dëgjonte kumandanti me gjithë që e perënduam në qell me të e qojtur Pasha edhe Bej, kështu që rymë në plloçat e kishës të dëshpëruar po më tepër Vani Çani edhe Kristaq Bratkua se ishte i sëmurë. Trimëresha shqipëtare Thina e Vangjel Gjikës u jepte kurajo dyke thënë që më në fund ç' do të bëjnë përveç se të na vrasin? Ditët



shkonin se rebelet lëftonin që të zapëtonin Beratin e vetëm ca nga kapitanët të krishterë na vizitonin e na shurdhonin veshët nga trimëritë edhe që sot ose nesër bije Berati. Një brëma e kishin djegur gushmaqin nga hidhërimi edhe u thomi me Vangjelin kapitanëvet: Mirë Tyrqit që duan Tyrqinë po juve kaurë qysh e doni? Qeshnë e na thonë kësisoj, si i kishim gjetur mjaft për shëndet të tyre edhe i lëvdonim: që ata lëftojnë pas programit të Dhespotit e Korfuzit, në faqe si për Tyrqinë po qëllimi është që dyke lëftuar Turqit me Turqit do të rynë më nj'anë Grekët e më tjetër anë Sërbët edhe atëhere do të jemi neve të zotërit e vëndit.

Qëllimi edhe programi ishte i vërtejtë! Osmanllinjte u çelnin rugën armiqëvet.

Pas ca luftëra të repta e të përditëshme, reth Beratit, u thyen Osmanllinjte edhe shohim të na vinjë Xhemali, i vëllaj i ruajtësit të fshatit, i cili bëhet i paditur e na thotë: kush u ka mbyllur këtu? Nuku e dinë që kanë vulosur të shtatë Mbretërit' e Mëdha për Shqipërinë edhe kurr nuku bëhet Tyrqi? Mirpo frikën kush na e nxirte? Vetëm atëhere besuam kur shohim dy xhandërma me flamurin në dorë besuam edhe si i përgëzuam për trimërin' e tyre me vrap shkruam në Berat, pas 10 dit në plloçat e kishës.

Me të arrirë në Berat më thërret Bexhet beu, Prefekti, në Kala ku lëftonte kundra rebelevet. Biseduam gjër' e gjatë mbi gjendjen kritike që shkonte Shqipëria. Kalanë e mbanin me topin të Ramazanit edhe me burrërinë të Kapiten Veis Sevranit i cili mbetur vetëm me 20 25 shpirt po qendronte i patundur. Bexhet beu më thotë të ri në Berat edhe 2 ditë se do të më japë ca të holla për në Korçë e do të më dërgonjë me 3-4 kalorës. I ndyeri Bexhet be e dinte për Korçën po nuku desh t' e përhapë edhe unë pa shkuar nër ment gjesendi u rëxova në qyet.

Të nesërmet ishte një pamje e tmeruarë! Mijë burra e gra me foshnjat në krahë vinin nga Korça





për në Berat. Ishin muhaxhirët që kishin lënë shtëpitë e kamjet për të shpëtuar jetën e tyre, nga Grekët e Osmanllinjtë. Midis tyre ishin Pandeli Vangjeli, Prefekt' i Korçës, Abdyl Ypi, Themistokli Gërmënji edhe vetëdashësit midis cilëvet vëllezërit e mij Petrua, Minaj edhe Koçua të cilët kishin marë edhe gruan time Niqka. Mësonj nga këta që pas luftave të repta që kishin patur me Osmanllijtë ardhur nga Elbasani si edhe me Grekët u shtrënguan t' e lënë Korçën të cilën e muar Grekët me 8 Korik. Në këto luftëra u vranë edhe Zalo be Prodanë edhe trimi i trimavet Gani S. Butka.

Osmanllinjtë të forcuar me ndihma të reja ju turë përsëri Beratit edhe pas 2 dit luftë ku muar anë edhe vetëdashësit e Korçës, nënë Themistokli Gërmënjën, u shtrënguan t' e lënë Beratin të bjerë në dorë të Osmanllinjvet. Shkuam gjithë natën në për plumbat edhe arrimë në Blash pas dreke. Dëshnim të qendronim po Kapiteni Qani Starja na këshilon te shkojmë që të kapërxenim Viosën, se ishim në rezik me patur edhe gra me vete. Arrimë më të ngrysur po lundrarët theshnim për nesër se ishin të lodhur edhe ish natë. Ca më të trembur edhe më tjetër anë më të u dhuruar Pandeli Vangjeli na hodhë pertej që të gjithë gjer më të gdhirë.

U çelothmë mirë edhe shkuam në Vlorë se gjëkundi nuku kish mbetur qetësi. Anarqia edhe rëmuja zotëronin në fatzeza Shqipëri nga bijt' e saj! Në Tepelenë të tjera luftëra bëheshin me Grekërit pranë Kodrës ku kishin qendruar Shqipëtarët. Më përpara kishin arrirë Shqipëtarët gjer në Monastir të Cepos 2 orë larg Gjinokastrës edhe pa dyshim me përparimin që kishin marë do t' i rynin Gjinokastrës, po një ushtëri e madhe me topa e mitralioza i thyen Shqipëtarët edhe qendruan në Kodrë.

Në këto luftëra Qerçis Topulli tregojti një trimëri të madhe si edhe në Berat që i nxuar Osmanllinjtë. Mjerisht nuku kis mbetur as për trimëri as strategji



se rebeshi e kish marë Shqipërinë! Togje, togje po vinin muhaxhirë burra e gra, të ngarkuar me foshnjat, po vinin në ullinj të Vlorës për të shpëtuar jetën!

Gjendja pra arriti në orën e fundit edhe Ambasadorët me Kontrollorët mbajnë një mbledhje edhe vendosin të këshillojnë Mbretin që të shkonjë, pa si Fuqit' e mëdha nuku munt t'i japin nonjë ndihmë në një gjendje kaqe kritike. Më 2 Gusht i çfaqin Mbretit menjtimet edhe këshillat, të cilat u përgjegj Mbreti që do t' i studionjë e bisedonjë me Ministrit.

Me 14 Gusht pëlcet lufta Europeane kështu që vendosnë më 19 Gusht të përcjellin Princin trashëgimtar Skënderbej edhe Princesën Eleonora, në Gjermani, edhe Mbreti me Mbretëreshën shkuan nga Shqipëria me 3 të Shtatorit, domethënë pas në të mbretëruari prej 5 muaj edhe 26 dit plot trubullime. Mbretëresha qante si nonjë foshnjë, gjer hyri në vaporin të luftës Italian « Mizurata », me gjithë ngushëllimet të Turhan Pashës e Sami be Vrionit, Shambellani i Pallatit edhe besnikn gjer në orën e fundit.

Shqipëria mbeti pa Mbret e vetëm në mëshirë të Perëndisë! 1914.

## KRYE E VI.

### **Shkelja edhe rikrijimi në Shqipëri**

Mjerimet edhe gjithë të këqijat në vënt të pushonin, pas ikjes të Mbretit, më tepër po sntoheshin në e ngrata Shqipëri. Gjakderdhja, midis vëllazërisë, vazhdonte edhe anarqia e rëmuja mbretëronin më të katër anëtë! Të tretën ditë, pas ikjes të Mbretit, rebellet Osmanllinj rynë në Durrës edhe ngritnë flamurin të Tyrqisë!

Me gjithë këto marrëzira edhe vepra aëndikombëtare shpresonin që paskëtaj si muar edhe Vlorën Osmanllinj të do të përkujdeshin të pakën për qetësinë të vëndit. U pandeh që dyke u formuar një pleqësi



qeveritare, në Durrës, nënë Mustafa Ndroqin do të vireshe një regullim, po Esati nuku flinte edhe niset ma anën të Greqisë vete në Serbi edhe që nga Dibra, si mori me vete mjaft Dibranë e të tjerë Shqipëtarë, arrin në Durrës më 19 Shtator 1914. Në krye Mustafa Ndroqi me shokët e tij nuku deshnin t' i dorëzonin fuqinë në dorë Esatit, po Esati u forcua edhe mori frenë në dorë dyke e njojturë për kryetar.

Në Toskëri edhe në Gegëri Grekit më nj' anë edhe Sërbët më tjatër anë diqin, vrisnin edhe plaçkitnin të mjerët Shqipëtarë, të cilët të dëshpëruar muar aratinë, ca në Vlorë edhe ca në Shkodrë me shpresë që të gjenin sigurimin të jetës. Shumë të tjerë, nga frika, u hodhë në Itali kështu që qytetet Brindisi edhe Bari zjenin nga Shqipëtarët, të cilët shprehnin që Italia i kish për të përkrahur edhe më ndihmën të saj të ktheheshin në Shqipëri. Në Shkodrë ngjasën trubullime edhe vrasje midis kombëtarëve edhe fanatikëve Osmanllinj që kërkonin të ngrihnin flamurin të Tyrqisë, po më së fundi u dërmuan nga kombëtarët edhe valojti flamuri i Shqipërisë gjer sa rynë Maleziasit në Shkodrë më 14 Qershor.

Kur të çmëndurit fanatikë përpiqeshin të ringjallnin Tyrqinë edhe i kishin vënë kazmën atdheut, lëkura e Shqipërisë kishte dalë në mezat me rastin e luftës Europeane. Fuqitë qendrore i propononin Italisë gjithë Shqipërinë, në qoftë jo vetëm se nuku mer anë në luftë, si Aliatë, po edhe në qëndronte neutrale, po Italia pa u marë vesh nxjer ushtëri më 25 Dhjetor 1914 edhe zapëton Vlorën. Në Londrë nënëshkruet një marëveshje, midis Aliatëve, me të cilën Shqipërinë e ndahnin midis Italisë, Greqisë edhe Serbisë, kështu që Shqipëria u bë shkelja e të gjithëve edhe fusha e luftës në Ballkan.

Me qënë që Greqia qëndronte neutrale edhe Aliatët dyshonin mbi qëndrimin të saj ushtëria Italiane përzuri Grekët nga Shqipëria e Jugës, përveç se Korçën të cilën e zaptojti ushtëria Franceze edhe përzuri




ushtërinë e zyrtarët Grekë. Në Shqipëri të Veriut ku kishin ryrë Sërbët edhe Maleziasit, si për të mprojtur Esatin nga rebellet, i vuri përpara ushtëria Austriake edhe si zaptojti Shkodrën arriti në Durrës. Kështu pra gjithë Shqipëria u përça midis lëftonjësve Aliatë edhe Qendrorë.

Më 1916 Themistokli Gërmënji, i cili ndodheshe në Poradec me shokët, meret vesh me Francezët edhe vjen në Korçë ku ngriti flamurin kombëtar më 10 Dhjetor 1916 edhe proklamohet Kazaja e Korçës vetëqeverimtare. Nënshkruet një protokoll midis Kolonelit Frances Descoins, Themistokli Gërmënji edhe këshillës qeveritare që independenca e kazasë Korçës do të ishte nënë mprojtje të Francës. Qeverimi do të ishte në dorë të këshillës; gjuha zyrtare do të jetë shqipeja, si në zyrat ashtu edhe në shkollat. Themistokliu emërohet Prefekt i Policiës Korçës edhe zunë nga vepërimet. Mjerisht intrigantët edhe armiqët të kombit përdorë gjithë mënyrat të poshtëra, kundra Themistokliut, gjer i bintnë Francezët edhe e dërgojnë në Selanik, ku gjyqi ushtëriak e dënojti për trathëtor edhe më 9 Nëntor 1917 e tyfeqisin! Q'atëhere u rëzua edhe i vetëmi flamur kombëtar që valonte në Shqipëri, edhe Korça sundoheshe prej Francezëve.

Si shkuan Austriakët nga Shqipëria, pas luftës Europeane, gjithë viset i zuri Italia përveç Shkodrës ku rynë Francezët gjer në përfundim të Kongresit të Paqës. Më 25 Dhjetor 1918 mbahet një mbledhje kombëtare, në Durrës, e shtyturë prej Italisë edhe formohet një Kabinet nënë kryesinë të Turhan Pashës kesisoj: Turhan Pasha Kryetar, Prenk Bib Doda nënë Kryetar edhe anëtarë Myfit Libohova, Imzot Bumçi, Mehmet Konica, Mehdi Frashëri, Dr. Turtulli, Fejzi Alizoti, Luigj Gurakuqi, Petro Poga, Sami Vrioni, Mustafa Kruja, Midhat Frashëri edhe Lef Nosi.

Midis Italisë edhe qeverisë tonë u nënshkrua një marrëveshje që Vlora i jépeshe Italisë edhe Shqipëria tjetër do të mbeteshë nënë protektoratë të Italisë,



kështu që Italia zuri t' i dorëzonjë sundimin qeverisë Shqipëtare. Mirëpo kjo marrëveshje, sado e fshehtë, nuk u pëlqye prej gjithë Shqipëtarëve edhe kështu, me gjithë pengimet të Italisë, mbajtnë një Kongres në Lushnjë më 21 Janar 1920.

Ky Kongres ka për të mbetur historik edhe i pavdekur, në histori të Shqipërisë, me qënë se nga ky Kongres i cili mbajti 10 dit u hodhë themelet të shtetit edhe shpëtojti Shqipërinë, nga armiqët, dyke mprojtur vetëqeverimin të saj me kufitë të caktuara prej Konferancës të Londrës 1913.

Po nuk duhet haruar kurrë që shpëtimi i atdheut u detyrohet fort shumë edhe Shqipëtarëve të mërgimit, të cilët me këtë rast nuk lanë gjesendi për prapa, për mprojtjen të vetëqeverimit Shqipërisë, aqë në kohë të luftës si edhe në kohë të Konferancës Paqës në Paris. Protestimet, Memorandumet edhe lutjet rithnin si breshëri, nga Rumania, Misiri, Amerika, Bullgaria, Tyrqia edhe tekdo ku ndodhoshin Shqipëtarë.

Përveç këtyreve dërguan edhe Delegatë në Paris pranë Konferancës së Paqës. Të Amerikës ishin Nuredin Vlora, Dr. Turtulli, Mehmet Konica, Parashqevi Qirjas, Amerikani filloshqiptar Enrikson edhe Mihal Gramenua, të Stambollit ishin Halil Pasha, Shan Tepelena, Fuat Dibra, At Bonatti, Sylejman edhe Dr. Blinishti, nga Rumania Pandeli Vangjeli, Princ Gjika, Dr. Temua, Dhimitri Berati edhe Petro Goxhamani, nga Korça Vangjo Turtulli, Salahedin Blloshi edhe Dhimitri Mano, edhe Shkodra përfaqësueshe me Pater Gjergj Fishtën.

Qeveria e Durrësit përfaqësueshe prej Turham Pashës, Imzot Bumçi, Mehmet Konicës, Louji Gurakuqit, Dr. Turtulli edhe Mustafa Kruja. Mjerisht edhe anëtarët të qeverisë ishin të përçarë midis tyre, kështu që Turhan Pasha me Imzot Bumçin, Mustafa Krujën edhe Luji Gurakuqin si edhe Fishtën punonin veçanërisht, Mehmet Konica, Dr. Turtulli edhe Midhat Frashëri, i cili vepëronte nga Svicera me mos mundur të



vinte në Paris, punonin veçanërisht. Delegatët të Kollonive të mërgimit punonin edhe ata veçanërisht dyke patur për kryetar Halil Pashën, mjaft i zoti edhe i rahur në çeshtje diplomatike. Për të sjellë një marëveshje ardhë në Paris Mehdi be Frashëri, Myfit Libohova e Lef Nosi po më kot të gjitha.

Shkaku i mos bashkëpunimit rithte nga të mos bësuarit që kishin mbi qeverinë të Durrësit, pas marëveshjes me Italinë që kishin bërë, po dyke gjykuar hollësisht ishte pa dobi ky vepërim i përçarë, se delegatët ishin të lirë edhe përdornin një gjuhë pas nevojës. Lumtërisht që të gjithë ishin në një program edhe në një qëllim. Edhe Esat Pasha nuku largoneshe as pak, nga programi e vepërimi kombëtar, dyke punuar veçanërisht. Nuku duhet mohuar që Esat Pasha i solli sherbime të çmuara atdheut, në Konferencë të Paqës, me qënë që u mbajt hesap që Esati si President i Shqipërisë mori anë në Luftë pranë Aliatëvet.

Kongresi i Lushnjës mbajti 5 dit edhe shtrojti bazat e qeverimit të shtetit gjer të mblidheshe mbledhja kombëtare themeltare. Vendosi që të qeveriset me një Këshillë të Naltë, prej 4 vetash, Kabineti të formohet prej 7 Ministër, Këshilla kombëtare prej 37 anëtarë edhe ndarjen Administratore. Vendosi rëzimin të Kabinetit Durrësit edhe zgjodhi një Delegacion pranë Konferencës së Paqës, prej Imzot Bumçit, Mehmet Konicës edhe Dr. Turtulit.

Si u betuan anëtarët të Këshillës kombëtare me vrap zunë nga vepërimi edhe me vota zgjodhë Këshillen e Naltë kësisoj: Akif Pashën, Imzot Bumçin, Dr. Turtulin edhe Abdi Toptanin. Kabineti u formua kësisoj: Sulejman Delvina Kryeministër, Ahmet Zogu i P. Brendëshme, Sotir Peci i Arësimit, Hoxha Kadri i Drejtësisë, Ndoc Çoba i Financavet, Mehmet Konica i P. Jashtme, i Luftës Ali Riza Pasha Kolonja. Për kryeqytet të hë për hëshmë vendosnë Tiranën edhe u vendos që Kuvëndi i Lushnjës të mos përçahet gjer të marë në dorë fuqinë qeveria.



Më 11 të Shkurtit arriti në Tiranë qeveria edhe zuri të vepëronjë dyke organizuar Ministrinë e të bënë emënimet e dhura në Administratë.

Gëzimi ishte i patreguarë në gjithë anët e Shqipërisë, për themelimin të shtetit tonë mbi një program fjesht kombëtar, edhe qarket diplomatike të botës u pritnë me simpathi të madhe aq më tepër të Parisit, ku bëri një përshtypje të pëlqyerë midis Konferenciarëve të Paqes. Shenjën të parë e dëftëtu Franca e cila dyke hequr ushtërinë, prej Shkodre, ja dorëzojti sundimin qeverisë të Tiranës më 11 Mars 1920.

Njëra pas tjetrës zunë Prefekturat të bashkoheshin reth qeverisë të Tiranës. Korça e cila sundoheshe prej Francezëve mban një meeting të math me mijë burra edhe gra ku kërkojnë bashkimin me Tiranën edhe për të tretën herë u ngrit flamuri kombëtar 26 Maj 1920. Të nesërmet sundimtarët Francezë u dorëzuan sundimin edhe llogaritë Shqiptarëve dyke uruar që të shohin një Shipëri të lumturë. Rëzuan flamurin Frances në buçim të Bandës « Vatra » me Marssiliezën edhe shkuan me nderime të mëdha nga ana e popullit Korçës.

Kur se vazhdonte gëzimi edhe mirëvajtja e shtetit tonë, pa pandehur, çfaqet një lëvizje me qëllim që të rezonte qeverinë edhe të sillte në fuqi Esat Toptanin. Lumtërisht nuku mundi të përhapet se populli ishte ngopur nga mjerimet që kish hequr, me të këtilla propaganda, prandaj u dërmua përnjerjesh pa gjakderdhje. Pas ca kohe më 13 Qershor u vra Esat Pasha në Paris prej Avni Rustemit edhe kësisoj shpëtojti kombi prej një pretendenti të rezikçme.

Në këtë kohë pëlçet edhe kryengritja e Vlorës kundra Italianëve. Kryengritja mori një ngjyrë lufte edhe u goditnë Shqipëtarët me Italianët, reptësisht, edhe me humbje të mëdha u thyen Italianët edhe Shqipëtarët zapëtuan qytetin. Pa si u forcuan Italianët i nxuar prapë Shqipëtarët, nga qyteti, po luftërat vazhdonin se, ardhë ndihmës nga gjithë anët e Shqipërisë, kështu që qeveria Italiane ardhë në një marë-




veshje paqësore me qeverinë tonë edhe u bë armëpushim. Më 17 Gusht Vlorë ju dorëzua xhandarmarisë edhe sundimtarëvet Shqipëtarë, pas traktatit Italo-Shqipëtar, edhe flamuri u ngrit për mbi Vlorën historike edhe trimnore, në mest të entuziazmit e në buçim të Bandavet kombëtare.

Me bashkimin të Vlorës Shqipëria mbeti vetëqeverimtare me kufitë të caktuara prej Konferencës të Londrës 1913 edhe nuku priteshe përveç që të vinte një Komision, i zgjedhur prej Lidhjes të Kombevet, për të regulluar kufitë strategjike edhe ca pengime të vogëla që qëndronin të pazgjidhura, midis Serbisë, Greqisë edhe Shqipërisë, për mbi çeshtjen të kufivë, aqe më tepër se kishin ngjarë goditje me Sërbët.

Më 14 Nëntor Kabineti i Sulejman Delvinës dha dorëheqjen edhe Këshilla e Naltë i ngarkon barrën Ilias Vrionit për formimin të Kabinetit, edhe si u formua më Nëntor u mbyll Senati i zgjedhur, prej Kongresit Lushnjës, dyke u vendosur me Dekretë prej Këshillës Naltë që të bëhet zgjedhje Parlamentare në Shkurtë 1921. Zgjedhjet u mbaruan edhe më 21 të Prillit çelet i pari Parlament i Shqipërisë me 97 Depytenj edhe si zgjodhnë Kryetarë të Parlamentit, Pandeli Evangjelin, si edhe Biroun nisë nga vepërimet, pa si votuan regullimin të Parlamentit.

Në Korik bëhet një lëvizje në Mirditë nga shkaku i të mos përkujdesurit të Qeverisë, po me këshilla urtësie u qetësua vëndi edhe lëvizja u pushua. Ilias Vrioni dha dorëheqjen të gjithë Kabinetit po Këshilla e Naltë i ngarkojti barrën përsëri Ilias Vrionit i cili, dyke përmbledhur nga elementat me të provuar, formojti Kabinetin e dyjtë më 11 Korik edhe mori besimin të Parlamentit, me një shumicë vetash. Pa shkuar as 3 muaj zunë përsëri vërtitjet politike, të parasenave, edhe Ilias Vrioni dha dorëheqjen me gjithë Kabinetin.

Gjendja politike ishte kaqe e përzjerë sa nuku priteshe përveç shkëndisë që të pëlciste eksplozja, që po zjente, nga bukurirat të politikanëve tanë, të cilët





per te mbushur egoizmat edhe inatet vetiake, ose më mirë për Fronat Ministeriale nuku e kishin për as gjesendi se të shkretoneshe Shqipëria. Te vetëqojturat partira politike, Populloreja edhe Përparimtarja, pa nonjë program grindeshin, midis tyre, vetëm e vetëm për fuqinë. Përveç këtyre partira ishte formuar edhe «Lidhja e Shenjtë» që t'i shenjtronte punërat ca më mirë!

Në të këtillë gjendje ndodheshin qarket politike, në Tiranë, prandaj, për të mos u majisur ca më shumë edhe mos ngjisnin trubullime, preferojti Ilias Vrioni që të japë dorëheqjen dyke shpresuar që me këtë mënyrë do të kulloheshe atmosfera e qelburë. Mirpo ahëre u ndjeh kriza më kritike, me qënë që cila parti ishte në pozitë të merte fuqinë në dorë». U menjtuan që për të u qetuar punërat të formoheshë një Kabinet asjatërë edhe kësisojë Këshilla e Naltë i ngarkoj barrën Pandeli Evangjelit, i cili më 16 Tetor formojti Kabinetin, i bazuar mbi besimin edhe ndihmën të gjithë partive siç i ishin zotuar.

Mjerisht, nuskat politike zunë të lozin në parasenë, dyke patur edhe Këshillën e Naltë që u hiqte spangon, kështu që për të mos u ashpëruar ca më tepër punërat u mbyll Parlamenti. Këto ngjisnin në kohën kur se Konferanca e Ambasadorëve, në Paris, e njojtë vetëqeverimin të Shqipërisë me kufitë të 1913 edhe urdhrojti Serbinë që të hiqet në kufitë të caktuara. Komisioni i Lidhjes së Kombevet, për të kqyrur gjendjen të Shqipërisë, arriti më 21 Nëntor, në Tiranë, edhe bukuroshët politikanë vazhdonin grindjen edhe çkatërimet!

Më 6 Dhjetor pra pas mezit natës një shumicë njerës të armatosur, Dibranë, Kosovës etj. rethojnë Hotelin Internacional, ku flinte Kryeministri, edhe prisnin të parën shenjë që të mbushnin detyrën e shenjtë për atdhenë!!! Më ora 2 pas mezit natës ngjiten në dhomë të Kryeministrit Hasan Prishtina, Mustafa Kruja edhe Ramis Daci, të cilët i tregojnë gjendjen kritike edhe bëjnë thirje në patriotizmë të tij për të



mos ngjarë nonjë gjakderdhje. Pandeli Evangjeli, si biseduan gjër e gjatë, u thotë që ajy ja ka dhënë dorëheqjen Qazim Koculit për të ja dorëzuar Këshillës Naltë.

I falnderojnë Pandeli Evengjelit për shëmbëllën patriotike edhe si bashkohen me Qazim Koculin, shkojnë për të dorëzuar dorëheqjen të Kabinetit në dorë të Këshillës Naltë. Këshilla ja ngarkon barrën Hasan Prishtinës i cili formojti Kabinetin. Pa mbushur as 6 dit u shtërngua edhe Hasan Prishtina të japë dorëheqjen më 11 Dhjetor nga shkaku se gjakrat u ndezë ca më tepër.

Gjendja politike kish kapërcyer çukën e krizës edhe duheshe gjendur melemi për të mbajtur gangrenën, të pakën për pakë kohë gjër mos i gjendeshe ilaçi i shërimit, prandaj vendosnë t'i dorëzojnë fuqinë Idomene Kosturit, i cili pranojti barrën dyke mbajtur Kryeministrinë vetë edhe Ministëritë t'i kqyrnin Kryesekretarët, të Ministrive, gjër të mblidheshe Parlamenti, e kësisojë u qetuan gjakrat. Parlamenti u mblloth me nxihtim të math edhe më 24 Dhjetor formojti Kabinetin Xhafer Ypi.

U pandeh që gjakrat u qetuan edhe do t'i jepnin gjithë ndihmën qeverisë për të mbushur nevojat e shtetit, aqe të brendëshmet si edhe të jashtmet, që lypnin një qetësi të plotë edhe bashkëpunimin, mirpo egoistët, intrigantët, ziliqarët edhe çkatëronjësit dëshëronin më mirë prishjen të Shqipërisë se satë mos mbushnin ambiciet edhe inatet vetiake, kësisoj që më 8 Mars 1922 pëlçet një kryengritje e madhe e cila e shpuri gjër në buzë të varrit Shqipërinë!

Në një orë kaqe të deshpëruarë edhe të rezikçme, në të cilën shkante fati i atdheut, nuku duheshin bisedime edhe këshilla prej të Honxho-Bonxhovet, dyke equr tespijet në dorë po duheshe punë, punë edhe punë! Duheshe një dor'e hekurtë që të munte të shpëtonjë atdheun, nga ky rezik i math, po qysh edhe cili guxonte?

Ahere si nga Zoti i Math i Oili e ka mprojturë edhe shpëtuarë të ngratën Shqipëri, nga shumë reziqe,



u çfaq në orizont një djalë i ri, po me një zemër prej dragua, i prikosurë me një mendje të kulluarë edhe i mbushurë plot ndjenja atdhesore mori guximin, dyke vënë jetën e tij në rezik, që t' i dalë ballë e të shpëtonjë atdheun nga ky rezik! Ky ishte një xhen, ishte një shpëtimtar i dërguar prej Qellit!

Ky djal' i ri, me kaqe guxim, nuku ishte tjetër për veç se Ahmet Zogut!

Ahmet Zogu ishte Ministër i P. të Brëndëshme edhe nuku kishte shumë kohë që kur se ishte kthyerë nga Mirëdita, ku pushojti lëvizjen, edhe nga kufitë Shqiptaro Serbe ku mundi të dërmonjë një trubullim të math, të përgatitur nga andikombëtarët me ndihmën, pa dyshim, të Serbisë. Gjith kësisoj rëmbëu hutën në dorë edhe me trimat e tij, besnikë e luftëtarë, dërmojti këtë kryengritje kaqe të rezikme për Shqipërinë. Si një leojkë, së cilës duan t' i prishin folenë edhe t' i përçajnë kiyshët, u hoth përmbi rebellet edhe i dërmojti. S' ka fjalë se u derth po fort pak gjak, në kryeqytet, po dyke i ndjekur këmba këmbës mundi t' i dërmonjë më gjithë anëtë, ku ishte përhapur kryengritja.

U zunë mjaft nga kryetarët, të cilët u dënuan me mvarje, prej Gjyqit ushtëriak edhe të tjerë u burgosnë. Hasan Prishtina me ca shokë shkuan, me improjtjen të Përfaqësuesit të Engliterës, jashtë Shqipërisë. Me këto masa të forta u qetua ç' do lëvizje kryengritëse në Shqipëri.

Edhe gjithë keto lëvizje, andikombëtare, ngjanë në ato dit kur se kishte ardhur në Shqipëri Komisioni strategjik Ushtëriak për të cakëtuar kufitë Shqiptaro-Serbe edhe Shqiptaro-Greke, pas vendimit të Ambasadorëve të Paqës në Paris.

Parllamenti, me këto ngjarje të vështira edhe të dëmshme, për atdheun, rëzojti nga Këshilla e Naltë Akif Pashën edhe Imzot Bamçin si improjtës të kundrështarëvet edhe trubullonjësvet. Dr. Turtuli me Abdi Toptanin për të protestuar kundra vendimit të Parllamentit, mbi shokët e tyre, dhanë edhe këta dorëheqjen.




Q' atëhere zuri të mbretëronjë qetësia edhe qeveria të mbushnjë detyrën e saj që t' u bënë ballë dëmeve të mëdha, që i ardhë shtetit mbi krye nga ambiciet edhe egoizmat të kundrështarëvet ose më mirë të dushmanëvet që losnin me fatin të Shqipërisë!

Më 24 Janar 1922 Parlamenti zgjodhi Këshillën të Naltë të përbërë prej Ymer Pashës Vrionit, Sotir Pecit, Refik Toptanit edhe Ndoç Pistulit.

Me gjithë këto ngjarje mos pandehin se u penduan edhe pushuan grindjet. Çaparët edhe nuskat vazhdonin të lozin në parasene, të Parlamentit, edhe në qarket politike. Tani ishte edhe një tjetër çeshtje e cila u hante mushkërinë. Trimëria e Ahmet Zogut, që shpëtoj atdheun, në vënt që t' i gëzonte i hidhëronte, me qënë se Ahmeti fitojti një famë edhe një simpathi, të patreguarë, në zemër të gjithë kombit Shqipëtar, prandaj kërkonin me lloji mënyra t' i sillnin pengime qeverisë.

Me qënë se Parlamenti zgjodhi në Këshillën e Naltë Gjon Çoben edhe Xhafer Ypin, Kryeministri dha dorëheqjen më 2 të Dhjetorit 1922, nga Kryeministria vetëm, të cilën e pranojti Ahmet Zogu bashkë me Ministrinë të p. të Brendëshme që kish. Më von u bënë ca ndryshime kesisoj: në vënt të Hysen Vrionit u emënuua Milto Titulani Ministër i Drejtësisë, në vënt të Spiro Kolekës, Ministër i p. Botore, u emënuua Seifi Villamasi edhe në vënt të Ismail Haki Tatzatit u emënuua Mustafa Aranitasi.

Me gjithë këto ndryshime prapë nuku reshtin kundrështarët. Pengime për mbi pengime i sillnin qeverisë, në Parlament, kur me pyetje për mbi njerën e tjetrën, kur për nonjë ligj xgjatnin bisedimet, vetëm e vetëm për të mërzhitur qeverinë edhe pastaj me obstrukcionizmën, për të u vënë kallaj të gjithavet. Obstrukcion kishin dëgjuar nofta vetëm, po nuku ishin enteresuar as pak, Parlamentarët tanë, që vetëm atëhere kur Qeveria del jashtë Konshtutës edhe shkel ç'do të drejtë me këmbë, po jo se u bë nonjë faj,



goftë me dashje ose padashje, nga Ministrit edhe nënëpunësit.

Obstrakcionët janë fort të ralla që ngjasën në Parlamentet Kushtutëse të botës, me qënë se një Obstruksion i paarësyeshmë nuk ka tjetër qëllim përveç se të iqet Qeveria edhe t'u thotë: Urdhroni merni vëndin tonë edhe mos beni shamatë! Përveç se në Parlament kishte ryrë edhe në Administratat një përçarje e mos bindje disiplinore, edhe për fat të keq kish kallur hundën në ushtëri!

Koha shkonte më kot kur ishin çeshtje me rëndësi për të biseduar e për të gjetur ilaçin të shërimit, të krizës ikonomike në të cilën shkonte Shqipëria.

Për mbi hallet e brendëshme kishim edhe halle të përjashtme me vrasjen të Amerikanëvet, që kishin ardhur në Shqipëri për të vizituar Shqipërinë e të mernin konçesionë. Qeveria Amerikane u vërtetua plotërisht që qeveria tonë ishte e pafajshme edhe përdori gjithë fuqinë gjer sa vravi ca nga vrasësit, që nuk jepeshin, edhe të tjerët i dënojt me varje. Më 27 Gusht, tek ktheheshin nga Janina, vritet, në prite q' i kishin bërë, Xhenerali Italian Tellini, Kryetari i Komisionit Nërkombëtar për të caktuar kufitë Shqiptaro-Greke edhe Shqiptaro-Sërbe.

Këjo ngjarje e keqe pikëllojt gjithë kombin Shqiptar e ca me tepër Qeverinë tonë me qënë që vrasja u vepërua afër kufisë tonë. Lumtërisht u vërtetua që këjo vrasje ishte vepëruarë me qëllim politik nga të tjerët edhe kësisoj shpëtuam nga nonjë konflikt diplomatik me Italinë. Shqipëtarët u helmuan pa masë për vrasjen të Xheneral Tellinit, se yshqenin një simpathi të madhe, kundrejt Xheneralit, edhe e qojt në që vrasja u vepërua më tepër kundra Shqipërisë.

Qarket politike, të Tiranës, bisedonin me nxehtësirë gjendjen të brendëshme pas dëshirave të vetase, për fat të mirë, që të gjithë ishin politikanë të mëdhënj edhe si cilido jepte e merte me teorit' e tyre, pa patur as parim as program po vetem se jam Po-




pullor ose Përparimtar etj.! Me një fjalë do të gjenjë Babilloninë të gjallë në kryeqytet!

Me Dekret të Këshillës Naltë më 30 të Shtatorit Parlamenti çpërndahet edhe populli thëritet në zgjedhje të rea për një Mbledhje Kombëtare Themeltare që të behen më 17 të Dhjetorit 1923, pas vendimit që ishte vendosur. Çpërndarja e Parlamentit edhe thirja për Mbledhjen Kombëtare Themeltare (Asamblenë) gëzojti gjithë popullin me qënë që me këtë mënyrë do të pushonin grindjet edhe më tjetër anë do t' i hidheshin themelet shtetnore të qeverimit të shtetit Shqiptar.

Kryeministri edhe Ministër i p. Brendeshme, Ahmet Zogu, me këtë rast dha një shëmbëll patriotike, si burrat e mëdhenj, i cili do të mbetet i paharuar edhe një trashëgim në të pritmet qeveritarë edhe politikanë të Shqipërisë. Dyke parë që gjithë lufta edhe veshtrimi i politikanëve, kundrështarë, ishte drejtuar vetëm kundra tij, Ahmet Zogu nuku qendrojti as pak në menjtim, po, për të mos u pandehur edhe besuar që do të sillte pengime edhe terorizma në zgjedhjet, u largua nga Ministria e p. Brendëshme dyke ja dorëzuar Seifi Villamasit, Ministrit p. Botore.

Një shëmbëll patriotike dha e një tjetër burrë i shënuar, një javë përpara zgjedhjevet. Ky është Pishkopi Noli. Me qënë që në dorëzimin e tij, në Amerikë, ngjajti një episod me Arqiepiskopin Rus, Aleksandrin, edhe populli fedak Orthodhoks Shqipëtar kishte një plenk në zemër, pranojti lutjet e popullit edhe kësisoj me ceremoni të madhe u dorëzua, ierarqisht, prej Sh. Tyre Ierotheo, Dhespot' i Korçës, përpara zyrtarëve edhe një shumicë të patreguarë nga populli. Me të u dorëzuar ju kënduan lutje me titllat që ka Dhespoti i Durrësit.

Enthusiazmi edhe gëzimi ishin të patreguara në zemrat të gjith Shqipëtarëve, të Krishterë e Muhamedanë, me veprën të shënjtë edhe patriotike që vepërojti Sh. e Tij Pishkopi Theofan Noli, Dhespot i Durrësit.



Kishin arësye që të gëzohen, se me këtë veprë Kisha Orthodhokse Autoqefale shqipe do të forcoheshe me themeltarin, kështu që bashkërisht të tri Pishkopët do të përpiqeshin t' e naltësonin Kishën Orthodhokse në themele të forta për lavdi të atdheut.

Me këtë veprë rodhë urimet nga Këshilla e Naltë, Qeveria edhe nga gjithë anëtë të Shqipërisë e mergimit. Që të gjithë shprehnin se, paskëtaj, Pishkopi Noli do të hidheshe në fushën fetare, për të cilën është prikosurë, edhe politikën militante do t'ua linte politikanëvet që janë të hedhur në këtë luftë.

Për fat të keq Korça e zgjodhi përfaqësonjës në Asamblenë, kështu që rekeja politike e hoqi me vete, për të humbur gjithë simpathinë që kish fituar, edhe, më tjetër anë, për të i sjellë dëme të mëdha edhe çkatërime, siç do të shohim, atdheut!

## KRYE E VII.

### Çelja e Asamblesë

Lufta elektorale u vepërua me një qetësi të madhe në gjithë anëtë. Në këto zgjedhje u ndjeh, për herën të parë, lufta elektorale se u përpoqnë kundrështarët midis tyre për të fituar besimin e votat të zgjedhësve. Vërtet që u përdorë dhelpërira e të taksura, gostira edhe të holla për të fituar vota më tepër cilado anë.

Pa fjalë edhe oratoritë ishin në urdhërin të ditës dyke çfaqur programë, që vetëm në ëndërat i kishin parë, për t' u mbushur mëndjen popullit që lumtëria ka për të rjedhur mbi Shqipërinë, nëqoftë se zgjithnin ata përfaqësonjës në Mbledhjen kombëtare. Edhe politikanët tanë nuku e kishin as pak për turp që të flisnin në emër të partive, të cilat natën i krijonin edhe në mëngjes na lajmëronin popullit me anën të propagandistëve. Me këtë mënyrë në ç' do qytet të Shqipërisë u formuan kaqe partira sa kapërxenin edhe Numrin të



kandidatet. Sa për Kryetarë ishin të gjithë, kështu që përnjerjesh u begatua Shqipëria!

Populli Shqipëtar sado i pastërvitur në luftërat elektorale mundi t' i kupëtonjë fort mirë, edhe të tregohet partizan i flaktë cilas do anë që i lypte votat e me këtë mënyrë përfitonte nga të gjithë.

Në Korçë e në Gjinokastrë lufta ishte m' e reptë midis partive edhe u harxhuan mjaft të holla. Këto të holla ishin nga dirsa e popullit, të atij populli që do t' i zgjithte përfaqësonjës! Edhe sikur nuku arrinte dirsa e brendëshme po edhe dirsa e Shqipëtarëve të Amerikës, që punojnë në Fabrikat, për të përkrahur politikanët e mëdhenj e të famëshme, në këto zgjedhje të Mbledhjes Themeltare! Vallë kur ka për të ardhur ajo ditë që të dijë populli të japë votën e tij për vetën e tij? ...

Me gjithë këto zgjedhjet muar funt në një qetësi të madhe më 27 Dhjetor edhe populli priste me paduhapjen të Asamblesë për të shëkuar themelet që do t' i hidheshin shtetit tonë mbi qeverimin të pritajes. Më 21 Janar 1924 hapet Asambleja edhe zgjidhet Kryetar vetërani plak Petro Poga. Vështrimi i gjithë kombit ishte drejtuar tek Asambleja, për të vështruar e dëgjuar programet, menjtimet edhe parimet që yshqenin politikanët, të cilët përfaqësonin kombin, po, për fat të zi, as gjësendi nga këto nuku çfaqnin. Për kundrazi që ditën e parë zunë pëshpërimet, të hiqen njëri prej jatrit me qëllim djallëzor, të formohen klika edhe të lozin përsëri nuskat në senën të Asamblesë!

Zilia, nakari, egoizma edhe inati i kish verbeuar më tepër se padija që përse ishin mbledhur, kështu që vetëm edhe vetëm grindje edhe me çeshtje vetjake shkonin kohën e tyre, pa u mejtuar ose u turpëruar, as pak, për barrën e rëndë edhe detyrën që kishin përpara kombit. Vetëm për të ndezur gjakrat të popullit mjerë mbanin nga nonj interpellim, për mbi gabimet të nonjë Krabinari, që të duken sa enteresohen edhe sa u dhembet Shqipëria!





Me të këtilla pengime i sillnin qeverisë ndalime në të shtruarit edhe biseduarit çeshtjet me rëndësi edhe çeshtjet themeltare të shtetit tonë. Çuka pastaj e diplomatisë, të kundrështarëvët, ishte Obstruccioni! Politikani i math, Pishkopi Noli, nuku munte të tregonte dot ndryshe programet e tij, të thella e të gjëra, përveç se me mënyrën të Obstruccionit, të cilin e kish mësuar siç duket, si Papagalloja! Dredhaniku Sulejman Delvina bashkë me susmajmunët e tjerë jepnin e merinin me metodat dhelparake, prej të shkollës vjetër Halldupe!

Nuku deshnin t' e çfaqnin, shqipëtarisht, që mënyrat e përdorimet e tyre, trashanike, të pakripura, të ndohtura edhe demprurëse nuku kishin tjetër qëllim përveç se rëzimin të qeverisë edhe të mernin ata fuqinë në dorë. Po; ky ishte qëllimi e programi edhe as gjësendi tjetër. Edhe veçanërisht e më tepër lufta edhe kundrështimi ishin drejtuar kundra Kryeministrit, Ahmet Zogut, të cilin e kishin hale në sy!

Ahmet Zogun nuku duhet të dyshonjë njeri që nuku e donin krokodillët politikanë tanë. Jo; që të gjithë e donin fort tepër, edhe me cilin do që të fjaloseshe e ngrinin në qell për virtutat e tij, po, mjerrisht, e donin me qëllim të fshehët. E donin Ahmetin që t' e kishin vegël politike edhe një fortesë të fortë që të zotëronin ata edhe t' e kishin fuqinë në dorë. Me të vërtetë i gjori Ahmet që të gjithë i nderronte edhe i dëgjonte, si djal' i ri, i papjekurë edhe i pastërviturë që të kupëtonte djalëlzit' e tyre, kështu që as pak nuku shkonte nër mënt madhështira po përpiqeshe që vetëm qysh e qysh t' i shërbente atdheut.

Mirpo këto sjellje edhe më urtësinë, patriotizmen e me theroritë që bëri dyke vënë jetën e tij përpara, për shpëtimin të atdheut, e naltësuanë kaqë tepër Ahmetin sa u përhap fama mbi gjithë anëtë edhe fitojti simpathinë të gjithë kombit. Emri pra i Ahmet Zogut kishte një adhurim të veçantë në zemër të popullit.



Ky ishte shkaku i ndalimeve, pengimeve edhe obstrukcionit q' i sillnin qeverisë në Parlament edhe në Asamble, edhe as gjësendi tjetër. Ahmet Zogu edhe vetëm Ahmet Zogu ishte tani q' i bashkojti kundërshtarët në një qëllim për të rëzuar Ahmetin, të cilin e urenin pa si e panë që nuku e fituan dot t'ë kishin për veglë mprojtëse, si cilido nga pleqtë politikanë, Krokodillë edhe Kamelionë!

Për fat të zi me propaganda e me lloji mënyra muntne të mbjellin edhe përhapin farrën e keqe e dëmprurëse, dyke bërë pasanike, këtu atje, të cilët ca me ditje ca me paditje gjyrimonin programin çkateronjës për atdheun. Edhe sot na dridhet zemra kur kujtojmë që këjo far' e zezë zuri rënjë ne Vlorë historike, ne ajo Vlorë që ngriti flamurin kombëtar, pas 500 vjet robërie!

Kurrë edhe kurrë nuku pandebte nonjë Shqipëtar që atë Vlorë me ndjenja kombëtare edhe me patriotë vetëranë, si Seit Qemali, Hamza Isaj, Qazim Kokoshi, Spiro Koleka, Qazim Koculi edhe shumë të tjerë, do të përgatiteshe një kryengritje për vëllavrasje! Mjerisht atje gjeti folenë ky qëllim kaqe i vështirë — se është turp të quajmë andikombëtar — për të i vënë një vulatë të zezë historisë kombëtare!

Në ushtëri prapë kishte hyrë përçarja e demoralizimi, nga shkaku i politikanëve, kështu që nuku njihte qeni të zotin, pa u mejtuar as pak që me këtë çkatërim humbiste kombi fuqinë shtetnor, për të cilë bënte therorira të mëdha vetëm e vetëm që të qendronte në naltësi, në disiplinë edhe asjatere prej ç' do të trazuarë në politikë. Administratat u tronditnë edhe ato nga detyrat që kishin edhe ishin ndarë dyke anuar kur ca më anën qeveritare kur ca më anën kryengritëse.

Në këtë gjendje kishin arrirë punërat prandaj për të sjellë qetësinë Ahmet Zogu preferojti që të i qet prej fuqisë edhe dha dorëheqjen me gjithë Kabinetin. Këshilla e Naltë, e cila iqte tespjet edhe nuku peshonte gjendjen kritike në të cilën shkonte Shqipëria, pranojti

dorëheqjen edhe i ngarkojti barrën Shefqet Verlacit për të formuar Kabinetin. Verlaci e formojti Kabinetin po kryengritësit nuku ishin të kënaqur edhe nuku bindeshin, as me këtë ndryshim, kështu që, për të siguruar qetësinë, qeveria emënojti Ahmet Zogun Kumandant të përgjithëshmë mbi ushtërinë pa si besimi humbi nga Kumandarët Ushtëriake, nga të cilët shumë ishin bashkuar me kryengritësit edhe nuku mbushnin urdhratat.

Kryengritësit dyke u forcuar me anën të ushtërisë zunë t' i shtojnë pretencionët edhe të dërsejnë dhëmbët kundra qeverisë. Kishin formuar e një pleqësi e cila zuri të këshillonte edhe të urdhronte, në për Prefekturat që të mos dëgjonin urdhratat të qeverisë po të bashkoheshin edhe të vepëronin pas urdhratit që do të jepte pleqësia e Vlorës!

Gjakderdhja edhe vëllavrasja ishin afruar në prapësi të erës, prandaj për të larguar një katastrofe kaqe të reziqme Shefqet Verlaci dha dorëheqjen me gjithë Kabinetin për të u gjendur nonjë mënyrë paqësore.

Formimi i Kabinetit ju dorëzua Ilias Vrionit i cili formojti qeverinë me burra asjatërë edhe përveç kësaj, dërgojti, në Vlorë, një Komision me Sami Vrionin në krye dyke u proponuar që qeveria është gati të vinjë në një marrëveshje edhe bashkëpunim të plotë, që të formohet një qeveri e zgjedhurë nga të dy anëtë.

Mjerisht kryengritësit nuku afronin në nonjë kupëtim edhe shtronin kondita të rënda me qëllim që të mos pranoheshin. Një nga konditat e para ishte të përzhurit të Ahmet Zogut, nga Shqipëria, edhe të mos ktheheshe kurrë prapë. Me tjetër anë i tureshin Tiranës me fuqi edhe dyke dashur që të marin Beratit gjejnë kundrështim nga ana e qeverisë vendiake, e cila qendronte besnike tek qeveria. Ushëtria e Beratit nënë Kumandë të Majorëvet Vei Sevranit edhe Demir Ali Areza ju kundrështua ushtërisë kryengritëse edhe kësisoj u goditnë. Lufta mbajti



2 dit edhe po të kish arrirë me kohë Osman Gazepi me 600 shpirt ndihmës do të ishin thyer kryengritësit edhe punërat do të kishin marrë tjetër ndryshim, me gjithë që nofta kësisoj shpëtojti atdheu nga nonjë gjakderdhje të madhe, dyke u përhapur mbi gjithë anëtë.

Në Shkodrë me qënë se patrioti, prej foshnjërie, Kapiten Ferit Frashëri u kundrështua urdhratave të kryengritësve u vra prej një Oficeri kryengritës. Te këtëlla e shumë të tjera vrasje edhe çkatërime u vëpëruan në shumë vënde, prandaj qeveria për të shpëtuat atdheun nga gjakderdhja edhe nga nonjë rezik më të math preferojti të largohet prej Shqipërisë dyke lënë kryengritësit t'ë marin fuqinë në dorë edhe të sundojnë Shqipërinë.

Pas 5 muaj Babillonie, grindje edhe rëmujë që kur se u hap Asambleja, pa kujtuar të shkuarat, më 15 Qershor qeveria e Ilias Vrionit bashkë me shumë partizanë shkuan për në Itali edhe Greqi, kështu që sundimi mbeti në dorë të Sotir Pecit, i vetëmi anëtar i Këshillës Naltë që kish mbeturë në Tiranë. Të fundit ishin Koço Kotta, Ministri i p. Botore edhe Mustafa Aranitasi.

Ahmet Zogu i bashkuar prej besnikëvet të tij, midis cilëvet Osman Gazepi trimi në luftërat e Devollit edhe Kolonjës Korçës kundra Grekëvet më 1914, Major Leon De Ghilardi e të tjerë muar malet e Shqipërisë edhe u hodhë në Mat. Këtu do të meresne një vendim kaqe i rezikëmë, sa vetëm Perëndia e di ç'përfundim do të kishte, për fatin të së ngratës Shqipëri, po të mos ishte Ahmet Zogu.

Me të dëgjuar që Ahmet Zogu arriti në Mat edhe kur mësuan për ngjarjet të Tiranës me vrap u mblodhë 6,000 Matjanë e të tjerë luftëtarë, besnikë të Ahmetit, të cilët kërkonin t'i tureshin Tiranës me domosdo. Frymat ishin kaqe të ndezura sa as një fuqi nuku munt që t'i përmbante edhe kësisoj do të ngjiste një gjakderdhje e vëllavrasje e tmeruarë! Lumtërisht,

patrioti i math i cili kish dhënë kaqe shëmbëlla patriotizme, dyke shpetuar atdheun nga kaqe reziqe, kur me urtësië, kur me trimërië, u mendua që do t'i vinte një katastrofë, nga më të tmeruarat, Shqipërisë, po të ishte se pranonte këtë vendim!

Me gjak ftohtësi u menjtua që do të vepëronte një krimë, të pashëruarshme, edhe do të shkelte me këmbë të veta famën edhe simpathinë që kish fituar, prej gjithë kombit, prandaj Ahmeti thiri kryetarët edhe si u falenderon i këshillon që të përndahen, për hir të atdheut, dyke u thënë kësisoj: Në është se doni Shqipërinë edhe mua atëhere u lutem tepër që të iqi në për shtëpitë edhe t'i bindi qeverisë edhe ligjevet!

Sa shpirt madhërie prej burri patrioti të vërtejti!

Ahmeti preferojti të duronjë më mirë gjithë pabesitë edhe ligësitë, të shokëvet edhe kundrështarëvet, sa të vepëronte një gjë të këtillë, e cila do t'e sillte, nofta, në fuqi po do të linte një vulatë të zezë mbi emrin e tij edhe në historinë kombëtare. U hoth pranë Serbi dyke lënë kohën edhe nevojat e shtetit që t'e thërisnin e te ktheheshe prapë në Shqipëri.

Kryengritësit, triumfallë, muar fuqinë në dorë edhe më 17 Qershor formohet Kabineti nënë kryesi të Pishkopit Noli dyke u përbërë me anetarë: Sulejman Delvina, Kasëm Qafëzezi, Luigj Gurakuqi, Rexhep Shala, Vinjahu, Qazim Koculi. Vetëm Sotir Peci, anëtar i Këshillës Naltë, u kundrështua në krye po pastaj, e dekretoj Kabinetin për të marë frymën legale, aqe më tepër për të u qetuar vendi. Me gjithë këto mori zotime që do të mblithnin Asamblenë ose do të bënin zgjedhje të rea.

Ishte natyrisht që ky Kabinet nuku u formua se bazoheshe në një program, në një qëllim edhe në një parim politik që i bashkonte për të qeverisur Shqipërinë. As nonjë nga këto nuku kishin midis tyre. I vetemi qëllim që i bashkonte ishte urejtja që yshqenin kundra Ahmet Zogut edhe as gjësendi tjetër, kështu që po t'i gërmitnje pakëzë që të gjithë Ministrit, të




këtij Kabineti, kishin si cilido nga një klike të veçantë të cilat punonin që qysh edhe qysh të zotëronte njëra për mbi tjetrën. Me të këtilla qëllime të fshehta u bashkuan, midis tyre, prandaj që ditën e parë zunë pëshpërimet edhe tryelet njëri kundra jatrit.

Populli i mjerë kishte një simpathi të madhe për Peshkopin Noli se ca me anën e berihajit, ca me oratoritë plot fjalë të nxehta e patriotike, si edhe me teoritë të gjërra, që shtronte, kish fituar një famë në Shqipëri. Gjendeshin mjaft njerës të cilët ishin kaqë të ipnotizuar sa besonin që Mesia e Shqipërisë ishte Pishkopi Noli, edhe gjithë shpresat e lumtërisë tek aju nvareshin. Ishte një punë tepër e rëndë që t'u kthenjemëndjen atyreve njerës, të berihajit, kështu që duheshe të vinte koha e të bindeshin vetë vetiu për besimin e shpresën që kishin varur.

Ata që e kishin psikologjisur edhe e njihnin për së afërmi e kishin peshuar fort mirë gjer ku e kish çapin të njojtjes diplomatike edhe politike. Aqe më tepër që nuku ishte marë me punëra qeveritare, andaj nuku dinte as qysh të vepëronte. Të qeverisurit të një shoqërie si « Vatra » e Amerikës me të qeverisurit të një shteti nuku afronet as gjëkund! Nga ana time që e kisha njojturë, prej vitesh, si në Amerikë si në Shqipëri e kisha lëftuar në menjtimet politike, kurdoherë, edhe e kisha këshilluarë të mos trazoneshe fare.

Edhe në Korçë si e në Tiranë bashkë me shumë atdhetarë të vërtetë i ishin lutur që të iqte dorë nga politika edhe të shëkonte Kishën Autoqefale shqipe, të cilën me mundime të mëdha e themelojti dyke i sjellë shërbime të mëdha atdheut. Duheshe pra si Themeltarë e Bari i Kishës Orthodhokse që të mbante këtë krabë në dorë, se vetëm kësisoj dobitë do të ishin shumë më të mëdha, që do t'i sillte kombit, edhe do të kishte një nder më të math se fronin e Kryemnistrisë.

Pranojti me gëzim lutjet edhe këshillat tona po, mjerisht, egoizma, zilia edhe nakari e shtynë në rëke-



të politikës që me këtë udhë të humbas famën edhe simpathinë që kish fituar, me dirsën e tij në luftën kombëtare. Pandehu ose më tepër u gënjye që dyke arrirë Kryeministër do të nderoheshe më tepër edhe, nofta, kish për të zënë serën më të naltë të qarkevet diplomatike, të gjith botës.

Këto menjtime edhe këto dëshira e verbuan kaqe tepër sa e humbi gjykimin edhe kësisoj u hoth në krahët të politikës, me një besim që ajy kish për të lumturuar Shqipërinë. Të dehur nga të mbushurit të qëllimit, me të marë fuqinë në dorë, nuku u përkujdeshnë as pak që të dëftenin nonjë program vepërimtar për pritmjën të qeverimit. Që në krye u duk që programi i këtij Kabineti ishte vetëm për të marë fuqinë, të mbushnjë etjen të urejtjes, kundra Ahmet Zogut, edhe as fare nonjë menjtim prë lulëzimin të atdheut.

Pishkopi Noli ishte vetëm me titllin si Kryeministër, se në punërat shtetnore, më nj'anë që nuku kishte ditje edhe më tjetër anë nga mos bashkimi i anëtarve që formonin Kabinetin, as pak nuku pyeteshe edhe si cilido Ministër vepëronte pas dëshirës të vet. Noli e kupëtojti gabimin edhe fajin të math, që kish bërë, po tani ishte vonuar edhe duheshe me dashje ose pa dashje të mbyllte sytë, të përunjesh edhe të mirte përsipër ç'do gjë që vepëroneshe nga shokët e tij.

Një nga fajet, të pandjera, që vepërojti ky Kabinet është faji kur vetë Kryeministri vajti për të përfaqësuar Shqipërinë në Lidhje të Kombeve. Këtu i solli dëm të math Shqipërisë edhe e fëlliqi krejt veten e tij, dyke u rëfyer që as në politikën të punërave të jashtme nuka është i zoti, mbi besimin të plotë e të patundur që kishin ca nga adhuronjësit të Pishkopit Noli. Kryeministri ynë pandehu që i ardhni dita që të mbushte ëndrat egoistike edhe pa nonjë gjë të keqe kërkojti, si një diplomat i math, të çfaqnjë theorit' e tij dyke kritikuar Lidhjen të Kombeve edhe Përfaqësorjësit. Me një fjalë desh të shkelnjë me këmbë gjithë diplomatinë të Europës edhe gjithë botës!




Mundet që të ishte e arësyeshme theoria e Nolit po jo si Kryeministër i një shteti, edhe ca më shumë jo përpara Lidjes të Kombevet po në nonjë mbledje të veçantë, ku munte të gjente edhe admironjës e t' o prisnin me dorëtrokitje. Këjo e rëzojti Nolin shumë poshtë, po me këtë gjë, për fat të keq, rëzojti edhe rezikojti nderin edhe enteresin të Shqipërisë. Me falimenton trashanik që dha Kryeministri u gëzuan nga shokët e tij, edhe deshnin të përfitonin që t' i marin vëndin, kështu që ishte pregafitur një propagandë për të mos e qasur në Shqipëri kur të ktheheshe nga Europa!

Pemët pra të qeverisë kryengritëse do t' i përmbledhim në këto pika: Falimento në punërat e jashtme edhe çkatërim në punërat e brendëshme!

Pik së pari formuan Gjyqet ushtëriake për të dënuar partizanët të Ahmet Zogut. Ndjekje edhe pushim nga puna të atij nënpunësi që pandeheshe partizan i Ahmet Zogut. Administratat u tronditnë të gjitha, qetësia e pasiguruarë edhe gjithë punërat vinin rëmuje, në vënt të drejtoneshin siç besonte e priste populli. Ushtëria, e cila duheshe të qendronte në naltësi, e paanëshme edhe mprojtëse e çdo reziku, që t' i vinte atdheut, u demoralizua dyke kallur politikën, kështu që qindi miliun (100,000,000) franga ar që kish shtrydhur dirsën e tij populli i mjerë, për këtë ushtëri, shkuan për dhjamë qeni!!!

Klikat politike, për të shkretuar Shqipërinë, laheshin midis tyre për kryesinë njëra mbi tjetrën, kësisoj që vepëronin cilado pas dëshirës edhe enteresit të vet që të fitonte partizanë më shumë.

Një nga veprat më të shënuara e të bukura, të kësaj qeverie, është ligji që bëri për të goditur kundrështarët. Ky ligj satrapik, dalë nga mëndja e të etu arvet kundra urejtjes, ka për të mbetur një turp edhe vulatë e zezë për Sekullin të 20<sup>te</sup>! Ligji, si për sigurimin të shtetit, thotë: kundrështarët, të rexhimit (qeverimit) sotmë euternohen!





Me të këtilla masa satrapike deshnin t' i vinin kruzmen Shqipërisë edhe t' e transferonin në nonjë satraplek, pa patur të drejtë as nonjë Shqipëtar që të guxonte t' u kundërshtoheshe, se me vrap enternoheshe ose dënoheshe. Sotir Peci, anëtar i Këshillës Naltë, dyke parë që këjo rugë e shpinte Shqipërinë në varrim të sigurtë, e shtrëngoiti qeverinë që të bënë zgjedhje Parlamentare edhe të marë formën legale e Konshtutese, se tjetërsoj do t' i bënte një thirje drejt për drejt kombit. Të shtrënguar vendosnë për zgjedhje Parllamentare edhe jo për Mbledhje Kombëtare Themeltare (Asamble).

Në të këtillë gjendje ndodheshe shteti ynë edhe kush e di ku do arrinte nga qeveritarët e ditës, të cilët, të çkujdesur nga ikja e Ahmetit e kishin xveshur robën edhe maskën të patriotizmës edhe ishin hedhur tani në dëfrime, dyke nisur që nga Kryeministri Noli edhe gjer në Kasëm Qafëzezi që të mësonin tromponën, kur si rufeja lajmëronin që Ahmeti zuri të shkundnjë këmbët. Këjo lajmë, e pa pritur edhe e pabesuarë, u prishi qetësinë bukuroshëvet edhe me vrap zunë të marën masat, për të ju kundërshtuar Ahmetit që të ktheheshe në Shqipëri.

Me këtë rast përfituan të mjerët sundimtarë që të hidhen, si korbet në kërmat, për mbi të mjerën Shqipëri e t' e shkretojnë, varfërojnë edhe rëmojnë! Si cilido që të ishte, nga të huajt, pandehte që Shqipëria ishte në prag të luftës me lëvizjen ushtëriake që vepëroheshe. Tekdo që të shkonje edhe udhëtonje nuku shëkonjë tjetër gjësendi përveç se fuqira ushtëriake që mblidheshin në kufitë Shqiptaro-Serbe. Shtrëngime të mëdha e të repta u vunë më gjithë anëtë për të mbledhur ushëtri pa pyetur moshën ose ç' farëdo, nga konditat e shendetësisë edhe pas regullit të ligjit ushtriak. Gjithë automobillat, qeret, arabatë edhe kuajt u vunë në shërbim të ushtërisë, për të transportuar municionet edhe ushtarët në kufi. Qytetet zjenin nga Oficerët të fabrikuar me një orë e sipërë, dyke dhënë



një pamje lufte edhe që të dëftenin ca më mirë fuqin'e tyre çpallë rethimin ushtëriak, që kësisoj t' u shtinin tmerin popullin edhe atyreve që të guxonin të flisnin edhe kundrështoheshin !

Po përveç lëvizjes ushtëriake, nga e cila vetëm Perëndia e di ç' u vepëruan, doli në shesh, ku ish mbyllur, zanati i vjeter i Tyrqisë, Arxhet edhe Arxhet ! E gjora Shqipëri ! Duheshe të duronjë ato që nuku kish hequr as nga armiqët, me të këtilla masa, vetëm e vetëm për të i rjepur lëkurën edhe t' e shkretinin. Larot kaqe prisnin që të ringjalleshe zanati i arxhevet (fuqi i mbledhur me të holla) që të vraponin si qenat e kasapanavet, për të marë pjesë në shpëtimin e atdheut !!! Katillëk m'i math se i arxhevet nuku munt që të bëhet. Me përdorimin, të këtij zanati, që të mos thomi shërbimi se është turp, vepërohen gjithë hajdutëritë, prandaj janë gati në ç' do orë që të kesh nevojë për kryetarë të arxhevet, se mo këtë zanat të bukur rjepet lëkura e popullit varfër nga dy anë. Nga njëra anë dyke paguar, pas kalemit edhe haterit, për 50 shpirt 500-1000 edhe nga tjetra anë dyke rjepur e plaçkitur popullin qetësor !

Me këto masa edhe shtrëngime qeveria mblodhi një fuqi prej 15-20000 vetash në kufitë Shqiptaro-Sërbe për të ju kundrështuar Ahmet Zogut që të rynte në Shqipëri. Me një fjalë kombi Shqiptar u dënua, për të mbushur egoizmat, inatet vetiake edhe urejtjet të ca njerësve pa ndjenjë atdhesorë, të paguanjë miliunë edhe miliunë lira Engleze, edhe jo franga, përveç gjakderdhjes, midis vëllazërisë, edhe rëmujes të Shqipërisë !

Këta janë pemët të qeverisë Noli e cila në një kohë, prej 5 muaj sundimi, mundi t' i sjellë dëmet më të mëdha Shqipërisë, sa të përmbliidhen gjithë dëmet q' u vepëruan nga gjithë Ministritë e shkuara se, nuku bëjnë as një të pesëdhjetën ! Përveç dëmeve marrëzore ishte edhe reziku i math në të cilin po e xvarosnin Shqipërinë !





## KRYE E VIII.

### Proklamimi i Republikës Shqipëtare

Ahmet Zogu i hequr më nj'anë, në Serbi, dëshëronte të rijë i qetë e të dëgjonte lumtëri e mbarësi për atdheun e tij të dashur. Dëshëronte nga zemra që të shëkonte vepra themeltare, prej qeverisë kryengritëse, edhe ndjente një gëzim të math, në veten e tij, që të kqyrte për së largu gabimet edhe fajet që kishte, nofta, vepëruar, sa kohë që sundojti ajy vetë Shqipërinë.

Besonte që largim' i tij, prej Shqipërisë, do t' i beheshe një shkoll' e naltë, për pritmjen të atdheut, se më nj'anë do të argaseshe në politikë, kur të shëkonte burrat e rahur e të pjekur qysh dinë të suudojnë shtetin, edhe më tjatër anë do të munte të piqeshe ca më mirë dyke njojtur cilët ishin shokët edhe bashkëpunonjësit e tij besnikë.

Me të vërtejt, për Ahmet Zogun, ky largim u bë një shkollë e naltë, se përfitojti kaqe shumë sa vallë do të kish përfituar nonjëherë kaqe fort, me qënë që pësimet ju bënë mësimë edhe nga ay Ahmet Zogu i ri duhëshe të dalë Ahmet Zogu Plak që të ringjallë Shqipërinë, dyke i shtruar themele të forta e të çelnikta. edhe të verë në serë të shtetevet të botës të qytetëruarë!

Në vënt që të dëgjonte nonjë lajmë të mirë edhe gazmore, nga atdheu, për kundrazi dita me ditën lajme të zeza dëgjonte edhe shëkonte, kështu që i copëtoheshe zemra edhe i pikëlloheshe shpirti prandaj, dyke psherëtitur, menjtohet thellë, vetë vetiu, edhe thotë: Shqipëria po shkretënet së gjithash edhe unë po ri në Beligrad! Mos më durofsh o Zot, bërtet, edhe me vrap mori vendimin të fundit: vdekja më mirë edhe vetëm e vetëm shpëtimi i atdheut! Q' atë orë shtron pllanin të vepërimit edhe mbleth shokët e tij besnikë, të aratisur në Serbi, Itali edhe Greqi, edhe u çfaq pllanin.



edhe vullnetin e tij, të patundur, që do të niset për shpëtimin të Shqipërisë.

Shokët e tij politikanë, si Xhafer Ypi, Shefqet Vërlaci, Ilias Vrioni, Koço Kotta e të tjerët, mbetnë të habitur me guximin të Ahmetit, po ç' do këshillë që t' i jepnin ishte e kottë, prandaj i shtrënguan dorën që Zoti t' e mpronjë nga ç' do rezik edhe daltëfaqebardhë. Me vrap Ahmeti mer shokët luftëtarë, midis cilëvet edhe Major Gjilardin, edhe shkon për në malet e Shqipërisë.

Lajmëja që Ahmet Zogu shkeli në malësi të Shqipërisë u përhap si vetëtima edhe në thirje të tij vrapuan përnjeherjesh jo vetëm Matjanët po edhe Mirditas, Dibranë e Kosovës gati që të derthnin pikën e fundit të gjakut për Ahmet Zogun edhe për shpëtimin të atdheut. Me gjithë që Ahmet Zogu e dinte fort mirë fuqinë të madhe, q' i kish vënë për ballë qeveria në gjithë anët e kufive, po këjo nuku i bënte nonjë përshtypje as q' e frikësonte prandaj, si mbledhi kryetarët, si i madhi Skënderbeu shtron pllanet për goditje

Njëhere pllanet të caktuara Ahmet Zogu u lutet edhe i këshillon që të përpiqen me sa t' u jetë e mundurë të largohen nga gjakderdhja, midis vëllazërisë, edhe nga ç' do dëm që munt t' i ngjiste popullit. U përndahnë që të gjithë për të marë kumandën e pjesës së tij, që ju ngarkua si cilit do, edhe Kumandanti i përgjithëshmë i vepërimit, Ahmet Zogu, mbajti për vete grykën e Matit, Gur' e Bardhë.

Plani i goditjes u përgatit kësisoj: Ahmet Zogu me 12.000 shpirt mbajti për qendër Peshkopinë dyke patur me të djathtë Shtetin Madhor, nënkryesi të Majorit Leon de Gjilardi, të njojturin luftëtar kundra Grekëve, në Kolonjë edhe Devol të Korçës 1914. Ceno Kryeziu me 3.000 shpirt mori anën e Lumës, Shkodrën me 1.400 shpirt, Malo Bushati edhe Salahedin Bloshti me 700 shpirt mori qafën e Thanës.

Në të dhënit të shënimit, prej Kolonelit Ahmet Zogut, për përparimi nga gjithë anëtë ushtëria e gj-



thë fuqitë qeveritare u gjetnë përpara një reziku të math edhe tmeri i math i pushtojti kështu që q' do kundrështim ishte i kottë Oficerët iknë dyke lënë ushtërinë pa nonjë kumandë kështu që gjakderdhja ishte e pakëtë, nga të dy anëtë.


Ceno Kryeziu pati kundrështimin më të math po dyke lëftuar burrisht munda t' i thyenjë edhe t' i vërrë përpara e t' i çakërdisnjë andej këtëj dyke mos qëndruar dot gjëkundi.

Goditjet u ndezë me gjithë anëtë, po pllanin strategjik të Ahmet Zogut nuku e kupëtonin dot Kumandarët të ushtërisë regullshme, të qeverisë, prandaj qeveria lajmëronte, zyrtarisht, popullin edhe botën e jashtme që kryengritësit i dërmojti ushtëria edhe po i ndjek këmba këmbës gjer në kufi Shqiptaro-Sërbe. Qeveria i kish me të drejtë qarkoret që jepte se, pas lajmeve edhe sigurimit që i jepte Shteti Madhor, besonte siç besonte edhe vet Shteti Madhor që fituan luftën edhe kryengritësit u aratisnë.

Ahmet Zogu gëzoheshe se vështronte që pllan' i tij po plotësoheshe, pas programit që kish shtruar, me qënë që qëllim' i tij ishte që kundrështarët t' i mbante në ato vënde, ku të besonin e pandehnin se gjithë fuqia e Ahmet Zogut atje qendronte. As fare edhe kurr nuku e shkonin nër mënt që Ahmet Zogu mbante një fuqi jashtë luftës e cila do të rynte në Tiranë në të parën shenjë që do t' u jepte.

Këjo fuqi po rinte e fshehtë në grykë të Matit, dyke pritur urdhërin e Kumandantit Math, i cili si një strategjik i mbaruar jepte e merte më të gjithë anëtë.

Kur beson që ardhi koha e duhur urdhëron fuqinë në të grykës Matit të dalë në qafë të Murisit 6 orë lark Tiranës! Me mos pandehur kurrë që do të guxon-te rynte nga këjo anë nuku ishin përkujdesur që të linin nonjë fuqi të madhe, prej të ushtërisë, prandaj në çfaqjën të kësaj fuqie, të Ahmet Zogut, një tmer e një panik i zapëtojti aqe qeveritarët e politikanët,



në Tiranë, si edhe gjithë ushtërinë kur mësuan këtë plan të papandehur edhe të pa pritur kurrë të kurrës!


Qeveritarët me nxitim të math mblodhë katrafuzët edhe shkuan për në Vlorë, ku, nofta, të shtronin të tjera plane për mprojtjen. Me gjithë frikën që kishin me vete, nga hieja e Ahmet Zogut, nuku haruan që bashkë me Arqivat të shkundin edhe arkat të shtetit. Shenjtëria e Tij Pishkopi Noli, Kryeministri, nuku munte që të ndaheshe nga Tromponi edhe kështu e mori me vete, për të haruar brengat edhe hidhërimet të ditës!

Oficerët, njeri pas jatrit, muar trajstat edhe shkuan edhe ata për në Vlorë që të keshilloheshin me qeverinë edhe të mernin masat e duhura nën urdhërin të Ministrit Math të luftës, Kasëm Qafzezit!... Të pakë Oficerë mbetnë në luftë, midis cilëve Shefqet Korça, po edhe këta dyke parë që ç' do kundërshtim ishte i kottë muar udhën e Vlorës dyke lënë ushtërinë të përndarë e pa kumandë, që të aratiseshin në për male si zoqt' e korbit!

Me gjithë këto ngjarje, të pashëmbëlta, edhe me katastrofën që pësuan, bukuroshët Qeveritarë, pa pikë turpi, deshin edhe nga Vlora të jepnin urdhërime e kumanda në për Prefekturat me seriozitë sikur me të vërtejt ata ishin sundimtarë. Edhe, pa tallje, besonin që përsëri do të ktheheshin në Tiranë dyke varur shpresën me të madhe tek Bajram Curi edhe tek Isuf Elezi, të cilit përveç Arxhevet q'i dhanë me këtë rast i paguan edhe arxhet q'i kishin mbetur, pa paguar, që në kohë të Mbretit 1914!

Më këto ëndërimë po mereshin qeveritarët, në Vlorë, kur më 24 Dhjetor fuqia e Ahmet Zogut, pas një përpjekje të vogëlë e pa nonjë dëm, rëzohet edhe ryn në Tiranë, të cilën e muar nënë mprotje dyke regulluar një shërbim qeverimi të hëpërhëshme.

Me 25 Dhjetor ryn vetë Ahmet Zogu, si kumandant i Përgjithëshmë i Operacionit me gradon Kolonel, edhe u prit me entuziazmë të madhe nga ana e popu-



llit. Lajmeja e rikthimit, në Shqipëri, të Ahmet Zogut u prit me gëzim të math nga gjithë populli, i cili i mërzitur nga një qeveri ilegale ishte tepër dëshpëruar, prandaj rikthimi i Ahmet Zogut e ngushëllojti dyke i mbushur zemrën plot shpresë për një pritje të lumturë.

Qeveria ilegale edhe çkatëronjëse, e cila ka për të mbeturë një pasqyrë për gabimet, fajet, dëmet edhe gjakderdhjet për inatet edhe egoizmat vetiake, mblodhi lekat edhe si shkundi arkat e shtetit shkojti në Itali më 26 Dhjetor 1924. Bashkë me qeverinë shkuan edhe Klikashët e mëdhenj, Mustafa Kruja edhe Bahri Omari me tarafet e tyre, për të organizuar partitë Radikale edhe Intelektuale!

Mjerisht me marrëzinë të këtyreve bukuroshë ishtë thënë që të gënjenen edhe t' i gjyrmojnë një shumice e madhe prej njerës politikanë, nëpunës edhe për mbi 400 Oficerë. Midis këtyreve ishin më të shumët të pafajshmë, po të gënjyer e të bindur në urdhërin e të mëdhenjvet e nuku bënë tjetër përveç se të mbushin detyrën, kështu që nga frika u hodhë në Itali, ku duheshe të lajnë mekatat e bukuroshëve. Edhe në këtë rebesh duheshe që të ndjente kombi edhe një hidhërim të math se u trazuan, me dashje ose pa dashje, ca burra kombëtarë vetëranë edhe burra shtetnorë, si Sotir Peci, Seit Qemali, Luji Gurakuqi, Hil Mosi, Qazim Kokoshi, Spiro Koleka, Kole Tromara, Jashar Zavalani e shumë të tjerë të rinj, nga të cilët atdheu priste edhe pret shërbime.

Nga krerët, të cilët u përkujdesnë të mbushin xhepet, për shërbimin të math e të paharuar q' i suall atdheut, u hodhë në dëfrimet edhe të mjerën Shqipëri e haruan, të tjerët mbetën në për rugat e Italisë si mos më keq!

Të këtillë përfundim mori qeveria ambiciose edhe e urejtjes nënë Kryesi të Nolit, i cili, për të arrirë qëllimin të egoizmës tij trashanike, shkeli me këmbë gjithë nderimet q' i kish dhënë kombi edhe, për çpajim, çkatërojti Shqipërinë!





Ahmet Zogu me të marë fuqinë në dorë, si Kumandant i përgjithëshëm i Operacionit, i bën një thirrje popullit dyke e këshilluar në qetësi edhe të shohë punën e vet si cilido, kështu edhe Prefekturavet u drejtoj qarkëtove dyke u hequr verejtjen që të shëkojnë punën edhe të mbushin detyrën, plotërisht, se janë përgjigjës për ç' do faj ose gabim që të vepëronet në Prefekturat e tyre. Me të vërtejt q' atë orë, që kur se u lajmërua rikthimi i Ahmet Zogut, mori përnjerësh ngjyrën e parë qetësia e vëndit, edhe cilido u hoth në punërat e veta.

Shumë, nga partizanët që simpathizonin edhe kishin bashkëpunuar me qeverinë ilegale, kishin edhe frikë se pandehnin mos ndiqeshin për kundrështarë po as nonjë ndjekje e këtillë nuku u vepërua, dyke lënë lirin' e plotë të gjykonjë si cilido, në të drejtat e ligjit.

Koloneli tonë, Ahmet Zogu, me të u qetuar vëndi krejt, deshe të tregonjë kalorësin' e tit fisnike edhe të japë shëmbëll patriotizme, shëmbëll bindje përpara ligjevet edhe kështu pas 10 dit sundimi, ushtërisht, si Kumandanti i Përgjithëshëm i Operacionit, xveshi robot ushtëriake edhe bashkë me kllëcin e lutën të tij, pa si nvari në peronë për kujtim i dorëzoi fuqinë në dorë Këshillës naltë, më 4 Janar 1925 që të rynjë shteti në udhën legale.

Ja shëmbëll patriotizme! Ja shëmbëll prej burri të math edhe shpirt Madhështori!

Ay që shpëtojti e ringjalli Shqipërinë edhe kur munte me kllëcin në dorë të sundonte, nuku desh se nuku ja pranonte shpirti edhe zemra atdhësore edhe madhështore. kështu që si ç' do nënështetas edhe ushtar i thjeshtë qendrojti gati në zërin të atdheut, për të i shërbyer me mish edhe me gjithë shpirt!


Xhafer Ypi, mbetur i vetëm anëtar i Këshillës Naltë, pa ndenjor në menjtime të thella, i ngarkojti barrën Ahmet Zogut, të vetëmit burrë që kish nevojë kombi, për të formuar Kabinetin dyke patur Ministër Myfit Libohovën, Petro Pogën edhe Koço Kottën.



Me largimin të Ahmetit, nga Shqipëria, kombi ynë përfitojti kaqe shumë sa, nofta, edhe me therorira vallë do të kish arrirë që të shëkonte kaqe dobira të mëdha, nga ky largim, me qënë se Shqipëria fitojti një xheni, një burrë shteti të math, të mbaruar edhe dorëçelniktë. Po; burri i math edhe dorëçelniku i Shqipërisë, i cili ishte dorëzuar prej Zotit Math që t' i hedhë themelet e forta e të çelnikta, ishte trimi i trimavet edhe guximtari i pashëmbëlltë Ahmet Zogu!

Kohën nuku e shkojti më kot e në dëfrime, si shumë të rinj, po në studime edhe studime të gjërra e të thella sa kohë që ndenji në Beligrad. I prikosur vertejt natyrisht me xgim, si e me diturinë që kish marë në shkollat po këto nuku i mjaftonin pa bërë e një praktikë, dyke u trazuar me burra politikanë të mëdhenj e të rahur gjithë jetën e tyre me politikën, kështu që mundi të përfitonjë shumë. Më tjetër anë edhe në Shqipëri pësimet ju bënë mësimë edhe ishte mjaft argasur që të psikologjiste në cilën kategori qendronte atdheu i tij, i dashur, edhe qysh duheshe vepëruar që t' e siguronjë mbi një themel të fortë e të çelniktë edhe t' e verë në sërën të gjithë kombevet të qytetëruara.

Prandaj me të marë Kryeministrinë me vrap ju vërvit punës edhe, në një kohë të shkurtër, të munde të habitnjë botën me veprat e tij shtetnore e të çudigme. Pik së pari i shëroj Shqipërisë gangrenin dyke desformuar ushtërinë, e cila thëthinte dirsën e popullit edhe në vënt që t' i shërbente atdheut i solli dëmet më të mëdha, me demoralezimin edhe politikën që kish adoptuar. Përveç këtyre për shtetin Shqiptar nuku duhet as pak që të mbanjë një ushtëri të madhe me kaqe spenzime, se është e ditur që Shqipëria nuku munt të lëftonjë dot me as nonjë mbretëri fqinjë ose tjetër. Për Shqipërinë duheshe që në krye reforma e Ahmet Zogut, një Xhandarmari e organizuarë në degën e fundit të përparimit edhe një ushtëri të vogël, vendiak, dyke shërbyer 6 muaj për ushtrim siç u votua.



Më 17 Janar u hap Asambleja edhe pa shkuar kohën me bisedime, të kota, edhe çeshtje vetiake u muar me bazën themeltare të qeverimit të shtetit Shqipëtar. Si biseduan edhe studiuuan hollësisht, nga ç' do pikëpamje, cili qeverim është m' i mirë edhe m' i pëlqyer, për Shqipërinë, pranuan, votuan edhe proklamuan Republikë!

Dita 21 Janar 1925 do të mbetet e shenjtë edhe historike, për kombin Shqipëtar, me qënë që në këtë ditë u proklamua *Republika Shqiptare!*

Gëzimin e math edhe rëndësirën, të kësaj dite historike, e ndjehu edhe e çfaqti gjithë kombi Shqipëtar, i cili nga entuziazmi ishte si i dehur me të mësuar këtë lajmë gazmore e cila u përhap si vetë-tima më gjithë anëtë të Shqipërisë edhe në gjithë botën. Festimet mbajtnë tri ditë e net dyke dëfryer e dyke kënduar. Në për Kishrat e në për Xhamitë u benë Të Deume (Lutje) për këtë ditë dyke ju lutur Perëndisë që t' e ketë nënë mprojtje Republikën Shqipëtare që të përparonjë edhe të ronjë sa të jetë bota. Kësisoj u festua këjo ditë e shenjtë edhe historike, e cila ka për të mbetur trashëgim në trashëgimtarët të Shqipërisë. Zërin të popullit Shqiptar i cili arrinte në qell, do t' e dëgjonjë i Madhi Zot, prandaj bashkë me atë zë që buçiste bashkonj edhe unë lutjet e zërin tim edhe nga thelbi i zemrës e bëtas: Roftë! Roftë edhe Roftë Republika Shqiptare! Amin.

Gjithë bota u lajmërua për proklamimin të Republikës Shqipëtare edhe u prit me gëzim të math që edhe Shqipëria ryri në sërën të shtetevet të qytetëruara. Qeveritë përgëzuan me telegrame të nxehta Kryeministrin të Shqipërisë, Ahmet Zogun, dyke çfaqur dëshirën që kanë për të ndihmuar e përkrahur Republikën e re që të rynjë në sërën të qytetërimit edhe përparimit.

Me të u proklamuar Republika Shqipëtare përnjerjesh Shqipëria mori një ngjyrë tjetër, në qarket Diplomatike edhe Kapitaliste. Me vrap u çfaqnë Kom-



panira të mëdha dyke kërkuar Konçesione për vaj gurin, Minerale, Banka edhe të tjera. Qeveria bashkë me Asamblenë pranuan një Konçesion të vaj gurit edhe formimin të Bankës kombëtare, e cila ishte m' e nevojshme nga të gjitha. Kësisoj zunë të zbulohen begatitë të Shqipërisë edhe nuku mbetet përveç se në dorë të Qeveritarëve edhe gjithë Shqipëtarëve që të hapin sytë e të punojnë me zell që të shohin edhe t' e lenë prapa tyre një Shqipëri të lumturë, *brez pas brezi!*

Asambleja, dyke punuar pa reshtur, me kujdes të math kqyrte edhe si i bisedonte Njëjtë të Konshtutës më 31 Janar 1925 zgjodhi Ahmet Zogun të Parin President të Republikës Shqiptare, në mest të entuziazmit e dorëtrokitjevet që nuku mernin pushim me bërtitje: Rroftë Presidenti! Rroftë Ahmet Zogu! Rroftë pritnja e lumtërisë!

Asambleja me këtë zgjedhje mundi të përfaqësojë, me të vërtetë vullnetin edhe dëshirën të gjithë kombit Shqipëtar, me qënë që burri i math i Shqipërië, si cili ka fituar simpathinë edhe zemrën të tij është Ahmet Zogu. Prandaj me të u përhapur sihariqi gazmor, në të gjithë anëtë, populli nuku dinte qysh të çfaqte gëzimin e tij. Me të gjithë anëtë nuku tingëlonte në hapësirë përveç se buçim i zërravet që bërtitnin: Rroftë! Rroftë edhe Rroftë Ahmet Zogu!

Lutje në për xhamite edhe Kishrat u bënë me ceremoni të madhe dyke ju lutun Zotit Math për të Parin President të Republikës Shqiptare. Nuku kish gojë e tjetër në për popullit përveç se të lavdëronin Zotin që u fali Republikën edhe President Ahmet Zogun, tek i cili kanë vënë gjithë shpresën të Shqipërisë, prandaj dita 31 Janar u festua me kaqe bujo edhe me kaqe entuziazme të madhe.

Kish edhe ka arsye të plotë populli që të entuziazmohet për të shtrenjtin, të çkëlqyerin, dorëçelnikun edhe burrin të math të Shqipërisë, me qënë se Ahmet Zogu përmbledh gjithë virtutet që të qendrojnë mbi Fronin Presidential, për mbi të cilin meritat e tij, të



fituara me theroritë që shtrojti mbi alltarin të atdheut, edhe vullneti i kombit e hipnë atje Nalt për të udhëhequë frenat të Republikës Shqiptare.

S'ka dyshim që tek Ahmet Zogu, Presidenti i Republikës, do të gjejmë Ahmet Zogun që kur se u hoth në luftën kombëtare, Ahmetin që mori anë në Kuvent të Lushnjës, Ministër, shpëtimtar, Kryeministër, Kolonel, Burrin të math edhe ringjallësin të Shqipërisë!

Bashkonj edhe unë lutjet edhe zërin tim edhe nga thelbi i zemrës bërtas: Rroftë Republika Shqiptare! Rroftë shpresa, burri i math edhe dorëçelniku Ahmet Zogu, i Pari President i Republikës Shqipëtare! Rroftë! Rroftë edhe Zoti i Math e mproftë edhe ndimofhtë për lumtërinë të Shqipërisë. Amin.

FUNT

